ANDREA LLUKANI

KISHA NË DIKTATURË
(1945-1990)

Tiranë, 2019

© Të gjitha të drejtat janë të autorit

Redaktor: **Prof. dr. Hajri Shehu**
Recensues: **Dr. Moikom Zeqo**

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje……5

KREU I PARË
KISHA NË DIKTATURË
(1945-1967)

1.1-Arrestimi i Visarion Xhuvanit dhe i Irine Banushit……47
1.2-Vizita e delegacionit kishtar në Moskë……...……...51
1.3-Dorëzimi i Paskal Vodicës në gradën peshkopale
dhe shkarkimi i Kristofor Kisit…….53
1.4-Dekretligji mbi komunitetet fetare……....58
1.5-Kongresi III i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë……...59
1.6-Vizita e Paisit në Moskë dhe vizita e peshkopit Nikon në Shqipëri…….69
1.7-Krijimi i Sinodit të Shenjtë……...….72
1.8-Përpjekjet për bashkimin e kishave…….....75
1.9-Zëvendësimi i Nolit……...77

KREU I DYTË
PERSEKUTIMI I KISHËS
(1967-1990)

2.1-Klerikët të sistemohen në punë……..82
2.2-Zëvendësimi i të kremteve fetare me festa socialiste……84
2.3-Dekreti për ndyshimin e emrave……87
2.4-Pasojat e përndjekjes…….89
2.5-Propaganda ateiste…….……94
2.6-Persekutimi i klerit……97
2.7-Kishat e shpallura monument kulture……..105
2.8-Kisha e nëndheshme…….109

KREU I TRETË
RINGJALLJA E KISHËS
(1990-1991)

3.1-Shërbesat e para në Korçë……114
3.2-Mbajtësit e Kryqit…….115
3.3-Rihapja e kishës së Shën Spiridhonit në lagjen Goricë të Beratit……116
3.4-Rihapja e katedrales së Ungjillëzimit në Tiranë……..118
3.5-Vizita e atë Arturit……..…..121

KREU I KATËRT
DOKUMENTE

4.1-Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Berat 1922.....123
4.2-Rregullorja e Kishës Shqiptare.....125
4.3-Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Korçë 1929.....126
4.4-Rregullorja e Administrimit të Përgjithshëm të Kishës.....136
4.5-Akti i dorëheqjes së Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqiërisë,
Fortlumturisë së Tij, Visarion Xhuvanit.....145
4.6-Tomi Patriakal dhe Sinodik mbi bekimin e Autoqefalisë
së Kishës Orthodhokse në Shqipëri.....152
4.7-Tomi Patriarkal dhe Sinodik për krijimin e Episkopatës së Gjirokastrës.....155
4.8-Visarion Xhuvani i kërkon falje Patriarkanës Ekumenike.....157
4.9-Ligji nr. 743, datë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”.....161
4.10-Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 1950……...166
4.11-Rregullorja mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës……177
4.12-Rezolucioni i Kongresit III të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.....190
4.13-Kushtetuta e Republikës Populllore të Shqipërisë, Tiranë 5 korrik 1950
(Nene që lidhen me komunitetet fetare).....194
4.14-Dekret Nr. 3030, datë 21.01.1960 “Mbi aprovimin e ndryshimit të
paragrafit të dytë të Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë”.....195
4.15-Dekret Nr. 3660, datë 10.04.1963 “Mbi disa ndryshime në
dekretin Nr. 743, datë 26.11.1949 Mbi komunitetet fetare”……..196
4.16-Dekret Nr. 4337, datë 13.11.1967 “Mbi çfuqizimin e disa dekreteve”……197
4.17-Vendim Nr. 6, datë 15.1.1963 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës
“Mbi shpalljen e monumenteve të kulturës”…….198
4.18-Dekret Nr. 5339, datë 23.09.1975 "Mbi ndërrimin e emrave dhe
të mbiemrave të papërshtatshëm".....199

Burime arkivore……...……..200
Bibliografi……..202
Tabela e ilustrimeve……...208

HYRJE

Libri “Kisha në diktaturë” përmban historikun e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë (nga vitet 1945 deri në vitin 1990). I pari që ka shkruar për historinë kishtare të Shqipërisë ka qenë Imzot Theofan Noli, (Fig.1) i cili botoi veprën "*Historia e Krishterimit në Shqipëri*". Vite më vonë teologu Dhimitër Beduli përgatiti studimin “*Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*”, e cila e pa dritën e botimit në vitin 1992 dhe është botim zyrtar i K.O.A.Sh-it. I treti që ka shkruar rreth kësaj teme është autori i këtij studimi, i cili në vitin 2002 ka botuar “*Krishtërimi në Shqipëri*” (nga vitet apostolike dhe deri në ditët tona). Që nga viti 2002 ky libër ka pasur disa ribotime, duke u përmirësuar ndjeshëm. Libri “*Krishtërimi në Shqipëri*” nuk ka qenë botim zyrtar i K.O.A.Sh-it, por vetëm një përpjekje vetjake e autorit, për të dhënë vlerat historike të ortodoksisë shqiptare dhe përpjekjet e saj për autoqefali. Në vitin 2012 autori i këtij studimi ka botuar “*Kisha në diktaturë*”, që është një libër i thjeshtë me të dhëna elementare dhe pa u thelluar në çështje të caktuara. Këtë e diktonin kushtet e kohës kur u shkrua dhe pamundësia e autorit për ti shkuar gjërave deri në fund.

Ja vlen të përmendim punën e miqve të mi të përkorë Nos Xhuvani dhe prof. em. dr. Pavli Haxhillazi, të cilët mundën të botonin veprën e Visarion Xhuvanit në vitin 2007. Kohët e fundit ka pasur dy përpjekje serioze për të botuar studime të mirëfillta rreth periudhave të caktuara të historisë së kishës shqiptare. I pari është dr. Ardit Bido, cili në vitin 2016 ka boruar dizertacionin “*Kisha Ortodokse Shqiptare, një histori politike (1878-1937)*”. Në vijim dr. Artan Hoxha më 2017 ka botuar “*Kisha Ortodokse nën Komunizëm, KOASH-i dhe regjimi diktatorial shqiptar, 1945-1967*”. Rreth kësaj teme ka shkruar teologu Pirro Kondili dhe është duke përgatitur dizeratcionin ish studenti im, Thoma Shkira. Për të qartësuar lexuesin po bëj një retrospektivë të shkurtër të përpjekjeve të patriotëve shqiptarë për të fituar autoqefalinë e Kishës Ortodokse. Përpjekjet për shqiptarizimin e Kishës Ortodokse lindën dhe u kultivuan në kolonitë e diasporës shqiptare.

Në Sh.B.A. Theofan Noli u dorëzua në gradën priftërore në moshën 26 vjeçare në këto rrethana historike. Kisha nuk kishte varrosur një shqiptar me emrin Kristo Dishnica në varrezat e Kishës së Shën Gjergjit në Boston. Ky incident ka ndodhur vërtet dhe daton më 25 gusht të vitit 1907, por në atë kohë prift në atë kishë nuk ishte një grek, por një sirian. Ky i fundit duke parë çertifikatën e lindjes së Kristo Dishnicës, e cila thoshte “lindur në Turqi, fshati Korçë”, nuk kishte pranuar që ta varroste, sepse sipas tij ai ishte mysliman. Në atë kohë të gjitha dokumentet e shqiptarëve mbanin vulën e Perandorisë Osmane. Kristo Thimo Dishnica u varros pa asnjë ceremoni kishtare. Kjo ngjarje shkaktoi zemërimin e shqiptarëve të Masaçusetsit, të cilët vendosën të kishin një prift shqiptar. Në këto rrethana Nolit i lindi dëshira për t’u bërë misionar i krishterimit dhe në vitin 1908 u dorëzua prift nga

mitropoliti rus i Nju Jorkut, Platoni në katedralen e Shën Nikollës, sipas rekomandimit të atë Aleksandër Hotovickit dhe atë Jakob Grigorievit[1].

Mesha e parë në gjuhën shqipe u celebrua më 22 mars 1908 prej Atë Theofan Nolit në sallën e "Kalorësve të Nderit" në Boston të SH.B.A. Liturgjia Hyjnore e përkthyer nga Atë Theofani tingëllonte shumë bukur në gjuhën shqipe dhe kuptohej nga besimtarët e pranishëm. Po atë ditë shqiptarët u mblodhën në sallën "Feniks" dhe themeluan Kishën Ortodokse Shqiptare të Shën Gjergjit. Kryekisha e Shën Gjergjit në Boston është themeluar më 22 mars të vitit 1908 dhe është kisha e parë ortodokse shqiptare në Amerikë. Grupi nismëtar për themelimin e kryekishës së Shën Gjergjit përbëhej nga patriotë shqiptarë me ideale të larta ardhedashurie. Disa prej tyre qenë: Nikolas Kristofer, arkëtar, Xhorxh Toli, sekretar, Filip Vasili, ndihmëssekretar, Misto Millona, Harri Kaçka, Xhon Kozma, Kosta Racka etj. Klerikët që kanë meshuar në gjuhën shqipe në këtë kishë kanë qenë: Atë Theofan Noli, Atë Naum Çere, Atë Damian Angjeli, Atë Stathi Melani, Atë Nikolas Kristofor, Atë Dhosi Katundi, Atë Thimi Theodhosi, Atë Vangjel Çamçe, Atë Vani Çani, Atë Krist Elli, Atë Artur Liolin etj. Meritë për mbledhjen e fondeve për blerjen e katedrales së Shën Gjergjit ka Arkimandriti Thimi Theodhosi[2]. Më 17 nëntor të vitit 1918 atë Theofani mori ofiqin e arkimandritit prej episkopit rus Aleksandër në Katedralen e Shën Nikollës, ndërsa më 25 shkurt të vitit 1919 në mbledhjen e përgjithshme kleriko-laike të kolonive shqiptare të SHBA-së, arkimandrit Theofani u propozua si kandidat për episkop. Me inisiativën e tij, më 20 korrik 1919 Kisha Ortodokse e diasporës shqiptare të Amerikës u shpall e pavarur.

Në Rumani. Në janar të vitit 1907 u themelua shoqëria "Bashkimi", nga shkrirja e të gjitha shoqërive që ndodheshin në Bukuresht. Eksponentët kryesorë të kësaj shoqërie qenë: Anastas Lakçe, Vangjel Çeço, Spiro Maçuka, Kristo Luarasi, Sotir Peçi etj. Më 1909 shqiptarët e Bukureshtit të udhëhequr nga Nikolla Naço[3] mundën të hapnin një kishë për shqiptarët. Anëtarët e kolonisë mblodhën fonde për ndërtesën e kishës[4] dhe për pagesën e meshtarit. Si kishë u zgjodh Shën Gjergji i

---

[1]-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 348; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 17; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 45; Koço Bihiku, *Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 32; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 71; Mehmet Gëzhilli, *Fan S. Noli*, Argeta LMG, Tiranë 2003, faqe 20.

[2]-Andrea Llukani, *Mesha e parë në gjuhën shqipe*, Le Radici, Anno 10, nr. 2, Aprile 2012, pagina 8.

[3]-Nikolla Naço (1843-1913) qe zgjedhur kryetar i Shoqërisë "Drita" në Bukuresht. Prej vitesh kishte punuar për themelimin e shkollave shqipe dhe për përkthimin e librave në gjuhën shqipe. Që në vitin 1893 në Bukuresht funksiononte shkolla normale shqipe nën drejtimin e Nikolla Naços, e cila financohej nga familja rumune Butulesku. Për ngritjen e shkollës Naço u përgëzua nga Mihal Grameno. Nikolla Naço ka vdekur në Bukuresht, më 24 prill të vitit 1913. Hysni Myzyri, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008, faqe 1804.

[4]-Stefanaq Pollo, *Problemi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare gjatë Rilindjes*, *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 26.

Vjetër[5], ndërsa si meshtar caktuan atë Harallamb Çalamanin.[6] Komuniteti ortodoks i Bukureshtit iu drejtua Mitropolitit të Ungro-Vllahisë, Athanas Missionescut për të marrë leje, që të meshonin në gjuhën shqipe. Mesha e parë në gjuhën shqipe u celebrua më nëntor 1909, ndërsa në 6 dhjetor 1909 u formua Komuniteti Ortodoks Shqiptar i Bukureshtit[7].

Gjithashtu me fondet e grumbulluara u ble një organo dhe u sigurua pagesa e drejtuesit të korit të kishës, që ishte një nga muzikantët e njohur prof. Kiriak.[8] Në mbajtjen e meshës së parë në gjuhën shqipe më 1909, pa dyshim kori kishtar i kolonisë shqiptare të Bukureshtit ishte pjesë e saj. Shqiptarët e Bukureshtit kishin korin[9] kishtar dhe kishin marrë me qira një sallë që bënin provat. Përveç këngëve patriotike shqiptare, kori mësoi edhe himnin e Rumanisë, i cili titullohej "Mbi flamurin tonë".[10] Shqiptarët e Rumanisë të entuzjazmuar prej këtij himni iu lutën Asdrenit që t'i përshtaste vargjet në gjuhën shqipe. Asdreni përshtati fjalët shqipe sipas melodisë së himnit rumun dhe tekstin e titulloi "Betimi mbi flamur". Ky himn u popullarizua shumë tek shqiptarët e Bukureshtit dhe mbërriti në atdhe me anën e Tashko Ilos dhe Hilë Mosit. Këta të fundit sollën partiturat e himnit në Korçë dhe më pas e përhapën në gjithë Shqipërinë. Hilë Mosi, i cili kishte prirje për muzikë bëri përshtatjen e himnit në gjuhën shqipe sipas muzikës rumune. Ky himn ka shoqëruar ngritjen e flamurit në Vlorë, më 28 nëntor të vitit 1912.

Më 5 nëntor 1912, Ismail Qemali mblodhi patriotët shqiptarë në hotelin "Continental" të Bukureshtit, ku diskutuan për pavarësinë e Shqipërisë. Ismail Qemali në fjalën e tij theksoi "Tjetër shpëtim për Shqipërinë nuk ka, përveçse të gjenden ca atdhetarë me guxim dhe bashkë me mua të hyjmë në Shqipëri dhe të kasnecojmë vetëqeverimin e saj".[11] Një dokument që mban datën 5 nëntor 1912 bën fjalë për mbledhjen historike të shqiptarëve të Bukureshtit, nën kryesinë e Ismail Qemalit.[12]

---

[5]-Meshimi në kishën e Shën Gjergjit të Vjetër zgjati deri në vitin 1911, atëherë kur Sinodi që drejtohej nga Mitropoliti Pimen i Moldavisë u dha shqiptarëve kishën e Shën Nikollës në rrugën Academici. Kisha e Shën Gjergjit të Vjetër ishte në zemër të Bukureshtit. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 20; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 46.

[6]-Arkimandrit Harallamb Çalamani ishte me origjinë nga Berati dhe vinte nga Patriarkana e Stambollit. Ai u zgjodh meshtari i komunitetit shqiptar të Bukureshtit. Arkimandrit Harallamb Çalamani mbërriti në Bukursht në gusht të vitit 1909.

[7]-*Aktiviteti i shqiptarëvet në Rumani*, Dituria, Nr.3, 1 janar 1927, faqe 87-89.

[8]-Kiriak Georgesku (1866-1929) ka qenë profesor në Konservatorin e Bukureshtit. Punën e prof. Kiriakut më vonë e vijoi Ionesku, një djalë 25-vjeçar, që ishte specializuar për këngë korale kishtare.

[9]-Kori përbëhej nga 30 vetë. Ndër ta mund të përmendim vëllezërit Dhimitër dhe Grigor Zografi, Dhimitër Kalakuçi, Ilia Teodoru, Pandel Durmishi, Rafail Anastasiu, Andrea Alizoti, Jani Danga etj.

[10]-Himni kombëtar i Rumanisë është shkruar nga poeti Ioan Barsan dhe është kompozuar prej Ciprian Porumbeskut. Valbona Karakaçi, *Himni kombëtar i shqiptarëve*, Naimi, Tiranë, 2009, faqe 98.

[11]-Ilir Ikonomi, *Pavarësia. Udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, Tiranë, 2012, faqe 74.

[12]-Proces-verbali i mbledhjes së Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit, të mbajtur nën kryesinë e Ismail Qemalit, ku u vendos mbi masat që do të merreshin për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë: "5 nëntor 1912. Duke pasur parasysh rrezikun e madh në të cilin ndodhet sot gjendja e Shqipërisë dhe duke marrë shkas nga ardhja e Z. Ismail Qemal Beut në Bukuresht, të nënshkruarit pjesëtarë të Kolonisë Shqiptare të këtushme, u mblodhën sonte nën kryesinë e Z. së Tij të vështrojnë e të përkujdesen se me ç'mënyrë e me ç'masa mund t'i bëjnë ballë gjendjes së sotme e të përpiqen që të mos shkelen të drejtat

Ismail Qemali, sikurse njoftonte gazeta "Universul" (Gjithësia), e datës 22.10.1912, kishte mbërritur në Bukuresht një ditë më parë. Në mbledhjen e drejtuar nga Ismail Qemali, morën pjesë Luigj Gurakuqi, Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni), Akile Eftimiu, Dhimitër Berati etj. Pra shpallja e pavarësisë dhe formimi i Qeverisë së Parë Kombëtare Shqiptare janë vendosur në Bukuresht.[13] Mbledhja e Bukureshtit ngarkoi Ismail Qemalin dhe delegacionin e tij të kontaktonte me përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha dhe të merte aprovimin për shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit të ri shqiptar.

Më 15 shkurt të vitit 1915 Kolonia Shqiptare e Rumanisë, u njoh zyrtarisht si institucion i mirëfilltë. Komiteti Ekzekutiv i saj përbëhej nga: Pandeli Evangjeli (kryetar), Vasil Zografi (nënkryetar), Aleks Stavre Drenova e Dhimitër Berati (sekretarë), Rafail Anastasi (arkëtar). Anëtarë qenë: Ilo Kosturi, Mark Qiriazi e Thanas Kantili. Të gjithë qenë përkrahës të zellshëm të qeverisë kombëtare shqiptare, që doli fill pas Shpalljes së Pavarësisë, duke dërguar në atdhe arka të shumta me rregullore dhe akte të ndryshme të administratës rumune, të cilat do t'i shërbenin qeverisë shqiptare për organizimin e ri administrativ të Shqipërisë së pavarur.

---

e kombit e të Atdheut tonë. Pasi të gjithë të mbledhurit e përgëzuan dhe iu falën nderit Z. Ismail Qemal Beut që deshi të mbetej për ca ditë në mes tyre e t'u jepte këshillat e tij të vlefshme, mbi veprimin që duhet të bëjnë për të ndihmuar Atdheun në rrezikun që ndodhet. Z. Ismail Qemal Beu u foli për gjendjen e Shqipërisë dhe masat që duhet të marrin shqiptarët për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ndër të tjera, u kujtoi edhe se lufta që duhej të bënin kishte si shkak të sipërfaqshëm lirinë e të krishterëve të Turqisë, prandaj mund të dilte një rrezik për kombin shqiptar. Lipsej, pra, që shqiptarët, të cilëve nuk u kishte sjellë kurrë ndonjë pengim a kundërshtim ndryshimi i besës, të lidheshin edhe më tepër me njëri-tjetrin, të luftonin e ta mbronin veten si shqiptarë e për shpëtimin, njohjen e forcimin e kombësisë së tyre. Me këtë të vërtetë të njohur e të praktikuar nga të gjithë shqiptarët, u bashkuan tërë të mbledhurit: ata theksuan se themeli e qëllimi i lëvizjes së tyre kishte qenë e do të mbetej thjesht kombëtar. E morën pastaj fjalën zotërinjtë Kristo Meksi, Akile Eftimiu, Athanas Kantili, Dhimitri Zografi, Luigj Gurakuqi e të tjerë. Të gjithë, si për vete e në emër të shokëve të tyre, thanë se kishin shpresë e besim të plotë në udhën që u tregoi Z. Ismail Qemal Beu e do të bënin sa të ishte e mundur për t'u përpjekur me gjithë shpirt e me të gjitha mënyrat për shpëtimin e Atdheut. Bashkë me të tjerët u bashkua edhe zoti Anastas Miho, i cili në fillim u tregua i dëshpëruar nga mungesa e një organizimi të mirë në Shqipëri. Zotërinjtë Dhimitër Berati e Milto Sotir shprehën dëshirën të venë në Shqipëri e të punojnë bashkë me ata që do të përpiqen për këto qëllime. Shqiptarët e Bukureshtit, që kurdoherë kanë qenë të parët në luftën kombëtare, të zgjedhin një komitet prej disa vetësh, të cilët të jenë në lidhje me komitetin e brendshëm e me qendrat e tjera të shqiptarëve të jashtëm dhe të bëjnë atë që mundet për të ndihur e për të mbrojtur Atdheun në ditën e sotshme". Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 71, Dosje 1, Nr. 71.283. *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Nëntor 1912-Janar 1914*, përpunuar e redaktuar nga Dhimitër Kotini, Xhavit Struga, Fane Veizi, Mediha Shuteriqi, Kleanthi Dedi, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore, Tiranë, 1963, faqe 25-26.

[13]-Në procesverbalin e 6 nëntorit 1912, ndër të tjera lexojmë. " … Vendimet e marra nga mbledhja që është mbajtur dje në mbrëmje, janë: Kolonia Shqiptare e Bukureshtit, e cila ka punuar një kohë të gjatë mbi terrenin e çështjes kombëtare shqiptare, të zgjedhë një këshillë prej disa personave, të cilët do të jenë në lidhje me këshillin nga Shqipëria e me shoqëritë e tjera të mërgimit, si dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i mbrojtur interesat e popullit shqiptar në momentet aktuale. Pas fjalimeve që janë mbajtur nën kryesinë e z. Ismail Qemal Beut, në bazë të votave, janë zgjedhur personat e mëposhtëshënuar: P. Evangjeli, Ilia Kosturi, Thanas Kantili, Vasil Zografi, Kristo Meksi, Dhimitër Emanoili, Akile Eftimiu, Asdreni, Dhimitër Ilo. Mbledhja njëzëri ka shpallur si kryetar nderi z. Ismail Qemal Beun dhe si anëtar nderi z. Luigj Gurakuqin".

Lidhja Orthodhokse. Sekretar i shoqërisë "Drita" ka qenë Mihal Grameno[14], i cili pasi u kthye në atdhe më 1 shkurt të vitit 1909 themeloi në Korçë shoqërinë "Lidhja Orthodhokse"[15]. Mbledhja u zhvillua në shtëpinë e Tasi Ilos. Lidhja Orthodhokse zgjodhi pleqësinë: Kryetar, Mina Frashëri, nënkryetar, Mihal Grameno, arkëtar Thoma Adam dhe sekretar, Pandeli Cale. Gjithashtu anëtarë të pleqësisë qenë: Thoma Eqimi, Ilo Furçi, Llambi Ramiz dhe Llambi Bilbili. Në vijim u miratua kanonizma e Lidhjes Orthodhokse. Menjëherë një përfaqësi e Lidhjes Orthodhokse shkoi në Mitripoli dhe i Kërkoi Mitropolitit të Korçës që priftërinjtë Ungjillin, Apostullin dhe Paqësoret ti lëçisin në gjuhën shqipe. Përgjigjja e Mitropolitit të Korçës ishte se nuk mund ta lejonte këtë gjë nëse nuk kishte miratimin e Patriarkanës Ekumenike. Kjo shoqëri patriotike botoi gazetën e përdyjavshme fetare dhe letrare, nëpërmjet së cilës zhvilloi propagandën e saj. Qëllimi kryesor i kësaj shoqërie atdhetare ishte përdorimi i gjuhës shqipe nëpër shërbesat fetare. Shumë shpejt kjo shoqëri krijoi degët e saj në Elbasan, Durrës, Berat e gjetkë[16].

Në Bullgari me pjesëmarrësit e kolonisë së Sofjes u formua shoqëria "Dëshira". Veprimtaria e shoqërisë "Dëshira" është e lidhur ngushtë me shoqërinë "Drita" të Bukureshtit. Shoqëria patriotike "Dëshirë" u themelua nga emigrantët shqiptarë më 1 janar 1893, në Sofje të Bullgarisë. Këtë e thonë vargjet e këngës të shkruar nga Spiro Garo "Që më një të kollozhegut, u formua shoqëria". Qëllimi i saj ishte përhapja e diturisë dhe gjuhës amtare në Shqipëri. Kjo shoqëri patriotike forcoi edhe më shumë miqësinë ndërmjet popullit shqiptar dhe atij bullgar. Shoqëria patriotike "Dëshirë" në vitin 1897 ngriti shtypshkronjën "Mbrothësia", ndërsa në vitet 1897-1915 botoi revistën "Kalendari Kombiar".

Në vitin 1904, anëtarët e saj vendosën të kishin flamurin e shoqërisë së tyre, sepse "flamuri ishte nektari i një shoqërie" dhe rreth tij do të mblidheshin anëtarët e saj. Për realizimin e flamurit kontribuan të gjithë. U mblodhën rreth 45 napolona ari dhe flamuri u qëndis nga Polikseni Luarasi. Flamuri është përdorur për herë të parë më 15 gusht 1904 në festën e Shën Mërisë, gjatë një manifestimi të anëtarëve të Shoqërisë patriotike "Dëshirë" në rrugët e Sofjes. Gjatë manifestimit Pando Llazar Treni valëviste flamurin, ndërsa banda frymore e qytetit e ngrinte edhe më lart

[14]-Atdhetari Mihal Grameno (1871-1931) ka lindur në Korçë. Në moshë të re emigroi në Bukuresht, ku u lidh me shoqërinë "Drita". Ai ka qenë luftëtar i çetës së vëllezërve Çerçiz dhe Bajo Topulli. Më 1909 mori pjesë ën Kongresin e manastirit. Ai ka qenë publicist dhe themelues i gazetave "Lidhja Orthodhokse" (1909-1910) dhe "Koha" (1911-1926). Gjithashtu ka botuar librat "Oxhaku", (1904-1905) "E puthura", (1909) "Varri i pagëzimit" 91909) etj. Thanas Gjika, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008, faqe 782-783.

[15]-Stefanaq Pollo, *Problemi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare gjatë Rilindjes, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 27.

[16]-Vepror Hasani, *Rrofshin priftërinjtë e Elbasanit, të parët që iu lutën Zotit shqip*, Standard, 19 tetor 2013, faqe 18-19; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 16; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 44; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 73-74.

entuzjazmin e manifestuesve. Të pranishmit këndonin: Që më një të kollozhegut, / U formua shoqëria / U formua brenda ndë Sofie / Për skoli ndë Shqipëri[17].

Flamuri mbërriti në Shqipëri në vitin 1930, gjatë vizitës së një përfaqësie të Shoqërisë patriotike "Dëshirë" në atdhe. Delegacioni erdhi në rrugë tokësore në drejtimin Bilisht-Korçë-Librazhd-Elbasan-Durrës-Tiranë. Përfaqësia e Shoqërisë patriotike "Dëshirë" përbëhej nga: Kryetari Z. Llazar Janko Grabova, nënkryetari Z. Sherif Terova, kryetari i degës, Z. Jovan Treni, kryetari i degës II, Z. Dhimitër Toska, kryesekretari, Z. Thoma Luarasi, sekretari, Z. Jorgji Prifti, këshilltari i kontrollit, Z. Adham Shkaba dhe anëtarit të këshillit administrativ. Z. Kollumbi. Nga Korça drejt Tiranës përfaqësia u shoqërua nga i përndershmi Mitrofor Vasil Marku. Më 31 mars 1930 përfaqësia e Shoqërisë patriotike "Dëshirë" ia dorëzoi flamurin mbretit Zog I. Ky i fundit urdhëroi që flamuri të ekspozohej në Muzeun Kombëtar në Tiranë[18].

Më 22 nëntor të vitit 1902 u çel shkolla shqipe e natës, të cilën e drejtonte Kosta Jani Trebicka, i cili në atë kohë ishte zgjedhur kryetar i shoqërisë "Dëshira". Kjo shoqëri patriotike zhvilloi një veprimtari të gjerë përsa i përket botimit të librave në gjuhën shqipe sipas alfabetit që kishte caktuar Shoqëria e Stambollit. Bashkëpunëtorët e shoqërisë "Dëshira" qenë: Asdreni, Jani Vruho, Mihal Xoxe, Petro Nini Luarasi, Mihal Grameno, Hil Mosi, Loni Logori, Kristo Luarasi, Josif Bageri, Spiro Dine, Dhimitër Mole, Kosta Jani Trebicka etj.

Me krijimin e shtetit shqiptar më 28 nëntor 1912, Kishës Ortodokse të Shqipërisë i lindi e drejta për të kërkuar autoqefalinë. Tashmë Shqipëria ishte e pavarur nga Turqia[19], kështu që kërkesa për autoqefali ishte e natyrshme. Duke u nisur nga parimi: "Kishë e pavarur në shtet të pavarur" në Shqipëri nisën përpjekjet për krijimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Më 1919 erdhi në Shqipëri për të ofruar shërbimet e tij arkimandrit Visar Xhuvani, (Fig.2) i cili u prit shumë mirë nga banorët e Elbasanit[20], Tiranës[21], Kavajës dhe të Pogradecit. Tek arkimandriti i ri

[17]-Vangjo Ilo, *Një nga ata, Libri II*, Tiranë, 2008, faqe 37.

[18]-Frederik Stamati, *Për flamujt e Muzeut Kombëtar*, Streha, Tiranë, 2019, faqe 33-34; Frederik Stamati, *Flamuri i shoqërisë "Dëshira" si u bë pronë e Muzeut Kombëtar*, Shqiptarja.com, 18 shkurt 2018, faqe 18.

[19]-E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me vendet e tjera të Ballkanit, të cilat sapo u shkëputën nga Turqia formuan shtetet e tyre dhe rrjedhimisht edhe kishat e tyre u shkëputën nga Patriarkana Ekumenike. Kështu pati ndodhur me Kishën Ortodokse të Rusisë, e cila e fitoi autoqefalinë në vitin 1771, me Kishën Ortodokse të Greqisë në vitin 1883, me atë të Serbisë më 1880, të Rumanisë më 1856 etj. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 7.

[20]-Pleqësia e Elbasanit i ka dërguar një letër qeverisë ku shkruhej: "Të ndershmes Qeverisë sonë të Durrësit, çdo zyre të çdo pleqësie të Elbasanit, Durrësit, si dhe çdo shqiptari si dhe shenjtditunisë së tij Visar Xhuvani. Nga ana e klerit dhe e popullit tonë njoftojmë se më 29-XI-1919 Atë Visarioni hypi në fronin e shenjtë dhe kështu u vendos të jetë Arqimandrit i Elbasanit, Tiranës, Kavajës, Shpatit, Pogradecit dhe gjithë krahinave të tyne. Letrën e firmosin personalitetet e kohës. Sa thamë kemi besim se Atë Visar Xhuvani do ta pranojë punën e sipërme për të mirën e vendit dhe të fesë sonë. Kryetari i Pleqësisë Z/mitropolit Papa Dhimitri". Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 152, Dosja nr. 1011, viti 1921.

[21]-Ortodoksët e Tiranës u mblodhën dhe pasi biseduan vendosën sipas propozimit të Arkimandrit Visar Xhuvanit të shpallin vetëqeverimin kombëtar të Kishës së Shenjtë Ortodokse të Shtetit Shqiptar dhe të organizohet sa më shpejt një mbledhje e përgjithshme panortodokse kishtare me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të gjithë klerit ortodoks. Banorët ortodoksë të Tiranës i kërkuan Arkimandrit Visarion Xhuvanit, të vepronte në çdo vend dhe për çdo punë që duhej për realizimin e vendimeve të marra dhe

ata panë plotësimin e dëshirës së tyre, që meshimi të bëhej në gjuhën shqipe, prandaj e emëruan “Arkimandrit të përgjithshëm dhe predikonjës i Elbasanit dhe Shpatit”. Më 1920 Visar Xhuvani u njoh edhe nga qeveria e Durrësit[22]. Arkimandrit Visari futi shërbesat në gjuhën shqipe në kishat e Durrësit, Kavajës dhe të Elbasanit[23]. Veprimtaria patriotike e Xhuvanit në shërbim të çështjes kombëtare dhe të meshimit në gjuhën shqipe tërhoqi vëmendjen e Fan Nolit, i cili e përshëndeti me anën e një letre[24], që daton më 7 mars 1920. Gjithashtu edhe Kongresi i Lushnjës që u mbajt më 20-31 janar 1920 e mbështeti veprimtarinë atdhetare të arkimandrit V. Xhuvanit, duke e zgjedhur anëtar të Këshillit Kombëtar. Xhuvani mori pjesë aktive në organizimin e shtetit të ri shqiptar[25] dhe të Kishës Ortodokse Kombëtare Shqiptare.

Në nëntor 1920 erdhën në Shqipëri për të ofruar shërbimet e tyre atë Vangjel Çamçe dhe atë Vasil Marku. Synimi i tyre ishte ngritja nga themeli i Kishës Ortodokse Shqiptare. Më 3 prill 1921 ata celebruan një meshë në gjuhën shqipe në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë. Në liturgjinë hyjnore morën pjesë atë Vasil Marko, atë Vangjel Çamçe dhe atë Gjergji meshtari i kishës së "Ungjillëzimit". Më 16 prill 1921 atë Vasil Marko dhe atë Vangjel Çamçe celebruan një meshë në gjuhën shqipe në qytetin e Pogradecit. Bashkëmeshtarë qenë klerikët e Pogradecit, atë Thanasi dhe atë Nastasi. Meshimet vijuan më 28 prill të vitit 1921 kur atë Agathangjel Çamçe (Fig.3) dhe atë Vasil Marku (Fig.4) celebruan liturgjinë e parë në gjuhën shqipe në kishën e Shën Gjergjit[26], në qytetin e Korçës. Me rastin e nëntë vjetorit të shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1921 në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë arkimandrit Visar Xhuvani celebroi një meshë, ku veç besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën pati edhe përfaqësues nga autoritetet zyrtare të vendit si anëtari i Këshillit të Lartë, Abdi bej Toptani etj. Në përfundim të liturgjisë hyjnore arkimandrit Visar Xhuvani shpalli krijimin e Kishës Vetëqeverimtare Orthodhokse Kombëtare. Theofan Noli nuk ishte i pranishëm në kishën e "Ungjillëzimit" në Tiranë, sepse kishte shkuar për të festuar përvjetorin e pavarësisë në Vlorë. Sipas Dr. Ardit Bidos nisja e shpalljes së autoqefalisë shenjonte mënjanimin e Nolit[27].

---

të kërkonte përkrahjen morale e materiale për të gjitha punët me rëndësi fetaro-kombëtare. Banorët ortodoksë iu lutën qeverisë të merrte në konsideratë vendimet e tyre. Për të qenë sa më i plotë vendimi, parësia e ortodoksëve të Tiranës caktoi edhe Këshillin Hierarqik me kryetar Arkimandritin e Ortodoksëve Dr. Visar Xhuvanin dhe anëtarë: Papa Jorgji Rusi, Papa Simon Athanasi. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 152, Dosja nr. 111, viti 1921, faqe 138.

[22]-“Vendim. Tue marrë parasysh atdhetarinë e tregueme të Z. Arkimandrit Visarion Xhuvani u vendos që zotnia e tij, sipas kërkesave të popullit të Elbasanit, Durrësit, Kavajës etj, të emnohet Arkimandrit i Ortodoksëve”. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 63, Dosja nr. 1011, viti 1921, faqe 9.

[23]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 64-65; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 15.

[24]-Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 3.

[25]-Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 142.

[26]-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë, 2003, faqe 348-349; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 85-86; Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 161.

[27]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 109-110.

Më 9 dhjetor 1921 Noli, i shoqëruar nga deputetët Leonidha Frashëri dhe Agathokli Xhitoni bëri një vizitë në qytetin e Korçës, ku u prit mes një entuzjazmi të madh të besimtarëve. Më 10 dhjetor Noli drejtoi mbledhjen e Pleqësisë Kishtare, ku u vendos ndryshimi i emrit nga "Bashkësia Orthodhokse Greke e Korçës", në "Bashkësia Orthodhokse Shqiptare e Korçës". Më 21 dhjetor 1921 Noli meshoi në kishën e Mitropolisë së Korçës, por dy klerikë nuk pranuan të merrnin pjesë në meshë, sepse Noli celebroi meshën peshkopale, ndërkohë që nuk ishte shpallur ende peshkop. Gjithashtu edhe deputetët Agathokli Xhitoni, Koço Tasi dhe Sotir Peci e cilësonin veprimin e Nolit të nxituar dhe përdhosje të fesë. Sipas deputetëve Noli duhej të merrej vesh me deputetët ortodoksë, si përfaqësuesit ligjorë të bashkësisë, të priste sa të bëhej kongresi kishtar, i cili do të propozonte të niste një dërgatë në Patriarkanën Ekumenike, e cila do të caktonte dy peshkopë që do të dorëzonin Nolin në gradën peshkopale[28].

Kongresi i Beratit. Nismëtari për mbledhjen e kongresit ishte kryetari i Bashkisë së Durrësit, Kostë Paftali. Ky i fundit duke u nisur nga qëllimi i mirë për eleminimin e përçarjes[29] midis ortodoksëve shqiptarë[30] mori nismën, që të organizonte kongresin. Për këtë qëllim u dërgoi telegrame[31] qarqeve ortodokse të prefekturave dhe nënprefekturave të Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit dhe Shkodrës. Çdo rreth zgjodhi dy delegatë dhe u tregua kujdes i veçantë që ata t'i përfaqësonin denjësisht. Peshën më të rëndë nga ana organizative dhe kanonike e mbajti Visarion Xhuvani, si njohës i mirë i kanoneve kishtare dhe i ligjeve të shtetit, si anëtar i Këshillit Kombëtar i zgjedhur nga Kongresi i Lushnjës.

Më 10 shtator të vitit 1922, në sallën e shkollës qendrore të qytetit të Beratit, u mblodhën delegatët e kongresit kishtar[32], që ishin dërguar nga ortodoksët e

[28]-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 14, Dosja nr. 130, viti 1922, fl. 1.

[29]-Noli nuk mori pjesë në Kongresin e Beratit, që të mos kishte përplasje midis rrymave kishtare. Qëllimi i kongresit ishte që të bindte Patriarkanën Ekumenike të pranonte një përfaqësi nga kisha shqiptare për të diskutuar për çështjen e dhënies së autoqefalisë. Prandaj në marrëveshje me qeverinë Noli qëndroi i mënjanuar, sepse pjesëmarrja e një episkopi të vetëshpallur do të ngjallte reagimin e Patriarkanës Ekumenike. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 115.

[30]-Dy rrymat midis delegatëve të kongresit qenë: 1-Fanolistët, që përfaqësoheshin nga delegatët e Mitropolisë së Korçës atë Josif Qirici, Dhosi Havjari, atë Jorgji, Anastas Çekrezi, Oshënar Sofroni, Dhimitri Ndini, atë Vangjel Çamçe, Thomo Prifti, Stathi Kondi, Vasil Zoto, Vasil Marku etj. 2-Përkrahësit e Visar Xhuvanit qenë: Gjergj Manushi, Kostë Paftali, Leonidha Nishku, Rist Gjybabiç, Gjok Nikolliç etj. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 118.

[31]-Në telegram shkruhej: "I nënshkruemi tue marrë parasysh përçamjen dhe mosmarrëveshjet që po vazhdojnë ndërmjet vëllezënve shqiptarë ortodoksë mbi çashtje që i përkasin kishës ortodokse, me që kjo gjendje po damton jo vetëm çashtjen fetare ortodokse por damton rreptësisht edhe shtetin tonë shqiptar si dhe kombin, po marr leje me i propozue vëllezënve shqiptarë që të formohet sa ma parë nji kongres për me shërue këtë plagë të hapun dhe në mbrojtje të dinjitetit si komb e si fe". Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 647, Dosja nr. 206, fl. 1-2.

[32]-Delegatët qenë sipas rretheve: Korça - Ikonom Papa Josifin dhe Dhori Havjarin. Pogradeci - Atë Vasil Marku dhe Thanas P. Kërxhallin. Bilishti - Atë Josifin dhe Anastas Çekrezin. Kolonja – Oshënar Sofronin dhe Dhimitër P. Ninin. Leskoviku – Atë Vangjel Çamçen dhe Thanas Priftin. Berati – Perikli Konën dhe Dhimitër Tutulanin. Fieri – Loni Xhoxhën dhe Dhimitër Qilicën. Durrësi – Arkimandrit Visar Xhuvanin dhe Gjergji Manushin. Përmeti – Dr. Kondin dhe Vasil Kotën. Vlora – Tol Arapin dhe Jani Seranin. Lushnja – Tun Gjergjin dhe Llazar Bozon. Kavaja – Pal Xhumarin dhe Andrea

prefekturave dhe të nënprefekturave për të paraqitur letër kredencialet. Për verifikimin e tyre u zgjodh një komision i posaçëm me kryetar Perikli Konën, sekretar Vasil Llapushin dhe anëtarë atë Vangjel Çamçen, Stathi Kondin dhe Taq Budën.

Mbas një pune serioze dhe cilësore përgatitore, Kongresi (Fig.5) u mblodh në sallën e shkollës së Mangalemit ditën e hënë më 11 shtator 1922. Kryetari i komisionit të mandateve Perikli Kona ia dha fjalën Kryetarit të Bashkisë së Beratit, i cili u uroi të pranishmëve mirëseardhjen. Mbas fjalës përshëndetëse të iniciatorit Kostë Paftali e mori fjalën përfaqësuesi i qeverisë Zenel Prodani, mbas tij arkimandrit Visarion Xhuvani dhe mbas tij delegati i Pogradecit, atë Vasil Marku[33]. Punimet e Kongresit u kryesuan nga atë Josif Qirici nga Korça në shenjë respekti për atë qytet që ishte pararendësi i përpjekjeve për autoqefalinë e kishës shqiptare. Atë Josifi njoftoi të pranishmit se qëllimi i mbledhjes së Kongresit të Beratit ishte shpallja e Kishës Autoqefale Ortodokse Kombëtare.

Menjëherë pas tij, arkimandrit Visar Xhuvani shpalli pavarësinë administrative të Kishës Ortodokse të Shqipërisë sipas vendimit: "Të gjithë Delegatët e Kongresit, Klerik e Laik, me një zë dhe entuzjazëm në emër të gjithë klerit dhe popullit ortodoks shqiptar, duke u bazuar edhe në faktin se Shqipëria u njoh prej gjithë shteteve të botës si një shtet i pavarur dhe sovran dhe mbi këtë bazë sipas kanoneve të shenjta të të Kishës Ortodokse në shtet të pavarur - kishë e pavarur, duke pasur për shembull edhe kishat autoqefale të Rusisë, Greqisë, Rumanisë etj, deklarojmë në emrin e Trinisë së Shenjtë të njëqenishme dhe të pandarë Autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë, "de fakto" sepse "de jure" ka qenë që prej ditës së shpalljes së indipendencës politike të shtetit shqiptar, duke mbajtur lidhje shpirtërore, dogmatike e apostolike me Patriarkanën Ekumenike dhe me kishat e tjera ortodokse autoqefale të botës. Rroftë Kisha Autoqefale"[34]. Të pranishmit u ngritën më këmbë dhe brohoritën "Rroftë Kisha Autoqefale" dhe në vijim nënshkruan. Sipas veendimit të Kongresit të Beratit Kisha Ortodokse e Shqipërisë ishte autoqefale prej vitit 1912, atëherë kur u shpall pavarësia e Shqipërisë. Ky fakt bazohej në parimin "kishë e

---

Ikonomin. Tirana – Papa Simonin dhe Mark Hobdarin. Elbasani – Vasil Llapushin (Fig.6) dhe Simon Shuteriqin. Shpati – Taq Budën dhe Dhimitër Papariston. Dibra – Leonidha Nishkun dhe Kostë Paftalin. Libohova – Spiro Katin. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 7-8; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani,* Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 57; *Visarion Xhuvani, në kishë, në parlament dhe në burg,* Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 56; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale,* Tema, 10-11 prill 2005, faqe 9; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016; faqe 119; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 187; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri,* Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 85-86; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 22; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 47.

[33]-Kaliopi Naska, *Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,* Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 14-15.

[34]-Fletore Zyrtare, Nr. 49, datë 26.10.1922; Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 7; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 22-23; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 47-48.

pavarur në shtet të pavarur". Problemi ishte që nuk kishte asnjë episkop në Shqipëri. Që një kishë të ishte autoqefale duhej të kishte të paktën katër episkopë të dorëzuar në mënyrë kanonike. Kongresi i Beratit kërkoi edhe ndihmën e qeverisë që t'i bëhej kërkesë Patriarkanës Ekumenike për njohjen e pavarësisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë, si dhe për emërimin e dy mitropolitëve me origjinë shqiptare të propozuar nga këshilli.

Në ditën e tretë të punimeve Kongresi votoi Statutin[35] e parë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga 14 artikuj. Në nenin I, Statuti përcaktonte se Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë ishte pjesë e pandarë e Kishës së Përgjithshme Ortodokse. Ajo përbëhej nga ortodoksët e shtetit shqiptar dhe sundohej prej episkopëve kanonikë, duke ruajtur kanonet e shenjta apostolike e sinodike. Statuti përcaktonte se kisha do të drejtohej nga sinodi i cili do të përbëhej prej peshkopësh kanonikë nën kryesinë e një mitropoliti. Ky sinod do të kishte titullin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Kisha do të drejtohej nga Këshilli i Lartë Kishtar, derisa të zgjidheshin episkopët kanonikë me pëlqimin nga Patriarkana Ekumenike ose nga kishat e tjera simotra vrenda dy vjetëve. Episkopët që do të dorëzoheshin do të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Kishtar pasi të betoheshin me ndërgjegje priftërore para Perëndisë për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Në nenin X, Statuti përcaktonte se gjuha e kishës qe shqipja. Meqenëse mungonin përkthimet kishtare Paqësoret[36], Ungjilli[37], Apostulli[38] dhe lutja Ati ynë do

[35]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,* Dhori Koti, Korçë 1923; Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 8-10; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg,* Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 57-59; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani,* Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 58-60; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale,* Tema, 10-11 prill 2005, faqe 9; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si betoheshin episkopët e kishës ortodokse shqiptare,* Tema, 12 prill 2005, faqe 9; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 184-186; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 87-90.

[36]-Paqesoret janë lutje, të cilat fillojnë me fjalët "*me paqe*" ose "*për paqen*". Quhen paqesore, sepse nëpërmjet tyre kërkojmë paqen e Perëndisë. Me anën e paqesoreve lutemi për shpëtimin e shpirtrave, për qëndrimin e mirë të kishave të Perëndisë dhe për bashkimin e të gjithëve, për ata që hyjnë në kishë me shprestari dhe frikë Perëndie. Lutemi për peshkopët, priftërinjtë, dhiakonët dhe për gjithë popullin, për kombin, presidentin, qytetin dhe vendin, për begatinë e pemëve, për udhëtarët, për të sëmurët, vuajtësit dhe robërit. *Dhiaku: Me paqe le t'i lutemi Zotit.* Dhiaku fton besmirët që t'i luten Zotit me paqe, qetësi dhe në heshtje. Besimtarët duhet të jenë të përkushtuar tek Perëndia dhe të ndjekin paqësisht lutjen e përbashkët. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit,* Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 8-9.

[37]-Me Ungjill kuptojmë librin liturgjik të kishës, i cili përmban pjesë nga të katër librat e shenjtë atë të Matheut, Markut, Lukës dhe Joanit, të cilët flasin për jetën dhe mësimdhënien e Isu Krishtit. Pjesët ungjillore lëçiten gjatë Liturgjisë Hyjnore ose nëpër shërbesa të tjera të kishës. Ungjilli simbolizon Krishtin, prandaj vendoset mbi Tryezën e Shenjtë. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit,* Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 21-22.

[38]-Apostulli përmban pjesë nga Veprat e Apostujve dhe letrat e Dhiatës së Re, për të dielat, të kremtet, ditët e zakonshme dhe për shërbesa të ndryshme. Kisha ka një seri të caktuar të këndimeve të Apostullit për çdo ditë të vitit, me përjashtim të ditëve të javës së Kreshmeve të Mëdha. Apostulli

të lëçiteshin detyrimisht në shqip. Këshilli i Lartë Kishtar do të bashkonte të gjitha episkopatat e atyre viseve që patën mbetur jashtë kufirit të shtetit shqiptar. Librat për përdorimin liturgjik do të njiheshin vetëm nëse kishin vulën e Këshillit të Lartë Kishtar. Duhet theksuar se deri në atë kohë qenë përkthyer këta libra liturgjikë kishtarë nga Fan Noli: "Shërbesat e Javës së Madhe"[39], “Librë i shërbesave të Shënjta të Kishës Orthodoxe”[40], "Të kremtet e mëdha të Kishës Orthodhokse"[41], "Triodi i vogël"[42], "Lutësorja"[43] dhe "Pesëdhjetore e vogël"[44]. Tre muaj pasi të qe krijuar Sinodi i Shënjtë, një Asamble Kishtare do të mblidhej për të miratuar statutin dhe rregulloren përfundimtare. Statuti (Fig.7) u këndua para kongresit dhe u pëlqye e u nënshkrua nga delegatët pjesëmarrës.

Autoriteti më i lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte Këshilli i Lartë ose siç quhej ndryshe Sinodi Provizor. Ky Këshill do të merrej me çështjet e drejtimit të kishës deri në krijimin e Sinodit Episkopal. Kryetar i Këshillit të

---

zakonisht lëçitet prej lexuesit (anagnostit) nga solea e kishës. Pas mbarimit të “*Shenjt Perëndi ...*” dhiaku del te Dera e Bukur. Lexuesi (anagnosti) thotë vargun e parë të Apostullit. Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 20-21.

[39]-Në vitin 1908 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Shërbesat e Javës së Madhe", 103 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të Javës së Madhe dhe të Pashkëve.

[40]-“Librë i shërbesave të Shënjta të Kishës Orthodoxe” është përkthyer prej të përndershmit At Theofan Nolit dhe është botuar në Boston Mass të Amerikës në vitin 1909. Libri përmban shërbesat e Mbrëmësores, Mëngjesores, Blata e Hyjshme, Mesha e Gojartit, Pagëzimi, Martesa, Rrëfimi, Prehja për të vdekurin, Bekimi i Vogël i Ujit, Hymne prej Lutjesores, dhe Zbritësoret e Motit. Në fund të librit gjendet një fjalor i termave të kishës, i cili jep shpjegimin e termave teologjikë shqip-greqisht. Libri përfundon me listën e ndihmëtarëve. Në parathënien e librit lexojmë: “Po u fal shqiptarëve Ortodoxë këtë librë e cila ësht’ e dyta, dhe pandeh që përdorja e saj do t’i siellë një shërbim vëndit tonë. I kam dhënë zotim kombit t’im t’u ap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të nevojshme për të praktikuar faljen e tyre më gjuhën kombëtare, dhe zotimin t’im do t’a mbaroj ndofta brënda në pak kohë, në qoftë se Shqipëtarët janë gati të më ndihin, sikundër më ndihnë më të shtypurit e këtyre dy librave. Më të kthyer të kësaj libre u përpoqa të mos largohem nga texti gërqisht dhe besoj që u dhashë Shqipëtarëve një kthim exakt të lutjeve të kishës Orthodoxe...”. Kthenjësi. *Librë e Shërbesave të shënta të Kishës Orthodoxe*, kthyer nga gërqishtja prej priftit Orthdox Fan S. Noli, Boston Mass 1909; Mehmet Gëzhilli, *Fan S. Noli*, Argeta LMG, Tiranë 2003, faqe 20.

[41]-Në vitin 1911 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Të kremtet e mëdha të Kishës Orthodhokse", 318 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të të kremteve kryesore.

[42]-Në vitin 1913 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Triodi i vogël", 270 faqe, botuar nga qeveria rumune në Bukuresht dhe përmban himne dhe lexime të Kreshmëve të dhe Pashkëve.

[43]-Në vitin 1914 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Lutësorja", 96 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himnet e së Dielës në tetë zëra, Kanunin e Vogël dhe Kanunin e Madh të Shën Mërisë. Në përkushtimin e librit lexojmë: "Motrës s'ime të dashur Shirma Noli, me lutje që të gjejë në qiell lumturinë që i mohoi kjo botë. Këtë vepër i detikoj".

[44]-Në vitin 1914 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik "Pesëdhjetore e vogël", 94 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himnet dhe leximet e të Dielave nga Pashkët deri te Rushajet dhe të Dielën e gjithë Shenjtorëve. Në përkushtimin e librit lexojmë: "Tim eti që më rriti e më mësoj, dhe që vdiq i lënduar se më pa prift, i detikoj këtë libër duke i lypur ndjesë". Fan Noli, *Pesëdhjetore e Vogël, Boston*, Mass 1914, faqe 3.

Lartë Kishtar u zgjodh delegati i Pogradecit, atë Vasil Marku[45]. Këshilli i Lartë Kishtar përbëhej nga katër klerikë dhe katër laikë. Anëtarët klerikë të Këshillit të Lartë Kishtar (1922-1923) qenë: Kryetar Atë Vasil Marku, Anëtarë klerikë: zëvendësmitropoliti i Durrësit, Arkimandrit Visar Xhuvani, zëvendësmitropoliti i Korçës, Atë Josif Qirici, zëvendësmitropoliti i Beratit Atë Anastasi dhe zëvendësmitropoliti i Gjirokastrës Atë Pano Çuçi. Anëtarët laikë qenë: Z. Simon Shuteriqi për mitropolinë e Durrësit, Z. Dhosi Havari për mitropolinë e Korçës, Z. Tol Arapi për mitropolinë e Beratit dhe Z. Stathi Kondi për mitropolinë e Gjirokastrës[46].

Në Kongresin e Beratit u diskutua edhe për Rregulloren[47] e Kishës Shqiptare, ku u bënë propozime të ndryshme, që kishin të bënin me të ardhurat e kishave dhe të manastireve, duke zgjedhur një komision për kontrollin e tyre. Në nenin I, Rregullorja përcaktonte se Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë përbëhej nga katë episkopatat: të Korçës, të Durrësit, të Beratit dhe të Gjirokastrës. Episkopatat do të vepronin sipas rregulloreve të Patriarkanës Ekumenike; zëvendësitë lokale do ti drejtoheshin zëvendësmitropolitit dhe ky i fundit Këshillit të Lartë Kishtar. Në nenin 3 të Rregullores përcaktoheshin detyrat e kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar. Mbledhjet e Këshillit do të drejtoheshin nga kryetari ose në rast mungese të tij, nga ai që e pasonte në shkallë kryepriftërore. Mbledhjet që të quheshin të ligjshme duhet të kishin më shumë se gjysmën e anëtarëve. Vendimet e mbledhjeve duhet të miratoheshin me shumicë votash dhe në rast barazie fitonte ana e kryetarit. Një anëtar i Këshillit nëse mungonte pa arsye në dy mbledhje shpallej i rrëzuar dhe vendin e tij e zinte një tjetër. Në kopetencë të këshillit qe zgjedhja e arkëtarit, ndërsa me emërimet e personelit merrej kryetari. Arkëtari nuk duhej të bënte pagesa pa nënshkrimin e kryetarit, ndërsa kryetari nuk duhej të urdhëronte pagesa pa vendimin e këshillit. Neni 9 dhe i fundit përcaktonte pagesat e anëtarëve të këshillit dhe të personelit kishtar.

Kongresi u mor me çështjen se ku do të vendosej selia e Këshillit të Lartë Kishtar. Delegati i Kavajës, Pal Xhumari propozoi që si qendër e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të ishte qyteti i Korçës[48]. Ky propozim u aprovua njëzëri

[45]-Fanolistët propozuan emrin e atë Vangjel Çamçes për kryetar të Këshillit të Lartë Kishtar. Arkimandrit Visar Xhuvani ishte një kandidaturë tjetër e mundshme. Megjithatë qeveria dhe fanolistët u pajtuan me kandidaturën e atë Vasil Markut. Ky i fundit ishte prift i martuar dhe nuk mund të pretendonte për gradën episkopale. Kjo ishte edhe arsyeja që Visar Xhuvani pranoi që atë Vasil Marku të zgjidhej kryetar i Këshillit të Lartë Kishtar. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 121.

[46]-Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 11; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 124; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 184.

[47]-Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 10-11; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 59-60; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 61-62; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 188-189.

[48]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 162.

nga kongresi. Në përfundim atë Josif Qirici nënshkroi telegramin, me anë të së cilit njoftoheshin kishat autoqefale se Kongresi i Beratit shpalli Kishën Autoqefale Ortodokse Kombëtare të Shqipërisë. Në fletoren zyrtare të Shtetit Shqiptar të vitit 1922 shpallja e Kongresit u quajt ditë historike.

Megjithatë, zbatimi i vendimeve të Kongresit të Beratit nuk eci me atë shpejtësi që kërkonte koha. Përplasjet e brendshme filluan të përçanin anëtarët e Këshillit të Lartë Kishtar. Përfaqësuesi laik i Mitropolisë së Durrësit në Këshillin e Lartë Kishtar, Simon Shuteriqi me anën e një telegrami i kërkoi pleqësive kishtare të zgjidhnin një zëvendësmitropolit tjetër në vendin e Visar Xhuvanit[49]. Pleqësitë zgjodhën atë Dhimitër Dhimitrukën[50]. Në muajin nëntor 1922 Xhuvani shkoi në Korçë për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Lartë Kishtar, por atë Vasil Marku nuk e pranoi me pretendimin se qe i shkarkuar. Visar Xhuvani e kundërshtoi, duke ia bërë të qartë se asnjë anëtar i këshillit nuk do të zgjidhej nëse pyeteshin pleqësitë kishtare. Zgjedhja e tij ishte bërë nga delegatët e Kongresit të Beratit. Nuk vonoi shumë dhe kryepleqtë e fshatrave të Shpatit kërkuan riemërimin e arkimandrit Visar Xhuvanit si zëvendësmitropolit i Durrësit[51]. Edhe pleqësia kishtare e lagjes Shën Koll të Elbasanit e mbështeti fuqishën Visarin. Gjithashtu edhe 100 besimtarë nga Lagjja Kala e Elbasanit, e mbështetën Xhuvanin. Ndër ta kishte emra të njohur si: Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Taja, Jeftimi Buda, Jan Nosi etj[52]. Në këtë situatë Këshilli i Lartë Kishtar vendosi të mos pranonte asnjë anëtar klerik nga Mitropolia e Durrësit derisa të zgjidhej mosmarrëveshja. Kështu prej 26 dhjetorit 1922 deri më 1 janar 1924 Mitropolia e Durrësit mbeti pa zëvendësmitropolit.

---

[49]-Në telegram është shkruar: Dhimogjerondisë, Zgjidhni antarin klerik, Zv Mitr. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit tjetër në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit. Simon Shuteriqi. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 12; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 62; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani,* Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 64.

[50]-Në telegram është shkruar: Kryesisë së Kishës. Korçë. Në vend të Arqimandrit Vissar Xhuvanit kemi zgjedhur Papa Dhimitrukën anëtar Klerik të Këshillit të Lartë Kishtar si dhe për Zv. Mitrop. të Përgj. të Dioqezës së Durrësit. Dhimogjerondia. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 12; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 62; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani,* Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 64.

[51]-Pamë në gazetën "Post' e Korçës" që shkruente se Elbasani ka protestuemun zgjedhjen e Arkimandrit Xhuvanit si zavendës i Përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit. Kjo nuk asht e drejtë se Dhimogjerondia e lagjes Kala nuk përfaqëson edhe lagjen e Shinkollit e Krahinën e Shpatit, të cilat pas vendimit të Kongresit Kishtar të Beratit në nyjën 4 të statutit pranojnë si zavendës të përgjithshëm të Mitropolisë së Durrësit Arqimandrit Xhuvanin. Vijojnë firmat e kryepleqve.

[52]-Pamë në gazetën "Post' e Korçës" se populli Orthodhoks i Elbasanit ka protestuemun zgjedhjen e Hirsisë së Tij Vissar Xhuvanit për zavendës të përgjithshëm të Mitropolitit të Durrësit që e zgjodhi Kongresi Kishtar i Beratit. Ky protestim nuk asht i vërtetë dhe ne të nënshkruemit populli Orthodhoks i lagjes Kala t'Elbasanit qëndrojmë në vendimin e Kongresit të Beratit dhe njofim për zavendës të përgjithshëm Mitropoliti të Mitropolisë sonë të Durrësit Hirsinë e Tij Arkimandrit Vissar Xhuvanin dhe as ndonji pleqësi (Dhimogjerondi) etj, nuk njofim kompetent për me veprue kundra këtij emnimi të Arkimandritit të përmendun dhe këtë kemi vendosë edhe më 1919; dhe vazhdimi në detyrën e sipërme të Arkimandritit V. Xhuvani asht dëshira jonë. Vijojnë firmat.

Në Mitropolinë e Drinopojës, Këshilli i Lartë Kishtar pati emëruar atë Pano Gjirokastrën si zëvendësmitropolit. Zgjedhja e tij solli grindje pas një takimi që pati me Komisionin Hetimor të Lidhjes së Kombeve. Atë Pano Gjirokastra qe shprehur se meshimi në gjuhën shqipe[53] do të ishte i detyruar për të krishterët shqipfolës. Inspektori i administratës, Vasil Dilo në emër të ortodoksëve të qytetit kërkoi zëvendësimin e tij. Prania e atë Pano Gjirokastrës sillte përçarje me grekomanët e fshatrave përreth Gjirokastrës, prandaj vetëm pak kohë pas emërimit atë e shkarkuan. Në vendin e tij u zgjodh atë Thanas Nikolla[54].

Patriarkana Ekumenike e informuar për zhvillimet që po ndodhnin në Shqipëri, më 11 shtator 1922 vendosi krijimin e një komisioni që do të shqyrtonte çështjen shqiptare. Në përbërje të komisionit qenë katër ish-mitropolitët e dioqezave shqiptare, ndërsa kryetar u zgjodh Mitropoliti i Rodhit. Një nga anëtarët e komisionit, Joakim Martiniani[55] vuri në dijeni anëtarin e Këshillit të Lartë të Shtetit, Sotir Pecin. Ish-mitopoliti i Beratit, Joakimi rendi në zyrën e Konsullatës Shqiptare, në Stamboll dhe njoftoi konsullin Nezir Leskovikun se komisioni kërkonte dërgimin e një përfaqësie nga ortodoksët e Shqipërisë. Gjithashtu, e bëri me dije se Patriarkana Ekuemnike kishte vendosur të dërgonte Mitropolitin e Meletit, Jerotheun[56] (Fig.8) si

[53]-Alqi Jani, *Papapano Gjirokastra-figurë e shquar e kishës shqiptare*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 88-92.

[54]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 123-124.

[55]-Joakim Martiniani ka lindur në Voskopojë, më 1875. Studimet e larta i ndoqi në shkollën teologjike të Halkit. Në vitin 1903 u dorëzua dhjak në kishën patriarkale të Shën Gjergjit, nga Patriku Ekumenik Joakimi III. Më 4 korrik të vitit 1911 Joakim Martiniani u zgjodh mitropolit i Beratit, ndërsa ceremonia e fronëzimit u celebrua më 10 korrik 1911. Sapo mbërriti në Berat, mitropoliti Joakim ngriti një shkollë hierartike në manastirin e Ardenicës. Në Vlorë ngriti shtypshkronjën, ku botonte një gazetë të përjavshme. Mitropoliti Joakim iventarizoi pasuritë e paluajtshme të manastireve. Me interesimin e tij u restaurua manastiri i Zvërnecit. Gjithashtu ndërtoi një bibliotekë të pasur në mitropolinë e Beratit, e cila u dogj më 14 shtator të vitit 1913. Në vitin 1920 vajti në Korfuz dhe nuk e jeluan të kthehej në mitropolinë e tij. Dr. Dion Tushi, *Joakim Martiniani*, Kërkim, Nr. 6, Tiranë 2010, faqe 59-62.

[56]-Jerotheu (+1956) ka lindur në fshatin Çarshovë të Përmetit. I ati quhej Andon Jaho dhe e ëma Kostandina. Janaqi vitet e fëmijërisë i kaloi në vendlindje. Në moshën e rinisë vajti tek i ati në Stamboll për të ndjekur studimet e larta në Shkollën Teologjike të Halkit, të cilat i përfundoi në vitin 1907. Tema me të cilën mbrojti diplomën ishte: "Hirotonia dhe zgjedhja kanonike e Fotit". Pas përfundimit të studimeve përqafon jetën monakale dhe ushtrohet në Skitin e Shën Anës duke marrë emrin Jerothe. Vite më vonë e gjejmë Kryefamulltar në Kalqedoni të Stambollit. Duke ngjitur njëra pas tjetrës shkallët e hierarkisë kishtare arriti që më 12 janar të vitit 1914 të hirotoniset Episkop i Melitopojës. Pas Kongresit të Beratit, Patriarkana Ekumenike vendosi të dërgonte Mitropolitin e Melitopojës, Jerotheun si eksark patriarkal, i cili mbërriti në Korçë më 27 nëntor 1922. Hirësia e Tij Jerotheu i dërgoi Patriarkanës Ekumenike raportin përkatës më 8 dhjetor 1922 duke i kërkuar që të dërgonte në Shqipëri Mitropolitin e Sinadonit Kristofor Kisin. Me ardhjen e këtij të fundit, më 4 dhjetor 1923 Jerotheu dhe Kristofori dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Imzot Jerotheu u zgjodh Mitropolit i Beratit. Me interesimin e Imzot Jerotheut u botua Revista "Zëri i Orthodhoksisë". Kjo revistë u botua në qytetin e Korçës ndërmjet viteve 1924-1925. Kjo ishte edhe revista e parë e Kishës Orthodhokse. Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9; Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10; Kristofor Beduli, *Revista Zëri i*

eksark patriarkal në Shqipëri. Jerotheu mbërriti në Korçë më 30 nëntor 1922, ku u takua me anëtarët e Këshillit të Lartë Kishtar dhe deputetët ortodoksë që kishin dalë për ta pritur. Më 2 dhjetor 1922 Jerotheu meshoi në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Në fjalën e tij tha se ishte i dërguar nga patriku Meleti IV për çështjen e autoqefalësë së kishës shqiptare. Jerotheu i dërgoi Patriarkanës Ekumenike raportin përkatës dhe i kërkoi dërgimin e një delegacioni nga kisha shqiptare për t`u sqaruar[57]. Delegacioni u nis në maj të vitit 1923 dhe kryesohej nga Kryetari i Këshillit të Lartë atë Vasil Marku, i cili i paraqiti Patriarkanës Ekumenike vendimet e Kongresit të Beratit, si dhe u parashtroi dëshirën e shtetit shqiptar për krijimin e një kishe autoqefale, sikundër qe vepruar në Greqi, Serbi dhe Rumani. Në këtë pikë Patriku Ekumenik, Meleti IV kundërshtoi njësimin me shtetet e tjera, pasi Shqipëria nuk kishte shumicë të popullsisë ortodokse. Delegacioni u kthye në Shqipëri pa rënë dakort me autonominë e pjesshme që parashikonte Patriarkana, gjë që ishte në kundërshtim me vendimet e Kongresit të Beratit.

Për të fuqizuar kishën ortodokse me kandidatë për episkopë, Jerotheu më 15 dhjetor 1922 ngriti atë Vangjel Çamçen në rangun e arkimandritit. Ndërkohë, Patriku Meleti IV thirri Jerotheun në Stamboll, duke e njoftuar se misioni i tij në Shqipëri kishte mbaruar. Jerotheu u dëshpërua pa masë. Disa muaj pas kthimit të delegacionit në Shqipëri, më 17 gusht të vitit 1923 Mitropoliti i Sinadës, Kristofor Kisi erdhi vullnetarisht për t`i shërbyer çështjes së kishës shqiptare. Patriarkana urdhëroi ndalimin e çdo lloj veprimtarie kishtare të Kisit. Mirëpo as Jerotheu dhe as Kisi nuk iu bindën urdhërit të Patriarkanës[58].

Në tetor 1923 Këshilli i Lartë Kishtar kishte emëruar Jerotheun, Mitropolit të Korçës dhe Kristofor Kisin, Mitropolit të Beratit. Në muajin nëntor 1923 u bë fronëzimi i tyre. Më 4 dhjetor 1923 Jerotheu dhe Kristofori dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin (Fig.10) në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Shërbesa u zhvillua me pjesëmarrjen e Ministrit të Jashtëm, Pandeli Evangjeli, kryebashkiakut Vasil Avrami, si dhe të mjaft personaliteteve të tjerë. Pas dorëzimit në gradën episkopale, Theofan Noli do të fronëzohej në fillim të janarit 1924. Vetëm Mitropolia e Gjirokastrës mbetej pa episkop.

Orthodhoksisë, Ngjallja, qershor 2002, faqe 4; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 133-134.

[57]-Në letrën që i dërgoi Kryetarit të Këshillit të Lartë, eksarku patriarkal Jerotheu ka shkruar: Fort i përndershëm! Duke bekuar vendimet dhe statutin e Kongresit Kishtar që u mblodh në Berat në shtator të vitit 1922, sipas qarkores së imët që bëri kleri dhe populli ortodoks i Shqipërisë, si Eksark Patriarkal që jam i them dhe e shtyj Atërisht Këshillin Kishtar të Përzier, që ndodhet në veprim dhe punon si e do puna me goditje, i them pra këtij Këshilli të shkojë me çapa të fortë e të sinqertë udhës që ka hapur Kongresi i Beratit me anën e Statutit, i cili u vërtetua plotësisht nga Qeveria e Ndershme Shqiptare. Urime të dala nga thellësia e zemrës së Patrikut Ekumenik për forcimin dhe përparimin e Qeverisë Shqiptare dhe të Kishës Ortodokse të Shqipërisë u shfaqën dhe po shfaqen me anën time zyrtarisht si Eksark Patriarkal që jam dhe kam besim të patronditur se në kohën që e do puna Kisha e Madhe e Krishtit ka për ta njohur edhe Kishën Ortodokse të Shqipërisë, e cila sapo u lind duke e siguruar këtë plotësisht sipas zakonit me anë të Tomit Kishtar sikundër urdhërojnë Kanonet e Shenjta. Korçë 19.12.1922. Urimtar i flaktë me Krishtin ndaj Perëndisë. Eksarku Patriarkal Jerotheu, i Melitopojës. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 141, Dosja nr. 438, viti 1922.

[58]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 131-138.

Këshilli i Lartë Kishtar në vitet 1923-1925 përbëhej nga: Atë Vasil Marku, Kryetar; Anëtarët klerikë: Mitropoliti i Durrësit, Hirësi Theofan Noli; Mitropoliti i Korçës, Hirësi Jerothe Jaho; Mitropoliti i Beratit, Hirësi Kristofor Kisi; Zëvendësmitropoliti i Gjirokastrës, Atë Thanas Nikolla. Anëtarët laikë: për Durrësin, Simon Shuteriqi; për Korçën Dhosi Havjari; për Beratin, Tol Arapi dhe për Gjirokastrën, Stathi Kondi[59].

Menjëherë pas dorëzimit, Imzot Theofani mori në dorë drejtimin e lëvizjes kishtare shqiptare. Tashmë tre mitropolitët e kishës shqiptare i dërguan Patriarkanës Ekumenike vendimin për krijimin e sinodit me pjesëmarrjen e Theofan Nolit, Mitropolit të Durrësit; Hirësi Kristoforit, Mitropolit i Beratit dhe Hirësi Jerotheut, Mitropolit i Korçës. Qenë plotësuar kushtet për dorëzimin e mitropolitit të katër, që ishte Arkimandrit Vangjel Çamçe, i cili do të dorëzohej Mitropilit i Gjirokastrës, duke formuar Sinodin e Shenjtë me pjesëmarrjen e katër mitropolitëve: Theofanit, Jerotheut, Kristoforit dhe Vangjelit. Ndërkohë me trazirat e vitit 1924, Imzot Theofani u detyrua të largohej nga Shqipëria[60], vetëm pak ditë përpara se të fronëzohej Kryeepiskop. Kjo ishte brenga më e madhe e Nolit.

Dorëzimi i Visarionit, në gradën episkopale. Më 24 mars 1925 Ministria e Brendshme i kërkoi Këshillit të Lartë Kishtar, që në vendin e Theofan Nolit të emërohej arkimandrit Visar Xhuvani. Besimtarët e Elbasanit[61], Pogradecit[62] dhe të Tiranës[63],

[59]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 139.

[60]-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 350; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 25; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 49; Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 164.

[61]-Sot më 8 Mars 1925 u mblodh Dhimogjerondija nën Kryesinë e Zavendës Mitropolitit Ikonom At Dhimitrukës, dhe pasi bisedoi gjatë e gjanë, vendosi me zana të përbashkëta, sa vijon: Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit e të rrethit t'Elbasanit, të çfaqun edhe dy herë ma parë me vendime të posaçme, bamun në muejt Shtatuer e Nanduer të vitit 1919, si dhe propozimin e bamun në Kongresin Orthodhoks të Beratit, ashtu edhe cilsinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arkimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop për Episkopatën Tonë. Për me i mbërri këtij qëllimi, t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondinavet të qytetevet tjera t'Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i u drejtue edhe ato Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 21.

[62]-Tue marrë parasysh dëshirën e nevojat fetare të popullit të qytetit tonë dhe të rrethit të Pogradecit dhe tue marrë parasysh cilësinat e duhuna të Hirsisë së Tij Arqimandrit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop i Episkopatës sonë. Për me i a mbërri këti qëllimi t'i njoftohet ky vendim Dhimogjerondinavet të qyteteve të tjera t' Episkopatës me lutje që ta përkrahin këtë inisiativë, tue i-u drejtue së bashku Këshillit të Naltë Kishtar në Korçë. Pogradec 14-III-925. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 21-22.

[63]-Sot më 19-III-925 të nënshkruemit me dëshirë vllaznore si pas vendimit t'Elbasanit D. 8-III-925 dhe Pogradecit d. 14-III-925 vendosën sa vijon: Tue marrë parasysh nevojat fetare të qytetit tonë Tiranës dhe tue marrë parasysh cilsinat e duhuna të Hirësisë së Tij Arqimandritit Dr. Vissar Xhuvanit, të kërkohet prej Këshillit të Naltë Kishtar dorzimi i Tij sa ma shpejt si Episkop t'Episkopatës sonë. Për me ai mri këti qëllimi ti njoftohet ky vendim qyteteve të tjera të Episkopatës me lutje që ta përkrahin

kërkonin emërimin e Visarit. Këshilli i Lartë Kishtar duke marrë parasysh kërkesën e tyre më 28 mars 1925 e emëroi arkimandrit Visar Xhuvanin zëvendësmitropolit të Durrësit, Gorës dhe Shpatit. Me emërimin e Visar Xhuvanit, Këshilli i Lartë Kishtar në vitet 1925-1925 përbëhej: Kryetar: Atë Vasil Marku; Anëtarë Klerikë: Zëvendësmitropolit i Durrësit, arkimandrit Visar Xhuvani; atë Vangjel Çamçe, Mitropolit i Korçës, Hirësi Jerotheu; Mitropolit i Beratit, Hirësi Kristofori; Zëvendësmitropolit i Gjirokastrës, atë Thanas Nikolla. Anëtarë laikë: Simon Shuteriqi për Durrësin; Vasil Rusi; Dhosi Havjari për Korçën; Tol Arapi për Beratin dhe Stathi Kondi për Gjirokastrën[64].

Në prill 1925 Visar Xhuvani iu drejtua dy episkopëve Jerotheut dhe Kisit, nëse ata qenë të gatshëm ta dorëzonin në gradën episkopale. Përgjigja e Jerotheut ishte se nuk mund të dorëzonte asnjë episkop pa lejen e Patriarkanës Ekumenike, ndërsa Kristofori pranoi me kushtin që të gjendej një episkop kanonik, për kryerjen e dorëzimit. Në këto kushte Visar Xhuvani më 3 maj 1925, duke marrë bekimin e patrikut të Serbisë, Dhimitrit u dorëzua në gradën episkopale në Manastirin e Savinës në Kotorr prej dy episkopëve rusë; Ermogenit të Ekaterinosllavit dhe Mihailit të Aleksandrovskit. Pas dorëzimit episkop mori emrin Visarion. Ai pasi lëçiti dëshminë kanonike të besimit u betua: "*Kam me qenë ruejtës besnik i të gjitha dogmavet, kanonevet dhe rregullavet të shenjta të Kishës Orthodhokse që përmblidhen në Shkrimet e Shenjta, në gojdhanat e Hyjnueshme dhe në vendimet e shtatë sinodhevet Ekumenike, si dhe në mësimet e Etënve të Shenjtë të Kishës së Shenjtë Orthodhokse, dhe siguroj me ndërgjegjen Time fetare se kam me qenë gjith jetën Time besnik i Kishës Autoqefale Orthodhokse kombëtare të Shqipnisë të kryesueme sot prej Këshillit të Naltë të saj; dhe nuk kam me iu përulë asnji fuqie që mund të kërcënohet ndonjiherë kundra detyrave të mija të Shenjta Episkopale, si pjestar i Kishës së sipërmërmendun. I Lutemi Përendisë për Këshillin e Naltë Kishtar të Shqipnisë, për Republikën Shqiptare, si dhe për paqen e gjithë botës dhe bashkimin e të gjithëve. Lavdi qoftë mbi të madhin Perëndi*"[65].

Dorëzimi i Visarionit në gradën episkopale solli pështjellime në kishë, sepse nuk ishte emëruar nga Këshilli i Lartë Kishtar, kryetari i të cilit Atë Vasil Marku nuk e njohu dorëzimin. Madje, ai njoftoi ministrin e Drejtësisë, Petro Poga, se dorëzimi ishte i paligjshëm. Atë Vasil Marku kërkoi ndalimin e Xhuvanit nga shërbesat fetare. Më 16 maj 1925 erdhi përgjigja nga ministri Poga, i cili theksonte se Xhuvani nuk duhej të lejohej të meshonte si episkop. Në këto kushte Këshilli i Lartë Kishtar emëroi anëtari laik të Këshillit të Lartë Kishtar Vasil Rusi si zëvendësmitropolit të Durrësit. Më 19

---

këtë inisiativë, tue iu drejtue edhe këshillit të Naltë Kishtar në Korçë për këtë punë. Parësia dhe populli i Tiranës. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 19-20.

[64]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 157.

[65]-Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 33; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 99; *Visarion Xhuvani, në kishë, në parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 89; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 97.

qershor 1925 Pleqësia Kishtare e Elbasanit[66] kërkoi emërimin e Visarionit, Mitropolit të Durrësit.

Protokolli i Tiranës. Në vitin 1926 Patriarkana Ekumenike, me ndërmjetësinë e qeverisë greke dërgoi në Shqipëri Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin si eksark patriarkal, që të bisedonte për çështjen e autoqefalisë. Patriku Ekumenik Vasili, më 13 prill 1926 i shkroi një letër Ahmet Zogut, ku theksonte përkujdesjen atërore patriarkale ndaj ortodoksëve shqiptarë. Krisanthi mbërriti në Tiranë në fillimmaji të vitit 1926. Këshilli i Ministrave ngriti një komision të posaçëm për të biseduar me Krisanthin. Në përbërje të komisionit qenë: Kreu i Senatit, Pandeli Evangjeli, Kryetari i Dhomës së Deputetëve, Koço Kota, senatorët Pilo Papa, Andon Beça, deputetët Mihal Kaso, Vasil Rusi, Dr. Simonidhi dhe Vasil Bamiha. Bisedimet nisën më 24 maj 1926 dhe zgjatën 40 ditë. Më 6 qershor 1926, komisioni i deputetëve dhe senatorëve dhe Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi nënshkruan marrëveshjen përfundimtare, që u quajt Protokolli i Tiranës[67]. Marrëveshja përcaktonte krijimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Protokolli i Tiranës kishte tetë nene si edhe një shtojcë. Neni i parë përcaktonte se Kisha Ortodokse Shqiptare do të përbëhej nga pesë mitropoli, të cilat qenë: e Tiranës, e Korçës, e Gjirokastrës, e Beratit dhe e Durrësit. Neni i dytë theksonte se: Mitropoliti i Tiranës, do të ishte Kryeepiskopi i Kishës Ortodokse Shqiptare dhe njëkohësisht Kryetar i Sinodit të Shenjtë. Neni tre përcaktonte se në mitropolitë e paplotësuara me mitropolitë komisioni i posaçëm ortodoks do të propozonte tre emra, të cilët do të emëroheshin nga Patriku Ekumenik. Neni i katërt theksonte për bashkësitë ortodokse se do të përdorej gjuha amtare, që ishte shqipja. Protokolli i Tiranës theksonte gjithashtu, se të drejtat e pakicës etnike greke do të përmbusheshin nga Shpallja për Mbrojtjen e Pakicave, që qe dorëzuar në Lidhjen e Kombeve. Neni i shtatë përcaktonte se Shqipëria do të dëmshpërblente Patriarkanën Ekumenike për manastiret stavropigjike[68], të cilat kalonin në varësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Neni i tetë theksonte se Patriarkana Ekemenike do të bekonte autoqefalinë e kishës, duke dorëzuar Tomosin përkatës. Shtojca e Protokollit të Tiranës bënte fjalë për tre emrat e propozuar në tre mitropolitë

[66]-Sot më 19 Qershor 1925, u mblodh Dhimogjerondija e Elbasanit dhe mbasi bisedoi mbi bazë të vendimevet të saj, dhanun ma parë, si dhe tue marrun para sysh dëshirën e gjithë popullit të qytetit e të qarkut bashkë me atë të krahinës së Shpatit, vendosi me zana të përbashkëta, që të kërkojë nga kryesia e Kishës, njohjen e Hirsisë së Tij Episkop Vissarion Xhuvanit si Episkop dhe emnimin e Tij për Mitropolit t'Episkopatës sonë. Dhe për këtë qëllim vendosi që n'emnin e kësaj Dhimogjerondije, t'i drejtohet Kryesisë së Kishës kjo lutje telegrafike: "Të shtyemun nga dëshira e gjithë popullit Orthodhoks të qytetit e të qarkut së bashku me krahinën e Shpatit, i paraqisim rishtazi Qendrës sonë Shpirtnore lutjen për me pranue në gji të Kishës së Shenjtë Episkopin Vissarion Xhuvani, tue e emnue Mitropolit t'Episkopatës së Durrsit". Elbasan më 19 Qershuer 1925. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 31.

[67]-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 62.

[68]-Manastiret që administroheshin direkt nga Patriku i Kostandinopojës dhe gëzonin statusin e manastirit stavropigjik në Shqipëri qenë: manastiri i Cepos, manastiri i Kamenës, manastiri i Spilesë në Saraqinisht, manastiri i Prodhromit në Voskopojë dhe manastiri i Drianos në Zervat të Dropullit. Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019.

vakante për të formuar Sinodin e Shenjtë[69]. Krisanthi ia kishte bërë të ditur qeverisë shqiptare se Tomosi do ti dorrëzohej në Lidhjen e Kombeve. Gjithashtu si parakusht qe shfuqizimi i Statutit të miratuar në Kongresin e Beratit dhe i Këshillit të Lartë Kishtar. Heqja nga detyra e Mitropolitit të Durrësit, Theofan Nolit etj. Krisanthi ishte takuar edhe me Visarion Xhuvanin në Tiranë. Në bisetë me të Visarioni kishte pranuar se kishte shkelur kanonet, por jo deri në atë shkallë sa vetëshpallja e Nolit. Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi u largua nga Shqipëria më 17 qershor 1926. Gjatë kohës së bisedimeve Visarion Xhuvani botoi dy vëllimet e librit "*Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë*". Në vëllimin e parë[70] argumentonte përse Kisha në Shqipëri duhej të ishte kombëtare, ndërsa në vëllimin e dytë[71] sqaronte përse Kisha Shqiptare duhet të ishte autoqefale. Visarion Xhuvani[72] në atë kohë ka shkruar për gjendjen e mjeruar të Kishës Ortodokse Shqiptare. Më 19 maj 1927 Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike kishte vendosur për dhënien e Autoqefalisë së Kishës Shqiptare, sipas protokollit të Tiranës. Patriku Ekumenik, Vasili sqaronte se ishte e rëndësishme të ruhej fryma e nenit të pestë të Protokollit, që siguronte pavarësinë e plotë të Kishës

[69]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 170-171.

[70]-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë,* Pjesa I, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.

[71]-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë,* Pjesa II, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.

[72]-Xhuvani në broshurën *Kujtim vepre dhe intrige* duke përshkruar gjendjen e kishës ka shkruar: 1) Shumica e Priftnavet t'Episkopatës së Gjinokastrës në Shqipni meshtojnë në Kishë n'emën të ish Mitropolitit të Gjinokastrës Vasilit, që Kongresi Kishtar i Beratit e ka rrëzue zyrtarisht si antishqiptar. Këtë përmendin për kryefetar rrethi i katundevet të Prefekturës së Gjinokastrës edhe sot. 2) Në Episkopatën e Beratit-Vlonë, Episkopi Em. Kristofori përmend (kujton) në meshë rregullisht Patrikun e Kostandinopojës edhe çdo Episkop t'Orthodhoksëvet deri sot. 3) Në Episkopatën e Korçës-Përmet, Episkopi Emz. Ierotheu meshton gjithashtu si i sipërmi në emën të Patrikut të Kostandinopojës, dhe vetëm në emën të Tij. 4) Në Episkopatën e Durrsit-Tiranë-Elbasan kleri meshton në emën të çdo Episkopie Orthodhokse (që do me thanë në emën të nji kishe indipendente po pa Episkop kryetar dhe pa Episkop të kësaj Episkopate, të Durrsit). 5) Në Shkodër kleri meshton në emën të Patriarhut të Serbisë. 6) Në qytetin Korçë mbrenda At Vasil Markoja, nji Prift që asht Kryetar i Kishës Orthodhokse Kombëtare Autoqefale të Shqipnisë (d.m.th. ka gradën e Patrikut, përveç titullit), dhe ky, kur meshton atje përmend edhe Episkop Ierotheun, i cili si thamë meshton në emën të Patrikut të Kostandinopojës. 7) Imz. Ierotheu dhe Imz. Kristofori a) erdhën në Shqipni, b) morën Episkopata të cilave Episkopë ishin të tjerë sipas pikpamjes kanonike të Patriarhisë së Kostandinopojës, - dhe c) dorzuen Episkop Fan Nolin, pa lejen e patriarhisë, kishës, nga e cila kur erdhën këtu urdhënoheshin, dhe nën juridiksionin e së cilës ishin kur erdhën këtu, si edhe sot prej Patriarhisë së Kostandinopojës njifen për Episkopë të asaj kishe. Por ajo Patriarhi nuk bani asnji veprim kundra tyne tash 5 vjet, sa do që Eksarhu, delegati Patriarhal Imz. Krisanthi, kto ditë në Shqipni tha se Patriarhia Imz. Ierothenë dhe Kristoforin i njef për Episkopë që vepruen në Shqipni kundra rregullavet dhe kanonevet Ierarhike disiplinore. 8) Statuti i Kishës dhe vendimet themeltare të Kongresit Kishtar të Beratit, si u spjegue në këtë libër, u shkelën keq, sidomos nyji i 10-të që i përket gjuhës shqipe në Meshë. 9) Vendimi i Kongresit Kishtar të Beratit për zv. Mitropolit të Gjinokastrës dhe antar klerik në Këshillin e N.K. të asaj dioqeze u shkel prej Këshillit të Naltë Kishtar. 10) Vendimi i Kongresit K. të Beratit që na emnonte ne provizorisht Zv. Mitropolit të përgjithshëm të dioqezës së Durrsit dhe pasandaj për Mitropolit definitiv, si u spjegue në këtë libërzë, u shkel. 11) Mbasi Imz. Ierotheu, Imz. Kristofori dhe Këshilli i Naltë Kishtar e lanë Kishën 4 vjet pa Sinodh Episkopal pse nuk donin të dorzonin nji Episkop të katërt që të mos formohet kështu Sinodhi Episkopal Shqiptar. Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige,* shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 22-23.

Ortodokse Shqiptare. Pranimi i marrëveshjes do të shoqërohej me dorëzimin e pesë mitropolitëve. Pas kësaj një përfaqësi do të dërgohej në Stamboll për të marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të Tomosit. Ndërkohë që komisioni i posaçëm ortodoks falënderoi Patriarkanën Ekumenike për pranimin e Protokollit të Tiranës, i cili i jepte zgjidhje çështjes kishtare. Mitropoliti i Trapezuntës, Krisanthi i dërgoi një letër Patrikut Ekumenik, Vasilit, ku i thoshte që ta zvarriste çështjen. Në këto rrethana, qeveria shqiptare kishte vetëm dy zgjidhje. E para ishte të priste kërkesat e reja që do të paraqiste Krisanthi, të cilat do të shqyrtoheshin nga komisioni i posaçëm, do të miratoheshin nga Këshilli i Ministrave dhe më pas do ti përcilleshin Patriarkanës Ekumenike për miratim. Ndërsa zgjidhja e dytë ishte krijimi i Sinodit të Shenjtë, duke e vënë Patriarkanën Ekumenike para një fakti të kryer[73].

Krijimi i Sinodit të Shenjtë. Që të sanksionohej plotësisht autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë nevojitej të krijohej një sinod, i cili do të udhëhiqte kishën. Por, që të formohej Sinodi i Shenjtë nevojiteshin të paktën katër episkopë, ndërsa në Shqipëri në atë kohë kishte mbetur vetëm një episkop, që ishte Visarioni. Atë Vasil Marku, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë Kishtar, e emëroi zyrtarisht Visarionin, Mitropolit të Durrësit dhe Tiranës. Gjithashtu e ngarkoi me detyrën që të shkonte në Beograd për të kërkuar ndihmë për zgjidhjen e çështjes së Sinodit të Shenjtë. Për të dorëzuar episkopët e tjerë nevojiteshin të ishin të paktën dy mitropolitë, prandaj Visarioni vajti në Shkodër, ku kërkoi ndihmën e mitropolitit serb, Imzot Viktorit. Kështu më 12, 13 dhe 17 shkurt të vitit 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë u bë dorëzimi i episkopëve nga Imzot Visarini dhe Imzot Viktori. Kryeministri Koço Kota, kur mësoi se Visarioni ja kishte dalë mbanë i telefonoi sekretarit të tij, Dr. Zoi Xoxa dhe i kërkoi që ta shoqëronte për të shkuar në kishë[74].

Në meshën e datës 12 shkurt 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë, Hirësi Visarioni me Hirësi Viktorin dorëzuan në gradën episkopale arkimandrit Vangjel Çamçen, i cili pas dorëzimit mori emrin Agathangjel. Në ceremoninë e dorëzimit merrnin pjesë Kryeministri Koço Kota, deputetë, përfaqësuesi i Mbretit, kolonel Sereqi etj. Visarion Xhuvani foli për vullnetin e Mbretit dhe qeverisë për zgjidhjen e çështjes së Sinodit të Shenjtë. Hirësi Agathangjeli në fjalën e tij, vlerësoi vullnetin e Mbretit dhe të Kryeministrit dhe u zotua që do të plotësonte detyrat e ngarkuara. Më 13 shkurt 1929 Imzot Vizarioni, Imzot Viktori dhe Imzot Agathangjeli dorëzuan në gradën episkopale atë Efthim Konomin, i cili mori emrin Eugjen[75]. Më 17 shkurt 1929 në katedralen e Ungjillëzimit në Tiranë u dorëzua në gradën episkopale Thanas Ambrozi.

---

[73]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 182-186.

[74]-Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, 55, Tiranë 2007, faqe 126.

[75]-Atë Efthim Konomi (Imzot Eugjeni) ka lindur në vitin 1870, në Hoshtevë të Zagorisë. Fillimisht ka punuar si mësues dhe më vonë ka studiuar teologji në Athinë. Pasi u dorëzua prift në Kavallë u kthye në atdhe dhe u emëruan në Mitropolinë e Korçës, ku është shquar për atdhetari. Alqi Jani, *Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva*, Republika, 27 maj 2009, faqe 14-15.

Të nesërmen më 18 shkurt 1929 Këshilli i Lartë Kishtar formoi Sinodin e Shenjtë[76] (Fig.11) të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga: 1-Visarion Xhuvani, (Fig.12) Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. 2-Agathangjel Çamçe, (Fig.13) Episkop i Beratit dhe Vlorës. 3-Thanas Ambrosi, (Fig.14) Episkop i Gjirokastrës, Delvinës dhe Himarës. Ndërsa Eugjeni u caktua Episkop ndihmës i Kryeepiskopit. 4-Ikonom i Madh Mitrofor Atë Vasil Marku. Mitropolia e Korçës kishte mbetur pa mitropolit, prandaj Pleqësia Kishtare vendosi që Hirësi Visarioni të ishte zëvendësisht Mitropolit i Korçës[77].

Në mbledhjen e parë të Sinodit, pas votimit të anëtarëve të zgjedhur Fortlumturia e tij, Visarioni u zgjodh kryetar i Sinodit të Shenjtë të Kishës së Shqipërisë. Hirësi Eugjeni u emërua ndihmës i Kryeepiskopit, si Episkop i Peshkopisë. Dr. Zoi Xoxa u emërua Sekretar i Sonodit. Rezidenca e Sinodit të Shenjtë u caktua në Korçë. Sinodi ngriti një komision për përkthimin e librave liturgjikë, në përbërje të së cilit qenë emra të njohur si prof. Aleksandër Xhuvani, Zoi Xoxa, Mihal Sherko etj.

Sinodi i Shenjtë me anën e një shkrese[78] iu drejtua Kryeministrit Koço Kota. Mesha e parë episkopale u celebrua më 24 shkurt 1929, në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Gjatë meshën atë Vasil Marku u dorëzua Ikonom i Madh Mitrofor. Në përfundim të liturgjisë atë Vasil Marku i dorëzoi Fortlumturisë së Tij, Visarionit, kryqin historik të Kongresit të Beratit. Kjo ishte shenja simbolike e dorëzimit përfundimtar të kryesisë së kishës.

Sipas ligjit për bashkësitë fetare dhe Statutit të Kongresit të Beratit duhej që Sinodi i Shenjtë të pëlqehej nga Mbreti dhe anëtarët duhet të betoheshin para tij. Më 26 shkurt të vitit 1929, Sinodi i Shenjtë bëri betimin para Naltmadhnisë së Tij, Mbretit Zog I dhe u dekretua nga Qeveria Shqiptare. Në mbarim të ceremonisë së betimit të episkopëve e mori fjalën Mbreti, i cili ndër të tjera tha: "*Shqiptari lirinë e ka aq të nevojshme dhe të shtrenjtë sa dhe jetën e tij. Si gjithë bota edhe shqiptari lirinë e ka fitue me mundime të çmueshme. Në këtë vepër të randësishme duket edhe mundi i priftnave shqiptarë. Bota le ta dijë se shqiptari, i cili me modesti të plotë*

[76]-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,* Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 65.

[77]-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 353; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 70; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 163; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 182-204; Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000; faqe 166; Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Paortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare*, në në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,* Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 64-65; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 98; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *1929, si u krijua Sinodi i parë i KOASh-it*, Tema, 16 prill 2005, faqe 9.

[78]-Në shkresë thuhet: "I shkëlqyeshëm Kryeministër! Sipas vendimit të marrun më datë 18 shkurt 1929 nga ana e hierarkisë shqiptare dhe në bazë të kanoneve kishtare, si dhe në konformitet të plotë me statutin kishtar të votuem në Berat, u formue Sinodi i Parë i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Kini mirësinë me pranue nderimet tona të nalta. Kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kryeepiskop i Tiranës, Durrësit, Fortlumtunia e Tij, Visarioni".

respekton të drejtat e popujve të tjerë, nuk lejon dhe nuk i ulet asnji force në botë që do të dhunojë të drejtat që ia ka falë natyra. Mos harroni se në kohën e detyrës së shenjtë, për të cilën jeni ngarkue, para çdo gjaje dhe mbi çdo send duhet të jetë Atdheu".

Fortlumturia e Tij, Kryeepiskop Visarioni tha: "Sinodi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare e ndjen veten shumë të lumtun dhe në thellësi të shpirtit asht tepër mirënjohës për këtë nder të madh historik që ka në këtë minutë. Si shqiptar dhe duke ndjekun gjurmët e stërgjyshëve tanë, na e ka anda shumë lirinë dhe jemi tepër të gëzuem jo vetëm të predikojmë, por edhe dëshmorë të biem për lirinë tonë kombëtare kur ta dojë nevoja dhe kur të urdhënojë Naltmadhnia Juej. Sinodi asht tepër i lumtun të deklarojë botnisht para Naltmadhnisë Suej se nuk do t'i përulet asnji fuqie në botë, e cila mund të kishte për qëllim t'i sjellë çfarëdo pengimi misionit tonë fetar kombëtar dhe sidomos misionit të veçantë shtetnor. Kisha Ortodokse Autoqefale asht nji krijim i shkëlqyeshëm i dorës së fortë dhe shpëtimtare tuejën, tue fillue qysh prej Kongresit të Beratit në vjeshtën e vitit 1922 e tue përfundue në rregullimin definitiv të sotëm. Nji i vetëm simbol ka me qenë gjithmonë udhëheqësi ynë paralel me detyrat tona shpirtnore për naltësimin e Atdheut. Me mbajtjen e stemës historike të Mbretit të Shqiptarëve Zogu I jemi të sigurtë se do të mbërrijmë realizimin e misionit tonë të naltë dhe me gjithë zemër thërrasim: "Rroftë Mbreti i Shqiptarëve"[79].

Më 21 shkurt 1929 Patriarku Ekumenik, Vasili u dërgoi një letër kishave autoqefale që qenë në varësinë e tij, me anën e së cilës i njoftonte se një prift kundërshtar duke bashkëpunuar me një episkop të huaj kanë bërë dorëzimin e parregullt të episkopëve, në kundërshtim me Protokollin e Tiranës, pavarësisht se nga kisha mëmë qenë bërë të gjitha përpjekjet për shpalljen kanonike të autoqefalisë. Patriarkana Ekumenike, si pushteti më i lartë kishtar i quajti antikanonike dorëzimet e Visarion Xhuvanit, Agathangjelit, Eugjenit dhe Ambrozit. Në mbledhjen e radhës së Sinodit të Shenjtë të patriarkanës Elumenike, që u mbajt më 5 mars 1929 u vendos mosnjohja e Ikonomit të madh Mitrofor Vasil Marku[80]. Sinodi theksonte se qeveria shqiptare kishte izoluar Imzot Kristoforin dhe kishte dëbuar Imzot Jerotheun[81].

Më 16 mars 1929 Fortlumturia e Tij, Kryeepiskop Visarioni u dërgoi një qarkore mërgatave shqiptare në Uashington, Ankara, Aleksandri, Bukuresht, Sofje dhe Athinë, ku i njoftonte për krijimin e Sinodit të Shenjtë. Ai kërkoi mbështetjen e gjithë shqiptarëve për këtë fitore historike të arritur me aq mund e përpjekje. Mërgatat e Bullgarisë dhe të Turqisë e mirëpritën lajmin dhe menjëherë nisën falënderimet e

---

[79]-*Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 142-143; Gazeta e Re, viti I, nr. 98, 27 shkurt 1929.

[80]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 230-231.

[81]-Në vitin 1929 Imzot Jerotheu pasi u largua nga Shqipëria u vendos në Skitin e Shën Anës në Shën Elefteri Vuleftira në Malin Athos. Për 27 vjet rresht ka qenë i vetmi episkop në Malin e Shenjtë. Imzot Jerotheu fjeti përgjithmonë më 1 shkurt të vitit 1956. Ceremonia e përmortshme u zhvillua më 2 shkurt në katedralen e Shën Dhimitrit në Selanik. Fjalën e rastit e mbajti teologu me origjinë nga Përmeti Vasil Joanidhi. Varri i Imzot Jerotheut është në Skitin e Shën Anës në Malin Athos. Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9; Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 133-134.

urimit. Theofan Noli qortonte rrugën e ndjekur për krijimin e Sinodit të Shenjtë, me ndihmën e Kishës të Serbisë, mirëpo nga ana tjetër ishte optimist se kjo rrugëzgjidhje shmangu vendosjen e kishës nën tutelën e kishës së Greqisë. Përfundimisht vetëm kisha e Trinisë së Shenjtë në Boston[82] u bashkua me Kishën Shqiptare më 14 qershor 1933. Një kundërshtar i flaktë ishte Koço Tasi, i cili nisi një fushatë kundër zgjidhjes së gjetur për çështjen kishtare. Tasi ishte mbështetës i një Kishe Autoqefale të drejtuar nga episkopë shqiptarë, me gjuhë meshimi shqipen, por i frikësohej një sundimi të mundshëm të shumicës myslimane mbi pakicën ortodokse[83].

Kongresi i Korçës. Imzot Visarioni menjëherë filloi të konsolidonte strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ai thirri Kongresin e dytë[84] (Fig.16) Kleriko-laik në qytetin e Korçës më 16 qershor të vitit 1929. Organizimi i Kongresit kishte nevojë për fonde dhe ato në pjesën më të madhe u siguruan nga shteti shqiptar i kohës. Në Kongres (Fig.17) u zgjodhën intelektualët e shquar të vendit[85], klerikë me merita kishtare, tregtarë dhe zanatçinj, të gjithë bij të bindur dhe besimtarë të aftë për të mbrojtur Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

---

[82]-Kryesia e Kishës Autoqefale, mori nga Bostoni i Amerikës këtë telegram: "Kisha Shën Trinia dëshiron të jetë nën juridiksionin e Kishës Autoqefale të Shqipnisë dhe në pranohemi lajmëronani telegrafisht se përgjigja asht pague stop. Jemi kundër Peshkopatës këtushme se s'ka lidhje me Kishën në Shqipni. Për komisionin: Kristo Josef, Kryetar d.v. Boston, më 25-X-1930". *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 208.

[83]-Koço Tasi, *Shqiptarëvet të Krishten bashkëpunëtorë të Muhamendanëvet*, Athinë 1929.

[84]-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i dytë panortodoks i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 65.

[85]-Delegatët e këtij Kongresi qenë: Delegat i Tiranës Kryepeshkop Visarioni d.v. Delegat i Tiranës Dr Athanas Shundi d.v. Delegat i Tiranës Dr Zoi Xoxa d.v. Delegat i Shpatit Taq Buda d.v. Delegat i Shkodrës Atë Velisha Popoviq Delegat i Shkodrës Naim Plevneshi d.v. Delegat i Shkodrës Mitro Llazareviq d.v. Delegat i Korçës Ik. i M. Mitrofor at Vasil Marko d.v. Delegat i Korçës Stavraq Ballauri d.v. Delegat i Korçës Thoma Turtulli d.v. Delegat i Korçës Vasil Avrami d.v. Delegat i Korçës Sotir Kotta d.v. Delegat i Përmetit Dhimitri Kacimbra d.v. Delegat i Gjinokastrës Thoma Papapano d.v. Delegat i Gjinokastrës Kostandin Lito d.v. Delegat i Gjinokastrës Episkop Ambrozi d. v. Delegat i Gjinokastrës Ikonom Papavlashi Delegat i Libohovës Dhimosthen Haxhoglu d.v. Delegat i Leskovikut Andon Kito d.v. Delegat i Lushnjës Llazar Bozo d.v. Delegat i Vlorës Kristaq Ikonomi d. v. Delegat i Vlorës Atë Isaia d.v. Delegat i Vlorës Kristo Karbunara d.v. Delegat i Delvinës Mihal Maksakuli d.v. Delegat i Sarandës Apostol Dhima d.v. Delegat i Konispolit Loli Qesko d.v. Delegat i Durrësit Kristaq Zaguridhi d.v. Delegat i Durrësit Vasil Bakalli d.v. Delegat i Durrësit Moisi Popa d.v. Delegat i Kavajës Kleanth Mineu d.v. Delegat i Himarës Dr Mihal Cane Delegat i Beratit Episkop Agathangjeli d.v. Delegat i Beratit Dr Nikolla Haxhistasa d.v. Delegat i Beratit Ikon. at Theodhor Brisku d.v. Delegat i Fierit Jovan Xoxa d.v. Delegat i Mallakastrës Ikonom atë Polizoi d.v. Delegat i Kolonjës (Ersekë) Petro Prodani d.v. Delegat i Bilishtit Petro Ilia d.v. Delegat i Tepelenës Dhimitër Mole d.v. Delegat i Elbasanit Kostaq Cipo d.v. Delegat i Elbasanit Kov Deliana d.v. Delegat i Elbasanit Dhimitër Papajani d.v. Delegat i Poradecit Spiro Naço d.v. Delegat i Dibrës Stavrofor Ik. Josifi d.v. Delegat i Dibrës Dr Filip Papajani d.v. Delegat i Dibrës Gavril Lasku d.v. Komisioni i Qeverisë pranë Kongresit Panorthodhoks Shqiptar në Korçë: Vasil Bidoshi d.v. Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 215; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 206-207; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 104-106; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Historia e fshehur e Kongresit të dytë të KOASh-it*, Tema, 5-6 qershor 2005, faqe 12-13.

Platforma kishtare e Kongresit u përcaktua me vëmendje të madhe nga Visarion Xhuvani. Në të u parashikuan vendimet e pritshme, detyrat e komisioneve për organizimin e Kongresit dhe ceremonitë festive. Bazën kryesore të Kongresit e përbënte zgjidhja e drejtë e interesave fetaro-kombëtare, sigurimi i indipendencës dhe i tërësisë territoriale të vendit. Vendimet e tij duhej të mos lejonin në të ardhmen asnjë veprim që të binte ndesh me interesat kishtaro-kombëtare dhe brezat e rinj të ishin syhapur e të kujdeseshin për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në të gjitha materialet e Kongresit vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit të kanoneve të shenjta. Sinodi i Shenjtë kishte vendosur që Kongresin e dytë do ta drejtonte kjo pari: Kryetar Imzot Visarioni, nënkryetar Vasil Avrami, kryesekretar Dr. Zoi Xoxa dhe kujdestar Thoma Papapano. Më 16 qershor të vitit 1929, të 46 delegatët përfaqësues të klerit dhe të ortodoksëve shqiptarë u mblodhën në Korçë për të filluar punimet e Kongresit të dytë Kishtar. Në fjalën e tij Imzot Visarioni parashtroi përmbajtjen kryesore të Statutit dhe të Rregullores së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Kongresi vazhdoi punimet 15 ditë. Mbasi miratoi statutin në parim, vendosi të krijojë një komision të posaçëm të përbërë nga: Mitrofor Vasil Marku, Vasil Avrami, Dhimitër Kacimbra, Taq Buda, Vasil Bakalli, Athanas Shundi, Llazar Bozo, Nikolla Haxhinasto, Kristaq Ikonomi, Thoma Papapano, Mihal Cani, Milto Maksakuli dhe dr. Zoi Xoxa, të cilët do t'i jepnin statutit formën përfundimtare. Mbas 15 ditë diskutimesh në orën 7.30 të datës 29 qershor të vitit 1929 të gjithë delegatët firmosën dokumentet për tu miratuar në statut përfundimtar. (Fig.18) (Fig.19) Ky Statut[86] e vuri në themele të qëndrueshme Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Në vijim Kongresi i dytë kishtar i Korçës shqyrtoi Rregulloren[87] e Administrimit të Përgjithshëm të Kishës, e cila përcaktonte të drejtat dhe detyrat e çdo forumi drejtues të Kishës. Për hartimin e Rregullores të Administrimit të Përgjithshëm të Kishës kontribut të shquar kanë dhënë dhespotët Agathangjel e Ambroz, Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku, si dhe avokat Ilia Kota, Vasil Avrami, Thoma Papapano, dr. Mihal Cani, Kristaq Zaguridhi, Vasil Bakalli, dr. Zoi Xoxa e në mënyrë të veçantë Kov Deliana. Me punën e tyre të përbashkët më 20 korrik të vitit 1929 u miratua Rregullorja.

[86]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, në "Gazeta Zyrtare", Nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950; Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 165; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 226-241; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si zgjidhej kryepeshkopi ortodoks në bazë të Statutit*, Tema, 7 qershor 2005, faqe 12-13; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Kryetari i KOASh Visarion Xhuvani shpjegon statutin*, Tema, 8 qershor 2005, faqe 12-13; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 187; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 107-121.

[87]-Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Mihal Duri, Tiranë, 1955; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 209-223; Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 246-260; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Çfarë parashikonte Rregullorja e KOASh-it*, Tema, 9 qershor 2005, faqe 12-13; Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Roli i Mbretit Zog në krijimin e KOASh-it*, Tema, 10 qershor 2005, faqe 12-13.

Më 9 korrik të vitit 1929 u dekretua ligji për komunitetet fetare, i cili zëvendësonte atë të vitit 1923. Sipas ligjit të ri komunitetet fetare duhet të ishin persona moralë, të cilët gëzonin të drejtat e përcaktuara me ligj. Komunitetet fetare gëzonin të gjitha të drejtat që parashikonte ligji, vetëm kur statuti i paraqitur prej tyre, pranohej nga Këshilli i Ministrave dhe dekretohej prej Mbretit. Statutet nuk duhet të binin ndesh me ligjet e shtetit. Në to theksohej që kryetarët e komuniteteve fetare të ishin shtetas shqiptarë mbi moshën 25-vjeçare dhe prej fisit e gjuhës shqiptarë. Emërimi i tyre dekretohej me dekret mbretëror. Ministria e Drejtësisë kontrollonte zbatimin e legjislacionit dhe miratonte buxhetet dhe rregulloret e komuniteteve fetare[88]. Statuti i miratuar në Kongresin e Korçës, më 14 gusht 1929 u botua në Fletoren Zyrtare[89].

Le të sqarojmë se çfarë ngjau me Mitropolitin e Cetinjës së Malit të Zi, Imzot Viktorin, (Fig.15) i cili së bashku me Imzot Visarionin dorëzuan në gradën episkopale anëtarët e Sinodit të Shenjtë. Më 16 qershor të vitit 1929, përpara hapjes zyrtare të Kongresit të Korçës, Fortlumturisë së Tij, Kryeepiskop Visarionit i vjen një telegram, ku me anën e së cilit qeveria urdhëronte që Imzot Viktori të mos merrte pjesë në meshën episkopale, por të largohej nga Shqipëria. Imzot Visarioni i lexoi tekstin e telegramit Viktorit dhe ky i fundit iu përgjigj: *Pranova të vij në Shqipëri dhe të kontribuoj në formimin e Kishës Autoqefale të Shqipërisë, pasi më premtuat se do të isha peshkop i Shkodrës dhe anëtar i Sinodit të Shenjtë me të drejta të barabarta. Për të ardhur në Shqipëri nuk kërkova as lejen e Patrikanës së Beogradit, sepse e dija që Beogradi nuk do t'i pëlqente këto kushte*. Visarioni i përmendi Viktorit se emri i tij do të shkruhej me gërma të arta në historinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe se qeveria shqiptare i pati dhënë dekoratën[90] më të madhe për shërbimet që i bëri kishës sonë. Imzot Viktori u kthye në Cetinjë[91].

Në Kongresin e Korçës u vendos ndarja kishtare në bazë dioqeze duke formuar dioqezat e Korçës, Durrësit, Beratit dhe Gjirokastrës. Prej vitit 1922 e deri më mars 1930 qendra kishtare ishte Korça, ndërsa duke filluar nga prilli i vitit 1930 qendra kishtare kaloi në Tiranë duke marrë emrin Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Rezidenca e Sinodit të Shenjtë u vendos në shkollën dykatëshe, në oborrin e kishës së Ungjillëzimit[92].

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me Sinodin e Shenjtë, me Statutin dhe me Rregulloren e Administrimit të Përgjithshëm përmbushi kërkesat kanonike të Autoqefalisë dhe e meritonte Tomin e Patriarkanës së Stambollit. Për fat të keq nuk

---

[88]-*Dekret-Ligjë mbi formimin e Komunitetet Fetare*, Korçë, 1929, në "Fletorja Zyrtare", Nr. 38, 16 korrik 1929, faqe 1-3.

[89]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Korçë, 1929, në "Fletorja Zyrtare", Nr. 45, 14 gusht 1929, faqe 1-8.

[90]-Më 25 shkurt 1929 Mbreti Zogu I e pati dekoruar patrikun e Serbisë, Dhimitrin, me "Kordonin e madh të Urdhërit të Skënderbeut", ndërsa Hirësi Viktorin me "Oficer i Madh i Urdhrit të Skënderbeut". *Patriku serb dhe Vikari i tij u dekoruan*, Gazeta e Re, Nr. 97, 26 shkurt 1929, faqe 1.

[91]-Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, 55, Tiranë 2007, faqe 131-132.

[92]-Shkolla qe dykatëshe dhe kishte 6-7 dhoma dhe dy sallone. Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 16.

ndodhi kështu, u deshën edhe gati nëntë vjet që të ulej zemërimi i Patriarkanës Ekumenike. Kjo e fundit arriti të bllokonte ndërkombëtarizimin e Kishës Shqiptare.

Përpjekjet për ndërkombëtarizimin e kishës. Në vitin 1931 Fortlumturia e Tij Visarioni, me ftesë të Lordit Dikson, mori pjesë në Kongresin e Aleancës Ndërkombëtare për Paqe në Kembrixh të Anglisë. Kongresi u zhvillua më 1 deri në 4 shtator 1931 dhe kisha shqiptare përfaqësohej nga Kryeepiskop Visarioni dhe Stavro Stavri. Përfaqësia e kishës shqiptare u prit nga Lordi Dikson, ndërkohë që përfaqësuesit e Patriarkanës Ekumenike dhe të Patriarkanës së Serbvisë e kundërshtuan praninë e Visarionit në kongres. Përfaqësuesi i Patriarkanës Ekumenike u largua nga kongresi në shenjë proteste, ndërsa përfaqësuesi i Patriarkanës së Serbisë, Irinej nuk pranoi ta njihte Visarionin, në shenjë hakmarrjeje për dëbimin e Hirësi Viktorit nga Shkodra. Në krah të përfaqësisë shqiptare u gjend Kryeepiskopi i Sofjes, Stefani. Me të u bashkua edhe Patriku i Rumanisë[93].

Në vitin 1932 një përfaqësi e kishës shqiptare që përbëhej nga Kryeepiskop Visarioni dhe Kristo Trapo mori pjesë në Konferencën e Bashkimit Botëror të Kristianizmit, që u mbajt në Bukuresht, ku zhvilloi bisedime me Patrikun Miron, i cili shprehu simpati për Kishën e Shqipërisë. Kryeepiskop Visarioni u prit në audiencë nga Mbreti i Rumanisë Karoli II, i cili e garantoi Xhuvanin se ishte dashamirës i kishës shqiptare. Madje, kryeministri rumun Jorga gjatë takimit kërkoi njohjen e autoqefalisë shqiptare, por Patriku Miron u shpreh se nuk mund ta anashkalonte Patriarkanën Ekumenike për këtë çështje delikate. Megjithatë Patriku i Rumanisë, Miron premtoi se do të ndërmjetësonte pranë patriarkanës Ekumenike për njohjen e kishës shqiptare[94].

Në shtator të vitit 1933, Kryepiskop Visarionin e ftuan në Kongresin e Aleancës Ndërkombëtare për Paqe, që u mbajt në Sofje të Bullgarisë. Gjatë ditëve të qëndrimit në Sofje, Fortlumturia e Tij Visarioni u dekorua nga Mbreti i Bullgarisë Boris me urdhërin "Kryqi i madh kombëtar i bullgarëve", ndërkohë që Kryeepiskopi i Sofjes, Stefani qe dekoruar më parë nga Mbreti Zogu I me “Kordonin e Madh të Urdhërit të Skënderbeut”. Kongresi i Aleancës Ndërkombëtare për Paqe u çel më 15 shtator 1933. Kryeepiskopi Visarion u ul në krahun e djathtë të Lordit Dikson dhe fjalimi që mbajti u prit mirë nga pjesëmarrësit. Kryeepiskopi u prit nga Mbreti Boris, i cili shprehu simpati për popullin shqiptar, Mbretin Zogu I dhe Kishën Autoqefale. Menjëherë pas këtij takimi, Kisha e Bullgarisë e njohu Kishën e Shqipërisë dhe Sinodin e Shenjtë të saj[95].

---

[93]-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 151, Dosja nr. 219, viti 1931; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 267; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 156-159; Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 6 nëntor 2007, faqe 15.

[94]-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 251, Dosja nr. 271, viti 1932, fl. 1-43; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 159-164; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 268; Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 6 nëntor 2007, faqe 15.

[95]-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 855, Dosja nr. 276, viti 1933; Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 269; *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 233-236; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i*

Më 30 qershor të vitit 1935 Kryepiskop Visarioni referoi për "Gjendjen aktuale të kishës me shtetin dhe influenca e kishës në shoqërinë kristiane të Shqipërisë" në Konferencën e Kishave të Ballkanit që u mbajt në Herzeg Novi të Jugosllavisë. Kryeepiskopi u prit me nderime nga Mitropoliti i Cetinjës, Gabrieli.

Kryepiskop Visarioni ka qenë pjesëmarrës në Mbledhjen e Përbotshme të Kishave në Montro të Zvicrës, që u mbajt në gusht të vitit 1935, ku u takua me Përfaqësuesin e Patriarkanës Ekumenike dhe të dërguarin e Kishës së Greqisë. Prej aktivizimit të Kryepiskop Visarionit nëpër veprimtaritë ndërkombëtare, qëndrimi i disa kishave ortodokse ndaj kishës sonë filloi të ndryshojë. Kjo u duk në telegramet e urimit për Krishtlindjet e vitit 1935 që mori Fortlumturia e Tij nga primatët e kishave të Serbisë, Rumanisë, Polonisë dhe të Bullgarisë[96]. Përpjekjet e Visarionit vijuan me dërgimin e dy telegrameve: më të parin uroi Mbretin e Grekëve, Jorgo II, për rikthimin në detyrë dhe më të dytin njoftoi Patrikun Ekumenik, Foti, se kishte meshuar greqisht me rastin e Krishtlindjeve. Visarioni e përfundonte telegramin e tij me një lutje drejtuar Tërëshenjtërisë së Tij, Patrikut Elumenik duke i kërkuar ndjesë[97], por nuk mori përgjigje. Patriarkana kërkonte me çdo kusht dorëheqjen e tij. Në 26 maj të vitit 1936, Kryepiskop Visarioni dha dorëheqjen[98] nga kryesia e kishës. Mbas 26 majit të vitit 1936, dita kur dha dorëheqjen, Visarionit iu dha pensioni jetik prej 500 fr. ar nga qeveria me dekret të veçantë. Ai jetoi në pronat e veta[99] të blera në

---

atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare, Tiranë 2003, faqe 164-170; Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 6 nëntor 2007, faqe 15.

[96]-Andrea Llukani, *Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse*, 55, 21 maj 2004, faqe 18.

[97]-Telegram: Nalt Shenjtënisë së Tij FOTIOS, Patriarh Ekumenik. Mbas Meshës hyjnore të soçme në gjuhën Helenike të Krysostomit, në të cilën kemi lutun Zotin për Shenjtënin Tuej, tue marrë kurajo prej ndjenjave dhe inspiratave që festat e Lindjes së Shpëtimtarit Tonë Jisu duhet të Na sjellin dhe tue dëshirue me besue se, mbas të shtatit vit, asht hedhun ma nga ana e Patriarhisë së Shenjtë në harresën e ndjesës çdo vepër e padëshirueshme atje, por e cila u konsiderue si detyrë e domosdoshme nga ana e Jonë për të mirën e Orthodhoksisë së Shqipnisë dhe tue qenë të sigurtë se i Madhi i Parë ndër të Parët e Orthodhoksisë mallëngjehet kur konstaton sinqeritetin e Kryebijvet të Vet. Ju lutemi me respektin ma të thellë e me devocion me denjue me pranue përshëndetjet dhe urimet ma të mira të Modestisë Sonë si dhe ato të Orthodhoksisë Shqiptare për jetëgjatësinë dhe lumtuninë e Shenjtënisë Suej dhe të lavdueshmes Patriarhisë Ekumenike stop. I lutemi gjithashtu Shenjtënisë Suej me bekue Modestin Tonë si edhe grigjën Tonë të vogël shpirtnore, të cilën Zoti i mëshirshëm Na e ka besue me anë të hirit të Perëndisë e për me i shërbye Orthodhoksisë këtu, e cila ka nevojë ma shumë se kurdoherë sot për solidarësinë e të gjitha Kishave Motra më Jesu Krishtin. Puthim të Djathtën Tuej të Shenjtë. VISARION. Kryepeshkop i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipnisë. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 302; Revista Predikimi, Tiranë, 25.12.1935.

[98]-Më 29 maj 1936 gazeta “Arbënia” botoi të plotë aktin e dorëheqjes së Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 311-321.

[99]-Banesa dhe pronat e tij tokësore janë të regjistruara në regjistrin hipotekor Nr. 42 datë 17 janar 1935, në të cilin figurojnë dy kulla (banesa) me anekset përkatëse të kufizuara në të katër anët me pronat e veta, si dhe në regjistrin hipotekor Nr. 12, datë 7 janar të vitit 1937 ku figurojnë 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) metra katrorë në fshatin Shkozë (Kodra e Priftit) me livadhe dhe zabele. Në këtë vend të qetë Visarion Xhuvani jetoi dhe studioi librat e shenjtë. Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008, faqe 170-171; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 208.

vitin 1935 nga Hamdi Tabaku dhe Myftar Disha, që ndodhen në fshatin Shkozë te Kodra e Hajdarit, e cila sot quhet Kodra e Priftit. Me këtë emërtim populli i Tiranës përjetësoi vendin ku banoi Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Visarion Xhuvani.

Tomi i Autoqefalisë. Më 4 janar 1933 Kristofor Kisi, me anën e një letre i parashtroi Kryeepiskop Visarionit se ishte i gatshëm ti shërbente kishës shqiptare, pasi kishte kaluar katër vjet i mbyllur në manastir. Pretendimi i Kisit ishte mitropolia e Korçës, e cila kishte mbetur pa episkop. Xhuvani nuk iu përgjigj kërkesës së Kisit. Mirëpo, Kisi me ndërmjetësinë e Koço Kotës mundi të siguronte një takim me Mbretin Zogu I. Gjatë takimit Kisi i kërkoi të merrte drejtimin e një episkopate. Në nëntor 1933 Sinodi i Shenjtë e emëroi Kristofor Kisin Mitropolit të Korçës. Në këto kushte Sinodi i Shenjtë përbëhej nga: Fortlumturia e Tij, Visarioni, Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit; Hirësi Kristofor Kisi, Episkop i Korçës; Hirësi Agathangjel Çamçe, Episkop i Beratit; Hirësi Ambroz Nikolla, Episkop i Gjirokastrës, Delvinës dhe Himarës; Hirësi Eugjen Hoshteva, Episkop Ndihmës i Peshkopisë dhe Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku[100]. Në vitin 1934 Eugjeni dha dorëheqjen dhe u tërhoq në vendlindjen e tij, në Hoshtevë, ndërsa Episkop Ambrozi ndërroi jetë më 20 maj 1934. Sinodi i Shenjtë ia besoi Kisit mbikëqyrjen e Episkopatës së Gjirokastrës.

Më 1936 qeveria shqiptare dërgoi në Athinë kryeministrin Koço Kota për të biseduar me përfaqësuesit e Patriarkanës Ekumenike. Pas kësaj në nëntor të vitit 1936 erdhën në Tiranë Pandelejmon Kotoko, Pandeli Evangjeli dhe Vasil Avrami për të biseduar me Kristofor Kisin. U vendos që një delegacion i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë i përbërë nga Imzot Kristofori dhe Josif Kedhi të shkonte në Athinë më 20 shkurt 1937 për të biseduar me Mitropolitin e Trapezuntës Krisanthin. Pas bisedimeve në Athinë delegacionit iu shtuan edhe dy kandidatët për episkopë Evlogjio Kurilla dhe Pandelejmon Kotoko. Kështu përfaqësia u nis për në Konstandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike nënshkruan marrëveshjen. Çështja para se të jepej Tomosi ishte falja e episkopëve. Agathangjel Çamçe e dorëzoi kërkesën për falje më 10 mars 1937, ndërsa Atë Vasil Marku më 20 mars 1937. Patriarkana Ekumenike i fali.

Më datën 11 prill 1937 në Kishën e "Trinisë së Shenjtë" të Halkit u bë dorëzimi në gradën episkopale i Pandelejmonit, dhe po atë ditë në Kishën e "Shën Gjergjit" në Fanar u dorëzua Evlogjio Kurilla. Kështu më 12 prill 1937 Patriku Veniamin dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës nëshkruan Tomin Patriarkal të njohjes së Autoqefalisë së Kishës Ortodokse të Shqipërisë. Tomi iu dorëzua Imzot Kristoforit duke e caktuar atë si Kryeepiskop të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Ceremonia e dorëzimit të Tomit u zhvillua në Sallën e Madhe të Patriarkanës, me pjesëmarrjen e Patrikut Ekumenik Veniaminit, anëtarëve të Sinodit të Shenjtë të Patriarkanës, Konsullit të Shqipërisë në Stamboll Asaf Çaçulit etj[101].

[100]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 270-271.

[101]-Apostolou Glavina, *H Orthodhoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Iperesia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998, faqe 66.

Pas dhënies së autoqefalisë dy mitropoli u bënë episkopata, kurse episkopata e tretë, ajo e Gjirokastrës, u formua nga ndarja e Mitropolisë së Drinopolit. Patriarkana Ekumenike, si çmoi mirë nevojat fetare dhe kishtare të popullit ortodoks të Shqipërisë, i cili ndodhet në eparhitë e Korçës, Durrësit, Beratit dhe të Gjirokastrës, njoftoi autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë me anën e Tomit[102] Patriarkal e Sinodik, që u lëshua më 12 prill 1937[103].

Para se të shpallej autoqefalia ishin bërë këto veprime kishtare prej Patriarkanës: 1-Duke marrë parasysh se qyteti i Tiranës, që ndodhet në mitropolinë e Durrësit, është shpallur kryeqytet i Mbretërisë Shqiptare vendosi të marrë këtë titull: "Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe e Elbasanit". Episkop i kësaj mitropolie u zgjodh me votim të rregullt, episkopi i Sinadës Kristofor Kisi. 2-Duke gjykuar të nevojshme vendosi që mitropolia e Beligradit të marrë titullin: "Episkopata e Hirëshme e Beratit, Vlorës dhe Kaninës". Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Agathangjel Çamçe (pasi më parë iu hoq dënimi dhe u njoh dorëzimi i tij në gradën episkopale). 3-Për mitropolinë e Korçës u vendos që të marrë titullin: "Episkopata e Hirëshme e Korçës". Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Evllogjio Kurilla. 4-Gjirokastra si pjesë e shkëputur nga mitropolia e Drinopolit formoi një episkopatë të veçantë duke marrë titullin: "Episkopata e Gjirokastrës"[104]. Episkop i kësaj episkopate u zgjodh me votim të rregullt Pandelejmon Kotoko[105].

---

[102]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 168.

[103]-Viron Koka, *Përpjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 74.

[104]-Tomi Patriarkal dhe Sinodik për krijimin e Episkopatës së Gjirokastrës. +Veniamini me mëshirë të Perëndisë, Kryepiskop i Konstandinopojës, i Romës së Re dhe Patrik Ekumenik. Kisha ka për detyrë të saj të kujdeset për drejtimin dhe zgjidhjen e të gjitha çështjeve kishtare dhe duke patur të drejtën e vjetër të krijimit apo të suprimimit të dioqezave, sipas nevojave të çdo kohe, të rregullojë pjesërisht apo tërësisht qenien dhe qeverisjen e tyre. Meqënëse edhe në këtë rast, në mbledhjen e tanishme të Sinodit u pa se një pjesë e Mitropolisë së Shenjtë të Drinopolit e Gjirokastrës, pas shpalljes në kohët e fundit të pavarësisë së Mbretërisë Shqiptare, përfshihet në territorin e saj, u gjykua se është më e dobishme dhe më e përshtatshme me gjendjen e tanishme, të shkëputet nga kjo pjesa tjetër e dioqezës së shenjtë të lartpërmendur dhe të nderohet e të ngrihet në dioqezë kishtare më vete, sot për sot nën vartësi dhe drejtim nga Froni ynë i Tërëshenjtë Patriarkal, Apostolik dhe Ekumenik dhe që në të ardhmen të bëjë pjesë edhe kjo në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që po formohet. Modestia jonë, duke gjykuar bashkë dhe me mitropolitët tanë të hirshëm, vëllezërit tanë të dashur bashkëmeshtarë më shpirtin e shenjtë, vendosëm dhe caktuam sinodikisht që: Pjesa e Mitropolisë së Tërëshenjtë të Drinipolit dhe Gjirokastrës, që ndodhet në Mbretërinë e Shqipërisë, të jetë që tani e tutje dioqezë kishtare më vete, me nderimin dhe vlerësimin e një aspirate dhe me emrin: "Episkopatë e Hirshme e Gjirokastrës", kryeprifti i vendosur në të me zgjedhje kanonike të emërohet: "Episkop i Hirshëm i Gjirokastrës" duke gëzuar të gjitha të drejtat që u takojnë kryepriftërinjve në aktivitet. Prandaj, si dëshmi, vërtetim dhe konfirmim të qëndrueshëm të atyre që gjykuan dhe vendosën kishtarisht, u bë dhe Tomi ynë Patriarkal e Sinosik, i regjistruar dhe i nënshkruar në Kodikun e Kishës sonë të madhe e të Shenjtë të Krishtit. Në vitin shpëtimtar 1937, muaji mars (30), periudhë e V-të, Patriku i Konstandinopojës Veniamin, Maksimi i Kalqidonës, Joaqimi i Dherkonit, Polikarpi i Prusës, Thomai i Prinqiponisë, Gjermanoi i Sardës, Gjenadi i Iliopojës dhe Thirës, Leonti i Theodoropojës, Konstandini i Irinopojës, Meleti i Kristopojës, Dorotheu i Laodicesë, Gjermanoi i Enit.

[105]-*Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së Kostandinopojës,* Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.

Patriarkana Ekumenike i dërgoi mesazh edhe Mbretit Zog dhe Kryeministrit Koço Kota. Delegacioni në pëbërje të së cilit qenë katër hierarkët e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë mbëriti në atdhe, të Dielën e Dafinës më 25 prill të vitit 1937. Me rastin e shpalljes së autoqefalisë në kishën katedrale të Tiranës u celebrua një liturgji panagjirike me pjesëmarrjen e hierarkëve dhe klerikëve të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe mbreti Zog. Nga episkopi i Gjirokastrës Pandelejmon Kotoko u lexua[106] përmbledhja e Tomit Patriarkal për dhënien e autoqefalisë shqiptare. Më 24 maj 1937 Kryeepiskopi Kristofor me cilësinë e kryetarit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë iu përgjigj me një letër falënderimi Patrikut të Kostandinopojës Veniaminit.

Sinodi (Fig.20) i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë përbëhej nga Kryehirësia e Tij, Kristofori Kryeepiskop i Durrësit, Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Agathangjel Çamçe Mitropolit i Beratit, Evllogjio Kurilla[107] (Fig.21) Mitropolit i Korçës dhe Pandelejmon Kotoko (Fig.22) Mitropolit i Gjirokastrës. Në përbërje të Sinodit të Shenjtë ishte edhe Ikonomi i Madh Mitrofor Atë Vasil Marku. Sipas Tomit të Autoqefalisë, organi më i lartë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte Sinodi i Shenjtë, i cili përbëhej prej episkopëve kanonikë. Kryetar i

[106]-Viron Koka, *Përpjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 74.

[107]-Evllogjio Kurilla ka lindur në fshatin Ziçisht të Korçës në vitin 1880. Studimet e larta teologjike dhe filozofike në Universitetin e Athinës i ka përfunduar në vitin 1912, ndërsa më 1935 mbrojti doktoratën me temë "Voskopoja dhe Akademia e saj". Po këtë vit u emërua profesor i historisë në Universitetin e Selanikut. Evllogjio Kurilla ka marrë pjesë në përfaqësinë, e cila u nis për në Kostandinopojë më 28 mars 1937 dhe në prani të përfaqësuesve të Patriarkanës Ekumenike ka nënshkruar marrëveshjen për dhënien e Tomit të Autoqefalisë të Kishës Ortodose të Shqipërisë. Më 11 prill të vitit 1937 u dorëzua Mitropolit i Korçës në Kishën Patriarkale të "Shën Gjergjit" në Fanar. Imzot Kurilla organizoi shkollën katekiste të së dielës, themeloi korin kishtar nën drejtimin e Sotir Kozmosit, mblodhi materiale folklorike etj. Meritë e tij ishte çelja e seminarit "Jovan Banga" në qytetin e Korçës. Me gjithë këtë aktivitet produktiv Imzot Kurilla nuk u vlerësua, por përkundrazi qeveria shqiptare më 29 shtator të vitit 1939, me anën e një shkrese të firmosur nga Xhafer Ypi e njoftonte se duhej të largohej nga Korça, me pretendimin se nuk kishte nënshtetësinë shqiptare. Pasi u largua nga Shqipëria Imzot Kurilla u emërua profesor i historisë në Universitetin e Athinës. Emrin e Evllogjio Kurillës mbajnë shumë libra, artikuj, transkriptime, fjalime dhe predikime. Si specialist i paleografisë ai ka transkiptuar shumë kodikë dhe dorëshkrime që gjendeshin në Bibliotekën e Athinës. Ai ishte një njeri i shquar në fushën e letrave dhe të teologjisë. Në një libër të tij, botuar në vitin 1935, Kurilla ka shkruar se Voskopoja është themeluar nga shqiptarët dhe më tej është populluar nga popullsia shqiptare dhe vllahe. Gjithashtu ai theksonte se në Voskopojë u ngjiz ideja e bashkimit shqiptar dhe e shkrimit të gjuhës shqipe. Ky pohim dhe disa të tjera si ky, qenë shkaku që në vitin 1942 në një mbledhje të Senatit Akademik të Universitetit të Athinës, Evllogjio Kurillën e akuzuan si nacionalist shqiptar dhe tradhëtar, i cili e kishte kthyer katedrën e historisë së Universitetit të Athinës në një katedër antikombëtare. Imzot Evllogjio Kurilla vdiq më 21 prill të vitit 1961 në Athinë. Shërbesa e përmortshme u zhvillua në Mitropolinë e Athinës me pjesëmarjen e Kryeepiskopit të Greqisë Theoklitit dhe hierarkëve të tjerë. Për jetën dhe veprimtarinë e Mitropolitit të Korçës Evllogjio, foli episkopi i Gjirokastrës Pandelejmoni. Dr. Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 70-75; Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, Toena, Tiranë 2010, faqe 23; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 204-206.

Sinodit të Shenjtë do të ishte gjithnjë Kryeepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, i cili ka për detyrë që të kujtojë emrat e Primatëve të Kishave Ortodokse Autoqefale. Gjithashtu në Tomin e Autoqefalisë theksohet që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë duhet të marrë Miron e Shenjtë nga Patriarkana Ekumenike. Kjo e fundit njoftoi të gjitha Kishat Autoqefale të Aleksandrisë, Antiokisë, Jerusalemit, Greqisë, Polonisë, Qipros, Ivirisë, Sebisë dhe Rumanisë. Në maj të vitit 1937 Patriarkana Ekumenike i dërgoi Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Miron e Shenjtë. Gjithashtu ofroi edhe dy bursa studimi për në Shkollën Patriarkale të Halkit. Mbledhja e parë e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u bë më 9 korrik 1937 me qëllim që hierarkët të qenë njohur me nevojat e grigjës së tyre.

Në 17 prill të vitit 1937 Visarion Xhuvani i drejtohet me anën e një letre Mitropolitit të Trapezundës, Krisanthit, me anë të së cilës i lutet që të ndërhyjë në Patriarkanën Ekumenike të Stambollit, që ajo të heqi dorë nga zhveshja e funksioneve të tij. Me anë të kësaj letre Xhuvani i drejtohet Patrikut Ekumenik Veniaminit I. Letrën ia dorëzoi[108] Krisanthit më 28 prill 1937 ambasadori i Shqipnisë në Athinë, Rauf Fico. Përgjigja e Kostandinopojës qe e shpejtë, Visarioni falet, i njihet grada episkopale, por i jepet e drejta Sinodit të Tiranës që të vendosë për detyrën e re të tij. Më 5 gusht 1937 Visarion Xhuvani udhëtoi drejt Stambollit, ku u prit nga Patriku Veniamin. Gjatë takimit Xhuvani e falënderoi dhe i shprehu mirënjohjen Patrikut Veniamin[109].

Sinodi i vitit 1942. Në vitin 1942 Kryeepiskop Kristofori thirri teologun Irine Banushi dhe i propozoi të dorëzohej në gradën episkopale. Në shkurt të vitit 1942 Ilia u dorëzua në gradën episkopale në manastirin e Shën Naumit[110], që në atë kohë ishte në administrimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[111]. Pas dorëzimit ai

[108]-Teksti i letrës ka shpëtuar dhe ruhet në arkivin e Mitropolitit të Trapezundës Krisanthit.

[109]-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016, faqe 288.

[110]-Në kohën që Konferenca e Ambasadorëve ia ktheu manastirin Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene panairi i Shën Naumit zhvillohej regullisht. Për lehtësimin e pelegrinazhit të shtetasve shqiptarë në manastirin e Shën Naumit, Konferenca Ambasadorëve më 6 nëntor 1925, hartoi një rezolutë. Disa nga nenet e rezolutës janë: "U lejohet shtetasve shqiptarë, që në përputhje me dispozitat e këtij protokolli, të kalojnë lirshëm dhe gjatë gjithë vitit kufirin për të kryer pelegrinazh në manastirin e Shën Naumit. Kalimi i kufirit do të bëhet nga rruga, që nis nga fshati shqiptar Tushemisht, në jug të liqenit të Ohrit dhe të çon në manastirin e Shën Naumit, ose udha që ndjek pjesën e poshtme të luginës së Çëravës. Pelegrinazhi duhet të bëhet gjatë ditës, që nga lindja e diellit deri në perëndim të tij dhe pa armë. Pelegrinët duhet të jenë të pajisur me karta identiteti të lëshuara në gjuhën serbe e shqipe nga nënprefekti kompetent shqiptar. Këto karta përveç përshkrimit fizik të pelegrinit, do të përmbajnë datën e krijimit të tyre si dhe firmën dhe vulën e autoritetit që i ka lëshuar. Ato do të jenë të vlefshme për një vit dhe do të mund të rinovohen pas skadimit të këtij afati. Me hyrjen e tyre në territorin e Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene, pelegrinët, të pajisur me karta do të duhet të paraqiten në postën kufitare, e cila do të ngjisë vizën e saj dhe datën e kalimit mbi kartë. E njëjta procedurë do të duhet të kryhet në dalje. Pelegrinët mund të qëndrojnë në territorin e Mbretërisë Serbe-Kroate e Sllovene maksimumi tri ditë". Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Kristalina-KH, Tiranë 2012, faqe 673.

[111]-Në vitin 1925 Mbreti i Shqipërisë Ahmet Zogu i dhuroi Mbretit të Serbisë Pashiq Manastirin e Shën Naumit në shkëmbim të disa kullotave në Vermosh. Kjo marrëveshje u miratua edhe nga parlamentet e të dy vendeve. Historiani Paskal Milo në lidhje me këtë marrëveshje thotë: "Zakonisht nuk është

mori emrin Irine dhe me vendim të Sinodit të Shenjtë të K.O.A.Sh-it u emërua Episkop i Strugës[112], Prespës dhe Caredvorit. Pas bashkimit të trojeve shqiptare gjatë pushtimit italian, u bë edhe riorganizimi i kishës. Kështu katër episkopatave ekzistuese iu shtuan edhe ato të Prizrenit, të Peshkopisë dhe Strugës[113]. Mitropolit i kësaj të fundit u emërua Imzot Irine Banushi.

Gjithashtu Imzot Agathangjeli qëndroi në fronin e Mitropolitit të Beratit deri në maj të vitit 1942. Agathangjeli u fronëzua Mitropolit i Korçës, post të cilin e mbajti nga viti 1942 deri më 1946 kur edhe fjeti përgjithmonë më Zotin. Vendin e Imzot Agathangjelit si Mitropolit i Beratit e zuri Imzot Visarion Xhuvani. Pas këtyre zhvillimeve Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në vitin 1942 përbëhej nga Fortlumturia e Tij, Kristofor Kisi, Kryeepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Imzot Agathangjel Çamçe, Mitropolit i Korçës, Imzot Visarion Xhuvani, Mitropolit i Beratit dhe Imzot Irine Banushi episkop i Strugës, Prespës dhe Caredvorit. Gjithashtu anëtar i Sinodit të Shenjtë ishte edhe Ikonomi i Madh Stavrofor Vasil Marku.

Lëvizja Unite në Shqipëri. Misionarë të shumtë kishin ardhur nga Italia, të cilët duke përfituar edhe nga kushtet e mjeruara ekonomike të popullsisë dhe të klerit ortodoks filluan propagandën e tyre për kthimin e popullsisë ortodokse në unitë. Murgjit bazilianë, të ardhur nga Manastiri i Grotaferatës, pranë Romës filluan të jenë të pranishëm nëpër qytetet me popullsi ortodokse si në Gjirokastër, Vlorë, Berat, Korçë, Fier etj. Ata gjetën terren të përshtatshëm në punën e tyre misionare sepse e flisnin disi gjuhën shqipe dhe nga veshjet dhe liturgjia qenë njësoj si riti lindor ortodoks. E vetmja kishë unite gjendej në qytetin e Elbasanit, në lagjen Kala. Kisha unite u përurua më 25 gusht 1929 me praninë e autoriteteve lokale, ushtarake, prefektit të Elbasanit etj. Liturgjia hyjnore u celebrua nga atë Pietro Scarpelli, atë Jovan Toda dhe atë Naum Peqini. Këta dy të fundit kishin qenë meshtarët e kishës së Shën Kollit në Elbasan dhe

praktikë dhurimi i tokave të një shteti dhe ky ishte një veprim i gabuar dhe i dënueshëm duke ditur që Konferenca e Londrës e kishte njohur Shën Naumin si tokë shqiptare". Ndërsa Akademiku Arben Puto në lidhje me dhurimin e Shën Naumit thekson: "Sipas të drejtës ndërkombëtare ky akt dhurimi nuk mund të kontestohet, pasi marrëveshja është miratuar edhe nga parlamentet e të dy vendeve". Mbreti i Serbisë Pashiq mbështeti Ahmet Zogun që të vinte në pushtet dhe ky i fundit i dhuroi një nga manastiret më të bukur të Shqipërisë. Ahmet Zogu me mbështetjen politike që i dhanë serbët mundi të rrëzonte kryeministrin Fan Noli. Në vitin 1941 manastiri i Shën Naumit iu kthye Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Të gjitha konferencat e fuqive të mëdha, si për shembull Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1922, Traktati i Firences i vitit 1913, Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës dhe vendimi i 31 dhjetorit të vitit 1924, që u morën me përcaktimin e kufinjve të Shqipërisë e njohën manastirin e Shën Naumit si manastir shqiptar. Paskal Milo, *Ja si e humbën Shën Naumin,* Gazeta Shqiptare, 29 gusht 2003, faqe 7.

[112]-Sipas Dhimitër Bedulit episkopata e Strugës në atë kohë kishtë 35 famulli dhe 36 famulltarë (priftërinj e dhjakonë).

[113]-Episkopatat e Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, pas bashkimit të tokave të liruara, me dekretin e këshillit të Nalt qenë: Tiranë-Durrës, Korça, Berati, Gjirokastra, Prizreni, Peshkopia dhe Struga; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944,* Tiranë 1992, faqe 29.

qenë konvertuar në unitë[114] që në vitin 1928. Në ditën që përurohej kisha unite, Visarion Xhuvani meshoi në kishën e Shën Mërisë, në lagjen Kala të Elbasanit dhe gjatë predikimit e cilësoi kishën unite si "vepër të djallit, një kancer që tenton të minojë autoqefalinë shqiptare". Kryeepiskopi arriti të bindte qeverinë se unitizmi duhej ndaluar me çdo kusht. Pas ankesës së Xhuvanit, kisha unite u mbyll pas një muaji. Zyra Sekrete e Ministrisë së Brendshme urdhëroi ndalimin e çdo meshimi të kishës unite në Elbasan. Mbrojtja e kishës nga unitët[115] u shënua si fitore e madhe e Sinodit të Shenjtë.

Më 16 prill të vitit 1930, Ministri i Brendshëm Rauf Fico i ka dërguar një informacion Prefekturës së Elbasanit në lidhje me aktivitetin e kishës unite. Prefekti i Elbasanit Qazim Bodinaku i është përgjigjur: "*Lokali i kishës unite ndodhet i bashkuem me banesën private të priftit atë Pietro Scarpelli, i cili meshon tinëz…Sot i naltpërmenduni u thirr në prefekturë dhe në mënyrë të pëlqyeshme u porosit të mos meshojë privatisht pa i ra kumbonës, derisa çeshtja të rregullohet dhe na njoftoi se nesër mbrama, mbasi asht nata e madhe do ta bajë detyrën e meshimit. Për të ndalue meshimet në këtë kishë dhe propagandat helmuese rreth kësaj çështje duhet të largohet këtej: Papa Pietro bashkë me Papa Jovanin, të cilët sado që të ndalohen nga meshimet prapë se prapë do të vazhdojnë tinëzisht. Lutemi deri nesër nga mesdita të njoftohet mënyra e veprimit*". Në letër përmendet vetëm atë Jovan Jovan Toda, sepse atë Naum Peqini qe penduar[116] dhe u kthye përsëri si meshtar i kishës ortodokse.

Më 12 korrik të vitit 1930, Kryeepiskopi i Kishës Ortodokse të Shqipërisë, Forlumturia e Tij, Visarioni është ankuar pranë Ministrisë së Drejtësisë për priftin unit të ardhur nga Kalabria, i cili përpiqej që të dërgonte djemtë elbasanas për studime teologjike në Itali[117]. Me ndërmjetësinë e priftit unit atë Pietro Scarpelli u

---

[114]-Ines Angeli Murzaku, *Returning Home to Rome, the basilian monks of Grottaferrata in Albania*, Grottaferrata, 2009, page 141; *Vetëm dy priftër orthodhoksë u lidhën me Romën*, Gazeta e Re, nr. 2, 2 nëntor 1928, faqe 3.

[115]-Në Deklaratën V të Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale thuhet: "Mbrojtja e dogmës sonë të shenjtë Ortodokse dhe luftimi i propagandës s'Unitizmit në Shqipëni qe një vepër për të cilën ne duhet të përgëzohemi. Me këtë u zhduk dhe një shkak i ndasisë së elementeve të kombit, u zhduk përçamja antiungjillore ndërmjet ortodoksve. Për këtë nuk muermë parasysh as një rrezik e interes personal por bamë detyrën tonë si kryetar i përgjithshëm shpirtnor i Ortodoksisë Shqiptare". *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 136; Arkivi Qendror i Shtetit, Koleksion fondesh pas 1912, Dosja 1552, viti 1929, fleta 38, poza 60, xhaketa 468.

[116]-Në Deklaratën IV të Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale ndër të tejra thuhet: "Me gëzim të shenjtë ju japim edhe nji lajm tjetër të bekimit të Zotit. I gabuemi vitin e kaluem, meshtari i Zotit At Naum Peçini, me hir të shpirtit të shenjtë dhe me përpjekjet tona, i ndihmuem prej Zotit gjeti rishtaz limanin e shpëtimit, gjinin tonë të shenjtë atnor, dhe pasi u kryen të gjitha sa urdhnojnë kanonet dhe rregullat e kishës sonë të shenjtë, ky sot asht ushtari besnik dhe i bindun dhe banëka meshari ynë si duhet nën urdhënat tona të shenjta i thirrun pas kësaj At Nikolla Protopeje. Në emën të Atit e të Birit e të Shpirtit të shenjtë. Lavdërojmë zellin tuej të hirshëm për bashkëqëndrimin dhe besnikërinë, që rrëfyet në veprimet tona për mbrojtjen tonë të Shenjtë". *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 133; Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 885, Dosja 151-154, fleta 38, poza 60, xhaketa 468, viti 1929.

[117]-Kryesia e Kishës i dërgoi Ministrisë së Drejtësisë shkresën me protokolli Nr. 379, që mban datën 12.VII.1930. "Mitropolia e Durrësit sipas informatave që ka nga Elbasani më njofton se prifti unit Papa Pjetri, nënshtetas italian nga Kalabria propagandon përhapjen e unitizmit në Shqipni. Brenda këtij mueji po mundohet të dërgojë në seminarin e propagandës unite në Romë djem shqiptarë, tue u sigurue

dërguan për studime nëpër shkollat teologjike të Italisë: 1-Nasi Spiro Ndria në shkollën "Via faro, mango presso Veri", 2-Josif Papamihali në kolegjin "Greko Vio Babuino", 3-Aleko Thanas Gega në shkollën "Suinar Grota Ferata" etj.

Më 19 shkurt të vitit 1936 prefekti i Elbasanit Sadik Metra ka njoftuar eprorët: "*Prifti unit quhet atë Pietro Scarpelli dhe asht njeri i zgjuem punëtor dhe me kulturë të plotë, asht organi kryesor për zhvillimin e unitizmës, simbas hetimeve personale disponueka fonde të mira dhe tash që papunësia asht tue u shtue, me mjetet e tij financiare asht tue tërheqë njerëz që kanë nevojë ushqimore, dhe mbasi ky veprim bahet tepër i fshehtë dhe pa bujë fare*". Priftërinjtë unitë kishin marrë shtëpi me qera dhe përveç katekizmës kishin hapur kopshte e shkolla. Murgeshat u mësonin vajzave punë dore, ndihmonin njerëzit në nevojë etj[118].

Më 21 mars të vitit 1939 Prefekti i Korçës, Ismet Kryeziu ka shkruar se kishte ardhur për të meshuar prifti unit. Ky i fundit ka meshuar në Korçë me pjesëmarrje besimtarësh, të cilëve u premtoi të holla në rast se përqafonin unitizmin. Prifti i Vithkuqit, atë Gjergj Deda është solidarizuar me të[119]. Nga besimtarët kanë qenë rreth 20 burra, gra e fëmijë, ndër të cilët Ilo Mosko, Gaqi Tushi etj. Gjithashtu Athina Kristos nga Grapshi i Devollit iu dha e drejta e studimit për në Itali[120].

Në librin "Pushteti i së vërtetës" Mitropoliti i Korçës Evllogjio Kurilla ka shkruar: "Katolikët gjatë mungesës sime për shkak të udhëtimit tim në Angli ku mora pjesë në një konferencë për dialogun ndërfetar midis kishës Anglikane dhe asaj Ortodokse, ngritën në Korçë një kishë, një manastir murgeshash dhe një shkollë, si dhe kishin proselitizuar 400 nxënës shkollash. Me tu kthyer i befasuar nga këto zhvillime të shpejta, fillova predikimet dhe me ndihmën e Perëndisë arrita ti neutralizoj"[121].

Më 5 maj të vitit 1939 prefekti Abdurrahman Hoxha ka deklaruar se në qytetin e Vlorës kanë vepruar këta unitë: famulltari i Vlorës Monsinjor Bonati, atë Pietro Scarpelli, i ardhur nga kisha unite e Elbasanit, Pietro Pjero nga Himara, Tol Arapi, Gaspër Kraja, Jak Beltoja, Sofokli Kume etj. Monsinjor Bonati ka deklaruar se punonte për çështjen kombëtare, me qëllim që t'i shkëpuste besimtarët ortodoksë nga ndikimet greke e sllave, duke i bashkuar në urdhërin e papës së Romës. Ortodoksët e kthyer në uniatizëm duhej të bënin një deklaratë, me të cilën pranonin kalimin në fenë uniate. Në vijim nëshkruhej deklarata, e cila theksonte se ortodoksët që i bashkohen Kishës Katolike Lindore, nevojat fetare si pagëzimet, kororëzimet etj do t'i bënin me

---

shpenzimet e udhëtimit, pasaporta dhe bursa në internat. Mbasi këto veprime janë në kundërshtim me ligjet e shtetit dhe kundër ligjeve të Mbretnisë për mbarëvajtjen e KOASH mbasi shkakton ndasi në elementin ortodoks, lutemi të merrni masa për ndalimin e këtyne veprimeve dhe për ndalimin në Shqipëni të atyne djemve që studiojnë në shkolla të tilla dhe kanë ardhë për vakanca. Me nderime të posaçme. Kryetari i KOASH. Visarion. *Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 217.

[118]-Kastriot Dervishi, *Lëvizja unite në Shqipëri dhe zhvillimet e saj*, 55, 30 mars 2005, faqe 12-13.

[119]-Andrea Llukani, Hasan Aliaj, *Il movimento Unita in Albania*, Le Radici, Anno 5, nr. 4, Ottobre 2007, pagina 1.

[120]-Kastriot Dervishi, *Lëvizja unite në Shqipëri dhe zhvillimet e saj*, 55, 31mars 2005, faqe 12-13.

[121]-Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 74.

priftin unit. Në përfundim betoheshin mbi Ungjill që do t'i qëndronin besnik deklaratës[122].

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 prill 1939 propaganda e romano-katolikëve për t'i kthyer ortodoksët në uniatë u intensifikua edhe më tepër sa që në vitin 1942 ata vepronin me 10 misione në Shqipërinë e Jugut. Por edhe qeveria shqiptare e asaj kohe ishte në shërbim të fashistëve dhe ushtronte presion ndaj Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për një kthim të mundshëm të ortodoksëve në unitë. Kështu më 16 gusht 1939 mëkëmbësi i Mbretit Viktor Emanuel III, Jakomoni ka njoftuar Pallatin Kixhi për një kthim të ortodoksëve në uniatizëm. Kryeepiskopi Kristofor nga njëra anë e kishte pranuar marrëveshjen me arbëreshët e Italisë dhe nga ana tjetër përpiqej që ta shtynte çështjen me qëllim që të fitonte kohë. Anën e Kryeepiskopit Kristofor kanë mbajtur edhe Mitropoliti i Beratit Agathangjeli dhe Ikonomi i Madh Stavrofor Vasil Marku, ndërsa kundër kthimit në uniatizëm ishin Mitropoliti i Korçës Evllogjio dhe Mitropoliti i Gjirokastrës Pandelejmoni, të cilët kërkuan me ngulm që të ruhej status-quoja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në këto kushte Kryeepiskopi Kristofor deklaroi se ishte gati për të mbledhur Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për të shpallur bashkimin me kishën romano-katolike. Nëse Sinodi i Shenjtë do ta pranonte bashkimin atëherë edhe popullsia ortodokse do ta pranonte patjetër duke marrë parasysh edhe trysninë e pushtimit fashist. Vendimi i Kryeepiskopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u prit mirë në Romë, megjithatë në Selinë e Shenjtë që në atë kohë drejtohej nga papa Piu XII nuk kishte unitet mendimi për rrugën që duhej ndjekur gjatë kthimit të ortodoksëve shqiptarë në uniatë. Disa qenë të mendimit për një bashkim të menjëhershëm me kishën romano-katolike, ndërsa të tjerë qenë për një kthim të shkallëzuar. Por me kapitullimin e Italisë fashiste më 1943 dështuan edhe planet e romano-katolikëve për t'i kthyer ortodoksët në uniatë[123].

Gjatë luftës për çlirimin e Tiranës nga okupatorët nazistë, më 4 nëntor 1944 u dogj Selia e Kryesisë së Kishës Ortodokse Autoqefale (Mitropolia) dhe bashkë me të u dogj edhe arkivi. Kjo ishte një humbje e madhe për komunitetin ortodoks të Shqipërisë, sepse në arkiv qenë të depozituara dokumente me vlerë historike për bashkësinë ortodokse[124]. Duhet theksuar se testamentet e ndryshme dhe akte të tjera të rëndësishme, që u përkisnin zëvendësive mitropolitane mbaheshin në arkivin e Kryesisë së Kishës në Tiranë.

Kisha në diktaturë (1945-1990). Në kreun e parë të librit do të njiheni me shkarkimin e peshkopit Pandelejmon Kotoko. Në vijim me akuzat ndaj Mitropolitit të

[122]-Në deklaratë kanditati duhet të pohonte se: Ortodoksët qi bashkohen me Kishën Katolike Lindore nuk i ndërrojnë zakonet kishtare, due të thom se taksin e pagëzimit, të kunorëzimit, të vojimit shejt, të vorrimit e të gjitha misteret i kanë njinji si në kishën ortodokse. Në Meshë e në çdo shërbim fetar prifti unit ose katolik linduer do të përmendin papën e Romës, sot me emën Pio, dhe episkopin e eparkisë, qi sot për sot për unit të Shqipnisë asht Delegati Apostolik e quhet Gjon. Kastriot Dervishi, *Lëvizja unite në Shqipëri dhe zhvillimet e saj*, 55, 1 prill 2005, faqe 12-13.

[123]-Roberto Moroco della Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë 1993, faqe 216.

[124]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 995, fl. 1-2; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 16.

Beratit, Imzot Visarion Xhuvanit dhe arrestimin e tij. Me prapaskenat ndaj Imzot Irine Banushit që çuan në burgosjen e tij. Një vend të rëndësishëm në kreun e parë zënë vizita e delegacionit kishtar në Moskë. Dorëzimin e Paskal Vodicës në gradën peshkopale dhe shkarkimin e Kristofor Kisit. Një vend të rëndësishëm zënë punimet e Kongresit të tretë kishtar të K.O.A.Sh-it, për të vijuar me vizitën e Paisit në Moskë dhe vizitën e peshkopit Nikon në Shqipëri. Me interes të veçantë është krijimi i Sinodit të Shenjtë. Gjithashtu do të njiheni me përpjekjet për vënien e Kishës Shiptare të Sh.B.A. nën juridiksionin e K.O.A.Sh-it si dhe me zëvendësimin e Nolit.

Kreu i dytë përmban pesekutimin e kishës në vitet e regjimit monist si dhe pasojat e përndjekjes ateiste. Gjithashtu do të njiheni me persekutimin e klerikëve ortodoksë dhe me zëvendësimin e të kremteve fetare me festa socialiste. Temë interesante është dekreti për ndryshimin e emrave. Do të njiheni me pasojat e përndjekjes, me propagandën ateiste, me kishën e nëndheshme etj. Për të ringjalljen e kishës dhe shërbesat e para do të njiheni në kreun e tretë. Për ti dhënë një qasje realiste në kreun e katërt kam publikuar dokumente të rëndësishme, të cilat konkretizojnë atë çka është shkruar. Studimi shoqërohet me fotografi të kohës dhe të personaliteteve më të spikatur të atyre viteve.

Regjimi totalitar u karakterizua nga: dhunimi masiv i të drejtave të njeriut, vrasjet dhe ekzekutimet individuale e kolektive, vdekjet nga uria, torturat, dëbimet, puna skllavëruese, terrori fizik dhe psikologjik, genoncidi për shkak të origjinës politike, si dhe dhunime të lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit dhe lirisë së besimit fetar. Ishte një epokë e errët kur në këtë vend mbretëroi errësira dhe fryma e ferrit. Ky studim modest është përzgjedhur me kujdes që të dhënat të jenë të sakta dhe historia të dalë me vërtetësi dhe paanshmëri.

KREU I PARË
KISHA NË DIKTATURË
(1945-1967)

Fitorja e komunistëve në Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare dhe sigurimi i përkrahjes së Jugosllavisë së Titos, i dhanë dorë diktatorit Enver Hoxha të instalonte në Shqipëri një nga regjimet më gjakatare, që ka njohur historia e njerëzimit. Vendi u zhyt në vorbullën e një lufte vëllavrasëse, në altarin e së cilës u flijuan njerëz, bindje, tradita dhe institucione. Në emër të dogmës së edukimit të njeriut të ri shqiptarët u detyruan ti nënshtrohen një procesit të indoktrinimit ideologjik ateist, që konsistonte në çrrënjosjen e bindjeve fetare[125].

Më 31 mars 1945, Kryeepiskopi Kristofor Kisi[126] u ka dërguar një letër anëtarëve të Sinodit të Shenjtë me Nr. Prot. 176, me anën e së cilës u kërkonte të shfaqnin mendimin e tyre në lidhje me aktivitetin antishqiptar të episkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko[127]. Ndër të tjera në letër kryetari i Sinodit të

[125]-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 52-72.

[126]-Kristofor Kisi (1890-1958) ka lindur në lagjen Kala të Beratit në vitin 1890. Studimet e larta i ndoqi në Shkollën Patriarkale të Halkit ku u diplomua në vitin 1906. Tema që mbrojti diplomën ishte "Mbi prejardhjen e jetës monakale". Me përfundimin e studimeve teologjike më 1908 u kthye në atdhe dhe filloi punë në gjimnazin e Jovan Bangës në Korçë. Në vitin 1916 u dorëzua në gradën priftërore në Kostandinopojë dhe u caktua kryefamullitar në Makrohor. Më vonë u hirotonis episkop i Sinadës, post të cilin e mbajti deri në vitin 1923. Duke parë përpjekjet e otodoksëve shqiptarë për autoqefali, Imzot Kristofori u kthye vullnetarisht në Shqipëri, ku mori në drejtim Mitropolinë e Beratit. Më 21 nëntor 1923 Imzot Kristofori së bashku me Imzot Jerotheun dorëzuan në gradën episkopale Theofan Nolin në kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Ndërsa në vitin 1929 u tërhoq në manastir duke mos marrë pjesë në veprimet antikanonike që po kryheshin në Kishën Ortodokse Shqiptare. Më 1934 Imzot Kristofori zuri vendin e Mitropolitit të Korçës dhe në vitin 1937 u zgjodh Kryetar i Sinodit të Shenjtë dhe Kryeepiskop i gjithë Shqipërisë. Për shumë vjet qëndroi në krye të Kishës Ortodokse në Shqipëri. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 43-44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 58; Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38; *Personalitet madhor i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 9; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 178-180; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 110-111; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 261; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 261.

[127]-Pandelejmon Kotoko ka lindur në Korçë në vitin 1890. Studimet e larta i kreu në Institutin Teologjik të Halkit në Stamboll, ku u diplomua në vitin 1912. Tema me të cilën mbrojti diplomën ishte: "Mësimi i Joan Gojartit për misionin pimantik". Në vitin 1936 mbrojti Doktoraturën në Drejtësi, ndërsa më 11 prill 1937 u dorëzua Mitropolit i Gjirokastrës në kishën e "Trinisë së Shenjtë" të Halkit. Pandelejmon Kotoko e mbajti postin e Mitropolitit të Gjirokastrës nga viti 1937 deri në vitin 1941. Pas ripushtimit të Gjirokastrës prej italianëve Kotoko u largua nga Shqipëria me ushtrinë greke. Pasi u vendos në Athinë themeloi Komitetin Qendror për Epirin e Veriut. Kotoko ka vdekur në Athinë më 24 maj 1969. Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika,

Shenjtë, Kisi shkruan se peshkopi dioqezës së Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko *de facto* është shkarkuar nga detyra dhe është zëvendësuar, por vendim pushimi nuk është marë dhe shkarkimi i tij nuk është dekretuar për shkak të pengesave, që paraqet statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili të drejtën e pushimit të kryetarit dhe të anëtarëve të Sinodit ia ka rezervuar vetëm kryetarit të shtetit. Për t'i dhënë fund kësaj çështjeje kryetari i Sinodit të Shenjtë, Kisi u drejtohet anëtarëve të sinodit që me anën e shkresave përkatëse të shfaqnin mendimin e tyre[128].

Sipas Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Imzot Pandelejmon Kotoko kishte bërë shkelje statutore dhe kanonike sepse kishte braktisur dioqezën e Gjirokastrës. Në letrën e tij, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë Imzot Visarion Xhuvani (Fig.2) i sugjeron Sinodit të ndjekë procedurat, që përcakton Statuti në lidhje me Gjykatën Shpirtërore, e cila ishte organi kompetent për të gjykuar çështjen e braktisjes së detyrës kishtare. Pasi të ndiqeshin të gjitha procedurat përkatëse, atëhere Gjykata Shpirtërore do të vendoste pushimin nga detyra të titullarit të Mitropolisë së Gjirokastrës. Për këtë vendim të Gjykatës Shpirtërore Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë lipsej të njoftonte qeverinë shqiptare sepse ajo e kishte të drejtën e miratimit të shkarkimit nga detyra peshkopale të peshkopëve[129].

Më 16 maj 1945 u mblodh Sinodi i Shenjtë i KOASh-it, nën kryesinë e Kryeepiskopit Kristofor, Mitropolitit të Korçës dhe zëvendës i përgjithshëm i Dioqezës së Gjirokastrës, Imzot Agathangjelit, mitropolitit të Beratit dhe Vlorës, Imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marku. Sinodi i Shenjtë në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme shqyrtoi dhe më pas dekretoi pushimin e Imzot Kotokos. Ndër çështjet që u diskutuan qenë se në vitin 1940 peshkopi Pantelejmon Kotoko, në atë kohë titullar i Dioqezës së Gjirokastrës është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, duke shkelur kështu artikullin 26 të Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas këtij akti Sinodi i Shenjtë e ka konsideruar të dorëhequr dhe Kryeepiskopi ka emëruar si Zëvendës të Përgjithshëm të Dioqezës së Gjirokastrës peshkopin e Korçës Imzot Agathangjelin[130]. (Fig.3) Gjithashtu ka

---

Tiranë 2011, faqe 221; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108; Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006, faqe 204-206.

[128]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 1.

[129]-Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Shqiptarja.com, 14 tetor 2012, faqe 20; Pavli Haxhillazi, *Një letër e panjohur e Visarion Xhuvanit*, Le Radici, Anno 10, Nr. 5, Ottobre 2012, pagina 18; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 3-4.

[130]-Agathangjel Çamçe (1877-1946) ka lindur në qytetin e Korçës më 1877. Në vitin 1913 emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u shqua si aktivist i lëvizjes kombëtare. Në vitin 1919 u dorëzua në gradën priftërore në Nju Jork, ku shërbeu dy vjet duke celebruar shërbesa fetare në gjuhën shqipe. Në vitin 1921 Atë Agathangjel Çamçe erdhi në Shqipëri dhe një vit më vonë më 1922 mori ofiqin e Arkimandritit. Në muajin shkurt të vitit 1929 u dorëzua Episkop i Beratit, Vlorës dhe Kaninës në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit prej Imzot Visarionit dhe Imzot Viktorit. Në vitin 1941 Imzot Agathangjeli u dorëzua Mitropolit i Korçës. Imzot Agathangjel Çamçe ka vdekur në vitin 1946. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1992, faqe 44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë

urdhëruar që të mos përmendet gjatë meshës emri i peshkopit të dorëhequr në kishat e peshkopatës së Gjirokastrës. Përpos faktit se është larguar nga Shqipëria pa lejen e Kryetarit të Kishës, peshkopi Pandelejmon Kotoko duke shtuar fajet e tij kanonike ka pranuar dhe kryesinë e një komisioni, që punon kundra integritetit të vendit[131].

Më 13 qershor 1945 Kryeepiskop Kristofor Kisi i ka dërguar një shkresë me numër protokolli 238 Ministrisë së Drejtësisë, me anën e së cilës i parashtronte për dekretim vendimin e Sinodit të Shenjtë të KOASh-it. Gjithashtu Ministria e Drejtësisë (Fig.1) me anën e shkresës që mban numrin e protokollit 794, datë 19 qershor 1945 i përgjigjet se vendimi i Sinodit të Shenjtë është me vend, sepse i përgjigjet misionit të lartë fetar dhe patriotik të institucioneve tona fetare. Kisha Ortodokse me të drejtë nuk mund të toleronte një peshkop, që ka zhvilluar dhe zhvillon veprimtari antikombëtare të vazhdonte të mbante titullin e një dioqeze shqiptare[132].

Pas shkarkimit të episkopit të Gjirokastrës, Pandelejmon Kotoko, Sinodi i Shenjtë i KOASh-it kishte këtë përbërje: Kristofor Kisi në cilësinë e Kryeepiskopit, Mitropoliti i Korçës dhe Zëvendës i Përgjithshëm i Dioqezës së Gjirokastrës, Imzot Agathangjeli, Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarioni dhe Ikonomi i Madh Stavrofor Vasil Marku[133].

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë të datës 4 korrik 1945 u diskutua çështja e episkopit të Strugës Irine Banushi[134]. Kryetari i Sinodit të Shenjtë Kristofor Kisi

---

2006, faqe 58-59; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 108-109; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 6.

[131]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 5-6.

[132]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 7-8.

[133]-Vasil Marku (1888-1949) është nga Borova e Kolonjës. Që në moshë të re emigroi në Amerikë, ku u dorëzua prift në Sant Louis. Në vitin 1919 së bashku me Agathangjel Çamçen erdhën në Shqipëri dhe morrën pjesë aktive në përpjekjet për autoqefalinë e kishës. Në vitin 1922 Kongresi historik i Beratit e zgjodhi Kryetar të Këshillit të Lartë. Më 1923 Atë Vasil Marku ka kryesuar përfaqësinë e kishës shqiptare, e cila shkoi në Kostandinopojë për çështjen e autoqefalisë. Më 24 shkurt 1929 Atë Vasil Marku mori ofiqin e Ikonomit të Madh Mitrofor dhe u caktua anëtar i Sinodit të Shenjtë, në cilësinë e titullarit të dioqezës së Korçës. Ceremonia u zhvillua në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 45-46; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 59; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 90; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 290.

[134]-Irine Banushi (1906-1976) ka lindur në Shkodër në vitin 1906. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes dhe më pas vajti në Seminarin "Bogosllava" të Cetinjës në Malin e Zi. Studimet e larta teologjike i vazhdoi në Beograd dhe i përfundoi në vitin 1938. Menjëherë u kthye në atdhe ku filloi punë në Seminarin “Apostull Pavli” dhe në gjimnazin e Tiranës duke dhënë lëndën e latinishtes. Në prillin e vitit 1939 Ilia Banushi u bashkua me qëndresën antifashiste. Më pas e internuan në provincën e Kolfioritos në Itali nga ku u kthye në vitin 1940. Në atë kohë Kryehirësia e Tij Kristofor Kisi, i cili drejtonte Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, duke shmangur një përpjekje të italianëve për të emëruar një episkop unit, i propozoi Ilia Banushit, i cili shquhej për përgatitje të lartë teologjike dhe përkushtim ndaj atdheut. Kështu në shkurt të vitit 1942 Ilia u dorëzua në gradën episkopale në Manastirin e Shën Naumit që në atë kohë ishte në administrimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas dorëzimit ai mori emrin Irine. Me vendim të sinodit u dorëzua episkop i Strugës, Prespës dhe Caredvorit. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 45; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 59; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon

deklaroi se Imzot Irineu (Fig.4) është emëruar me vendim sinodi episkop i Strugës, por dekreti qeveritar nuk ka dalë ende, prandaj Sinodi i Shenjtë vendosi që Imzot Irineu të jetë anëtar i sinodit me cilësinë e episkopit të Strugës[135].

Në korrik të vitit 1945 u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it, e cila zgjodhi si kryetar të saj teologun Theofan Popa[136]. Sekretar i lidhjes u zgjodh teologu Dhimitër Beduli[137]. Anëtarë të lidhjes qënë: Petro Doçi[138],

---

Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 141; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 127-128; *Irine Banushi-martir i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, nëntor 2018, faqe 9.

[135]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945, fl. 18.

[136]-Theofan Popa ka lindur më 3 nëntor të vitit 1914, në lagjen Kala të Elbasanit në një familje zanatçinjsh. Pasi përfundoi shkollën fillore "Kostandin Kristoforidhi", me ndërhyrjen e atë Josif Mihalit mundi të sigurojë një të drejtë studimi për në Seminarin Teologjik “Joan Teologu” në Manastir. Me mbarimin e seminarit në vitin 1936 u kthye në Shqipëri dhe pas një viti me mbështetjen e Kryepeshkopit Visarion Xhuvani mundi të shkonte për të ndjekur studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Universitetit Kapodistria të Athinës, në vitin akademik 1937-1938, me bursë nga fondacioni Jovan Banga. Ndërkohë në Shqipëri ndodhën ndryshime të mëdha përsa i përket organizimit kishtar. Më 12 prill 1937, Patriarkana Ekumenike shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u zgjodh Kristofor Kisi. Sapo përfundoi vitin e parë të fakultetit, Theofani mori një letër nga Kryepeshkop Kisi, me anën e së cilës i thuhej se duhej t’i ndërpriste studimet në Athinë, për t’i vazhduar në Kolegjin Anglikan "Ngjallja e Krishtit" në Londër. Pasi qëndroi vetëm disa muaj në Londër (gusht-tetor 1938) u kthye në Athinë për të vazhduar studimet, të cilat i përfundoi në vitin 1941. U kthye në atdhe më 1942 dhe filloi punë në Liceun e Korçës si profesor i gjuhës latine. Më vonë u transferua në Tiranë ku punoi si predikues dhe artikullshkrues pranë kryesisë së kishës. Theofani botonte një buletin dyjavor me predikimet e të dielave, i cili u dërgohej kishave ortodokse të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë, 2019, faqe 13; Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 286; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 278-279; Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.

[137]-Dhimitër Beduli (1914-1996) ka lindur më 1914 në Skore të Pogonit në rrethin e Gjirokastrës. Në vitin 1930 pasi përfundoi gjimnazin në Athinë, u nis për studime teologjike në Rumani, të cilat i përfundoi në vitin 1934. Përveç studimeve teologjike në seminarin e Besarabisë, Beduli u specializua edhe në Muzikën Bizantine. Sapo u kthye nga Rumania në vitin 1934 punoi si pedagog dhe gjatë viteve 1935-1944 u emërua drejtor i seminarit “Apostull Pavli” në Tiranë. Me mbylljen e Seminarit në vitin 1945 Beduli filloi punë në Drejtorinë Qendrore të Ofiçinave në Durrës dhe në vijim shef plani në Uzinën Mekanike në Tiranë. Mund të themi se që nga viti 1945 deri në vitin 1967 kur u prishën kishat, janë plot 22 vjet, gjatë të cilave Beduli i talentuar ka qenë i mënjanuar. Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 66; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 288.

[138]-Petro Doçi ka lindur në Elbasan, më 20.07.1909. Në vitin 1928 siguroi një bursë nga Visarion Xhuvani për të ndjekur studimet teologjike në Seminarin e Manastirit (Bitolës). Gjatë viteve të seminarit ishte e detyruar mësimi i një vegle muzikore. Petro Doçi zgjodhi mandolinën. Seminarin e përfundoi në vitin 1934. Në vijim u kthye në Elbasan ku ka punuar si mësues. Më 19 shtator 1937 emërohet nga Kryeepiskop Kristofor Kisi si predicator në kishat e Elbasanit. Më 1935 u martua me Vasillon. Më 25 shtator 1938 u dorëzua dhjakon nga Imzot Kristofor Kisi. Më pas është emëruar Protodhiakon i Kryesisë së Kishës. Më pas e gjejmë Drejtor Përgjegjës i revistës “Jeta Kristiane”. Në vitin 1950 u dorëzua prift. Ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme kishtare brenda dhe jashtë vendit. Me mbylljen e kishave më 1967 Petro Doçi ka punuar në një pikë karburanti. Vite më vonë ka

Vlash Semini[139], Anastas Duka, Vangjel Popa, Petro Frashëri, Vlash Nushi[140], Sotir Kanxheri etj., të gjithë njerëz të shkolluar nëpër seminare dhe shkolla teologjike brenda ose jashtë vendit. Këta kishin qenë pjesë aktive e kishës, por Këshilli Ekonomik për mungesë fondesh disa prej tyre i kishte shkarkuar nga detyra dhe ata qenë të detyruar të punonin ku të mundnin që të siguronin jetesën. Teologët dhe seminaristët e larguar nga kisha e ndienin veten të shpërfillur dhe për këtë bënin me faj Kryesinë e Kishës. Njeri prei tyre Anastas Duka[141] ishte mjaft kritik ndaj Kryesisë së Kishës, sepse teologët dhe seminaristët qenë larguar nga kisha dhe qenë punësuar në administratën shtetërore.

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it hartoi statutin, rregulloren dhe ligjëroi vulën. Simboli bazë në vulën e Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve qenë dy duar të shtrënguara, duke mbajtur një kryq. Rreth këtij simboli shkruhej Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të Kishës Ortodokse. Qendra e lidhjes ishte në Tiranë, por u krijuan degë nëpër rrethe si në Durrës, Korçë, Shkodër

---

punuar roje në Laboratorin Shkencor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës etj. Petro Doçi ka vdekur më 27 dhjetor 1983. Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006, faqe 10-31.

[139]-Vlash Semini ka lindur në qytetin e Kavajës më 1906. Pas përfundimit të studimeve teologjike në Bukuresht, Vlashi u kthye në Tiranë, ku ka shërbyer si kujdestar dhe psalt në Kishën e Shën Prokopit. Vlash Semini ka botuar shumë artikuj teologjik në shtypin periodik të K.O.A.Sh-it. Ai vdiq më 24 qershor të vitit 1989. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296.

[140]-Vlash Nushi ka lindur në Tiranë më 8 shkurt 1914. Pasi përfundoi shkollën fillore ka punuar pranë babait, i cili kishte një dyqan të vogël në Shën Vlash. Në vitet 1931-1935 përfundoi seminarin Apostull Pavli në Tiranë. Në vijim ka punuar si psalt në Tiranë, ndëtsa më 1937 ka punuar si mësues feje. Në vitin 1940 ka punuar në Ministrinë e Ekonomisë në Tiranë. Gjatë viteve 1954-1959, Vlash Nushi ka punuar si referent i pasurive kishtare. Vlashi ka botuar disa artikuj në revistën "Predikimi". Kur u themelua Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it më një korrik të vitit 1945 Vlash Nushi ka qenë i zgjedhur në kryesinë e lidhjes. Vlash Nushi ka vdekur në vitin 1981. Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, *Neraida*, Tiranë 2001, faqe 46-48; Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8; Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 25; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 296; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951, fl. 34-36.

[141]-Anastas Duka ka lindur më 10 maj 1921 në Sheper të Gjirokastrës. Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje ka bërë tre vjet shkolë të mesme në Gjirokastër dhe pesë vjet në Tiranë ku ka përfunduar Liceun më 1942. Gjatë viteve të qëndrimit në Tiranë ka kryer seminarin Apostull Pavli ku ka qenë bursist. Në prill të vitit 1945 ka qenë në varësi të Kishës Ortodokse, duke punuar në vende të ndryshme. Gjatë muajve prill-gusht 1945 ka punuar në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, prej andej për nëntë muaj ka punuar në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Në qershor 1946 ka punuar për disa muaj në manastirin e Ardenicës. Në periudhën dhjetor 1946 deri në mars 1947 ka punuar në Pogradec. Prej andej ka qenë në dispozicion të Kryesisë së Kishës në Zyrën e Llogarisë. Në janar 1948 ka shërbyer në Fier si predikues dhe mësues katekizmi. Në prill 1948 ka punuar në Shën Vlash të Durrësit dhe prej andej ka shkuar në vendlindje në Sheper, në pritje të një detyre të re nga Kryesia e Kishës. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja nr. 1470, viti 1951, fl.3-4.

etj. Me vendimin e Gjykatës së Tiranës datë 19 shtator të vitit 1945, Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it u ligjërua zyrtarisht[142].

Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve të K.O.A.Sh-it pikëpamjet e saj i shfaqi në broshurën me titull "Ç'është dhe çfarë kërkon Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve ortodoksë". (Fig.5) Qëllimi kryesor i kësaj Lidhjeje ishte që të kontribuonte në përparimin dhe lartësimin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, me qëllimin e vetëm që ajo të ruante integritetin e saj dhe të mos përshtatej me rrethanat që i diktonte sistemi. Në kryesinë e lidhjes u zgjodhën: Sotir Kanxheri[143], Dhimitër Beduli, Ilia Stavre, Vlash Semini dhe Arkile Kondi. Kryesia e lidhjes më 24 shtator 1945 i shkroi një letër[144] Sinodit të Shenjtë, me anë të së cilës i parashtronte synimet e saj. Sinodi i Shenjtë më 18 korrik 1945 iu përgjigj, se do ta studionte përmbajtjen e letrës, gjë që acaroi edhe më shumë marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të lidhjes dhe kryesisë së kishës. Anëtarët e Lidhjes fajësonin Kryeepiskopin Kristofor për gjendjen e mjeruar në të cilën ishte katandisur Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë. Qëllimi i tyre ishte të merrnin në dorë situatën, duke tërhequr pas vetes klerikët dhe besimtarët. Teologët e seminaristët e rinj qenë njerëz të arsimuar dhe synonin të detyronin Kryeepiskopin Kristofor që të përfshiheshin brenda strukturave të kishës. Në mbledhjen e datës 20 tetor 1945 Sinodi i Shenjtë refuzoi të njihte Statutin e Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve. Madje u vunë si kusht se nëse dëshironin njohjen e Lidhjes duhej ti kërkonin falje kryesisë së kishës për letrat me tone të ashpra që i kishin dërguar. Sinodi i Shenjtë ngarkoi episkopin e Gjirokastrës, Imzot Irineun tu komunikonte anëtarëve të Lidhjes vendimin e sinodit[145]. Në këto kushte teologët dhe semiranistët, por edhe kryesia e kishës vendosën të ulin tonet dhe të gjejnë gjuhën e përbashkët. Në fund të dhjetorit Kryeepiskopi Kristofor Kisi u bëri të ditur anëtarëve të Lidhjes së do ti merrte parasysh kërkesat e tyre, nëse ata do të tregonin respekt ndaj kryesisë së kishës[146]. Më 31 dhjetor 1945 Lidhja e Teologëve dhe Seminaristëve vendosi ti dërgojë një letër tjetër Kryeepiskopit Kisi, me anën e së cilës e sqaronin se do të qenë bij të

[142]-Kristofor Beduli, *Shkollat teologjike-hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 46-48; Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019, faqe 14; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 351.

[143]-Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka lindur në qytetin e Korçës më 10 nëntor të vitit 1922. Në vitet 1932-1935 ndoqi Liceun Francez të Korçës dhe në vijim kreu Seminarin "Apostull Pavli" në Tiranë. Në vitin 1950 u dorëzua në dhjakon, ndërsa në vitin 1965 mori ofiqin e kryedhjakonit. Kanxheri me zërin e tij kumbues i lëçiste aq bukur ungjillin, paqësoret dhe himnet e Liturgjisë Hyjnore. Më 27 mars 2000 u zhvillua shërbesa e varrimit për kryedhjakon Sotir Kanxherin në Kishën e Ungjillëzimit në Tiranë. Kryedhjakon Sotir Kanxheri ka dhënë kontributin e tij në financat e kishës. *Fjeti Kryedhjakoni Sotir Kanxheri*, Ngjallja, prill 2000, faqe 3; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 161-162; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 13-14.

[144]-Disa nga pikat e letrës qenë: punësimi i teologëve dhe i seminaristëve, vendosja e njerëzve të ndershëm në Këshillin Ekonomik të kishës dhe në Këshillin Mikst, transparenca mbi shpenzimet e kishës etj.

[145]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 42.

[146]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.

bindur të kishës[147]. Madje ata ndryshuan edhe disa pika në statutin e tyre, duke pranuar autoritetin e kryesisë së kishës dhe premtonin se çdo gjë do të zhvillohej sipas statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas kësaj, Kisi ishte i gatshëm ta njihte Lidhjen e Teologëve dhe Seminaristëve për të shmangur përçarjen në gjirin e kishës[148].

1.1 ARRESTIMI I VISARION XHUVANIT DHE I IRINE BANUSHIT

Ndaj Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarionit, (Fig.6) u inskenuan akuza qesharake dhe të pabaza. Akuzat ndaj Mitropolitit Visarion[149] qenë

[147]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945, fl. 43.

[148]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 52.

[149]-Visarion Xhuvani (1887-1965) ka lindur më një maj 1887 në Lagjen Kala të Elbasanit. Studimet e mesme i kreu në Shkollën Kishtare të Athinës. Në vitet 1911-1914 ndoqi studimet e larta për Teologji në Universitetin e Athinës. Më pas vijoi me studimet pasuniversitare, në përfundim të të cilave mori titullin "Doktor" dhe në vitin 1918 u emërua Lektor në Falultetin Teologjik të Universitetit të Athinës. Po këtë vit u dorëzua në gradën priftërore nga Mitropoliti Jakov dhe pas një viti filloi punën misionare në Sofje të Bullgarisë. Më 1919 është misionar në Rumani për të organizuar komuntetin shqiptar. Në shtator 1922 ka marrë pjesë aktive në Kongresin e Beratit, në të cilin u propozua kandidat për episkop. Më tre maj të vitit 1925 Arkimandrit Visarioni, duke marrë bekimin e patrikut të Serbisë Dhimitrit u dorëzua në gradën episkopale në Hercegnov (Kotor) prej dy episkopëve rusë Ermogenit të Ekaterinosllavit dhe Mihailit të Aleksandrovskit. Imzot Visarioni duke u mbështetur në ndihmën e pakursyer që i premtoi qeveria dhe mbreti, si dhe me shpresë se do të gëzonte përkrahjen e Kishave Ortodokse të Serbisë dhe të Rumanisë, mori përsipër të zgjidhte problemin e autoqefalisë të Kishës Ortodokse. Në vitin 1929 kur Imzot Jerotheu u detyrua të largohej nga Shqipëria për t'u vendosur në Malin Athos, ndërsa Imzot Kristofori vendosi që të qëndronte vetëm si murg i thjeshtë, i erdhi radha Imzot Visarion Xhuvanit të merrte drejtimin e kishës. Por që të sanksionohej plotësisht autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë nevojitej të krijohej një sinod, i cili do të udhëhiqte kishën. Që të formohej Sinodi i Shenjtë nevojiteshin të paktën katër episkopë, ndërsa në Shqipëri në atë kohë ekzistonte vetëm një episkop që ishte Imzot Visarioni. Për të dorëzuar episkopët e tjerë nevojiteshin të ishin të paktën dy mitropolitë, prandaj u kërkua ndihma e episkopit serb Imzot Viktorit (i cili ishte Vikar i Patrikut Dhimitër në qytetin e Shkodrës). Kështu më 12 shkurt 1929 u bë dorëzimi i episkopëve dhe disa ditë më vonë më 18 shkurt 1929 Imzot Visarioni me mbështetjen e qeverisë shqiptare formoi Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga Fortlumturia e Tij Visarioni, Kryeepiskop i gjithë Shqipërisë, që kishte në juridiksion Mitropolinë e Korçës, Imzot Agathangjeli Mitropolit i Beratit, Imzot Efthimi Mitropolit ndihmës i Kryepiskopit dhe Imzot Ambrozi Mitropolit i Drinopulit (Gjirokastrës). Patriarkana Ekumenike i shkishëroi episkopët e sinodit të kryesuar nga Imzot Visarioni. Gjithashtu sinodin e ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë e njohu vetëm sinodi i kishës ruse në emigracion. Fortlumturia e Tij Visarioni i ka dërguar një telegram Patriarkanës Ekumenike me anën e të cilit kërkonte ndjesë, por nuk mori përgjigje. Patriarkana kërkonte me çdo kusht dorëheqjen e tij, derisa në vitin 1936 Kryeepiskop Visarioni dha vetë dorëheqjen nga kryesia e kishës. Në vitin 1942 Visarion Xhuvani u dorëzua Mitropolit i Beratit, Myzesë, Vlorës dhe Kaninës. Në këtë detyrë qëndroi deri në vitin 1947 kur e arrestuan dhe e burgosën. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 44; Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006, faqe 58; Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003; Andrea Llukani, *Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse*, 55, 21 maj 2004, faqe 18;

nga më të ndryshmet, të artikuluara nga njerëzit e sigurimit të shtetit në bashkëpunim me ata të kishës. Ata e akuzonin sikur kishte punuar për rrëzimin e pushtetit popullor, duke ngjallur pakënaqësi tek besimtarët ortodoksë, sikur kishte dekospiruar letrat e kryesisë së kishës, abuzime në detyrë gjatë kohës që ishte Mitropolit i Beratit etj. Kujdestarët e kishës së Libofshës me anën e një deklarate të nënshkruar më datën 8 mars 1945 e akuzonin Visarionin se u kishte marrë me imponim një teneqe me djathë, dy karroqe fasule dhe 80 franga[150]. (Fig.7) (Fig.8) Kujdestarët e kishës së fshatit Kadipashaj me anën e një deklarate të nënshkruar më datën 24 mars 1945 e akuzonin Visarionin se u kishte marrë 1930 franga ari[151]. Prifti i Libofshës atë Joan Kule më datën 4 prill 1945 deklaronte se Visarioni i kishte marrë 400 franga ari për ta hirotonisur në gradën priftërore[152]. Epitropët e kishës së lagjes Goricë të Beratit më 18 prill 1945 e akuzonin se u kishte marë 380 franga ari pa u lëshuar dëftesë, etj[153]. Në dy letrat e fundit kërkohet largimi i Visarion Xhuvanit nga dioqeza e Beratit. Janë gjithsej shtatë letra të tilla pak a shumë të ngjashme me njera-tjetrën. Këto letra i janë dërguar Kryesisë së Kishës dhe autoriteteve vendore.

Më 19 qershor 1945 Kryeepiskop Kisi i dërgon Visarionit një shkresë me Nr. Prot. 250 me anën e së cilës i kërkon të falte priftërinjtë që kishte pezulluar. Ndër të tjera në letër thuhet se kujdestarët e kishave të Myzeqesë i janë ankuar se i ka detyruar që të paguajnin shuma kolosale dhe ata që nuk paguanin qenë pezulluar nga detyra[154].

Për të shqyrtuar këto letra më 6 korrik 1945 u bë mbledhja e parë e Sinodit ku u paraqitën akuzat, ndërsa më 10 korrik 1945 u bë mbledhja e dytë, në të cilën u miratua zyrtarisht përmbajtja e dokumentit akuzues. Më 11 korrik 1945 u mblodh përsëri Sinodi i Shenjtë i KOASH-it, ku pasi u lexuan akuzat (Fig.9) ndaj Mitropolitit të Beratit, Imzot Visarionit u vendos që këto akuza ti komunikoheshin atij[155].

Visarioni Xhuvani mori në dorëzim prej sekretarit të Kryesisë së Kishës Dhimitër Beduli (Fig.10) shkresën Nr. 272/1 datë 10. VII. 1945 prej 4 faqesh, që përmbante akuzat ndaj tij[156]. Të gjitha akuzat qenë trillime nga më të poshtrat dhe të qëllimshme, prandaj më 12 korrik 1945 Visarion Xhuvani për përgatitjen e apologjisë kërkoi: emrat e atyre që kanë nënshkruar shkresat dërguar Kryesisë së Kishës dhe Këshillit Antifashist Nacional-çlirimtar, kopjet e shkresave etj[157]. Kërkesat e mësipërme të Visarionit nuk u përmbushën dhe çdo reagim i mëtejshëm ishte i kotë prandaj vendosi që të bënte një prokurë të posaçme, duke caktuar av. Vasil Dilo, Dr. Spiro Stringën, Vasil Xhajin dhe Menella Noçkën të bënin mbrojtjen e tij[158].

Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 293-295; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 95-96.

[150]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945, fl.1-2.

[151]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945, fl.5-6.

[152]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945, fl. 7-8.

[153]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945, fl. 10-11.

[154]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945,fl. 20.

[155]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945,fl. 23.

[156]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945,fl. 38.

[157]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945, fl. 31.

[158]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945,fl. 34.

Se si është proceduar më vonë me akuzat ndaj Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarionit ka mbetur mister, sepse mungojnë dokumentet arkivore në dosjen përkatëse. Gjithsesi, Imzot Visarioni vazhdoi të kryente me përkushtim detyrën e tij funksionale si Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë.

Reformën agrare që nisi të ndërmerrte regjimi komunist në Shqipëri, Visarioni e shihte me shqetësim të madh, sepse do të kishte pasoja të rënda ekonomike edhe për kishën. Për këtë çështje më 20 gusht të vitit 1946 Visarion Xhuvani iu drejtua Këshillit të Përhershëm Ekonomik të Kishës me një shkresë zyrtare, me anën e së cilës i raportonte problemin e shpronësimeve[159]. Meqenëse problemi ishte i ngutshëm dhe shumë shqetësues, Visarion Xhuvani më 25 gusht të vitit 1946 e vijoi letërkëmbimin duke iu drejtuar në anën e një shkrese tjetër Këshillit Ekonomik të Përhershëm[160]. Me porosi të Kryeepiskopit Kristofor Kisi, Këshilli i Përhershëm Ekonomik i Kishës ia dërgoi të dy letrat Ministrisë së Drejtësisë dhe operativët e degës së punëve të brendshme të Vlorës menjëherë e arrestuan[161]. Gjykata Ushtarake e Vlorës me anën e vendimit Nr. 512, datë 12 dhjetor 1946 e dënoi Visarion Xhuvanin me me 20 (njëzetë) vjet privim lirie, me punë të detyruar dhe me humbjen e të drejtave politike për pesë vjet[162].

Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë filloi të spastrojë radhët e saj. Njerëzit e aftë dhe me integritet shikoheshin me dyshim nga ata që qenë në shërbim të sistemit monist. Në vitin 1946 ndërroi jetë Mitropoliti i Korçës,

---

[159]-Në shkresë thuhet: "Zbatuesi i Reformës së ullinjve në Nartë ka deklarue se Kishave dhe Manastireve të Myzeqesë, që kanë ullinj në rrethin e Nartës të Vlonës, u shpronësohen pa shpërblim, në dobi të publikut. Meqenëse këta ullinj janë dhurue për nevojat e zakonshme të kultit ortodoks të kishës dhe të Manastirit përkatës, si dhe për përmbajtjen e zakonshme të tyne, kemi nderin t'ju lutemi të na lajmëroni masat, që mund të ketë marrë i Hirshmi Këshill Ekonomik ose organet e këtij, mbasi çeshtja asht urgjente dhe dihej me kohë që kjo reformë do të zbatohej". Lutës ndaj Zotit, Mitropoliti Visarion.

[160]-Në shkresë thuhej: "Ndër pasunitë manastiriale dhe kishtare, duke përmbledhun kopshtet, bostanet, bahçet dhe ullishtat, ka shkue këto ditë komisioni i Reformës Agrare dhe po i shpronëson në dobi të bujqve, njikohësisht dhe po ua dorëzon. Nuk dimë normat e së drejtës që kanë pasunitë manastiriale dhe kishtare mbi Reformën Agrare. Lutemi të ketë mirësinë Ai i Hirshëm Këshill të marrë në studim çështjen dhe të na njoftojnë veprimin". Lutës ndaj Zotit, Mitropoliti Visarion. Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003, faqe 228-229.

[161]-*Visarion Xhuvani, në Kishë, në Parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007, faqe 365.

[162]-Visarion Xhuvanin e akuzonin se: “Ka raportuar në kuesturë dhe karabinieri njerëzit e lëvizjes, të cilët janë arrestuar mbas kapitullimit të Italisë dhe okupimit të vendit prej nazistëve. Është zgjedhur anëtar i regjencës kuislinge. Ka qenë i lidhur me tradhëtarët e Ballit Kombëtar. Ka mbajtur fjalime kundër Luftës Nacional-çlirimtare. Mbas çlirimit ka propaganduar kundër pushtetit. Ka raportuar pranë gjeneralëve Hogdison Smith në lidhje me popullsinë e vendit. Ka mbajtur lidhje me misionarët anglezë dhe amerikanë në Shqipëri dhe në bazë të neneve 2,3,4 të ligjit Nr. 372, datë 12 dhjetor 1946 dënohet me 20 (njëzetë) vjet privim lirie, me punë të detyruar dhe me humbjen e të drejtave politike për pesë vjet kohë”. Ministria e Drejtësisë, regjistër i gjendjes gjyqësore, Nr. Prot. 2896, 2307, 3612; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 259; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 259.

Agathangjel Çamçe, ndërsa më 28 tetor të vitit 1946 u arrestua Irine Banushi[163]. (Fig.10) (Fig.11) Në shënimet biografike Irineu ka shkruar: *...qëndrova si ndihmës Episkop i Kryesisë deri më 12 korrik 1945, në atë datë prej Sinodhit të kishës jam emëruar si Episkop për dioqezën e Gjirokastrës, por pushteti më ndaloi që të mos shkoj në Gjirokastër dhe unë atëhere qëndrova këtu në Tiranë pranë Kryesisë së Kishës si titullar i dioqezës së Gjirokastrës deri më 28 tetor 1946, ditën që u arrestova*[164]. Akuzat ndaj Irineut qenë krejtësisht të pabaza[165]. Dolën disa dëshmitarë të rremë, të cilët me paturpësinë më të madhe dëshmuan kundër tij. Pas disa muaj qëndrimi në hetuesi, më 28 tetor 1946 iu komunikua vendimi, me anën e të cilit dënohej me pesë vjet heqje të lirisë[166]. Irine Banushi e vuajti dënimin në burgun e Tiranës.

Pas arrestimit të Visarion Xhuvanit dhe Irine Banushit situata në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte kritike, sepse organi më i lartë që ishte Sinodi i Shenjtë kishte humbur kuorumin për të qenë funksional. I vetmi peshkop në sinod kishte mbetur Kristofor Kisi dhe sipas nenit 11 të statutit[167] të vitit 1929 për kuorumin e Sinodit të Shenjtë duhet të qenë gjysma plus një e anëtarëve të tij. Kryeepiskopi Kristofor ja shprehu këtë shqetësim Monol Konomit, që në atë kohë mbante postin e ministrit të Drejtësisë. Kristofor Kisi i tha ministrit të Drejtësisë që në qershor do të shkonte për vizitë zyrtare në Bashkimin Sovjetik dhe nëse patriku

[163]-Imzot Irineu do të provonte egërsinë e diktaturës kumuniste duke u burgosur dy herë në vitet 1946-1948 dhe 1952-1960. Pasi kreu dënimin atë e gjejmë në manastirin e Shën Vlashit. Lidhjet e shumta me njerëzit dhe ndikimi i madh që kishte në popull do të bëheshin shkak që organet e diktaturës ta transferonin Imzot Irineun në manastirin e Ardenicës. Tashmë i zhveshur nga çdo detyrë kishtare punoi si llogaritar (1967). Danish Bebeziqi, *Si e njoha Peshkopin Irine*, Vegim Drite, Nr.4 qershor 1997, faqe 25; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 262; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 262.

[164]-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 2000, faqe 17.

[165]-Ka qenë në lidhje me armiqtë e popullit Gjergj Kokoshi, Dom Shtjefën Kurti etj. Ka zhvilluar aktivitet kundër Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe ka nxitur elementë të tjerë për të shpifur kundër Kryesisë së Kishës me qëllim për të diskretituar udhëheqjen e saj dhe më në fund për ti hequr nga posti dhe për të kthyer Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë kundra vijës që ndjek sot dhe për të zhvilluar aktivitet kundër Pushtetit. Irine Banushi, element armik i Pushtetit dhe që paraqet rrezikshmëri për Republikën tonë Popullore i shtyrë nga urrejtja që ka kundër Pushtetit dhe për tu shërbyer armiqve është interesuar dhe ka mbledhur informata të ndryshme në vendin tonë dhe sidomos në portin e Durrësit mbi eksportet dhe importet që sjell shteti ynë nga jashtë, sidomos nga ato që vijnë nga Bashkimi Sovjetik se mos këta vaporë sjellin material luftarak. Ka folur kundër lëvizjes nacional çlirimtare dhe kundër pushtetit... Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi, martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 2000, faqe 32.

[166]-Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 262; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 262.

[167]-Në nenin 11 të Statutit të vitit 1929 është shkruar: "Sinodhi ka kuorum kur ndodhen prezentë gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Po kurdoherë mbledhje legale mund të bëhet vetëm kur përveç Kryepeshkopit ndodhen dhe dy anëtarë të tjerë..... ". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 193.

Aleksej do ta pyeste për përbërjen e Sinodit të Shenjtë, atëhere nuk kishte se çfarë përgjigje ti jepte. Me anën e këtij argumenti bindës Kisi i kërkoi Konomit të lironte nga burgu Irine Banushin, por ministri nuk pranoi ta bënte këtë gjë[168]. Duke ndjekur zhvillimet kishtare interesi i regjimit për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte që të zgjidhej çështja e Sinodit të Shenjtë. Në muajin shkurt 1949 ministri i Brendshëm, Mehmet Shehu e takoi Irine Banushin në burgun e Tiranës, ku folën për situatën, që po kalonte kisha në atë kohë. Dy muaj më pas, më 28 prill 1949, Irine Banushi u lirua nga burgu falë një amnistie. Irineu u çaktua në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Synimi i regjimit ishte që Irine Banushi do të shërbente si njeriu i pushtetit brenda kryesisë së kishës, por faktet treguan se Irineu nuk u thye.

Gjatë një takimi që patën më muajt mars-prill të vitit 1949 diktatori Enver Hoxha dhe Stalini ndër të tjera diskutuan edhe për çështjen e fesë. "Stalini e pyeti Enverin nëse ka shumë ortodoksë në Shqipëri, si dhe njerëz me fe të ndryshme nga ajo e myslimanëve". Në përgjigjen e tij Enver Hoxha e sqaroi se ortodoksët në Shqipëri përbëjnë 30-35 % të popullsisë, ndërsa katolikët 10-15 %". Nga këto të dhëna arrijmë në përfundimin se Enver Hoxha i njihte mirë statistikat e popullsisë, sepse në vitet e diktaturës komuniste sigurimi i shtetit regjistronte çdo gjë me saktësi. Çdokush do ta besonte se diktatori këto shifra i kishte të sakta, sepse askujt nuk do t`i shkonte në mendje që të gënjente Stalinin, i cili interesohej për popullsinë ortodokse në Shqipëri i shtyrë nga fakti, sepse dikur kishte qenë seminarist[169]. Në përfundim të bisedës së 23 marsit të vitit 1949, Stalini e këshilloi diktatorin Enver Hoxha: "Popullit shqiptar të mos i dhunohet feja"[170].

1.2 VIZITA E DELEGACIONIT KISHTAR NË MOSKË

Më 8 maj të vitit 1947 u mblodh Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në kryesinë e Kryehirësisë së tij, Kryeepiskopit Kristofor Kisi, Mitropolitit të Beratit Imzot Visarionit dhe Ikonomit të Madh Stavrofor Vasil Marko. Qëllimi i mbledhjes së sinodit ishte dërgimi i një delegacioni kishtar në përgjigje të ftesës së Patrikut të Moskës dhe gjithë Rusisë Aleksej me rastin e 500 vjetorit të shpalljes së autoqefalisë së Kishës së Rusisë[171]. Në ftesën e Patrikut Aleksej drejtuar Kristofor Kisit thuhej se periudha më e përshtatshme qe fundi i shtatorit. Fillimisht u vendos që në përbërje të delegacionit të qenë: 1-Kristofor Kisi, Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. 2-Ikonom Dhimitër Kokoneshi, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Pogradecit. 3-Atë Petro Doçi, famullitar i komunitetit ortodoks të Tiranës dhe 4-Atë Llazar Popoviç, famullitar i

[168]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 102.

[169]-Riçard Vurmbrand, *Përgjigje Biblës së Moskës,* Kreuzlingen 1993, faqe 69; Andrea Llukani, *Toleranca ndërfetare në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2006, faqe 6; Andrea Llukani, *Vepra I*, Trifon Xhagjika, 2008, faqe 6.

[170]-*Stalini-Enverit, Popullit shqiptar të mos i dhunohet feja*, Shekulli, 8 nëntor 2005, faqe 21.

[171]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947, fl.2.

komunitetit malazez të Shkodrës. Kjo ishte përbërja e delegacionit të lartë kishtar sipas shkresës që Kryeepiskopi Kristofor i dërgonte më 11.VI.1947 Ministrisë së Punëve të Jashtme[172]. Por keqësimi i shëndetit të Kristofor Kisit e bëri të pamundur pjesëmarrjen e tij. Kështu përbërja e delegacionit sipas shkresës së Kryesisë së Sinodit të Shenjtë Nr. 375 datë 15 dhjetor 1947 ishte: 1-Arkimandrit Paskal Vodica, drejtues administrativ i Episkopatës së Korçës, shef i delegacionit. 2-Ikonom Dhimitër Kokoneshi dhe 3-Ikonom Llazar Popoviç[173]. Delegacioni zyrtar (Fig.13) i Kishës Ortodokse të Shqipërisë qëndroi 18 ditë në Bashkimin Sovjetik. Gjatë ditëve të qëndrimit delegacioni shqiptar vizitoi Moskën, Leningradin dhe Kievin. Delegacioni shqiptar pati një pritje të përzemërt nga patriku Aleksej. Kryetari e delegacionit arkimandrit Paskal Vodica[174] dhe patriku Aleksej[175] folën për Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare. Të dy kishin qenë partizanë. Edhe anëtari tjetër i delegacionit Dhimitër Kokoneshi ka marrë pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacional-çlirimtare[176]. Delegacioni i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë bëri disa vizita nëpër monumentet historike të Moskës. Ata vizituan Sheshin e Kuq, kishën

[172]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.11.

[173]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947, fl.32.

[174]-Paskal Vodica ka përkrahur pa rezerva Luftën Nacional-çlirimtare deri në çlirimin e plotë të atdheut. Ndonëse në moshë të thyer Paskal Vodica u zgjodh anëtar i Këshillit Nacional-çlirimtar të Qarkut të Korçës. Madje në Kongresin e Përmetit arkimandrit Paskal Vodica u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional-çlirimtar. Duke parë veprimtarinë e tij atdhetare okupatorët fashistë e arrestuan dhe e internuan rreth një vit në Bari të Italisë. Pasi u lirua nga internimi, më 28 nëntor të vitit 1939 në kishën e Ersekës celebroi një tedeum, gjatë të cilit mbajti një fjalim me ndjenja të larta patriotike. Për meritat e tij patriotike gjatë luftës është nderuar me "Urdhërin e Flamurit" dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Pas çlirimit të vendit u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja 1333, viti 1966; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 130.

[175]-Patriku Aleksej ka qëndruar i rrethuar bashkë me popullin për 90 ditë në Leningrad, ku ka marrë pjesë aktive në luftë dhe ka mbajtur lart moralin e popullit rus. Për këtë kontribut të çmuar në rrethimin e Leningradit ai është dekoruar nga instancat më të lartat të shtetit rus.

[176]-Dhimitër Kokoneshi e vuri manastirin e Shën Marenës në dispozicion të Lëvizjes Nacional-çlirimtare. Ai ka luftuar me armë në dorë deri në çlirimin e plotë të vendit. Fatmir Gjata në Ditarin partizan ka shkruar: "*Më 19 tetor të vitit 1943 mbërritëm në Llëngë. Fshat mikpritës. Që aty shkuam në manastirin e Shën Marenës, ku na priti Kryetari i Këshillit dhe komandanti i njësitit atë Dhimitër Kokoneshi. Qëndruam atje dy ditë sa të riorganizohej Batalioni i Mokrës. Në Shën Marenë "Prifti me kobure" patrioti i shquar i Llëngës kishte marrë të gjitha masat për fjetje dhe për ngrënie*". Manastiri i Shën Marenës u kthye në një qendër të rëndësishme të luftës. Aty u vendos misioni anglez, sepse ishte vendi më i përshtatshëm strategjik. Gjithashtu Enver Hoxha në librin "Njerëz të thjeshtë" ka shkruar: "*Dy priftërinjtë kryesorë të Mokrës, Kokoneshi dhe prifti i Podgozhanit, u bënë luftëtarë me armë, partizanë me kamillaf dhe me kobure në brez*". Kokoneshi i Shën Marenës shkonte në kishë me kobure në brez. Kur kryente shërbesat fetare, dikush ia mbante koburen tek dera e kishës. Si mbaronte shërbesën, dilte dhe e ngjeshte përsëri koburen në brez. Prifti patriot mori pjesë në shumë aksione që u zhvilluan në zonën e Mokrës. Për meritat e tij gjatë Luftës Nacional-çlirimtare Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka nderuar Dhimitër Kokoneshin me urdhërin "Ylli i kuq" dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010, faqe 3-4; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 132; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 68-69.

Uspjesku, (Fig.14) në të cilën kurorëzoheshin carët e Rusisë, mauzoleumin e Leninit, muzeun e Stalingradit[177] etj. Gjatë një interviste (Fig.15) që dha në selinë e Patriarkanës së Rusisë, kryetari i delegacionit Paskal Vodica ndër të tjera tha: "Lidhja e kishës sonë me kishën ruse na pëlqen dhe e dëshirojmë me gjithë shpirt. Kisha jonë është e lidhur me kishën ruse dhe si një fëmijë i vogël të mbahet në pëqi të mëmës së madhe, e cila do ta përkëdhelë e do ta dirizhojë dhe do e organizojë siç di vetë"[178]. Me rastin e kthimit të delegacionit nga Moska më 8 korrik 1948 në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë u mbajt një referat nga kryetari i delegacionit Paskal Vodica, i cili foli për përshtypjet e vizitës[179].

1.3 DORËZIMI I PASKAL VODICËS NË GRADËN PESHKOPALE DHE SHKARKIMI I KRISTOFOR KISIT

Në kuadër të forcimit të miqësisë ndërmjet dy kishave tona rusët premtuan se në momentin e përshtatshëm do të dërgonin një delegacion të lartë kishtar për të vizituar Shqipërinë[180]. Patriku Aleksej i Moskës i dërgoi një letër Kristofor Kisit, me anën e së cilës theksonte se kisha ruse do të ndihmonte kishën shqiptare. Me fjalën ndihmë nënkuptohej mbështetja që do të jepte për krijimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në koordinim me Patriarkanën e Moskës, Ministria e Drejtësisë i kërkoi Kristofor Kisit, të përgatiste procedurat e hirotonisjes së dy episkopëve për dioqezat e Gjirokastrës dhe të Korçës. Kisi pranoi dhe sipas tij, kisha kishte nevojë të ngutshme vetëm për një episkop, ndërsa për të dytin priste puna. Delegacioni rus mbërriti në Shqipëri më 14 prill 1948. Ai përbëhej nga Kryeepiskopi Nestor, protoprezviteri Pjetër Fillonov dhe atë Mihail Zjernov. Më 18 prill 1948 Nestori bashkë me Kristofor Kisin hirotonisën në gradën episkopale Paskal Vodicën në kishën katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë. Pas dorëzimit si Mitropolit

[177]-Anëtari i delegacionit Dhimirër Kokoneshi në shënimet e tij ka shkruar: “Nëpër stendat e muzeut të Stalingradit pashë madhështinë e betejave që janë zhvilluar prej 12 nëntorit 1942 deri më 21 shkurt 1943. Gjatë betejave qenë asgjësuar 32 divizione dhe tre brigada të armikut. Populli rus është shquar për krenarinë kombëtare, e cila u shfaq dukshëm gjtë viteve të luftës së Dytë Botërore. Në Stalingrad heroizmi nuk ishte një ngjarje individuale, por një fakt kolektiv. Nëpër stendat e muzeut u njoha se si popullsia mori pjesë gjallërisht në Betejën e Stalingradit, se si gratë ishin të gatshme të zinin vendin e shokëve të rënë, se si shtëpitë dhe rrugët e tyre u kthyen në fortesa e transe, se si luftuan brenda godinave gjysmë të shkatërruara, kat më kat e portë më portë. Pashë në qytezën e ndërtuar rishtazi, ruhej si një kujtim i përjetshëm i betejës gjiganteske të Stalingradit, shtëpia e rreshterit Pavllov, ku sovjetikët u mbrojtën për dyqind ditë nga sulmet e gjermanëve. Në Stalingrad unë pashë fotot e tri gjigandëve të aleancës së Luftës së Dytë Botërore, Stalin, Rusvelt dhe Çërçill”. Llazi Tona, *Në labirintet e monumenteve kulturore historike të përbotshme*, Mokra, prill 2009, faqe 7.

[178]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 218, viti 1948, fl. 2-4.

[179]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 32.

[180]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948, fl. 23-24.

i Korçës, Paskal Vodica mori emrin Paisi[181]. Kandidatura e Paskal Vodicës nuk ishte shqyrtuar më parë në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë dhe ishte antikanonike, pasi ai nuk plotësonte kriterin e arsimimit[182] dhe të beqarisë, ndonëse prej vitesh kishte mbetur i ve. Procedura e dorëzimit të Paskal Vodicës ishte e rregullt, pasi qe hirotonisur nga dy peshkopë kanonikë, Nestorit dhe Kristoforit.

Më 5 qershor 1948, në mbledhjen e Byrosë Politike, ndër të tjera diktatori Enver Hoxha diskutoi edhe për Kristofor Kisin, duke e cilësuar atë si agjent të perëndimit, që nuk dëshironte afrimin e Kishës Autodokse Autoqefale të Shqipërisë me Patriarkanën e Moskës. Hoxha pretendonte se Kisi gjatë vizitës së delegacionit rus, ishte përpjekur të lidhej me Legatën franceze në Tiranë, që të merrte udhëzime nga Perëndimi. Pas kësaj akuze false diktatori Enver Hoxha mendonte se Kisi duhej mënjanuar nga drejtimi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[183].

Në muajin korrik 1948, autoritetet shtetërore i sugjeruan Kryeepiskopit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturisë së Tij, Kristofor Kisit të tërhiqej nga administrimi i kishës, ndonëse në nenin 19 të statutit të vitit 1929 thuhej: "*Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dhioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut*"[184]. Ndonëse Kristofor Kisi mbeti formalisht në krye të kishës, udhëzimet do ti jepte Paisi me ndihmën e sekretarit të përgjithshëm Niko Çanes. Madje, Paisi iu besua edhe mbajtja e vulës së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[185]. Në fakt sipas nenit 22 të statutit, Sinodi i Shenjtë kishte të drejtën ta shkarkonte Kryeepiskopin, për shkak të moshës së thyer ose problemeve shëndetësore, të cilat nuk e linin të përmbushte detyrën[186].

---

[181]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 30.

[182]-Në nenin 17 të Statutit të vitit 1929 theksohet: "Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorëzohen, përveç cilësive t'Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanonet e Kishës, si dhe të kenë mbaruar një Fakultet Theollogjie. Në rast nevoje, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, mund të dorëzohet Peshkop edhe ay që ka dipllomë fakulteti drejtësie, filologjie ose të një Seminari Orthodhoks në gradë Liceu". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 195.

[183]-Sipas studiuesit Artan Hoxha lidhjet e Kristofor Kisit me ministrin e Francës në Shqipëri, Guy Menant qenë të forta. Megjithatë organet e Sigurimit të Shtetit nuk raportojnë për asnjë lloj kontakti mes tyre gjatë muajit prill 1948, që përkonte me vizitën e delegacionit rus. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 105; Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 140, Dosja Nr. 60, fleta 51.

[184]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929, Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

[185]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi Nr. 536, Dosja Nr. 232, fl.115.

[186]-Në nenin 22 të statutit është shkruar: "Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos. Po Sinodhi mundet edhe *motu proprio* të çfaqi mejtimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodhit vetë, dy prej të sëmurit dhe një prej Drejtorisë së P. të Shëndetësisë. Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk japin dorëheqjen brenda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodhi me një herë emëron një ndihmës Peshkop, i cili merr përsipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët të deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonitë e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej

Paisi kishte nevojë për mbështetje brenda sinodit, prandaj kërkoi që anëtarë të sinodit të qenë edhe Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi[187], i cili në atë kohë drejtonte dioqezën e Beratit dhe Ikonom Aristotel Strato[188], që administronte dioqezën e Gjirokastrës. Nga ana kanonike si Kokoneshi ashtu edhe Strato nuk mund të qenë anëtarë të sinodit, sepse nuk e patën marrë ende gradën episkopale. Ndërkohë që më 5 korrik 1949, Ministria e Drejtësisë e thirri Kisin dhe e urdhëroi të mbledhë sinodin. Kristofor Kisi u kërkoi autoriteteve shtetërore, që në përbërje të sinodit të ishte edhe Irine Banushi, por ata iu përgjigjën me diplomaci "do ta studiojmë si rast". Duke mbetur i vetëm përballë klerikëve, që qenë caktuar nga regjimi, Kristofor Kisi më 9 korrik 1949 njohu Kokoneshin dhe Straton si anëtarë të sinodit[189]. Duke patur në dorë Sinodin e Shenjtë, regjimi do të niste zbatimin e një politike të re brenda kishës me mbështetës të bindur ndaj kryesisë së kishës dhe të pushtetit.

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë[190] të 25 gushtit 1949 Kryeepiskop Kristofor Kisin e shkarkuan me akuza nga më banalet sikur kishte ngrënë dhe pirë në një çanak me pushtuesin, sikur mbante veshët çuar nga deti, duke pritur shpëtimin nga jashtë, sikur kishte bërë punë armiqësore të rrezikshme për të diskretituar pushtetin popullor etj[191]. Në kohën që u shkarkua Kisi, Irine Banushi deklaroi se procedura e ndjekur ishte antikanonike, sepse duke u bazuar në nenin 21 të statutit ku thuhet: "*Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëvet dhe i Ikonomit të Madh Mitrofor bëhet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinare dhe për arsye ekstraordinare*.[192]" Kisin e shkarkuan në mënyrë antikanonike dhe nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por e mënjanuan dhe e izoluan në kishën e Shën Prokopit në Tiranë.

---

gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin asnjë pjesë aktive n'administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërinë e tyre, ata japin dorëheqjen duke marrë nga arka e përgjithshme e Kishës një shpërblim të përmuajshëm për Kryepeshkopin gjashtëqind franga ari, dhe për Peshkopët katërqind fr. ar". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 197.

[187]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 5.

[188]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948, fl. 8.

[189]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 116.

[190]-Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë qenë Paisi Vodica me cilësinë e kryetarit, Dhimitër Kokoneshi, anëtar, Aristotel Strato anëtar, Niko Çane, anëtar. Ikonomi i Madh Mitrofor Vasil Marku nuk mori pjesë për arsye shëndetësore.

[191]-Disa nga akuzat sipas Paisit ndaj Kisit qenë: "Kristofor Kisi me origjinë nga Berati, por i mbrujtur në llumin e shovinizmit të Fanarit, u bë renegat i Kishës dhe i popullit tonë dhe tregtar e ryshfetxhi i idealeve më të shenjta të saj, i fshehur nën maskën e Kryepiskopit dhe të Episkopit, punoi gjithmonë në dëm të Kishës sonë, të cilën nuk e drejtoi kurrë sipas interesave të saj dhe të popullit shqiptar, por sipas interesave dhe sugjerimeve e diktateve të të huajve, duke e shikuar gjithnjë çdo çështje nën prizmin e rryshfetit....Nën cilësinë e Kryetarit të Sinodit dhe të Këshillit Miks dhe në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e këtij të fundit Andon Beça, Vangjel Gozhomani e Mihal Sherko dhe në prapaskenë me doktor Petrotën e delegatin Apostolik vendosi hedhjen e Kishës sonë në prehërin e unizmit, duke e prurë këtë çështje gjatë një mbledhjeje të Këshillit Miks dhe duke pritur rastin e volitshëm që të shpallte bashkimin definitiv dhe zyrtarisht me papën". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl. 44-49.

[192]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Fletorja Zyrtare, 14 gusht 1929; Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 196.

Sinodi u mor edhe me problemin e Irine Banushit. Më 31 gusht 1949 Irineu u emërua peshkop ndihmës i kryesisë së kishës, por nuk u lejua që të drejtonte ndonjë dioqezë.

Pas shkarkimit së Kristofor Kisit i erdhi radha Paisi Vodicës[193]. Më 25 gusht 1949 Paisi Vodica u shpall Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[194]. Në fjalën e tij Kryeepiskopi i sapofronëzuar tha: *"Sinodi i Shenjtë i Kishës tonë Ortodokse Autoqefale më ngarkoi barrën e rëndë që të jem në krye të kishës sonë. Kjo barrë si për moshën ashtu edhe për aftësitë e mia është shumë e rëndë, por, me ndihmën e gjithë besimtarëve, me ndihmën tuaj dhe të gjithë klerit dhe me përkrahjen e Pushtetit Popullor unë do të vë të gjitha forcat për të udhëhequr grigjën që mu besua. Në radhë të parë falënderoj Perëndinë e shumë fuqishmë për këtë ngritje që mu bë dhe me forcën dhe bekimin e Zotit tonë të Plotfuqishëm, Jisu Krishtit, do të plotësoj urdhërat e tij"*[195]. Më 26 gusht 1949, sekretari i përgjithshëm Niko Çane në emër të Sinodit të Shenjtë njoftoi gjithë episkopatat dhe zëvendësitë mitropolitane për zgjedhjen e kryeepiskopit të ri. Më 29 gusht 1949, Kryeepiskop Paisi i dërgoi Patrikut të Moskës Aleksej një telegram, me anën e të cilit e njoftonte për emërimin dhe e garantonte se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do të ndiqte luftën kundër imperializmit. Më 19 shtator 1949 kryeepiskopi u dërgoi telegrame kishave bullgare, rumune, polake, çekosllovale dhe gjeorgjiane, të cilat si pjesë e vendeve të bllokut sovjetik e njohën Paisi Vodicën si kreun e ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Paisi e shpërfilli Patriarkanën Ekumenike, kishën greke dhe atë serbe, duke mos i njoftuar për zgjedhjen e tij në postin e kryetarit të Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Në qarkoren që i dërgoi klerit ortodoks, Paisi theksonte se qëllimi i tij ishte të forconte lidhjet me kishat ortodokse të vendeve motra dhe veçanërisht me Patriarkanën e Moskës[196].

---

[193]-Paisi Vodica ka lindur më 1881 në Vodicë të Kolonjës. Në moshën 29-vjeçare u dorëzua prift dhe ka shërbyer në fshatin e tij të lindjes. Vite më vonë u zgjodh zëvendës episkop. Paisi Vodica ka përkrahur pa rezerva luftën nacional-çlirimtare deri në çlirimin e plotë të atdheut. Për meritat e tij patriotike gjatë luftës është nderuar me "Urdhërin e Flamurit" dhe medaljet e Kujtimit, Çlirimit dhe të Trimërisë. Pas çlirimit të vendit u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Paisi kishte qenë më parë i martuar dhe kishte mbetur i ve. Ai ishte i ati i Josif Pashkos, i cili në atë kohë mbante postin e Ministrit të Ndërtimit. Më 18 prill të vitit 1948 në Kishën Katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë, arkimandrit Paisi Vodica u dorëzua Mitropolit i Korçës prej Kryeepiskopit Kristofor Kisi dhe një episkopi rus të quajtur Nestor, që kishte ardhur enkas për këtë punë. Ndërsa më 25 gusht 1949 Paisi u shpall Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 158.

[194]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 169.

[195]-*Në kathedralen orthodhokse të Kryeqytetit u zhvillua mesha kryepiskopale e kryesuar nga Krye-Hirësia e tij, Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë Pasisi Vodica*, Bashkimi, 30 gusht 1949, faqe 3, 4.

[196]-Sipas studiuesit Artan Hoxha pjesëmarrja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në bashkësinë e kishave ortodokse të botës kushtëzohej nga marrëdhëniet e shtetit shqiptar të asaj kohe. Për sa kohë që Greqia dhe Jugosllavia qenë vende armike me regjimin komunist shqiptar edhe marrëdhëniet me kishat e këtyre vendeve do të qenë armiqësore. Gjithashtu në krye të patriarkanës Ekumenike të Stambollit qëndronte një klerik proamerikan si Atenagora, prandaj edhe marrëdhëniet do të qenë jo të mira. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 126-127.

Me vendosjen e Paisit në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë regjimi komunist nisi procesin e konsolidimit të pushtetit. Kryesia e Kishës tashmë gjithë veprimtarinë e saj e përqendroi në funksion të interesave të pushtetit. Për të realizuar këtë Kryesia e Kishës duhej të spastronte personelin nga njerëzit e papërshtatshëm. Personelit iu kërkua të dorëzonin biografitë në Kryesinë e Kishës. Biografitë[197] u përdorën për të eleminuar rivalët në radhët e personelit të kishës. Në organikën e kishës u shtua një post, ai i nëpunësit të biografive, i cili u shpërndante dhe më pas administronte formularët e biografive të personelit.

Problem tjetër i rëndësishëm qe edhe uniteti i përçarë i njerëzve që qenë zgjedhur në rangjet e larta kishtare. Paisi vendosi të kryente spastrime në radhët e personelit kishtar. Të parët që u vunë në shënjestër qenë anëtarët e kryesisë së Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve, Theofan Popa, Vlash Nushi dhe Sotir Kanxheri, të cilët patën kundërshtuar hapur draftin e parë të Statutit. Mëria e teologëve të rinj ishte jo vetëm ndaj Paisit, por edhe ndaj Niko Çanes, që në atë kohë mbante postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kishës. Kundër Niko Çanes ishte edhe Dhimitër Kokoneshi. Në janar 1950 Kokoneshi i dërgoi një letër Mehmet Shehut me anën e së cilës e akuzonte rëndë Niko Çanen, si arkitektin e të gjitha konflikteve, që patën shpërthyer në Kryesinë e Kishës. Akuza më e fortë ishte se Niko Çane ishte njeriu i Kotokos në Kryesinë e Kishës. Ky fakt i vrau veshin Mehmet Shehut prandaj kërkoi një hetim të thellë mbi njeriun, që kishte kaq pushtet mbi Kryeepiskopin Paisi Vodica. Kokoneshi, duke bashkëpunuar me Spiro Velin dhe Aristotel Straton kërkuan thirrjen e mbledhjes së Sinodit të Shenjtë, në të cilin do të merrej masa disiplinore ndaj kryesekretarit Niko Çane. Paisi Vodica vuri në dijeni kryeministrin Mehmet Shehu. Ky i fundit udhëzoi drejtorin e Komitetit Klerik, Gaqo Peristerin që ta shkarkonte Çanen nga detyra e sekretarit dhe ta emëronte diku në administratën shtetërore. Në këtë moment u fut në lojë Josif Pashko, i cili i quajti shpifje akuzat e Kokoneshit. Madje, Pashko theksoi se konflikti është kurdisur nga Irine Banushi, Theofan Popa, Dhimitër Beduli dhe Sotir Kanxheri[198]. Nga ana tjetër Niko Çane u hodh në sulm, duke e akuzuar Kokoneshin si papist e reaksionar, që punonte kundra interesave të kishës në bashkëpunim me armiqtë Theofan Popa, Dhimitër Beduli, Sotir Kanxheri dhe Vlash Nushi.

[197]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951; Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste,* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014, faqe 7-8.

[198]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 180-181.

1.4 DEKRETLIGJI MBI KOMUNITETET FETARE

Laiciteti i Shtetit Shqiptar ka qenë i padiskutueshëm në regjime të ndryshme, por të gjitha regjimet kanë pasur një ligj të posaçëm për komunietet fetare. Më 26 nëntor të vitit 1949 Presidiumi i Kuvendit Populllor shpalli dekretligjin nr. 773 "Mbi komunitetet fetare". Ky dekretligj u aprovua nga Kryesia e Presidiumit të Kuvendit Populllor më datë 16 janar të vitit 1950[199].

Më 16 dhjetor 1949 Këshilli Ministerial me anën e shkresës nr. 2121/2 me lëndë: "Shpjegime mbi Dekret-ligjën Nr. 743 datë 26.11.1949", që u dërgonte gjithë komuniteteve fetare të Shqipërisë i sqaronte se si mund të organizohen dhe të funksionojnë më mënyrë të atillë që të njihen nga shteti[200]. Regjimi komunist me anën e këtij ligji i detyronte komunitetet fetare që të bënin ndryshime nëpër statutet e tyre. Ligji i ri theksonte që komunitetet fetare duhej të kultivonin tek besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit popullor[201]. Zgjedhja e kryetarëve të komuniteteve fetare miratohej nga Këshilli i Ministerial. Klerikët e të gjitha niveleve qenë të detyruar të dorëzonin pranë Këshillit Ministerial dosjet biografike, të cilat përgatiteshin nga nëpunësi i biografive, që u shtua si post në organikën e komuniteteve fetare. Ai dërgonte formularët dhe klerikët pasi i plotësonin me saktësi ia dërgonin. Pasi të zgjidheshin ata duhet të kishin aprovimin e Këshillit Ministerial. Dekretligji i detyronte organet drejtuese qendrore të komuniteteve fetare të jenë të regjistruar pranë Kryesisë së Këshillit të Ministrave duke shënuar emër për emër anëtarët e organeve drejtuese. Ky regjistrim është i domosdoshëm sepse pushteti ka mundësi të njohë se ç'njerëz janë ata që drejtojnë aktivitetin fetar në territorin e Republikës së Shqipërisë[202]. Shteti mund të pezullonte çdo klerik që nuk përmbushte kriteret e përcaktuara[203]. Nëse dikush nuk aprovohej dhe vazhdonte të kryente funksionin e tij fetar, atëhere dënohej me heqje lirie deri në tre vjet[204]. Lidhja me qendrat shpirtërore të huaja do të bëhej vetëm me anën e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Dekretligji i ndalonte komunitetet fetare të hapnin shkolla spitale, jetimore dhe institucione të tjera analoge. Të gjitha institucionet e sipërpërmendura u shtetëzuan dhe pasuritë e tyre të luajtshme dhe të paluajtëshme kaluan nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë, ose nën Drejtorinë e Kujdesit Social. Kuptohet vetvetiu se në Republikën tonë të re, shkolla, edukimi dhe kujdesi social janë direkt nën kujdesin e shtetit, i cili mendon për rritjen dhe edukimin e brezit të ri[205].

---

[199]-Gazeta Zyrtare, nr. 8, Tiranë, 23 shkurt 1950, faqe 13-14; Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë komuniste,* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014, faqe 7.

[200]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 228, viti 1949, fl. 1-2.

[201]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 12.

[202]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 13.

[203]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 15.

[204]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 34.

[205]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 24.

Komunitetet fetare kishin të drejtë të ndërtonin faltore, të ushtronin publikisht dhe në vende të hapta ceremonitë, shërbimet dhe proçesionet fetare, të thërrisnin kongrese, sinode, konferenca etj. Çdo aktivitet fetar ishte është i lirë. Ceremonitë dhe shërbimet fetare qenë të lira vetëm nëse ato qenë në komformitet me ligjet e shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira. Dekretligji duke qenë në komformitet me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili e ndalon përdorimin e kishës dhe të fesë për qëllime politike dhe formimin e organizatave politike me baza fetare. Një gjë e tillë është shumë e drejtë, sepse kisha dhe feja duhet të kryejë vetëm shërbimin që ka ndaj besimtarëve. Gjithashtu ligji përcaktote që komunitetet fetare ose degët e tyre që kanë qendrën e tyre jashtë shtetit nuk mund të hapin në Republikën Popullore të Shqipërisë degë të tyre dhe ato qe ekzistojnë duhet të mbyllen. Për këto urdhëra, shoqata e misione fetare populli është i qartë dhe e di qëllimin e tyre. Ato i kanë sjellur dëm të madh vendit tonë, sepse kanë qenë kurdoherë në shërbim të imperializmit. Kisha duhet të jetë kombëtare dhe e pavarur. Pushteti ynë me anë të këtij ligji i jep një ndihmë të madhe komuniteteve fetare. Ndihma morale dhe materiale gjer më sot nuk ka munguar, por me anë të këtij ligji kjo bëhet dhe më e fuqishme[206].

Komunitetet fetare që mund të funksiononin si persona juridikë duhet të njiheshin nga Shteti. Njohja bëhej me aprovimin e Statutit të tyre nga Presidiumi i Kuvendit Popullor[207]. Gjithashtu brenda tre muajve duhej të hartonin statutet e tyre, te cilat duhet tia paraqisnin qeverisë për miratim[208]. Për të ndjekur ecurinë e këtij procesi pranë Kryeministrisë u krijua Komiteti për Çështjet Klerikale, i cili do të luante rolin e ndërmjetësit ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare tradicionale.

Në vitin 1963 Dekretligjit nr. 743 "Mbi komunitetet fetare" iu bënë disa ndryshime. Njohja e komuniteteve fetare nga shteti dhe revokimi i njohjes së tyre nuk qe më kompetencë e Kuvendit Popullor, por e Këshillit të Ministrave.

1.5 KONGRESI I TRETË I KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

Në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë më 2 shtator 1949 u formua një komision të përbërë prej shtatë vetësh, të cilat do të hartonin statutin e ri të të K.O.A.Sh-it. Komisioni u mblodh për herë të parë më 5 tetor 1949. Në të merrnin pjesë Kryepeshkopi Paisi Vodica, Episkopi ndihmës Irine Banushi, Niko Çane, Dhimitër Beduli, Theofan Popa dhe dy juristë. Në përfundim të mbledhjes komisioni ngarkoi Niko Çanen dhe Theofan Popën të hartonin statutin e ri të të K.O.A.Sh-it. Hartimi i statutit që në fillim u paralizua nga fërkimet që patën Çane dhe Popa. Përplasja e tyre ishte për sa i përket marrëdhëniveve ndërmjet kishës dhe shtetit. Theofan Popa ishte i

[206]-*Mbi marëdhëniet midis shtetit dhe kishës*, Bashkimi, 1 dhjetor 1949, faqe 1.
[207]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 7.
[208]-Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 36.

vendosur dhe nuk pranonte politizimin e kishës, ndërsa Niko Çane[209] e quante qëndrimin e Theofanit sabotues dhe mospajtues me grupin e Paisit, gjë e cila do të përdorej më pas, në dhjetor 1950 për ta larguar atë nga kisha[210]. Sipas një raporti të Sigurimit të Shtetit arsyeja e largimit të Theofan Popës nga kisha ka qenë konflikti që ka pasur me Sekretarin e Përgjithshëm të K.O.A.Sh-it Z. Niko Çane[211].

Me anën e shkresës Nr. 321, datë 16.12.1950 të nënshkruar nga Kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Paisi, Theofan Popa mbetej jashtë strukturës së kishës[212]. Largimi i Theofanit nga kisha nuk u prit mirë nga ata që e njihnin dhe e vlerësonin punën e tij. I pari reagim erdhi nga Zëvendësi i Episkopatës së Korçës, Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, i cili me anën e një shkrese, që mban datën 19.12.1950 i drejtohej Kryetarit të Kishës Ortodokse Imzot Paisit ku i kujtonte se largimi i Theofanit nga kisha do të linte përshtypje të keqe në radhët e besimtarëve[213]. Por edhe Irine Banushi, i cili deri në atë kohë nuk ishte përzierë me çështjet kishtare e kritikoi ashpër Kryeepiskopin për mënyrën antikanonike të zgjedhjes në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. "Ç'statut e kongres do të bëjmë neve kur s'kemi Sinodh dhe Episkopë" kishte deklaruar Irine Banushi.

---

[209]-Sekretari i Përgjithshëm i K.O.A.Sh-it Niko Çane ka lindur më 1909 në Stegopul të Lunxhërisë. Studimet teologjike i kreu në universitetin e Athinës me bursë nga K.O.A.Sh. Si i arsimuar jashtë shtetit fillimisht Niko Çane iu bashkua grupit të Lidhjes së Teologëve dhe Seminaristëve, por duke parë konjukturat e momentit shërbeu si një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Kryeepiskopit Kristofor Kisi. Pas dorëheqjes së Kisit, Niko Çane duke mbajtur postin e sekretarit të përgjithshëm ka bashkëpunuar ngushtë me Kryeepiskopin Paisi Vodica. Madje Niko Çane përgatiste dhe drejtonte gjithshka, ndërsa kryeepiskopi vinte vetëm firmën. Përpos këtyre Niko Çane ka qenë informator i Sigurimit të Shtetit, duke mbajtur pseudonimin Virtyti. Niko Çane përdori të gjitha lidhjet e tij për të larë hesapet me kundërshtarët. Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 116-117.

[210]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 140-142; Dhimitër Beduli, *Theofan Popa-teolog dhe studiues i denjë i kishës dhe i kombit,* Ngjallja, janar 1995, faqe 6,8.

[211]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 108.

[212]-Në shkresë shkruhej: Z. Theofan Popa. Duke marrë parasysh mospranimin tuaj që të konformoheni me udhëzimet e herë pas herëshme të Titullarit të kësaj kryesie në lidhje me përmbajtjen e predikimeve të mbajtura prej jush si predikator dhe sidomos refuzimin tuaj relativ që të konformoheni këtej e tutje, të cilin refuzim e bëtë gjatë mbledhjes kushtuar punimit të Rezolucionit të Sinodit të Shenjtë dhe i Këshillit të Hirshëm Mikst, ku u shtruan njëkohësisht dhe detyrat që i dilnin çdo nëpunësi në të ardhmen konform frymës së Rezolucionit në fjalë dhe duke marrë gjithashtu parasysh se edhe vëndi i shefit të personelit është suprimuar në organikën e re, për këto arsye që konsistojnë në mos pranimin nga ana juaj që të punoni në kishë në përputhje me vijën e saj të caktuar në Kongresin Kishtar, në Statut dhe në vendimet përkatëse të këshillave të larta dhe që tregojnë se ju vet me anën e refuzimit të lërtpërmendur keni shkarkuar vetveten nga detyra, ju bëjmë të ditur se mbeteni jashtë kuadrit të nëpunësve të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë qysh nga data 1 janar 1951. Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 536, Dosja 299, Viti 1950, fl. 24.

[213]-Në shkresë thuhej: Mora shkresën tuaj Nr. Prot. 3 ku na theshit për Theofan Popën të mbetur jashtë kuadrit për vitin 1951; gjë që mua nuk mu duket e mirë, se do të tingëllojë keq, se neve njerëzit e kishës duhet ti afrojmë dhe jo ti zbojmë. Por vetëm se nëse kini ndonjë urdhër ahere menjëherë të pushohet. Por nëse jo unë shfaq mendimin tim por më fal, Predikator mos e ver, vere ndonjë referent dhe nëqoftëse ai nuk e pranon se rroga është e paktë atëhere le të hiqet vetë se neve nuk mund të shkelim vendimet e marura... Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 536, Dosja 299, Viti 1950, fl. 320.

Ngërçi qëndronte me Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili në rastin konkret përbëhej vetëm nga një episkop, në vend të tre të tillëve që e kërkonte statuti. Dalja e ligjit për komunitetet fetare e bënte urgjente hartimin e statutit, por Theofan Popa nuk e pranonte me asnjë mënyrë politizimin e kishës, ndërkohë që po afronte data e kongresit kishtar. Më 1 shkurt 1950, në mbledhjen e Sinodit të Shenjtë u vendos që të suprimohej komisioni i parë dhe të ngrihej një komision i dytë, i cili u kryesua nga Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Paisi[214]. Theofan Popa u la jashtë këtij komisioni, ndërsa Irine Banushit ia paraqitën projektstatutin vetëm për ta parë nga ana gjuhësore dhe jo nga ana kanonike. Më pas Paisi Vodica ia dërgoi kopjen përfundimtare të projektstatutit për ta nënshkruar. Përfundimisht, studiuesi Artan Hoxha mendon se statuti u hartua nga Niko Çane[215], ndërsa teologu Pirro Kondili është i bindur se ai u hartua nga juristët e kryeministrisë, Ilia Kota dhe Foni Qirko[216].

Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it (Fig.16) u çel në 7 shkurt të vitit 1950 në Tiranë. Në Kongres qenë të ftuar Kryetari i Komunitetit Mysliman Hafiz Musaj, Kryegjyshi Bektashian Ahmet Myftar Dede dhe nga Kisha Katolike Don. Zef Bicaj. Rendi i ditës së Kongresit ishte: 1-Aprovimi i vendimeve të Sinodit mbi disa ndryshime në udhëheqjen e kishës. 2-Shqyrtimi dhe aprovimi i projekt-statutit të ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[217]. Në ditët e punimeve të kongresit binte në sy mungesa e Kristofor Kisit dhe Irine Banushit, që qenë përjashtuar nga Sinodi. Fjalën përshëndetëse e mbajti Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij, Paisi, i cili pasi përshëndeti delegatët e kongresit nuk kurseu komplimentat për përfaqësuesin e qeverisë dhe në veçanti për Enver Hoxhën[218]. Për drejtimin e punimeve të Kongresit u zgjodh presidiumi, në përbërje të së cilit qenë: Kryehirësia e Tij, Paisi, Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Ikonom Aristotel Strato, Spiro Luarasi, Llazi Bozdo, Aleksandër Xhuvani dhe Zoto Boshari. Anëtarët e presidiumit pas thirrjes së emrave zunë vend në panelin kryesor në krah të Paisit. Ky i fundit propozoi sekretariatin teknik të kongresit për mbajtjen e procesverbaleve. Në sekretariat qenë Av. Vasil Xhaj, Koço Kostaqi dhe Kryedhjakon Sotir Kanxheri[219].

---

[214]-Komisioni hartoi një procesverbal, në të cilin thuhej: "Vdekje fashizmit. Liri popullit. Sot ditë e mërkurë më një shkurt 1950 u mblodh komisioni për hartimin e projektstatutit të K.O.A.Sh-it, i përbërë prej Kryeepiskop Paisit, në cilësinë e kryetarit, prej anëtarëve të sinodit, të përndershmit arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, ikonom Aristotel Strato, Hirësia e Tij, Episkop Irine Banushi, në cilësinë e specialistit për çështjet kanonike dhe dogmatike, Z. Foni Qirko, Z. Ilia Kota, në cilësinë e juristëve dhe prej Z. Niko Cane, në cilësinë e specialisit për çështjet kanonike dhe dogmatike. Komisioni në fjalë pasi shqyrtoi për të fundit herë, nen për nen dhe në tërësi projektstatutin e përgatitur prej tij, vendosi unanimisht t'i parashtrohet Kongresit për shqyrtim dhe aprovim…". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.1.

[215]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 142.

[216]-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 56.

[217]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.17.

[218]-*Në Tiranë u çel Kongresi i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1.

[219]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.17.

Në vijim foli përfaqësuesi i qeverisë Adil Çarçani, i cili përshëndeti punimet e kongresit. Ndër të tjera ai theksoi direktivat që duhej të ndiqte K.O.A.Sh-i në kuadrin e kursit të ri komunist që ishte vendosur në Shqipëri[220].

Referatin kryesor të Kongresit e mbajti Kryeepiskopi Paisi Vodica, i cili foli rreth historikut të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe detyrat që i dalin asaj në kohën e sotme[221]. Pas referatit kryesor kongresi vazhdoi me diskutimet. I pari

[220]-Në fjalën e tij Adil Çarçani tha: "Më lejoni të përshëndes në emër të qeverisë Kongresin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe delegatët klerikë dhe laikë që marrin pjesë në këtë kongres. Misioni i Kishës është që t'i shërbejë popullit. Këtë mision kisha nuk u la ta kryente dhe nuk e kreu gjatë regjimeve të së kaluarës. Si çdo institucion tjetër ashtu edhe kisha përdorej si vegël për të gënjyer dhe për të shtypur masat duke çfrytëzuar ndjenjat e tyre fetare. Kisha ishte vegël e klikave reaksionare të brendshme, e qendrave fetare të huaja si kisha e Bizantit dhe Vatikanit, kështjella të fuqive imperialiste dhe kundërshtare të vendosura të aspiratave të popullit për liri dhe demokraci. Ajo nuk ishte një faktor për bashkimin e popullit, por një instrument përçarjeje. Reaksioni u përpoq të përdori kishën për të thelluar akoma më shumë hendekun që kishte hapur në mes masave të popullit tonë të besimeve të ndryshme. Kisha sundohej nëpërmjet dinjitarëve të saj të lartë nga klikat feudal-borgjeze. Ata i diktonin kishës vullnetin e tyre dhe luftonin çdo pikëpamje të klerit..." Në përfundim të fjalës së tij shoku Adil Çarçani tha: "Në demokracinë tonë popullore liria e kishës, liria e ndërgjegjes dhe e besimit është e plotë. Në demokracinë tonë polpullore janë vendosur marrëdhënie të drejta në mes të Shtetit dhe Kishës, zbatohet drejt parimi i drejtë i ndarjes së kishës nga shteti. Bazat e këtyre raporteve janë hedhur në ligjin themelor të shtetit, në Statutin e Republikës Popullore dhe janë përcaktuar me hollësi në ligjin e ri mbi komunitetet fetare. Shteti ynë nuk ndërhyn në punët e brendshme të kishës dhe kisha nuk duhet të përzihet në aktivitetin politik të shtetit. Ky është koncepti i ndarjes së kishës nga shteti dhe kështu duhet të zbatohet në marrëdhëniet në mes tyre..." *Përshëndetja e përfaqësonjësit të Qeverisë Shokut Adil Çarçani*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 291, viti 1950, fl. 1.

[221]-Ndër të tjera Kryeepiskopi Paisi Vodica tha: "Asnjëherë Kisha jonë nuk ka pasur mundësinë të praktikojë parimet e saj të larta mbi dashurinë, vëllazërimin dhe paqen midis njerëzve se sa në shoqërinë e sotme. Të drejtat e kishës janë të garantuara dhe të sanksionuara me anën e Statutit të Republikës sonë Popullore. Ligji i ri mbi komunitetet fetare i përcakton në mënyrë të përsosur të drejtat dhe detyrat e kishës dhe të funksionarëve të saj. Dhe ky statut dhe ky ligj janë gjëra të shenjta për ne. Duhet pasur gjithmonë parasysh dhe të mos harrohet në asnjë çast se detyra e kishës sonë është që të jetë besnike e Republikës sonë Popullore, besnike e popullit dhe aspiratave të tij, besnike e atdheut tonë të dashur dhe flamurtare e predikatore e unitetit popullor, luftëtare e mbrojtjes së kufinjve të shenjta dhe të lirisë së indipendencës dhe integritetit tokësor të atdheut tonë kundër tentativave grabitqare. Dhe kur themi kisha nënkuptojmë gjithë funksionarët dhe nëpunësit e saj, klerikë dhe laikë, gjithë besnikët ortodoksë, që nga më i madhi e gjer tek më i vogli. S'ka kishë të lirë pa atdhe të lirë dhe popull të lirë. Gjithashtu kisha jonë duhet të jetë besnike kampit të madh anti-imperialist dhe demokratik, e kampit unik të socializmit të udhëhequr shkëlqimisht nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe i madhi Stalin kundër çdo tentative që ndërmer imperializmi skllavëronjës për të minuar paqen ndërkombëtare dhe për të hedhur botën në një kasaphanë dhe katastrofë të re. Pikërisht dhe këtu e ka vendin dhe kisha jonë, në gjirin e kampit të madh dhe unik të paqes, ku bëjnë pjesë kishat ortodokse përparimtare të botës me në krye kishën e madhe ortodokse ruse, e cila qëndron në ballë të kampit kishtar progresiv për një dashuri, vëllazërim dhe paqe të vërtetë. E kemi për nder të madh që jemi lidhur me Kishën e Madhe Ortodokse Ruse, e cila interpreton dhe praktikon drejt parimet e larta ungjillore mbi dashurinë, vëllazërimin dhe paqen dhe që udhëhiqet nga prelatë të lartë siç është shenjtëria e tij patriku i Moskës dhe i gjithë Rusisë Aleksej. Vizitat që kemi bërë dy herë në Bashkimin Sovjetik na kanë dhënë shumë dritë në këtë drejtim dhe kanë bërë që lidhjet tona të jenë të pavdekshme. Gjithashtu e kemi për nder që kisha jonë ka lidhje të ngushta bashkëpunimi dhe me kishat ortodokse të demokracive motra që punojnë në të njejtën rrugë....". Ndër të tjera Paisi tha:

e mori fjalën zëvendësi i përgjithshëm i Mitropolisë së Korçës, Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi. Në vijim u lexua telegrami që kishte dërguar Patriku i Moskës dhe i gjithë Rusisë Aleksej. Ky i fundit shprehte keqardhjen se për arsye kohe nuk kishte mundur të dërgonte një delegacion kishtar në kongres. Në seancën e dytë të kongresit diskutuan: delegati i Tiranës, Jorgji Pano, delegati i Korçës av. Kristo Pilika, delegati i Vlorës, Thimi Opingari, delegati i Durrësit, Stavrofor atë Erazmi Jorgo[222], delegati i Pogradecit atë Kristo Bitro, delegati i Gjirokastrës av. Vasil Xhaj, delegati i Beratit atë Kostandin Arbëri, delegati i Shkodrës atë Llazar Popoviç, delegati i Fierit Stavrofor atë Polizoi Ikonomi[223] etj[224].

Kryetari i mbledhjes propozoi të ngrihej një komision revizionimi prej tre vetash për të kontrolluar mandatet e delegatëve të kongresit. Komisioni përbëhej nga arkimandrit Sofron Borova, Dhimitër Beduli dhe Jorgji Sorra. Komisioni konstatoi se delegati i Vlorës atë Ilia Loli nuk është paraqitur për arsye shëndetësore. Dhimitër Beduli ishte zgjedhur edhe delegat i Tiranës edhe i Pogonit, ndërsa delegati i Zagories atë Thoma Carka nuk është paraqitur pa bërë asnjë njoftim. Qenë të pranishëm 47 delegatë nga 50 të zgjedhur[225].

Delegat i Tiranës *Kryeepiskop Pais Vodica d.v.*

"Kisha duhet të mobilizohet dhe të japë kontributin e saj maksimal në zgjidhjen e problemeve aktuale të popullit, në respektimin dhe zbatimin e urdhëresave dhe të ligjeve, në realizimin e planit, në përmbushjen e detyrimeve etj. Priftërinjtë në qytete dhe sidomos në fshatra të lozin një rol të rëndësishëm dhe të bëhen vetë shembull në plotësimin e planeve të shtetit dhe në shlyerjen e detyrimeve karshi shtetit duke udhëzuar në këtë drejtim besimtarët. Ata duhet të jenë patriotë të kulluar...". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 4-12.

[222]-Erazmi Jorgo (1900-1989) është dorëzuar në dhiakon më 15 mars 1924. Pas një muaji më 16 mars të vitit 1924 u dorëzua në gradën priftërore, në Kishën e Ungjillëzimit të Tiranës nga Imzot Fan Noli. At Erazmi ishte prifti i parë i dorëzuar nga Fan Noli. Pas ceremonisë së dorëzimit, Imzot Noli i pati thënë: "Paske zë të hyjshëm bir." At Erazmi ka shërbyer prej vitit 1927 në Kishën e Shën Gjergjit në Durrës, e cila për disa vite ishte njëherësh Seli e Mitropolisë së Shenjtë të Durrësit dhe Tiranës. Lidhjen shpirtërore me Imzot Nolin At Erazmi e mbajti gjatë gjithë jetës.

[223]-Polizoi Ikonomi (1894-1967) ka lindur në fshatin Sop të rrethit të Fierit më 11 mars të vitit 1894. Është dorëzuar prift në Fier më 31 janar 1924 nga ish Mitropoliti i Beratit, Kristofor Kisi. Më 23 shkurt të vitit 1928, ai mori gradën Ikonom prej Mitropolitit të Beratit, Kristofor Kisit. Më 16 qershor të vitit 1929 Ikonom Polizoi mori pjesë si delegat në Kongresin e Dytë të KOASH-it, që u zhvillua në qytetin e Korçës. Më 31 dhjetor të vitit 1929 Polizoi Ikonomi u bë Stavrofor nga Episkopi i Beratit Imzot, Agathangjel Çamçe. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, Stavrofor Polizoi Ikonomi u emërua "Zëvendës i Mitropolitit i qytetit të Fierit" nga Imzot Visarion Xhuvani. Stavrofor Polizoi Ikonomi shërbeu 43 vjet në kishën e Shën Gjergjit të Fierit. Në shkurt 1950 Stavrofor Polizoi Ikonomi ka qenë delegat i Fierit në Kongresin III kishtar të KOASH-it që zhvilloi punimet në Tiranë. Më 1 dhjetor 1966 Stavrofor Polizoi u emërua sërish në postin e zëvendës Mitropolitit. Këtë herë emërimi i tij u bë nga Episkopi Beratit Spiridhoni. Më 21 janar të vitit 1967, ai bëri shërbesën e fundit në kishën e Shën Gjergjit të Fierit, ndërsa më 5 shkurt të po këtij viti, një ditë para fillimit të uraganit ateist, vdiq në moshën 73 vjeçare. Nuri Plaku, *At Polizoi Ikonomi një emër i nderuar në kujtesën e ortodoksëve myzeqarë*, Fier 2019.

[224]-*Në Tiranë u çel Kongresi i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1, 2; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.1-2.

[225]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.19.

Delegat i Tiranës *Ikonom atë Marko Papajani d.v.*
Delegat i Tiranës *Dhimitër Beduli d.v.*
Delegat i Tiranës *Jorgji Pano d.v.*
Delegat i Durrësit *Stavrofor atë Erazmi Jorgo d.v.*
Delegat i Durrësit *Thoma Papakostandini d.v.*
Delegat i Durësit *Kozma Teneqexhiu d.v.*
Delegat i Elbasanit *Aleksandër Xhuvani d.v.*
Delegat i Elbasanit *Ilia Trandafili d.v.*
Delegat i Kavajës *Jorgji Surra d.v.*
Delegat i Shkodrës *Stavrofor atë Llazar Popoviq d.v.*
Delegat i Pogradecit *atë Risto Bitro d.v.*
Delegat i Beratit *atë Kostandin Arbëri d.v.*
Delegat i Beratit *Siku Gjoka d.v.*
Delegat i Beratit *Caci Dollani d.v.*
Delegat i Vlorës *Thimi Opingari d.v.*
Delegat i Vlorës *Dhimitër Mërtiri d.v.*
Delegat i Fierit *Stavrofor atë Polizoi d.v.*
Delegate e Fierit *Marija Bakalli d.v.*
Delegat i Lushnjës *Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi d.v.*
Delegat i Lushnjës *Llazar Bozdo d.v.*
Delegat i Lushnjës *Jorgji Dhamo d.v.*
Delegat i Lushnjës *atë Jorgji Prifti d.v.*
Delegat i Korçës *Arkimandrit Sofron Borova d.v.*
Delegat i Korçës *Stavrofor atë Llazar Pashko d.v.*
Delegat i Korçës *Av. Kristaq Pilika d.v.*
Delegat i Korçës *Spiro Luarasi d.v.*
Delegat i Korçës *Pandi Progri d.v.*
Delegat i Korçës *Xhorxhi Papa d.v.*
Delegat i Kolonjës *Stavrofor atë Naum Rehova d.v.*
Delegat i Kolonjës *Vasil Tane Arëza d.v.*
Delegat i Përmetit *Lilo Proko d.v.*
Delegat i Përmetit *Atë Mina Dhama d.v.*
Delegat i Përmetit *Nisi Zhaka d.v.*
Delegat i Leskovikut *Nikolla Kozma d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Ikonom Atë Aristotel Sirato d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Zoto Bashari d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Av. Vasil Xhaj d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Niko Cane d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Koço Kostaqi d.v.*
Delegat i Gjirokastrës *Niko Mastaka d.v.*
Delegat i Pogonit *Dhimitër Beduli d.v.*
Delegat i Delvinës *Ikonom atë Vangjel Mastakuli d.v.*
Delegat i Delvinës *Minella Kuramana d.v.*
Delegat i Sarandës *Atë Kristo Plaku d.v.*

Delegat i Sarandës *Vasil Gjikopuli d.v.*
Delegat i Himarës *Ikonom atë Foto Duni d.v.*
Delegat i Himarës *Kristo Dhima d.v.*

Më datën 8 shkurt 1950 u hap seanca e radhës nën kryesinë e atë Aristotel Strato, Zëvendës i Përgjithshëm i Mitropolisë së Gjirokastrës. Kryetari i mbledhjes autorizoi Kryesekretarin e Sinodit të Shenjtë të K.O.A.Sh-it Z. Niko Cane, të lexojë nen për nen projektstatutin.

Në pjesën e parë të projektstatutit parashtrohej misioni i kishës. Në nenin 1 të projektstatutit thuhej se kleri dhe populli ortodoks i Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesë e pandarë e Kishës së Shenjtë, të Përgjithshme dhe Apostolike ruan të paprekshme, parimet dogmatike, kanonet e hirëshme apostolike e sinodike, si edhe traditën e shenjtë. Kisha Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë është person juridik. Në juridiksionin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë bënin pjesë të gjithë ortodoksët, që banojnë brenda territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe prej atyre shqiptarëve ortodoksë, që banojnë jashtë atdheut.

Neni 2 i projektstatutit theksonte se marrëdhëniet e kishës me shtetin qenë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe në ligjin "Mbi komunitetet fetare".

Neni 3 i projektstatutit sanksiononte gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare të kishës, por lejonte edhe përdorimin e gjuhëve të tjera në celebrimin e shërbesave fetare[226]. Me anën e nenit 3 pakicave kombëtare u sigurohej të kryenin shërbesat fetare në gjuhën e tyre.

Neni 4 i projektstatutit përcaktonte se veç ndjenjave fetare kisha duhet të kultivonte te besimtarët edhe ndjenjat e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë si edhe ndjenjën e bashkimit kombëtar. Të gjithë funksionarët dhe personeli i kishës, duhet të qenë shtetas, të ndershëm, besnikë të popullit dhe atdheut. Ky nen qe krejt i ndryshëm me artikullin 16 të Statutit të vitit 1929, aty ku bëhej fjalë për cilësitë e episkopëve[227], "duhet të jenë prej gjaku, gjuhe shqiptarë si dhe të kenë shtetësinë shqiptare", që është edhe neni më i rëndësishëm për pavarësinë e kishës shqiptare. Sipas projektstatutit të ri, të gjithë funksionarët dhe personeli i kishës duhet të ishin thjesht shtetas shqiptarë, të ndershëm dhe besnikë ndaj popullit e atdheut[228]. Heqja e kushtit të kombësisë shqiptare të parisë kishtare qe

[226]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, neni 3, në "Gazeta Zyrtare", Nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950, faqe 3.

[227]-"Kryeepiskopi, episkopët, zëvendësit e tyre lokalë, Ikonomi i madh Mitrofor, Sekretari i Përgjithshëm i Sinodit, si dhe ndihmësit e Kryepiskopit dhe të episkopëve, duhet të jenë prej gjaku, gjuhe shqiptarë si dhe të kenë shtetësinë shqiptare". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Korçë, 1929, Art. 16, në "Fletorja Zyrtare", 14 gusht 1929, faqe 2.

[228]-"Krahas me zhvillimin e ndjenjave fetare, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do t'u kultivojë besimtarëve ndjenjat e besnikërisë ndaj Pushtetit Popullor dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe ndjenjën e atdhedashurisë dhe të përforcimit të bashkimit kombëtar. Prandaj gjithë funksionarët dhe personeli i saj duhet të jenë shtetas shqiptarë, të ndershëm, besnikë ndaj popullit dhe atdheut dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat civile". *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, neni 4, në "Gazeta Zyrtare", Nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950, faqe 4.

bërë me dekret-ligjin "Mbi komunitetet fetare"[229] të vitit 1949. Dukej sheshit se të gjitha ndryshimet në projektstatut u hartuan sipas udhëzimeve të Patriarkanës së Moskës[230], e cila do ta kishte fare të lehtë që në krye të K.O.A.Sh-it të vinte njeriun e saj, vetëm me kushtin që të kishte shtetësinë shqiptare[231]. Pra duke kapur postin e primatit të K.O.A.Sh-it, patriarkana Ruse do të shtrinte hegjemoninë e saj në Shqipëri. Në komentimin e këtij neni të projektstatutit studiues të ndryshëm kanë shprehur pikëpamjet e tyre në një debat që ka nisur pas vitit 1990. Kjo ide është publikuar nga Kristaq Prifti[232] dhe është mbështetur nga Dashnor Kaloçi[233]. Këtë fakt e thekson Aurela Anastasi, e cila argumenton se zbatimi i nenit 4 të statutit nuk krijonte pengesa për klerikë nga vendet e botës socialiste[234].

Në nenin 5 të projektstatutit theksohej se Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë do të mbante lidhje bashkëpunimi me kishat ortodokse motra, të cilat praktikojnë drejt parimet e larta ungjillore mbi paqen dhe vëllazërimin e vërtetë ndërmjet popujve.

Neni 6 i projektstatutit theksonte se lutjet që bëheshin gjatë meshimeve dhe ceremonive të tjera fetare për autoritetet shtetnore, duhej të formuloheshin prej Kryesisë së Kishës dhe të merrej pëlqimi i autoriteteve shtetërore.

Neni 7 i projektstatutit theksonte se asnjë klerik nuk mund të ushtronte veprimtarinë klerikale, pa qënë i emëruar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë.

Neni 8 i projektstatutit sanksiononte anën organizative të kishës. Nenit 8 me propozim të delegatit të Tiranës, Jorgji Pano u vendos që kryeepiskopatës ti shtohet edhe zëvendësia, por propozimi i tij nuk u pranua. Av. Kristaq Pilika propozoi që pas nenit 8 të shtohej edhe një nen me këtë përmbajtje: "Me vendim të Këshillit Mikst, mund të krijohen episkopata për Shqiptarët Orthodhoksë jashtë shtetit, të varura nga Kisha Shqiptare mëmë". Propozimi u pranua dhe ky nen u rendit i nënti[235].

Neni 10 i projektstatutit theksonte se autoriteti më i lartë për të gjitha çështjet dogmatike, kanonike dhe spirituale të kishës qe Sinodi i Shenjtë, i cili përbëhej prej episkopëve efektivë. Në këtë nen del zbuluar kryesia e re, sepse në të nuk përfshiheshin episkopët Kristofor Kisi dhe Irine Banushi.

---

[229]-"Kryetarët e komuniteteve fetare, funksionarë fetarë dhe të gjithë personat në shërbim të komuniteteve fetare, duhet të jenë shtetas shqiptarë besnikë të popullit dhe të shtetit, të ndershëm të dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat civile.....". Dekretligji nr. 743 "Mbi komunitetet fetare", neni 13.

[230]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri,* Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 169.

[231]-Dashnor Kaloçi, *Si e manipuluan komunistët Kishën Ortodokse Shqiptare,* Gazeta Shqiptare, 1 maj 2002, faqe 12-13.

[232]-Kristaq Prifti, *The Albanian Autocephalous Orthodox Church. A Brief History (1922-1992),* në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,* Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 101.

[233]-Dashnor Kaloçi, *Si e manipuluan komunistët Kishën Ortodokse Shqiptare*, Gazeta Shqiptare, 1 maj 2002, faqe 12-13.

[234]-Aurela Anastasi, *Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 58.

[235]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950, fl.25; *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, neni 9, në "Gazeta Zyrtare", Nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950, faqe 4.

Neni 11 i projektstatutit sanksiononte kompetencat e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Sinodi i Shenjtë duhej të ruante unitetin dogmatik, kanonik, të traditës së shenjtë dhe të kultit me të gjitha kishat ortodokse autoqefale.

Neni 12 theksonte se Sinodi i Shenjtë në mungesë të Kryetarit, për çfarëdo arsye të justifikuar, kryesohet prej episkopit titullar më të vjetër në hirotoni.

Neni 13 theksonte se Sinodi i Shenjtë duhet të mblidhet detyrimisht një herë në vit dhe sa herë e lyp nevoja në mënyrë të jashtëzakonshme.

Neni 14 përcaktonte se thirrja dhe caktimi i rendit të ditës, të mbledhjes së Sinodit të Shenjtë bëhej prej Kryetarit një muaj më përpara. Për mbledhje të jashtëzakonshme, afati mund të jetë më i shkurtër.

Neni 15 i kushtohej mbledhjes së Sinodit të Shenjtë, i cili konsiderohej i mbledhur kur qenë prezentë gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve.

Neni 16 i projektstatutit përcaktonte qartë se kandidatët për episkopë, duhet të qenë të diplomuar në një fakultet teologjik ortodoks, por në mungesë kandidatësh mund të dorrëzohen episkopë dhe kandidatë, pa arsimin përkatës, por që qenë të aftë si autodidaktë.

Në statut detyrat e Kryeepiskopit[236] përcaktohen nga neni 24 deri në nenin 28, ndërsa detyrat e Episkopit[237] përcaktohen nga neni 29 deri më 32.

Diçka e re në statut ishte sigurimi i klerit me anë të neneve 65[238] dhe 66[239]. Fondi i sigurimit të klerit synonte të siguronte jetën e klerikëve kur ata të dilnin në pension. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave punonjësit duhet të derdhnin 0,5 % të pagës për sigurimet shoqërore.

Nenet 67 dhe 68 të projektstatutit parashikonin se për përgatitjen e funksionarëve të saj Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, duhet të kishte shkolla fetare dhe programet e tyre duhej të merrnin aprovimin nga Këshilli Ministerial.

---

[236]-Titulli Kryeepiskop ka kuptimin e *peshkopit udhëheqës* të një kishe autoqefale. Një episkop i kryeqytetit të një vendi ka në varësi edhe episkopë të tjerë, prandaj quhet Kryeepiskop. Kryeepiskopi është Kryetari i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, kreu i të krishterëve ortodoksë në Shqipëri, përfaqësuesi i tyre përpara autoriteteve shtetërore dhe organizmave ndërkombëtarë dhe përpara çdo lloj autoriteti dhe pushteti. Përveç sekretarit të përgjithshëm dhe personelit tjetër, i cili parashikohet në Rreguloren e Përgjithshme të Administrimit me dispozita të posaçme, Kryepiskopi ka edhe një episkop ndihmës, i cili është anëtar i Sinodhi pa mbajtur përgjegjësinë e administrimit të ndonjë dioqeze dhe kryen çdo detyrë që i ngarkohet mga Kryepiskopi, duke u titulluar në hymnin e tij si Episkopi i Apollonisë.

[237]-Episkopi titullar është organi drejtues i një dioqeze dhe gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara nga kanonet e shenjta, nga Statuti dhe nga Rregullorja e Përgjithshme e Administrimit, si dhe nga ligjet përkatëse në fuqi.

[238]-Në nenin 65 të Statutit është shkruar: Pranë Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë krijohet “Fondi i sigurimit të Klerit”, i cili ka për qëllim të sigurojë të gjithë klerikët e Shqipërisë në raste pa aftësije për të kryer misionin e shenjtë dhe dalje në pension, si edhe familjet e tyre në raste vdekjeje.

[239]-Në nenin 66 të Statutit është shkruar: Fondi i sigurimit të klerit drejtohet dhe administrohet nga Këshilli Mikst në bazë të dispozitave të një rregulloreje të posaçme të hartuar nga Këshilli Mikst, konform dispozitave ligjore përkatëse.

Nenet 69 dhe 70 parashikonte që herë pas here të zhvillohen konferenca, për të cilat duhet të kërkohej leja përkatëse nga ana e atoriteteve komtetentë në konformitet me dispozitat ligjore në fuqi mbi mbledhjet publike.

Nenet 71 dhe 72 të projektstatutit bëjnë fjalë për botimin e një reviste të përmuajshme, në botimin e së cilës, do të respektoheshin dispozitat përkatëse të "Ligjit mbi komunitetet fetare".

Nenet 85 dhe 86 të projektstatutit theksonin se në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqeze mund të zgjidhej një klerik i dalluar me titulll: "Zëvendës Episkopal i Përgjithshëm", i cili për sa kohë administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe me të njënjtën të drejtë anëtarësie në Sinod. Por me plotësimin e një dioqeze vakante me anën e një episkopi titullar, "Zëvendësi Episkopal i Përgjithshëm" i saj, e humbet të drejtën e administrimit të dioqezës së plotësuar, por mbetet anëtar i rregullt i Sinodit me votë konsultative.

Në fjalën mbyllëse e mbajti Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë të K.O.A.Sh-it Z. Niko Cane[240]. Fjala mbyllëse e Kongresit theksonte: "Kongresi u mbajt në një kohë kur populli i Shqipërisë, i çliruar prej gjashtë vjetësh, në saje të fitores së shkëlqyer të ushtrisë Sovjetike të prirë nga Gjenerali Stalin dhe në saje të luftës heroike Nacional-çlirimtare, në udhëheqjen e Komandantit tonë të dashur Gjeneral-Armate Enver Hoxha, ka përmbysur regjimet antipopullore të tiranisë, të shtypjes dhe shfrytëzimit duke marrë pushtetin në duart e veta…." Kryeepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlumturia e Tij Paisi dënoi veprimtarinë armiqësore të ushtruar nga udhëheqësit e mëparshëm dhe aprovoi rrugën që duhet të ndjekë K.O.A.Sh-i duke caktuar këto detyra: 1)Të punohet në një mënyrë të atillë që kisha të orientohet dhe drejtohet në rrugën që shpie drejt kampit unik të paqes, në dashurinë dhe vëllazërimin midis popujve, në krye të së cilit qëndron Bashkimi Sovjetik dhe i madhi Stalin. 2) Gjithë funksionarët e kishës, klerikë dhe laikë, gjithë priftërinjtë dhe personeli kishtar, si dhe gjithë anëtarët e këshillave kishtare të qyteteve dhe fshatrave, të jenë njerëz me ndjenja të larta patriotike, të jenë njerëz të ndershëm, të ushqejnë dashuri të pakufishme për Republikën tonë Popullore, për Qeverinë Demokratike, për Partinë e Punës dhe udhëheqësin e saj të ndritur shokun Enver. 3) Kongresi falënderon nga zemra Qeverinë Demokratike, Partinë e Punës dhe shokun Enver dhe shpreh ndjenjat e mirënjohjes së thellë për përkrahjen dhe ndihmën e madhe morale dhe materiale që i kanë dhënë dhe po i japin vazhdimisht K.O.A.Sh-it në përmbushjen e detyrave të saj karshi popullit dhe atdheut.

[240]-Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë të K.O.A.Sh-it Z. Niko Cane ndër të tjera theksoi: "Në emër të Sinodit të Shenjtë po i parashtroj këtij Kongresi për shqyrtim dhe aprovim, projektstatutin më të ri të kishës sonë, të përgatitur nga vetë Sinodi në bashkëpunim me specialistët e tjerë mbi çështjet dogmatike dhe kanonike. Në përpilimin e Statutit janë marrë parasysh këta faktorë: 1) fitorja historike që korri populli ynë nëpërmjet Luftës Nacional-çlirimtare, i udhëhequr nga Partia e Punës me shokun Enver në krye. 2) situata e re që u krijua me rrëzimin e sistemeve totalitare të krijuar nga hierarkë të degjeneruar dhe renegatë të interesave të kishës, siç ishin Kristoforët dhe Visarionët me shokë, të cilët në kundërshtim të hapët me parimet demokratike të ortodoksisë kishin monopolizuar kishën në duart e një klike të privilegjuar, së cilës i shërbenin verbërisht…". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950.

Kongresi i tretë i K.O.A.Sh-it u mbajt 5-10 shkurt të vitit 1950 në Tiranë. Në përfundim të punimeve të Kongresit të tretë të K.O.A.Sh-it u miratua statuti dhe rregullorja e re e përshtatur me kushtet politike dhe sociale të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Më 16 shkurt 1950 statuti iu dërgua Seksionit Klerik pranë Kryesisë së Këshillit të Ministrave me qëllim që ky t'ia përcillte Presidiumit të Kuvendit Popullor për shqyrtim dhe aprovim[241].

Statuti është aprovuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor[242] me Dekretin Nr. 1065 datë 4 Maj 1950. (Fig.19) Rregullorja e Administrimit të Përgjithshëm (Fig.20) të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, u përpilua sipas dispozitave të Statutit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të ligjit mbi komunitetet fetare. Në hartimin e Rregullores mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u caktua një komision i përbërë nga:

Kryetar -Kryeepiskopi Pais Vodica. d.v.

Anëtar -Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi. d.v.

Anëtar -Ikonom Stavrofor atë Aristotel Strato d.v.

Anëtar -Ikonom Stavrofor atë Spiro Veli d.v.

Anëtar -Spiro Luarasi d.v.

Anëtar -Jorgji Pano d.v.

Anëtar - Kristo Cevo d.v.

Sekretari Përgjithshëm -Niko Çane d.v

Rregullorja mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[243] u aprovua me anën e Vendimit Nr. 1085, datë 28.12.1950, të Këshillit të Ministarve të Republikës Popullore të Shqipërisë.

1.6 VIZITA E PAISIT NË MOSKË DHE VIZITA E PESHKOPIT NIKON NË SHQIPËRI

Më 13 gusht 1950 Kryeepiskopi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë Paisi Vodica ndërmori një vizitë zyrtare në Moskë. Në përbërje të delegacionit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë qenë edhe atë Stavro Kanxheri dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Kishës Niko Çane. Delegacioni shqiptar udhëtoi për në Odesa me vaporin Kotosovski[244]. Në meshën peshkopale që u celebrua në kishën patriarkale të Moskës më 13 gusht 1950, Kryeepiskop Paisi meshoi së bashku me Patrikun e Moskës dhe gjithë Rusisë, Aleksej[245]. Ky i fundit në

[241]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.29.

[242]-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, në "Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Shqipërisë", Nr. 38, 21 qershor 1950, faqe 2-19; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl.31.

[243]-Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Mihal Duri, Tiranë, 1955; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 691, viti 1955, fl. 1-22.

[244]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.13.

[245]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1467, viti 1950, fl. 1-4.

fjalën e tij përmendi rolin dhe kontributin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për paqen, ndërsa Kryeepiskop Paisi shprehu falënderimet për pritjen e përzemërt që iu rezervua delegacionit shqiptar. Gjatë 26 ditëve të qëndrimit në Rusi, delegacioni i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë vizitoi kisha, manastire dhe seminare, në Moskë, Kiev dhe Odesa. Delegacioni vizitoi antikitetet e Kremlinit, mauzoleumin e Leninit, muzeumin e Stalinit etj[246]. Vizita e delegacionit shqiptar u finalizua me nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërmjet dy kishave, e cila synonte në koordinimin e punëve në luftën për mbrojtjen e paqes[247]. Me nënshkrimin e marrëveshjes Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë radhitej në grupin e kishave që e kishin orientimin nga Patriarkana e Moskës.

Më 27 maj 1951 një delegacion i kishës ruse mbërriti në Shqipëri. Në përbërje të delegacionit ishin peshkopi i Odesës, Nikon dhe eksarku i Dioqezës së Moskës Pavël Cvetkov. Në portin e Durrësit të dërguarve të patrikut të Moskës, Aleksej iu bë një pritje e përzemërt. Në vijim udhëtuan drejt kryeqytetit ku u sistemuan në Hotel Dajti. Në orën 18.00 të mbrëmjes delegacioni rus u prit në rezidencën e Kryeepiskopit, ku në prani të klerikëve dorëzuan një letër nga patriku i Moskës, Aleksej dhe një arkëz me vezën e kuqe të Pashkës ku qe shkruar "Krishti u Ngjall". Kryeepiskop Paisi thellësisht i prekur nga ky simbol i dashurisë vëllazërore kristiane shprehu gëzimin madh për harmoninë shpirtërore, që ekzistonte ndërmjet kishës shqiptare dhe asaj ruse. Në vijim folën përfaqësuesit e institucioneve të kryeqytetit, të cilët nuk i kursyen komplimentat për marrëdhëniet vëllazërore ndërmjet dy popujve tanë. Më 28 maj paradite delegacioni rus vizitoi muzeun e Luftës Nacional-çlirimtare, ndërsa pasdite në orën 18.00 u pritën në kishën e Shën Prokopit[248].

Të nesërmen më 29 maj 1951 delegacioni i kishës ruse vizitoi manastirin e Shën Vlashit, ku u prit përzemërsisht nga murgeshat ruse, të cilat nën udhëheqjen e igumenes Maria këndonin psalmin "Engjëlli thërriste". Pas tedeumit që u celebrua në kishën e manastirit u shtrua një drekë. Murgeshat ruse e përcollën delegacionin deri në rëzë të kodrës duke psallur kanonet e Pashkës[249].

Delegacioni rus i nis drejt Durrësit ku bënë një tedeum në katedrale, në prani të besimtarëve, klerikëve dhe autoriteteve vendore. Në vijim delegacioni rus vizitoi qytetin. Më datën 30 maj 1951 delegacioni bëri një vizitë në komunitetin mysliman si dhe muzeun arkeologjik të kryeqytetit. Mresëlënëse ishte vizita që bënë më 31 maj në qytetin e Korçës. Një përfaqësi klerikësh dhe besimtarësh kishin dalë në Pogradec. Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi kishte organizuar një pritje madhështore. Kortezhi i

[246]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 461, viti 1951, fl. 1-6.

[247]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 461, viti 1951, fl. 2-6.

[248]-Ish Kryeepiskopi Kristofor Kisi nuk u lejua të takonte delegacionin rus. Një orë përpara pritjes Kisit iu komunikua mospjesëmarrja në pritje, prej atë Dhanil Çulit. Pakënaqësinë e tij Kristofor Kisi e shprehu me anën e një letre, e cila mban datën 29 maj 1951. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja Nr. 4633, viti 1951, fl.1; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 21.

[249]-Sipas shkresës me Nr. Prot. 6/54, datë 29 maj 1950 në manastirin e Shën Vlashit qenë strehuar 17 murgesha ruse si dhe hieromonaku Germano Popov. Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.7; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950, fl.15.

makinave sapo hyri në qytetin e Korçës u prit mes një entuziazmi të madh të besimtarëve, klerikëve dhe të autoriteteve vendore. Të pranishmit që morën fjalën në pritjen e organizuar me këtë rast folën përzemërsisht për miqësinë vëllazërore midis dy popujve. Pasdite u zhvillua dhoksologjia në kishën katedrale të Burimit Jetëdhënës, ku në emër të delegacionit rus foli peshkopi Nikon. Dhoksologjia u celebrua nën drejtimin e arkimandrit Dhimitër Kokoneshit dhe stavroforit Stavro Kanxheri me pjesëmarrjen e dhjetë priftërinjve dhe besimtarëve të shumtë. Më 1 qershor 1951 delegacioni rus pati një takim me diktatorin Enver Hoxha në rezidencën e tij. Pasi pyeti për përshtypjet që kishin nga udhëtimi nëpër Shqipëri, Enveri u interesua për shëndetin e patrikut Aleksej dhe iu lut delegacionit që ti transmetojë atij urimet më të mira. Pasi përfundoi takimi me diktatorin Enver Hoxha, delegacioni rus i shoqëruar nga Kryeepiskop Paisi, stavrofori Aristotel Strato dhe nga sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane u nis për në portin e Durrësit ku i priste vapori "Çiaturi" me të cilin kishin ardhur nga Moska. Kryeepiskop Paisi i dha rusëve një arkë të argjendtë, si dhuratë për Patrikun e Moskës, Aleksej[250].

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë ishte nismëtare për thirrjen "Konferencës së paqes së klerit në Shqipëri", që u mbajt më 8-9 korrik 1952. Në konferencë morrën pjesë 200 klerikë përfaqësues të besimeve fetare tradicionale në Shqipëri. Qenë 70 klerikë nga komunitetin mysliman, 23 nga komuniteti bektashian, 42 nga komuniteti ortodoks dhe 26 nga komuniteti katolik. Në konferencë veç klerikëve merrnin pjesë edhe 30 laikë. Një konferencë e tillë me përfaqësues nga komunitetet tradicionale qe mbajtur në Moskë, prandaj autoritetet zyrtare autorizuan Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të ndjekë shembullin e "vëllait të madh". Paqja në vendet e kampit socialist ishte në rrezik. Ky ishte shkaku i mbajtjes së konferencës klerikale[251]. Me interes është fakti se përveç klerikëve në konferencë merrin pjesë edhe disa ateistë si dhe një delegacion me përfaqësues të klerit ndërkombëtar.

Në konferencë veç Kryeepiskopit Paisi Vodica folën edhe Dhimitër Beduli, Dhimitër Kokoneshi, Sofron Borova, Aristotel Strato, Spiro Veli dhe Polizoi Ikonomi. Në tribunën e kongresit qenë Paisi Vodica dhe Dhimitër Kokoneshi. Pas përfundimit të konferencës Paisi urdhëroi të gjitha episkopatat ortodokse të diskutonin dhe të analizonin fjalimin e tij[252]. Në përfundim të konferencës, më 10 korrik 1952 iu dërgua një telegram[253] diktatorit Enver Hoxha me anën e së cilit e vinin në dijeni për përfundimin me sukses të punimeve.

---

[250]-Peshkopi Nikon, *Zhurnal Moskovskoj Patriarhij*, Nr. 9, shtator 1951; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951, fl. 26-30.

[251]-Olimbi Velaj, *Klerikët një konferencë si vëllezërit moskovitë*, Metropol, 30 tetor 2006, faqe 18.

[252]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 488, viti 1952, fl. 24.

[253]-Në telegram ndër të tjera shkruhej: në shembullin e Konferencës të mbajtur në Moskë më datë 9 deri 12 maj të këtij viti prej gjithë kishave dhe shoqatave fetare të bashkimit Sovjetik ne përfaqësuesit e gjithë besimtarëve të Shqipërisë u mblodhëm më datë 8 dhe 9 korrik në një konferencë për të diskutuar rreth mbrojtjes së paqes. Në përfundim të telegramit thuhej: paqja do të triumfojë pa tketër sepse gjithë popujt e botës e duan atë dhe urrejnë pakicën luftënxitëse dhe spekullatore. Olimbi Velaj, *Klerikët një konferencë si vëllezërit moskovitë*, Metropol, 31 tetor 2006, faqe 22.

1.7 KRIJIMI I SINODIT TË SHENJTË

Siç e kemi theksuar edhe më sipër më 25 gusht 1949 Paisi Vodica u shpall Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Që të formonte Sinodin e Shenjtë të Kishës Autoqefale të Shqipërisë duheshin kandidatë të mundshëm potencialë që të plotësonin kriteret nga ana kanonike. Çështja e plotësimit të Sinodit të Shenjtë qe hapur që në Kongresin III të K.O.A.Sh-it, kur në sesionin e paradites së datës 8 shkurt 1950 delegati Siku Gjoka propozoi dorëzimin e arkimandritit Dhimitër Kokoneshi në gradën episkopale. Propozimi u prit me duartrokitje të zjarrta nga ana e delegatëve, por Kokoneshi me modesti e refuzoi këtë propozim me arsyen se nuk i plotësonte kushtet për tu bërë episkop. Delegati i Gjirokastrës Niko Çane e miratoi refuzimin e Kokoneshit, ndërsa teologu Dhimitër Beduli theksoi faktin se në historinë kishtare ka pasur raste, që klerikë të ndryshëm të ngrihen në gradën episkopale me imponimin e popullit, siç qe rasti i Ambrozit të Milanos[254].

Më 7 mars 1950, zëvendësepiskopi i Himarës, Jani Kutulla propozoi në emër të priftërinjve të zonës së Bregut kandidaturën e Foto Dunit. Më 17 tetor 1950 Sinodi i Shenjtë[255] i mbledhur nën kryesinë e Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Imzot Paisit, me anëtarët; arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Zëvendës i përgjithshën e Episkopatës së Korçës dhe Ikonom Aristotel Straton, Zëvendës i përgjithshëm i Episkopatës së Gjirokastrës dhe me sekretar Z. Niko Çane vendoi unanimisht atë Spiro Velin[256] si titullar të Episkopatës së Beratit me cilësinë e

[254]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 290, viti 1950; fl. 28-29; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 292, viti 1950, fl. 3.

[255]-Me këtë përbërje Sinodi i Shenjtë ishte antikanonik. Sipas kanoneve kishtare vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj.

[256]-Spiro Veli (1914-1995) ka lindur më 1914, në Erind të Gjirokastrës. Që në moshën 18-vjeçare ka studiuar në seminarin Ortodoks "Apostol Pavli" në Tiranë, që drejtohej prej Vasarion Xhuvanit. Pas mbarimit të seminarit më 1936, banoi në qytetin e Durrësit, duke punuar mësues i fesë, njëkohësisht kryente edhe detyrën e psaltit në kishën e Shën Spioridhonit. Më 1 janar të vitit 1945 dorëzohet dhiak dhe më 3 janar të po atij viti, hirotoniset në gradën priftërore. Atë Spiro Veli shërbente në qytetin e Durrësit së bashku me Atë Erazmi Jorgon, duke lënë mbresat më të mira për urtësimë, ndershmërinë dhe profesionalizmin e tij. Në vitin 1948 së bashku me arqimandrit Dhimitër Kokoneshin morri pjesë në delegacion kishtar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, në Bullgari e Rumani. Në vitin 1950 emërohet zëvëndësi i përgjithshëm i Episkopatës së Beratit. Duke parë punën e tij të mirë organizative, më 1953 emërohet Zëvendës i përgjithshëm në Mitropolinë e Elbasanit. Gjatë viteve të diktaturës punoi në punë të ndryshme shekulare si shitës kinkalerie, shitës tullash apo roje. Në vitin 1991, rihapja e kishës së Shën Marisë në Elbasan e gëzoi pa masë. Ndonëse në moshën 81-vjeçare, Atë Spiro Veli punoi me përkushtim dhe devodshmëri deri sa vdiq më 23 prill 1995, në ditën e Pashkës së Madhe. At Stavri Çipi, *At Spiro Veli, shembull i një kleriku të devotshëm*, Ngjallja, qershor 2005, faqe 9; Andrea Lluknai, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 263-264; Andrea Llukani, *Krishtërimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 162-163.

zëvendësit episkopal[257]. Gjithashtu atë Spiro Velit dhe atë Aristotel Stratos iu dha grada e nderit Ikonom-Stavrofor.

Pas shumë përpjekjesh dhe negociatash u hartua lista me kandidatët për episkopë: Arkimandrit Dhimitër Kokoneshi, Mitropolit i Gjirokastrës, Qirjako Efthimi (Naslazi), Mitropolit i Beratit, Foto Duni, Mitropolit i Korçës dhe Imzot Sofron Borova[258] ndihmës episkop. Miratimi i qeverisë për hirotonisjen e klerikëve në gradën episkopale u bë më 8 nëntor 1952. Problem i madh ishte se kush do të dorëzonte kandidatët për episkopë. Qe menduar se episkopët e rinj do ti dorëzonte Paisi dhe Irineu, por ky i fundit nuk pranoi në asnjë mënyrë të bënte veprime antikanonike. Sipas kanoneve kishtare zgjedhja e episkopëve mund të bëhej nga një sinod i përbërë të paktën nga tre episkopë.

Në lidhje me dorëzimin e episkopëve të rinj Irine Banushi ka deklaruar: "Rruga e daljes ishte që më parë t'ja parashtronim udhëheqjes dhe nëse kjo dëshironte, Paisi dhe Irineu të shkonin në Moskë dhe aty të parashtronin situatën dhe të legalizohej Irineu (sepse ishte shkarkuar nga grada episkopale). Në vijim të mblidhej sinodi kanonik i përbërë nga Paisi, Kristofori dhe Irineu, ku Paisi të ishte kryeepiskop, ndërsa Kristofori dhe Irineu episkopë të ndonjë dioqeze. Vetëm sinodi i përbërë nga tre episkopë kanonikë mund të propozonte kandidatë për episkopë edhe mund të dorëzonte episkopët e rinj. Pasi të dorëzoheshin episkopët, Kristofori dhe Irineu do të jepnin dhorëheqjen. Irineu do ti parashtronte Sinodit dorëheqjen për shkak të sëmundjes, ndërsa Kristofori për shkak pleqërie. Kështu do të ishin brenda kanoneve dhe rregullave që përcakton neni 22 i statutit të vitit 1929, i cili thotë: "*Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos....*"[259].

Kreu i Komitetit Klerik, Gaqo Peristeri dhe Niko Çane shkuan në manastirin e Shën Vlashit për të bindur Irineun, që të merrte pjesë në dorëzimin e episkopëve. Irine Banushi nuk pranoi. Ai kundërshtoi hapur shkeljet dogmatike dhe kanonike që po bëheshin në atë kohë nga njerëz të pashkolluar, të cilët kishin zënë poste drejtuese

[257]-Atë Spiro Veli do të qe me cilësinë e zëvendësit episkopal të Përgjithshëm me të drejtat që i jepte eni 85 i Statutit: "Në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqeze mund të zgjidhet në të njëjtën mënyrë nji klerik i dalluar me titulll: "Zëvendës Episkopal i Përgjithshëm", i cili porsa kohë që administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe të njënjtën të drejtë anëtarësie në Sinodh, me përjashtim të atyre kompetencave që i përkasin ekskluzivisht gradës episkopate. Edhe ky jep të njënjtin betim përpara Sinodhit të Shenjtë". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 293, viti 1950, fl. 13.

[258]-Sofron Borova ka lindur në Borovë të Kolonjës më 1881. Në moshë të re shkoi në Athos ku u qeth murg. Pasi u kthye në atdhe ka shërbyer si klerik në rrethin e Korçës. Sofron Borova shihej me sy të mirë nga regjimi për shkakun se gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare nga familja e tij qenë gjashtë dëshmorë. Kriteri matës që përcaktonte qëndrimin e mirë politik në atë kohë ishte angazhimi personal ose familjar në lëvizjen nacional-çlirimtare. Në tetor 1952 u dorëzua në gradën episkopale, detyrë të cilën e kreu deri më 3 gusht 1963 kur edhe vdiq. Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 40-41.

[259]-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000, faqe 39.

në kishë vetëm se kishin luftuar gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare. Irineu nuk pranoi të merrte pjesë në dorëzimin episkopëve të rinj, të cilët më parë kishin qenë priftërinj të martuar. Pasi kishin mbetur të ve ata kërkonin të ngjisnin shkallët më të larta të hierarkisë kishtare duke shkelur kanonet e shenjta. Ky ishte shkaku që Irine Banushi u burgos përsëri në vitin 1952.

Në këto kushte alternativa e vetme ishte Kristofor Kisi. Në fund të gushtit 1952, Kisi pranoi të merrte pjesë bashkë me Vodicën në dorëzimin e episkopëve, duke kërkuar si shkëmbim rehabilitimin e tij. Më 14 shtator 1952 në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë u dorëzua episkop i Gjirokastrës Dhimitër Kokoneshi, (Fig.24) i cili mori emrin Damiano[260]. Dorëzimi u bë nga episkopët Paisi dhe Kristofor. Më 21 shtator 1952 Sofron Borova (Fig.25) u dorëzua episkop ndihmës prej episkopëve Paisi, Kristofor dhe Damiano. Më 28 shtator 1952 në katedralen Burimi Jetëdhënës në Korçë u hirotonis Foto Duni, i cili mori emrin Filothe, (Fig.26) ndërsa më 12 tetor 1952 në katedralen e Shën Dhimitrit në Berat u hirotonis Qirjako Naslazi, i cili mori emrin Qirill[261]. (Fig.27) Ky ishte Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

Më 17 qershor 1958 Kristofor Kisi vdiq në rrethana të dyshimta në kishën e Shën Prokopit. Varrimi i Kristofor Kisit u bë më datën 18 qershor 1958. Arkivoli që mbante trupin e tij u vendos në mesin e kishës katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë. Ceremonia e përmortshme u kryesua nga Fortlumturia e tij, Paisi, me pjesëmarrjen e Episkopit Ndihmës Sofronit, Arkimandrit Dhanil Çulit, Stavrofor Thoma Popës, Ikonom Marko Papajanit, Saqellar Petro Doçit, Kryedhjakonit Sotir Kanxheri etj. Në prani të të afërmve dhe besimtarëve të shumtë që kishin mbushur kishën, foli Sekretari i Sinodit të Shenjtë, Niko Çane, i cili theksoi virtytet e të ndjerit[262].

Episkopi ndihmës, Sofron Borova vdiq në vitin 1963 në moshën 82-vjeçare dhe vendin e Episkopit të Apolonisë e zuri Dhanil Çuli. (Fig.28) Me vdekjen e Mitropolitit të Korçës, Filotheut, vendin e tij e zuri Qirilli. Në vendin e Qirillit si Mitropolit i Beratit më 27 janar të vitit 1965 u dorëzua Spiridhon Papa[263]. (Fig.29) Kryeepiskop Paisi në vitet e fundit të jetës së tij ka qenë i sëmurë dhe administrimi i K.O.A.Sh-it bëhej prej episkopit ndihmës Dhanil Çulit. Paisi Vodica ndërroi jetë më 4 mars të vitit 1966 pas një hemoragjie cerebrale. Kryesia e Kishës me anën e një njoftimi të posaçëm[264], i cili mban datën 4 mars 1966 njoftonte vdekjen e Fortlumturisë së Tij, Paisit. Njoftimi është nënshkruar nga Episkop Damjan Kokoneshi, Episkop Spiridhon Papa, Episkop Dhanil Çuli, Niko Çane, Jorgji Pano,

[260]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 31.

[261]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi nr. 536, Dosja Nr. 476, viti 1950, fl. 44-54.

[262]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 37-38.

[263]-Spiro Papa ka lindur më 1885 në Sinjë të Beratit. Në vitin 1934 u dorëzua prift. Për 33 vjet ka shërbyer si famullitar i fshatit Paftal të Beratit. Pas disa viteve mbeti i ve dhe më 1965 u hirotonis Mitropolit i Beratit. Familja e tij ka qenë e lidhur me regjimin. Spiro Papa ka qenë babai i kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Beratit. Imzot Spiro Papa ka vdekur në vitin 1970. Ikonom Vangjel Xoxe, Ilia Zaka, *Spiro Theodhor Papa*, Ngjallja, dhjetor 1999, faqe 9-10; *Ata që punuan për kishën tonë. Imzot Spiro Papa*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 11.

[264]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966, fl.5.

Ikonom Andrea Prifti, Ikonom Grigor Zografi etj. Ceremonia e varrimit u bë në 5 mars 1966 në Kishën Katedrale të "Ungjillëzimit" në Tiranë[265].

Sinodi i Shenjtë i K.O.A.Sh-it në mbledhjen e datës 7 mars 1966 zgjodhi unanimisht në postin vakant të kryeepiskopit, Episkopin e Gjirokastrës, Hirësinë e Tij, Damianin. Me anën e Qarkores me numër 24/11, datë 14 mars 1966 njoftoheshin episkopatat e hirëshme dhe zëvendësitë mitropolitane në lidhje me vendimin e Sinodit të Shenjtë të datës 7 mars 1966, ku u zgjodh me vota unanime në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Hirësia e Tij, Damiani. (Fig.30) Gjithashtu Fortlumturia e Tij, Damiani do të mbante përkohësisht drejtimin e Mitropolisë së Gjirokastrës si *Ad interim*. Titullarët e Episkopatave të Hirëshme u porositën që gjatë celebrimit të shërbesave fetare të përmendnin emrin e Kryeepiskopit të sapofronëzuar. Qarkorja mbante firmën e Episkopit Ndihmës Dhanilit[266].

Pas zhvillimeve të mësipërme sinodi i ri përbëhej nga Fortlumturia e Tij, Damjani[267], në postin e Kryeepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Qirilli, Mitropolit i Korçës, Imzot Spiridhon Papa, Mitropolit i Beratit dhe Episkopi i Apolonisë, Dhanil Çuli si ndihmës i Kryeepiskopit.

1.8 PËRPJEKJET PËR BASHKIMIN E KISHAVE

Në vitin 1950 komuniteti shqiptaro-amerikan përjetoi një krizë përçarjeje[268]. Ky konflikt kishtar mori përmasa politike dhe u përqendrua në zëvendësimin e Fan Nolit me një episkop tjetër. Gjithashtu edhe dy episkopët e larguar nga Shqipëria, Pandeilejmon Kotoko dhe Evlogjio Kurilla intensifikuan sulmet kundër Nolit, i cili mbante lidhje me sinodin e Paisi Vodicës. I gjendur përpara një presioni të tillë, Noli

[265]-Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 77.

[266]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1334, Viti 1966, fl.1.

[267]-Dhimitër Kokoneshi ka lindur më 26 tetor të vitit 1886 në fshatin Llëngë të Pogradecit. Në vitin 1925 Dhimitër Kokoneshi ka përfunduar Seminarin në Janinë të Greqisë. Në vitin 1927 Dhimitër Kokoneshi u dorëzua prift nga Kryeepiskop Visarion Xhuvani. Atë Dhimitër Kokoneshin e emëruan në kishën e Shën Marenës në manastirin e Llëngës. Më 31 korrik të vitit 1927 atë Dhimitër Kokoneshi ka celebruar meshën e parë në kishën e Shën Marenës. Me fjetjen e bashkëshortes në vitin 1939 atë Dhimitër Kokoneshi mori ofiqin e arkimandritit. Ndërkohë mori emrin Damjan. Në tetor të vitit 1947 arkimandrit Damjan Kokoneshi u dorëzua në gradën episkopale prej Hirësisë së Tij, Paisit dhe Hirësisë së Tij, Kristoforit dhe u emërua Mitropolit i Gjirokastrës. Më 7 mars 1966 Damjan Kokoneshi u fronëzua Kryeepiskop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Dhimitër Kokoneshi vdiq më 18 tetor të vitit 1973 kur ishte në moshën 87-vjeçare. Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2; Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78.

[268]-Përçarja ndërmjet komunitetit shqiptaro-amerikan të Bostonit ka filluar që herët. Përveç kryekishës së Shën Gjergjit u ngritën edhe dy kisha të tjera, ajo e Trinisë së Shenjtë më 1921 dhe kisha e Shën Johanit më 1934. Por çudia më e madhe është që në një distancë prej tetëqind metrash një komunitet të ketë tre kisha armike me njera tjetrën.

kërkoi ndihmën e K.O.A.Sh-it, nëpërmjet përfaqësuesve të Shqipërisë në Sh.B.A: *"Tani që jo vetëm po plakem shumë, por ka filluar një luftë e vërtetë nga Patriarkana e Stambollit kundër meje dhe kundër kishës këtu. Kësaj të keqeje duhet t'i dalim përpara. Prandaj dua që Sinodi i Shenjtë i K.O.A.Sh-it të pranojë dhe të njohë kishën e këtushme si degë të saj për të gjitha efektet".*

Në Kongresin e tretë të K.O.A.Sh-it u vendos bashkimi me Kishën Ortodokse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që udhëhiqej nga Imzot Theofani. Më 10 shkurt 1950 Kongresi III i K.O.A.Sh-it i dërgoi një telegram[269] Fan Nolit në Boston. Vendimet e Kongresit u përshëndetën nga Imzot Theofani, i cili në atë kohë ishte Mitropolit i Dioqezës Shqiptare[270] të Amerikës. Në telegramin që i dërgonte Kishës Ortodokse të Shqipërisë me këtë rast ai është shprehur: "Jemi shumë të kënaqur nga vendimi i favorshëm që mori Kongresi III Ortodoks i Shqipërisë në lidhje me kërkesën e dioqezës sonë për t'u vënë nën juridiksionin e Kishës Mëmë. Presim me lutje ratifikimin e Sinodit të Shenjtë"[271].

Në nenin IX të statutit të K.O.A.Sh-it sanksionohet organizimi i diasporës në episkopata në varësinë e Tiranës. "Me vendim të Këshillit Mikst mund të krijohen episkopata për shqiptarët ortodoksë jashtë shtetit, të varura nga Kisha Shqiptare mëmë". Por për fat të keq autoritetet komuniste nuk e lejuan këtë bashkim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë me atë të diasporës shqiptare të Amerikës. Për këtë qëndrim negativ ndikuan disa faktorë: 1-acarimi i marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me atë të SHBA, 2-presioni i lëvizjes antikomuniste në SHBA, 3-reagimi i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës. Në atë kohë Patrik Ekumenik ishte

[269]-Në telegram thuhej: "Të gjithë delegatët e Kongresit të tretë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të mbledhur në Tiranë në një atmosferë lirije të plotë dhe bashkimi mendimesh dhe zemrash për të rahur problemet e saj aktuale dhe për t'i dhënë kësaj një statut me parime të përshtatshme për një kishë ortodokse të vërtetë dhe një udhëheqje të denjë për të praktikuar këto parime të përshtatshme për një kishë ortodokse të vërtetë, përshëndesim në personin tuan inisjatorin dhe thelluesin e kishës së parë kombëtare. Duke ju lutur që këto përshëndetje t'ua transmetoni gjithë komuniteteve të shqiptarëve ortodoksë vëllezër që bëjnë pjesë në juridiksionin tuaj episkopal, ju bëjmë njëkohësisht të ditur se ky kongres shprehu unanimisht dëshirën e tij të zjarrtë që komunitetet në fjalë të bashkuar nën udhëheqjen tuaj peshkopale të inkuadrohen dhe të bëjnë pjesë në gjirin e kishës mëmë të Shqipërisë, ashtu siç kanë shfaqur vullnetin shumë prej tyre, por që udhëheqja e deridjeshme e kishës sonë, armike e bashkimit tonë kishtar dhe kombëtar, ka mbajtur një qëndrim negativ në këtë drejtim. Në konformitet me sa më sipër, Kongresi ngarkon unanimisht Kryesinë e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për veprime të mëtejshme në këtë drejtim, së cilës kini mirësinë ti njoftoni pikëpamjen tuaj". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 295, Viti 1950, fl.2.

[270]-Kisha Ortodokse Shqiptare në Amerikë është organizuar në një dioqezë me qendër në Boston. Në varësinë e saj janë 14 kisha: Katedralja e Shën Gjergjit në Boston Masaçusets; Shën Gjonit në Boston, Masaçusets; Shën Mëria në Natik, Masaçusets; Shën Mëria në Uorçester, Masaçusets; Shën Nikolla në Sauthbrixh, Masaçusets; Shën Gjergji në Brixhport, Konektikat; Shën Nikolla në Nju-Jork, Krishti Mbret, Albani, në në Nju-Jork; Shën Pjetri e Pavli në Roçester, Nju-Jork; Shën Eliah në Xhejmstaun, Nju-Jork; Shën Pjetri e Pavli në Filadelfia, Pensilvani; Shën Gjon Gojarti në Filadelfia, Pensilvani; Shën e Premte në Kliveland, Ohajo; Shën Thomai në Detroid, Miçigan. Shërbesat kryhen në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht. Primat i Dioqezës Shqiptare të Amerikës ka qenë Theofan Noli. Fan S. Noli, *Vepra II*, Dudaj, Tiranë 2003, faqe 357.

[271]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 295, Viti 1950, fl.1.

Atenagora, i cili qe me origjinë shqiptare. Ky i fundit në dhjetor 1950 dërgoi në Boston, Marko Lipen[272] si ndihmëspeshkop i kryepeshkopit grek dhe peshkop për kishat shqiptare të Amerikës[273]. Peshkopi i Lefkës, Marko Lipe fillimisht gjeti strehë në kishën e Shën Joanit (Fig.32) dhe më vonë mori edhe kishën e Trinisë së Shenjtë. (Fig.31) Pasi zotëroi dy kisha shqiptare të SHBA, më 31 dhjetor 1950 Marko Lipe u zyrtarizua si peshkop i peshkopatës së re. Këto kisha u shkëputën nga juridiksioni i Nolit dhe kërkuan të kishin varësi nga kisha greke. Në atë kohë u krijua Sinodi i Episkopëve Kanonikë Ortodoksë të Amerikës (SCOBA). Ky sinod njohu Marko Lipen si episkop kanonik duke mos e përfshirë Nolin. Kjo ishte brenga më e madhe e Nolit. Por çudia më e madhe për Nolin ishte që në krye të SCOBA-s u zgjodh greku Jakovos Kukuzis, të cilin Noli e konsideronte si armikun kryesor. Noli njoftoi menjëherë Kryeepiskop Paisi Vodicën dhe priste mbështetje nga kisha mëmë, e cila nuk vonoi. Kryeepiskop Paisi Vodica i dërgoi një letër patrikut Atenagora, me anën e së cilës i parashtronte situatën[274].

1.9 ZËVENDËSIMI I NOLIT

Në verën e vitit 1964 Imzot Theofani, (Fig.33) në moshën 83 vjeçare, kaloi një sëmundje të rëndë. Ai u shtrua në spital dhe iu nënshtrua një operacioni të vështirë në muajin nëntor 1964. Vuante nga kanceri në zorrë. Imzot Theofani i kishte rralluar meshimet dhe takimet me ortodoksët e Bostonit. Në stinën e dimrit në Boston bënte shumë ftohtë, prandaj Noli kishte vendosur që të shkonte në Florida, në shtëpinë që kishte blerë me ndihmat e shqiptarëve[275].

Në dhjetor të vitit 1964 gjendja shëndetësore e Nolit ishte keqësuar dhe po mendohej për zëvendësimin e tij. Në atë kohë Kryekisha e Shën Gjergjit drejtohej nga ikonom Krist Elli, i cili ishte njeriu më i besuar i Nolit. Ato ditë në Boston kishte

[272]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 169.

[273]-Marko Lipe ka lindur më 1920 në krahinën e Oparit. Studimet teologjike i kreu në Kelkis të Stambollit. Marko Lipe brenda gjashtë muajve u bë dhjak, prift dhe më gusht 1950 u dorëzua Episkop i Lefkës, në moshën 30-vjeçare. Marko Lipe vdiq në mars 1982. Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 200.

[274]-Në letër thuhej: "Nga lajme të botuara në shtyp dhe nga informata relative që i kanë ardhur Kryesisë së Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, prej Hirësisë së Tij, Episkopit të Kishës Ortodokse Shqiptare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Fan S. Noli, me hidhërim të madh u njoftuam rreth tentativave dhe përçapjeve të asaj Patriarkane të Shenjtë Ekumenike, për të instaluar me inisiativën e saj dhe jashtë çdo rregulli të drejte kanonike dhe tradite kishtare ortodokse një tradhëtar dhe renegat të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, të quajtur Marko Lipa, si episkop për Kishën Ortodokse Shqiptare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllime të paracaktuara që synojnë në mënyrë të hapët direkte dhe të ndërgjegjshme të godasin unitetin kishtar, kombëtar dhe patriotik të shqiptarëve ortodoksë me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në interes, në shërbim, dhe për dobi të rivendikimeve të marëzishme dhe lakmive grabitqare të shovinizmit grek, kundër të drejtave dhe interesave kishtare dhe kombëtare të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar në përgjithësi". Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 356, viti 1950, fl.2-4.

[275]-Nasho Jorgaqi, *Fan Noli në ditët e fundit*, Shekulli, 11 mars 2005, faqe 18-19.

ardhur për vizitë Kryeepiskopi i Greqisë Jakovi. Ky i fundit kishte shërbyer për shumë vite si prift në Boston dhe njihej nga të gjithë. Ikonom Krist Elli pas takimit që pati me Jakovin u pushua menjëherë nga kisha e Shën Gjergjit. Mendohet që biseda e tyre të ketë qenë për të ardhmen e kishës pas vdekjes së Nolit. Në mbledhjen e fundit të kuvendit të peshkopatës Noli zyrtarizoi pushimin nga detyra të famullitarit të Kishës së Shën Gjergjit në Boston Krist Ellit. Gjithashtu shkarkoi edhe disa anëtarë të këshillit të kishës, të cilët qenë ithtarë të Ellit[276].

Vendin e Krist Ellit, e zuri atë Sotir Dilogjika, të cilin Noli e caktoi me detyrën e sekretarit të peshkopatës. Atë Sotir Dilogjika ishte nga Zagoria dhe ka punuar si piktor skenograf. Duke parë aftësitë e tij Noli i propozoi të dorëzohej në gradën priftërore.

Noli për zëvendësues të tij zgjodhi kandidaturën e atë Stefan Laskos, i cili shërbente në Filadelfia. Ky i fundit në atë kohë ishte i vetmi prift i pamartuar nga pesëmbëdhjetë klerikët që shërbenin nën juridiksionin e Nolit. Atë Stefan Lasko (Fig.34) në atë kohë ishte në moshën 66-vjeçare[277]. Në dhjetorin e vitit 1964, Noli i dërgoi një letër zyrtare Kryeepiskopit Paisi Vodica, me anën e së cilës i

[276]-Krist Elli (1895-1985) ka lindur më 1895 në Hoçisht të Devollit. Me fillimin e luftrave Ballkanike, në vitet 1912-1913 u detyrua të emigroi në SH.B.A, në Boston. Pasi kreu studimet për Stomatologji në Boston, punoi ca kohë si dentist, në Kleveland fillimisht dhe më pas në Boston. Pas luftës së Dytë Botërore u dorëzua prift nga Imzot Theofan Noli, i cili në atë kohë ishte Kryeepiskop i dioqezës shqiptare të Amerikës. Atë Krist Ellin e emëruan famullitar i Katedrales së Shën Gjergjit në Boston. Ai ishte shumë popullor, i aftë dhe i devotshëm, prandaj besimtarët e donin dhe e respektonin. Elli organizoi për herë të parë kurset e katekizmit, të cilat quheshin "Shkolla diellore". Gjithashtu ngriti dhe organizoi korin e kishës së Shën Gjergjit. Atë Krist Elli i përpoq për bashkimin dhe paqtimin e të gjitha kishave shqiptare të ngritura në Amerikë dhe njohjen e e tyre zyrtarisht nga Patrikana Ekumenike. Ikonom Krist Elli ndërroi jetë më 15 prill të vitit 1985. Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, Ombra GVG, Tiranë 2005, faqe 421; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 177-178; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 202.

[277]-Stefan Lasko (1900-1975) ka lindur në Malëshovë, më 2 shtator të vitit 1900. Pasi emigroi në SH.B.A, më 20 qershor të vitit 1949 u hirotonis prift në kishën e Shën Gjergjit në Boston. Në vitet 1949-1950 ka shërbyer në kishës e Shën Gjergjit në Boston, ndërsa në vitet 1951-1955 ka shërbyer në kishën e Shën Pjetrit dhe Pavlit në Filadelfia të Pensilvanisë. Në këtë kohë hyri në radhët e klerit murg. Ng aviti 1956 deri më 1963 ka shërbyer si famullitar i kishës së Shën e Premtes në Kleveland të Ohajos. Në fundin e vitit 1964 u kthye në Boston për të ndihmuar Peshkop Nolin, i cili qe i sëmurë rëndë. Me kërkesën e Imzot Fan Nolit, në mars të vitit 1965 Stefan Lasko u dërgua në Shqipëri për tu bërë episkop. Stefan Lasko u dorëzua në gradën episkopale më 20 mars të vitit 1965 në kishën e Shën Spiridhonit në qytetin e Durrësit, prej Kryehirësisë së Tij, Imzot Paisit, Imzot Kirillit dhe Imzot Damianit. Imzot Stefani udhëhoqi grigjën e shqiptarëve të Amerikës nga viti 1965-1975 në një periudhë të vështirë, duke dorëzuar priftërinj shqiptarë. Ndër ta mundt të përmendim atë Artur Liolinin si dhe peshkopin Nikon. Në vitin 1971 imzot Stefan lasko u pranua pjesëtar i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Amerikane, ngjarje që plotësoi ëndrën e Nolit për të bashkuar dioqezat ortodokse rumune, bullgare, shqiptare, ruse etj dhe duke formuar me to një sinod episkopal. Imzot Stefan Lasko vdiq më 30 prill të vitit 1975. *Celebrating 100 years 1908-2008, Albanian Orthodox Archidiocese in Amerika*, Boston 2008; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 264-265; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 203.

rekomandonte që të dorëzonte Stefan Laskon në gradën episkopale[278]. Kundërshtarët e Nolit nuk qenë dakort, që kandidati për episkop të dorëzohej në Shqipërinë komuniste, prandaj Noli për të mos krijuar pështjellime në kishë i dërgoi një letër të dytë Kryeepiskop Paisit, ku i shkruante se e anullonte vendimin për dorëzimin e Laskos. Noli u tërhoq sepse fuqitë po e linin dhe nuk kishte më nerva të përballonte konfliktin mes besimtarëve, por nga ana tjetër nuk u tërhoq Stefan Lasko, i cili u nis me kokën e tij dhe në javën e parë të marsit të vitit 1965 mbërriti në Shqipëri. Ndërkohë më 13 mars 1965 Theofan Noli vdiq[279]. Stefan Lasko u dorëzua në gradën episkopale më 20 mars të vitit 1965 në kishën e Shën Spiridhonit në qytetin e Durrësit[280], prej Kryehirësisë së Tij, Imzot Paisit, Imzot Kirillit dhe Imzot Damjanit. Imzot Stefan Lasko ishte hierarku i fundit që u dorëzua në gradën episkopale në Shqipëri, sepse më pas vijoi persekutimi ndaj kishës[281].

[278]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1283, viti 1964, fl.8.

[279]-Theofan Noli vdiq më 13 mars të vitit 1965. Qindra e qindra njerëz shqiptaro-amerikanë, si dhe miq të tij të shumtë erdhën për t`i dhënë nderimet e fundit. Katedralja ishte në zi. Arkivoli i tij ishte mbuluar me flamurin kombëtar, me shqiponjën me dy krerë në mes. Katër qirinj ishin vendosur anës tij në formë kryqi. Ceremonia e përcjelljes për në banesën e fundit u zhvillua ditën e shtunë më 20 Mars, në orën 10 paradite. Kisha ishte mbushur plot e përplot nga shqiptaro-amerikanë të ardhur nga të gjitha anët e Amerikës, sidomos nga Bostoni, nga funksionarë të tjerë me guvernatorin e shtetit të Masaçusets Xhon Volpe në krye. Kurora me lule të shumta mbulonin arkivolin, ndër të cilat dallohej kurora e dërguar në emër të shtetit shqiptar. Mbi 15 priftërinj ortodoksë shqiptarë morën pjesë në zhvillimin e ceremonisë së përmortshme. Djem dhe vajza të kishës së Bostonit përbënin korin që shoqëronte panagjirikët, të cilët u mbajtën në gjuhën shqipe dhe atë angleze prej të perëndishmëve Sokrat Sotiri dhe Sotir Dilogjika. Arriti çasti më prekës, kur arkivoli u ngrit në duar e doli jashtë kishës, i shoqëruar nga vajtimi i korit dhe lotët e njerëzve me kokë të ulur. Vargu i gjatë i makinave kaloi nëpër dëborën e butë, e cila binte vazhdimisht duke veshur çdo gjë me të bardha ashtu si ishte edhe shpirti i tij. Në krye ishte delegacioni i Vatrës. Në varreza fjalën e rastit e mbajti i perëndishmi Sotir Dilogjika, më pas përshëndetën edhe përfaqësuesit e komunitetit mysliman i perëndrituri Vehbi Ismaili dhe Baba Rexhepi, përfaqësues shpirtëror i Teqesë Bektashiane, të dy me qendër në Detroit. Ceremonia e varrimit të tij u pasqyrua hollësisht në gazetën "Dielli" si dhe në shtypin amerikan. Pas varrimit sipas traditës shqiptare u dha një drekë në kishën e Shën Gjergjit. Efthim Dodona, *Noli i panjohur*, Tiranë 1996, faqe 184-187; Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, Ombra GVG, Tiranë 2005, faqe 432-435.

[280]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1283, viti 1964, fl.5.

[281]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Tiranë 2004, faqe 42.

KREU I DYTË
PERSEKUTIMI I KISHËS
(1967-1990)

Në janar të vitit 1967 organizata e rinisë së shkollës së mesme "Naim Frashëri" në qytetin e Durrësit shpalli nismën: "Të luftojmë deri në fund ideologjinë fetare, besytnitë dhe zakonet prapanike", ndërsa më 6 shkurt 1967 Enver Hoxha, në mbledhjen e përbashkët të disa organizatave të partisë në Tiranë, mbajti fjalimin me temë: "Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit". Menjëherë pas kësaj gazeta "Zëri i popullit" e datës 7 shkurt 1967 botoi artikullin: "Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë, kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, besytnive dhe zakoneve prapanike"[282]. Më 27 shkurt 1967, diktatori Enver Hoxha, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, u drejtoi një letër komiteteve të partisë në rrethe "Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare", ku i porosiste për ta zhveshur popullin nga besimi fetar dhe për të futur në të botëkuptimin marksist-leninist[283].

Komiteti Qendror i PPSh nxori një raport informativ për masat që duhej të merreshin për çrrënjosjen e botëkuptimit fetar. Si pasojë e kësaj lufte disa nga objektet e kultit u rrafshuan krejt, ndërsa ca të tjera u kthyen në magazina, vatra kulture etj. Gjithashtu ikonat, librat liturgjikë dhe sende të tjera me karakter fetar u sekuestruan. Për shkatërrimin e kishave dërguan nxënësit e shkollave dhe repartet ushtarake. Nën udhëheqjen e aktivistëve fanatikë të organizatave të rinisë dhe sipas udhëzimeve të komiteteve të partisë ata filluan vinin dorë mbi kishat. Klerikët dhe besimtarët kujtuan se shkatërrimi i objekteve te kultit ishte me të vërtetë një nismë e organizatës së rinisë, prandaj filluan të dërgonin letra te diktatori Enver Hoxha, me anën e së cilave kërkonin ndalimin e fushatës shkatërruese. Ata shpresonin se udhëheqësi kryesor i Partisë së Punës do të ndërhynte me autoritetin e tij për të ndaluar barbarizmat që po bëheshin[284].

Më 11 prill 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxorri dekretin nr. 4263 "Për bashkësitë fetare", me anën e së cilit u hiqte atyre çdo siguri ligjore dhe i shpronësonte krejtësisht. Çdo pasuri e tyre e tundshme ose e patundshme, duhet tu shpërndahej organizatave socialiste[285]. Me dekretin nr. 4337, të datës 13.11.1967 të

---

[282]-*Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë, kundër ideologjisë fetare, paragjykimeve, besytnive dhe zakoneve prapanike*, Zëri i Popullit, nr. 32, 7 shkurt 1967; Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 108; Leonard Veizi, *Projektet "anti-Zot" të Ramiz Alisë"*, Dita, 23 mars 2005, faqe 14-15.

[283]-*Letër e Komitetit Qendror të PPSh drejtuar komiteteve të partisë në rrethe "Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare"*, në "Dokumente kryesore të PPSh", Vëllimi V, 1966-1970, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSh, "8 Nëntori", Tiranë 1974.

[284]-Dashnor Kaloçi, Genta Popa, *Viti 1967, kur Tirana zyrtare i shpalli luftë Zotit*, Shqip, 9 dhjetor 2007, faqe 18-19.

[285]-Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 110.

Presidiumit të Kuvendit Popullor, u shfuqizuan të gjitha dekretet[286] që aprovonin veprimtarinë fetare në vend[287] dhe Shqipëria u shpall zyrtarisht shteti i parë dhe i vetëm ateist në botë dhe në histori, që ndalonte çdo shprehje të fesë. Dy ditë më vonë, më 15 nëntor 1967, Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë vendosi që të gjitha kishat dhe manastiret t'ia dorëzonin organizatës së rinisë për ti shfrytëzuar në të mirën e popullit shqiptar. Vendimi i Komitetit Qendror të PPSH-së për mbylljen e objekteve të kultit ngjalli pakënaqësinë e klerikëve dhe të besimtarëve nga i gjithë vendi. Shkatërrimi i objekteve të kultit fillimisht u kamuflua si një nismë e rinisë dhe gradualisht mori përmasa kombëtare.

Sektori i edukimit në Komitetin Qendror të PPSh-së më 16 shtator 1968 i ka dërguar një material me numër protokolli 679 komiteteve të partisë në rrethe me temë: "Mbi luftën kundër fesë". Materiali është firmosur nga Dashnor Mamaqi me porosi të sekretarit të Komitetit Qendror Ramiz Alia. Në material thuhet: "Nga konstatimet që ka bërë aparati i Komitetit Qendror të Partisë, me gjithë sukseset e arritura kundër fesë, rezulton se influencat fetare, sidomos ato të lidhura me praktikat jetësore, vazhdojnë të rezistojnë, të përhapen aty këtu duke marrë shpesh herë edhe forma të reja. Akoma përdoren përshëndetje, urime, ngushëllime, mallkime, frikësime të lidhura me emrin e zotit dhe të shprehjeve fantastike idealiste. Nga të moshuarit përhapet te fëmijët një letërsi gojore me përmbajtje fetare dhe reaksionare me anën e përrallave, tregimeve, legjendave, thënieve, proverbave etj. Bëhen përpjekje për të trashëguar në brezat e rinj praktikat fetare në lindjet, vdekjet, shenjat në varreza, në sëmundjet e njerëzve, të kafshëve, të bimëve, në fenomenet e natyrës, në vënien e festimin e emrave, në ngrëniet etj. Ka tentativa t'u mësojnë fëmijëve përmendësh dogma fetare. Disa nga këto praktika përpiqen t'ia adoptojnë situatës së sotme. Kthehet nusja në të parë, ditën e një shenjti dhe në emrin e gostisë për çupën, festohet shenjti. Nën pretekstin e festimit të ditëlindjes festohet dita e shenjtit. Nuk vihet emri shqip me kuptim fetar dhe zëvendësohet me një emër të huaj po fetar etj. Aty këtu janë shikuar tentativa klerikësh për të udhëzuar si t'i kryejnë ritet fetare. Mbahen akoma ndërtesa pa asnjë vlerë historike dhe përdorimi, si një formë e një rezistence pasive. Në ndonjë rast këto janë përdorur edhe për pagëzim, ose veprimtari tjetër fetare. Të gjitha këto tregojnë se është i gabueshëm mendimi që ndihet aty këtu se tashti që u mbyllën kishat dhe xhamitë, s'kemi çfarë të bëjmë kundër fesë..."[288].

Në Kongresin V i PPSh-së që u mbajt më 30 nëntor 1969 u dekretua se Shqipëria ishte vendi i parë ateist i botës. Në Kushtetutën e vitit 1976 ndalimi i besimit u saksionua me ligj. Neni 37 i Kushtetutës thoshte: "Shteti nuk njeh asnjë fe

[286]-Në mbështetje të nënit 58, pika 6, të Kushtetutës, me propozim të qeverisë Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë vendosi të çuqizohen: Dekretligji Nr. 743, datë 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare"; Dekreti Nr. 1065, datë 4 maj 1950, i Presidiumit të Kuvendit Popullor për aprovimin e Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

[287]-Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm,* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 111; Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste,* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014, 155-156.

[288]-Leonard Veizi, *Si u ngrit propaganda komuniste në luftën e egër kundër besimeve fetare,* Metropol, 2 dhjetor 2007, faqe 16; Leonard Veizi, *Projektet "anti-Zot" të Ramiz Alisë*, Dita, 23 mars 2005, faqe 15; Sotir Melka, *Dëmet e riteve dhe festave fetare,* Naim Frashëri, Tiranë, 1967, faqe 3-4.

dhe përkrah e zhvillon propagandë ateiste për të rrënjosur tek njerëzit botëkuptimin materialist shkencor”[289].

2.1 KLERIKËT TË SISTEMOHEN NË PUNË

Persekutimi filloi me reduktimin e numrit të kishave dhe të personelit që shërbente në to. Më 1 janar 1967 funksiononin vetëm pesë kisha, një në Tiranë, një në Durrës, një në Berat, një në Kavajë, dhe një në Shkodër, ndërsa të tjerat kishin kaluar në pronësi të Komiteteve Ekzekutive dhe të kooperativave bujqësore. Gjithashtu u reduktua ndjeshëm personeli. Në atë kohë personeli përbëhej nga 194 vetë dhe u reduktua në 10 vetë. Madje udhëzimi ishte që Kisha Ortodokse të ekzistonte vetëm për efekte protokollare me një personel prej tre vetësh (kryetari, një sekretar dhe një person tjetër për shërbime të ndryshme)[290].

Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në një mbledhje të posaçme të datës 22 shkurt të vitit 1967 vendosi që klerikët të hiqnin rasot. Mbledhja kryesohej nga Kryeepiskopi Damiano, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, Episkopin e Beratit Spiridhonin dhe Episkopin ndihmës Dhanilin si dhe Sekretarin e Sinodit të Shenjtë Z. Niko Çane. Episkopi i Korçës, Kirili për arsye shëndetësore nuk ishte i pranishëm në mbledhjen e Sinodit, por dha pëlqimin me shkrim, me anën e shkresës me numër protokolli 13, datë 24 mars 1967. Sipas Urdhëresës së Sinodit të Shenjtë klerikët duhet të hiqnin rasot dhe të dilnin në publik me veshje civile: “Me të marrë letrën tonë, brenda 24 orëve të visheni me veshje civile, në qoftë se këtë nuk e keni bërë deri më sot, duke na njoftuar se e zbatuat urdhërin tonë përkatës, sepse ndryshe nuk mund tu dërgojmë rrogën e muajit mars”[291].

Atë Jorgji Zaro nga Bularati i Dropullit në shënimet e tij ka shkruar: *“Na mblodhi, në fund dimri, mitropoliti i Gjirokastrës, të gjithë klerikët e Mitropolisë. Na porositi me ton urdhërues që deri në fillim të marsit të kemi rruajtur mjekrat, të kemi zhveshur rasot dhe të kemi dorëzuar në organizatat e rinisë komuniste kishat tona. Ishte ftohtë dhe ngricë. Dhe atmosfera u ngri e gjitha. Heshtja ishte e tmerrshme. Guxuan dhe reaguan vetëm klerikët e ardhur nga zona e Himarës”*[292].

Më 18 prill 1967, Zija Beqiri, kreu i ri i Komitetit Klerik zhvilloi një takim me krerët e bashësive fetare. Në takim Kryeepiskopi Damjan Kokoneshi shprehu shqetësimin që fondi klerik të mos prekej, sepse kishte të bënte me pensionet e

[289]-Ligj Nr. 5506, datë 28.12.1976, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, neni 37; Leonard Veizi, *Zbatimi i platformës marksiste mbi shkatërrimin e fesë,* Ballkan, 9 shtator 2005, faqe 14-15.

[290]-Ben Andoni, *Pronat e klerit. Lista e pasurive të katër komuniteteve fetare*, Java, 7 shtator 2013, faqe 7-9; Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

[291]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1367, Viti 1967, fl.4.

[292]-Orfea Beci, *Orthodhoksi e çliruar, sepse u ngjall*, Kërkim, Nr.9, Tiranë, 2012, faqe 81-82.

klerikëve që nuk qenë në moshë pune. Ndër të tjera Kokoneshi theksoi se llogaritë e kishave qenë krijuar me të ardhurat e vetë klerit, prandaj nuk duhet të prekeshin. Përfundimisht në takim u vendos që komunitetet fetare do të bashkonin llogaritë bankare në një llogari të vetme. Në qershor 1976 me urdhër të Ministrisë së Financave, Banka e Shtetit e krijoi këtë llogari[293]. Nuk vonoi shumë dhe Kryesia e Kishës nxori njoftimin drejtuar arkave të kursimeve mbi faljen e obligacioneve shtetit[294].

Ramiz Alia dhe Dashnor Mamaqi, më 20 prill të vitit 1967 i dërguan një letër, komiteteve të partisë në rrethe ku i porositnin: *-Deri më 15 maj 1967 të na dërgoni një relacion informativ mbi organizimin e punës dhe rezultatet e deritanishme të luftës kundër fesë dhe zakoneve e besytnive, sipas letrës së shokut Enver. Lidhur me këtë problem relacioni të përmbajë se si është organizuar puna e partisë dhe e organizatave të masave, efektet e saj, çfarë problemesh dalin nga puna e deritanishme, si po ndiqet e thellohet lufta kundër besimeve fetare, në ç'drejtim e kanë përqendruar propagandën, e të tjera çështje që ju mendoni të na informoni. Me qëllim që të kemi një pasqyrë të qartë, na informoni sa kisha, sa xhami, sa vakëfe, sa tyrbe etj, janë marrë nga populli dhe çfarë është bërë me to. Sa është numri i klerikëve në rrethin tuaj, çfarë bëjnë tani, me ç'punë merren, si u veprua për t'i sistemuar në punë dhe çfarë problemesh dalin në këtë drejtim*[295].

Diktatori Enver Hoxha theksonte: "Në propagandën kundër fesë, riteve, dogmave dhe institucioneve fetare duhet të kemi parasysh që të mos futemi në luftë të hapët me masat e popullit, sepse në popull do të ketë edhe njerëz të ndershëm të lidhur me Partinë dhe patriotë të flaktë, të cilët do ta ruajnë në ndërgjegjen e tyre besimin"[296].

Klerikët duhet të paraqiteshin nëpër zboret ushtarake. Në telegramin që i dërgonte sekretari i Kryesisë së Kishës Niko Çane Zëvendësisë episkopale të Himarës i shkruante: Ne demarshuam, por ligji përkatës nuk i përjashton klerikët nga deyrimi ushtarak. Interesohuni pranë Degës ushtarake aty"[297]. Në vitin 1965 Këshilli i Ministrave me vendim të posaçëm hoqi përkatësinë fetare nga dokumetet e identifikimit[298]. Klerikët ortodoksë filluan të përbuzen dhe të tallen nga rinia[299]. Kjo bëhej që ata të mos guxonin të dilnin rrugëve të qytetit. Po pati edhe klerikë trima[300] nga ata që patën luftuar dhe nuk u dridhej qerpiku.

---

[293]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 277.

[294]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1382, viti 1967, fl.1-2.

[295]-Letra ka me numër protokolli 311 dhe lëndë: "Mbi dërgimin e një relacioni mbi luftën kundër fesë dhe zakoneve e besytnive fetare". Leonard Veizi, *Projektet "anti-Zot" të Ramiz Alisë*, Dita, 23 mars 2005, faqe 14-15.

[296]-*Enveri, vendimi që hoqi festën e Bajramit dhe Pashkët*, Metropol, 7 shkurt 2005, faqe 27.

[297]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1237, viti 1964, fl.1-2.

[298]-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017, faqe 241.

[299]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1161, fl.1-2; Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

[300]-Damjan Kokoneshi po kalonte pranë kafe "Flora" dhe disa të rinj që qenë ulur në bordurën e rrugës filluan ta tallin, duke thënë "ta lashë". Kokoneshi nxorri koburen nga brezi dhe e kërcënoi njerin prej

Në një raport të Sigurimit të Shtetit në nëntor 1967 në rrethin e Përmetit përshkruhet se nga 13 klerikët që qenë në këtë rreth asnjë nuk vazhdon ta kryejë funksionin fetar[301]. Një pjesë e klerikëve qenë sistemuar në punë të ndryshme, ndërsa klerikët e moshuar patën dalë në pension. Megjithatë klerikët dhe anëtarët e këshillave kishtarë mbaheshin në survejim nga sigurimi. Në relacion theksohet se gjatë vitit 1967 kleri reaksionar në rrethin e Përmetit e ka shtuar veprimtarinë e tij në agjitacion e propagandë kundër masave që ka marrë partia e populli kundër fesë[302].

Si përfundim mund të themi se synimi i Partisë së Punës me masat që pati ndërrmarë ishte që kleri të hiqte dorë nga jeta parazitare që bënte, duke u shndërruar në klasë punëtore ose kooperativiste si gjithë të tjerët dhe të jetonte me djersën e ballit[303]. Pjesa më e madhe e klerikëve u detyruan të bënin punë të rënda. Madje, atyre iu mohuan edhe vitet e vjetërsisë në punë, gjë e cila solli që ata të punonin dhe të rropateshin derisa dhanë frymën e fundit[304].

2.2 ZËVENDËSIMI I TË KREMTEVE FETARE ME FESTA SOCIALISTE

Me porosi të Sekretarit të KQ të PPSh Ramiz Alia, doli një qarkore, me anën e së cilës festat fetare duhej të zëvendësoheshin me festat socialiste: "Çdo njeri e ndjen nevojën e gëzimit, bashkimit dhe të dëfrimit bashkë me miqtë, me shokët, me të afërmit. Pikërisht, për këtë arsye, institucionet fetare i jepnin rëndësi organizimit të festave. Disa nga këto si Pashkët apo Bajrami, përbënin festën e përbashkët për të gjithë, pra njerëzit gëzonin bashkarisht. Disa të tjera, si dita e emrit, pagëzimit etj, qenë më tepër festa familjare. Feja, sidomos kisha, për këto festa organizonte ceremoni pompoze, solemne, që tu mbeteshin në mendje njerëzve. Çdo gjë shoqërohej me një organizim sa më të bujshëm: që nga veshja, zbukurimet, organizimi i ceremonisë etj. Duke hedhur poshtë të gjitha festat fetare, ne duhet të

---

tyre. Lajmi u përhap anembanë qytetit dhe që nga ajo kohë nuk guxonte më njeri të tallej me të duke i thënë "ta lashë".

[301]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 275, viti 1967: *Relacion mbi veprimtarinë e klerit dhe besimtarëve reaksionarë*, nëntor 1967; Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur, (Përmeti 1943-1990)*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2016, faqe 375.

[302]-Sipas të dhënave të Sigurimit të Shtetit klerikët që bënin agjitacion e propagandë qenë: Jani Kovaçi, ish-klerik nga Qilarishti, i vënë në kontroll operativ 2-A; Vasil Boçi, nga Çarshova, i vënë në kontroll operativ 2-B; Jani Gaqe nga Strëmbeci, ish-klerik, i vënë në kontroll operativ 2-B; Llazi Lipe, ish-epitrop nga Kaludhi; Apostol Tatazi, besimtar nga Qilarishti; Kano Dhionisi nga Përmeti; Avram Prifti, ish-klerik nga Përmeti; Sotir Sevo, besimtar nga Këlcyra. Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur, (Përmeti 1943-1990)*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2016 faqe 375-376; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 275, viti 1967: *Relacion mbi veprimtarinë e klerit dhe besimtarëve reaksionarë*, nëntor 1967.

[303]-*Çaste nga persekutimi ateist*, Ngjallja, shkurt 2019, faqe 9.

[304]-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 60.

organizojmë festimin e festave tona kombëtare, lokale apo familjare. Por t'i organizojmë më mirë, më bukur, më me madhështi seç i organizonin klerikët. Festat tona duhet t'u mbeten në mendje për një kohë të gjatë njerëzve"[305].

Materiali është përgatitur nga sektori i edukimit në Komitetin Qendror të PPSh më datën 30 maj 1967 dhe mban numrin e protokollit Nr. 429, lënda: "Mbi festat e reja socialiste" dhe është firmosur nga Ramiz Alia dhe Dashnor Mamaqi. Ndër të tjera thuhet: "Në jetën individuale të njeriut ka shumë ngjarje të shënuara që duhet t'i festojmë. Të tilla janë lindja, ditëlindja, hyrja në shkollë, futja në organizatën e pionierit, në rini, në parti, në ushtri, dhënia e fletë-lavdërimit e dekorimit etj". Më tej materiali vijon: "Masat e gjera punonjëse dhe në mënyrë të veçantë rinia, kanë marrë zotime që të heqin dorë nga të gjitha festat dhe ceremonitë fetare, nga zakonet e vjetra dhe prapanike dhe të festojnë festat tona socialiste. Mirëpo kjo nuk mund të bëhet menjëherë. Të zhdukësh diçka, dhe aq më tepër që kjo ka të bëjë me botën shpirtërore të njeriut, nuk mund të bëhet po nuk u zëvendësua me diçka tjetër më përparimtare për njeriun". Në kuadrin e festave lokale mund të hyjnë dhe të festohet dita e minatorit, e naftëtarit, e transportit, përcjellja dhe pritja e vullnetarëve që shkojnë nëpër aksione etj. Pyetja shtrohet se çfarë festash duhet të festojmë? Festat me karakter kombëtar si për shembull: 10 janari që është festa e shpalljes së Republikës, 1 maji, dita e solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve, 8 nëntori, dita e themelimit të PKSh etj. Gjithashtu një rol të rëndësishëm duhet të zënë edhe festat me karakter shoqëror si për shembull: 1 janari, dita e vitit të ri, 7 marsi, festa e mësuesit, 8 marsi, festa e grave, 25 prilli, dita e kufirit, 5 maji, dita e dëshmorëve, 10 korriku, festa e ushtrisë, 1 qershori, festa e fëmijëve etj[306].

Zhdukja e festave fetare dhe zëvendësimi i tyre me festat socialiste përbën një problem ideologjik. Këtu nuk është fjala vetëm për zëvendësimin e festave fetare me festat tona, por është fjala për ushqimin e përditshëm shpirtëror që ka nevojë njeriu, prandaj organizatat e partisë dhe organizatat e masave duhet të mendojnë seriozisht si ta organizojnë më mirë edukimin dhe dëfrimin e punonjësve në punë dhe pas pune. Duhet menduar ku do ta kalojnë njerëzit kohën e lirë e sidomos të dielave.

Në materialin e përgatitur nga sektori i edukimit në Komitetin Qendror të PPSh më datën 30 maj 1967, lënda: "Mbi festat e reja socialiste" në lidhje me ceremonitë martesore thuhej: -Një ngjarje me rëndësi në jetën e njeriut është fejesa dhe martesa, mbi të cilën feja ka ushtruar ndikimet e saj shekullore. Si do të festohen këto tani? Kanë dalë mjaft pyetje që tregojnë se njerëzit kanë disa shqetësime. Njerëzit pyesin: -A do të bëhen pas kësaj fejesa me shkes, a duhet bërë darkë kur

[305]*-Letra e PPSh, synetllëku dhe pagëzimi hiqen me vendim*, Metropol, 8 shkurt 2005, faqe 27; Sotir Melka, *Dëmet e riteve dhe festave fetare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1967, faqe 35-38; Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 99-101.

[306]-Leonard Veizi, *Udhëzimet e Ramizit për festat e reja*, Dita, 9 mars 2005, faqe 14-15; Dorela Paci, *1967, si u zëvendësuan ritet fetare me festat socialiste*, Standard 3 dhjetor 2007, faqe 10; *Raport informativ për rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e saj të mëtejshëm*, Ngjallja, mars 2018, faqe 5; Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 101-102.

fejohet apo martohet, sa njerëz duhet të ftojë, a duhet ta marrin nusen me kuaj apo me taksi, a duhet të bëjë pajë etj? Kuptohet se për këto e të tjera pyetje, receta nuk mund të jepen, por as indiferentë nuk mund të qëndrojmë. Është e drejtë që të rinjtë e të rejat ta zgjedhin vetë shokun e jetës, por kur këta kanë simpati njëri me tjetrin dhe nuk kanë guxim ta shfaqin, pse të mos ndërhyje një njeri i afërt i tyre, ose pse të mos ja u thonë prindërve të tyre dhe të arsyetohen me ta. Madje është e këshillueshme dhe ne duhet ta rekomandojmë dhe t'i nxisim të rinjtë që t'ua thonë prindërve dhe të kërkojnë ndihmën e tyre dhe vetëm atëhere kur ndonjë është konservator dhe nuk pranon, atëhere të rinjtë e zgjidhin vetë. Sa do të ftojë në fejesë apo në dasmë, receta nuk jepen. Recetë është vetëm porosia e partisë që të mos bëhet ky gëzim shkak i shkatërrimit të ekonomisë. Kuptohet kur nusja është larg, ajo mund të merret qoftë me kuaj, qoftë me taksi. Ditën e dasmës nusja të vishet sa më bukur dhe hijshëm.

Zhdukja e festave fetare dhe e zakoneve prapanike dhe zëvendësimi i tyre me ceremonitë dhe festat socialiste përbën në vetvete një problem ideologjik që meriton kujdesin dhe vëmendjen e partisë, dhe këtu nuk është fjala vetëm për zëvendësimin e festave fetare me festat tona, por është fjala për ushqimin e përditshëm shpirtëror që ka nevojë njeriu, prandaj organizatat e partisë dhe organizatat e masave duhet të mendojnë seriozisht si ta organizojnë më mirë edukimin dhe dëfrimin e punonjësve në punë dhe pas pune[307].

Në materialin e përgatitur nga sektori i edukimit në Komitetin Qendror të PPSh më datën 30 maj 1967, lënda: "Mbi festat e reja socialiste" në lidhje me ceremonitë mortore theksohej: -Vdekja si ngjarje është më e hidhura në jetën e njeriut. Ajo është shfrytëzuar gjithnjë nga klerikët si momenti më i përshtatshëm për të ushqyer tek njerëzit idetë skllavëruese të fesë, për të përforcuar ndjenjat fetare me anë të frikës dhe për të përhapur idetë reaksionare të ekzistencës së botës së përjetshme. Për këtë qëllim kisha dhe xhamia duke iu përshtatur kohës kanë shpikur dhe zbatuar ceremonira dhe shërbime fetare nga më të ndryshmet, që kanë zënë rrënjë në ndërgjegjen e njerëzve të paformuar nga ana shkencore. Për të zhdukur këto zakone e praktika fetare, duhet të luftohet në mënyrë sistematike përmbajtja filozofike, idealiste dhe mistike e tyre, duke i zëvendësuar ato me ceremoni e shërbime të tilla, ku të shprehet respekti për kujtimin e njeriut që ka vdekur. Me prishjen e institucioneve fetare kanë dalë disa probleme dhe njerëzit me të drejtë pyesin: -si do të njoftohen të afërmit për vdekjen, kur dihet që këtë e bënte kisha me rënien e kambanave në shenjë zie? Kjo gjë do të zëvendësohet me shpalljen e ngjitur në shtyllë. Problem tjetër në lidhje me këtë çështje ishte: -si do të varrosen njerëzit, nga lindja apo perëndimi? Kjo do të zgjidhej nga komunalja, e cila t'i vendoste sipas vendit dhe ku të mundte, në varreza të thjeshta e me varre të lira[308].

---

[307]-Leonard Veizi, *Udhëzimi i Ramizit: Martesat e orientim,* Telegraf, 10 shtator 2008, faqe 10-11; *Ramiz Alia, Fejesat e martesat me orientim*, Metropol, 3 dhjetor 2007, faqe 16-17.

[308]*-Letër e KQ dërguar rretheve, mbi zëvendësimin e praktikave fetare me festat socialiste,* Ballkan, 20 mars 2007, faqe 14-15; *1967, festat fetare, si u zëvendësuan me festat socialiste*, Standard 23 dhjetor 2006, faqe 22-23; Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012, faqe 103-104.

2.3 DEKRETI PËR NDRYSHHIMIN E EMRAVE

Zakonisht prindërit preferojnë që fëmijës së tyre t'i vënë emrin e gjyshit ose të gjyshes, si dhe emrin e ndonjë shenjti sipas kalendarit ortodoks. Për shembull emrin tim e ka përzgjerdhur gjyshi Koço Llukani, "Mësues i Merituar", i cili më quajti Andre, sepse linda në shëndre (dhjetor). Pas vitit 1967, që përkon me prishjen e kishave emrat e shenjtorëve u kufizuan. Më kujtohet rasti i një kolegu nga Durrësi, babai i të cilit bënte jesë në grupin e të krishterëve të fshehtë dhe ndonëse u përpoq shumë që djalit ti vinte emrin Vlash, ata të gjendjes civile ia quajtën Lash[309].

Qytetarët shpesh reagonin ndaj presionit që u ushtrohej nga nëpunësit e zyrave të Gjendjes Civile, duke pretenduar se emri që dëshironin ti vinin fëmijës nuk kishte lidhej me fenë, por me persona familjarë shumë të dashur për ta. Ata dëshironin të trashëgonin emrin e gjyshit ose të gjyshes te fëmija i porsalindur. Duke parë se qytetarët nuk qenë të vendosur për ta ndërprerë këtë traditë, në vitin 1975 regjimi ateist nxorri një ligj të posaçëm, me anën e të cilit ndalonte nëpunësit[310] e zyrave të Gjendjes Civile të regjistronin fëmijët e porsalindur me emra të papërshtatshëm nga ana ideologjike, politike dhe etike[311].

Në ato vite lulëzuan emrat Artan, Farbardh, Alban, Arben, Kujtim, Dritan, Drita, Shpresa, Shpëtim, Lulëzim etj. Disa prindër u vinin fëmijëve emra të vendeve gjeografike ose emra kafshësh dhe shpendësh, si për shembull Luan, Shqipe, Shpend, Gjelosh, Skifter etj, të cilët tipizonin bukuri ose trimëri. Për shkak të marrëdhënieve të mira që kishim me vendet e kampit socialist prindërit filluan t‘u vinin fëmijëve emra ideologjikë, duke abuzuar tej mase politikisht dhe estetikisht. Shumë fëmijë në atë kohë u quajtën Marks, Engels, Lenin, Stalin, Mao, Tito, Molotov[312], Dimitrov, Kirov, Zhukov etj. Gjithashtu gjeje emra të tillë si Aksion, Buletin, Divizion, Federatë, Festival, Asamble, Republika etj. Në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë kam njohur një grua, e cila quhet Asamble. Ajo është e bija e Pandi Kristos, një grua fisnike dhe shpresëtare. Emrin Asamble[313] ia ka vënë vetë diktatori Enver Hoxha, sepse lindi në ditën që u mbajt Asambleja Kushtetuese.

---

[309]-Andrea Llukani, *Onomastika e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2012, faqe 3.

[310]-Në nenin 3 të dekretit nr. 5339, datë 23.09.1975 "Mbi ndërrimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm" është shkruar: Nëpunësi i gjendjes civile nuk lejohet të regjistrojë lindjen e fëmijës, së cilës deklaruesi kërkon t’i verë emër të papërshtatshëm në vështrimin politik, ideologjik e moral. Me kalimin e afatit 30 ditor, regjistri i lindjeve bëhet, me vendim të këshillit popullor ose komitetit ekzekutiv të fshatit të bashkuar, të qytetit dhe për Tiranën me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të lagjes, ku kanë vendbanimin prindërit, duke i vënë fëmijës një emër të përshtatshëm.

[311]-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Ngjallja, shtator 2019, faqe 9.

[312]-Molotov ka qenë emri i studiuesit dhe poligrafit Moikom Zeqo. Sipas thënieve të tij në gjetjen e emrit të përshtatshëm Moikom ka ndikuar Ismail Kadare. Madje edhe sot e kësaj dite shokët e fëmijërisë e thërresin Tovi.

[313]-Andrea Llukani, *Onomastika e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2012, faqe 4.

Në vitin 1975 doli dekreti për ndryshimin e emrave të papërshtatshëm. Dalja e këtij dekreti i futi në punë nëpunësit e gjendjeve civile. Ata u urdhëruan të kontrollojnë nëpër regjistra gjithë emrat e mbiemrat e papërshtatshëm. Kështu mjaft emra me përmbajtje fetare[314] u zëvendësuan me emra të përshtatshëm. Regjimi komunist e kuptoi që me vënien e emrave ishte abuzuar shumë, prandaj nxori dekretin Nr. 5339, datë 23.09.1975 "Mbi ndërrimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm". Me qëllim që të ruheshin dhe të forcoheshin traditat kulturore përparimtare në mbështetje të nenit 58, pika 6 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë vendosi që: Shtetasit që kanë emra të papërshtatshëm në vështrimin politik, ideologjik e moral si edhe mbiemra përçmues, detyrohen t'i ndërrojnë[315]. Kërkesa për ndërrimin e emrave të papërshtatshëm dhe të mbiemrave përçmues dhe zgjedhja e emrit dhe e mbiemrit të ri bëhej nga vetë i interesuari dhe për fëmijët e mitur, nga prindërit. Që nga ajo kohë emrat filluan të ndërroheshin, duke u zëvendësuar me emra të përshtatshëm. Fëmijëve që lindnin duhej tu vinin emra historikë[316] si Kreshnik, Ylli, Drita, Lumturi etj. Ndërrimi i emrave të papërshtatshëm dhe i mbiemrave përçmues përfundoi më 31 dhjetor 1976[317].

Megjithatë, të krishterët shpresëtarë filluan të përdornin shkurtimet e emrave[318], të cilët nuk qenë në listën e emrave të patërshtatshëm. Në Shqipëri janë shumë emra fshatrash, të cilët kanë emra shenjtorësh të krishterë: Shënvlash, Shijak, në rrethin e Durrësit; Shëmri, Shëngjergj, Damjan, Shëngjin, në rrethin e Tiranës; Shënpjetër, Marinëz, në rrethin e Fierit; Theologo në Sarandë; Shmil në Çermenikë; Shënepremte në Gramsh; Shënvasil në Delvinë; Shirgj në Obot, Shirgjan dhe Shijon në Elbasan, Shëngjin në Lezhë; Shëngjergj në Nikaj; Shënlli dhe Shlli në Mat; Panaja në Vlorë; Shënllesh në Reç; Shënpal, Shtoder në Mirditë; Shënanu; Shëngjergj në Cakran; Shënkollas në Bilisht. Gjithashtu kemi emrat: Abat, Bozhiq, Domën, Kishaj, Manastirec, Metoq, Panahor, Papaj, Pashkashesh, Popçisht, Protopapë, Qelëz,

[314]-Disa nga emrat me përmbajtje fetare janë: Agjërim, Altar, Anxhelo, Dom, Kler, Kristostom, Kësmet, Hyjnesh, Hyjnor, Hajmali, Hazrete, Mevlud, Mevlude, Mëshirë, Pagëzime, Parajsë, Patër, Perëndi, Shëngjergj, Shëngjergje, Shemrije, Tito, Trini, Thellogo, Uratë, Xhami, Xhamije, Xhenet, Xhenete, Yjneshë, Yjnore etj. Kastriot Dervishi, *Fjalori i emrave të papërshtatshëm në Shqipëri*, 55, 9 shkurt 2012, faqe 17.

[315]-*Çaste nga persekutimi ateist*, Ngjallja, shkurt 2019, faqe 9.

[316]-Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë 2004, faqe 390.

[317]-Kastriot Dervishi, *Fjalori i emrave të papërshtatshëm në Shqipëri*, 55, 9 shkurt 2012, faqe 16, 17.

[318]-Disa nga shkurtimet e emrave janë: për emrin *Aleksandër* shkurtimet janë Aleks, Lekë, Leksi, Leko, Sandri; për emrin *Anastas*, Nasi, Tasi, Tase, Tasho, Taskë, Stasi, Caci, Cace, Caco; për emrin *Athanas* shkurtimet janë Thanas, Nase, Nasi, Naçi, Nasho, Nako, Naku; për emrin *Gjergj* shkurtimet janë Jorgo, Jorgaq, Xhoxhi, Gaqi, Gaqe, Gogo, Gjikë, Gaqo, Gjokë; për emrin *Dhimitër* shkurtimet janë Mitër, Mitrush, Taqo, Miti, Dhimo, Dhimash, Miço; për emrin *Joan* kemi shkurtimet Jovan, Jani, Janko, Janaq, Naqi, Nako, Nani; për emrin *Kostandin*, kemi shkurtimet Kosta, Ndini, Koço, Koçi, Kosti, Kostaq, Kushi; për emrin *Mihal* kemi shkurtimet Miho, Milo, Mile, Malo, Mikel, Misha, Keli, Mëhill, Hill; për emrin *Nikollë* kemi shkurtimet Kola, Koli, Kolec, Niko, Nika, Llaqi; për emrin *Petro* kemi shkurtimet Pjetër, Petër, Pepe, Pero, Peço, Prenk, Guri; për emrin *Thoma* kemi shkurtimet Thomo, Çome, Shomo, Tomë, Toma etj. Thimi Mitko, *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, Vol. III, Instituti i Folklorit, Tiranë 1962, faqe 32-33.

Qishbardhë, Gjinikas, Donofrosë, Gjokaj, Gjinaj, Lekaj, Lazarat, Lekas, Marian, Menkulas, Martanesh, Varvarë etj[319]. Pas vitit 1967 disa nga fshatrat që kishin emra shenjtësh për tu fshirë nga kujtesa e besimtarëve ndryshuan emrin. Rasti më flagrant është fshati Shënvlash, që mori emrin Vrinë.

2.4 PASOJAT E PËRNDJEKJES

Si pasojë e përndjekjes u sheshuan rreth 608 kisha ortodokse, ndërsa të tjerat u kthyen në ofiçina mekanike, magazina, stalla, salla kinemaje apo klube[320]. U shkatërruan me qindra ikona dhe afreske, u dogjën libra liturgjikë kishtarë, enët e shenjta u sekuestruan dhe u përvetësuan, veshjet e klerikëve u përdhosën. Kisha iu nënshtrua ikonoklazmës, e cila ishte hartuar nga inkuizitorët komunistë. Pothuajse të gjitha manastiret u shkatërruan ose u kthyen në reparte ushtarake[321].

Rreth viteve 1950 manastiri i Zvërnecit u vu në dispozicion të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke u kthyer në vend internimi për elementët antiparti[322]. Me interesimin e Theofan Popës kisha e "Fjetjes së Hyjlindëses" është shpallur monument kulture[323] në vitin 1963.

Më 1962 u mbyll kisha e "Aleksandër Nevskit"[324] në Shkodër. Mbi truallin e kishës u ndërtua Shtëpia e Oficerëve. Në Korçë, më 1960 punonjësit e Pallatit të Kulturës patën kërkuar shtetëzimin e kishës katedrale të "Shën Gjergjit" me preteksin se kisha qe dëmtuar si pasojë e tërmetit, që ra në maj të vitit 1960. Në fakt qenë dëmtuar vetëm dy këmbanoret e larta si dhe një pjesë e kubesë. Kisha e Shën Gjergjit u rrafshua[325] tërësisht në vitin 1971. Blloqet e kishës[326] u përdorën për ndërtimin e stadiumit të lojrave me dorë. Një vit më vonë të rinjtë korçarë i dërguan një peticion selisë së peshkopatës, ku i kërkonin shpronësimin e kishës së "Profetit Ilia"[327], me preteksin e parkut që do të ndërtohej aty. Këshilli Kishtar me në krye Stavro Kanxherin e kundërshtuan këtë veprim. Megjithatë në qershor 1962 Këshilli Kishtar ia dorëzoi kishën Bashkimit të Rinisë së rrethit. Të moshuarit e asaj kohe i propozuan drejtuesve të pushtetit, që kishën të mos e rrafshonin, por ta kthenin në klub për

[319]-Andromaqi Gjergji, *Reflekse të krishterimit në kulturën popullore*, Tempulli, Nr. 4, Korçë 2001, faqe 10-12.

[320]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 171; Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

[321]-Janë rreth 100 kisha ose manastire ortodokse që janë kthyer në reparte ushtarake. Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 6.

[322]-Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*, Instituti i Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2015, faqe 47-51.

[323]-Mbrojtja e monumenteve, Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë, 1974, faqe 53; *Trashëgimia Kulturore akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2003, faqe 86.

[324]-Spiro Mëhilli, *Ndalimi i fesë: Stalini rrafshoi katedralet, Enveri u vuri dinamitin*, Telegraf, 23 shkurt 2011, faqe 18.

[325]-*Kisha e shkatërruar e Shën Gjergjit, Korçë*, Ngjallja, dhjetor 2016, faqe 10.

[326]-Arben Gjata, *Kisha e Shën Gjergjit*, Tempulli, Nr. 8, Korçë 2003, faqe 14-15.

[327]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1156, viti 1961, fl.7.

pensionistët. Në vitin 1970 kishës iu bënë ndërhyrje arkitektonike, duke ia prishur harqet e dritareve. Kisha e "Profetit Ilia" u kthye në pijetore. Pjesa e shenjtërores u përdor për makineritë e telekomit[328]. Në maj të vitit 1964 u prish kisha e "Shën Mërisë"[329] në Korçë. Ndërtesa e Mitropolisë së Korçës[330] vazhdoi të funksionojë deri në vitin 1967 kur u sekuestrua[331].

Në vitin 1963 mbi karabinanë e kishës së "Shën Mërisë së Pazarit" në Përmet u ndërtua Pallati i Kulturës së qyetit të Përmetit. Në ceremoninë e inagurimit të Pallatit të Kulturës ka marrë pjesë edhe Kryeepiskopi Paisi Vodica[332]. Muret mbajtës të kishës deri në një farë lartësie u ruajtën të paprekura, por u shkatërrua pjesa e sipërme e tyre. U mbyllën dritaret dhe hyrjet ekzistuese të kishës dhe u hapën dritare dhe hyrje të reja. Pjesa që u prish nga muret e kishës u shtua rreth dy metra me tulla të kuqe. Megjithë ndërhyrjet kanë mbetur format origjinale të ndërtimit të kishës. Në lartësinë e murit perëndimor mund të shquhet forma e kambanerisë[333]. Kisha “Fjetja e Shën Mërisë”[334] në Peshtan, pas vitit 1967 u shkatërrua dhe u kthye në stallë bagëtish. Gjithashtu në vitin 1967 u gremis edhe kisha e “Shën Thanasit” në Peshtan[335].

Në shënimet e tij atë Marko Papajani thotë se më 25 maj 1960 në Kryesinë e Kishës u zhvillua një mbledhje, në të cilën Kryeepiskop Paisi u komunikoi vendimin e qeverisë në lidhje me prishjen e kishës së "Shën Prokopit" në Tiranë. "...*meqenëse*

---

[328]-Arben Gjata, *Kisha e Profetit Ilia*, Tempulli, Nr. 10, Korçë 2005, faqe 16.

[329]-Arben Gjata, *Kisha e Fjetja e Hyjlindëses së Përmbishenjtë Mari*, Tempulli, Nr. 4, Korçë 2001, faqe 25.

[330]-Mësuesit e shkollës "7 Nëntori" të urdhëruar nga Komiteti i Partisë mblodhën nxënësit dhe hynë në kishën e Mitropolisë. Aty grumbulluan ikona, libra dhe objekte kishtare, të cilat i dogjën në sheshin para Mitropolisë. Madje detyruan një nxënës që dikur vishej me stoli çdo të lielë në kishë për të vënë zjarrin. Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

[331]-Në vitet 1988-1989 ndërtesës iu bë një rikonstruksion, sepse përdorej si shkollë ku përgatiteshin kuadrot e Partisë së Punës. Arben Gjata, *Mitropolia e Korçës dhe ndërtesa e saj*, Ngjallja, Tetor 2002, faqe 4.

[332]-Apostol Kotani, *Ndërtimi i Pallatit të Kulturës me miratimin e mitropolitit të qytetit dhe të këshillit kishtar*, Sot, 1 nëntor 2013, faqe 12.

[333]-Muret e kishës janë të ndryshëm nga ata të Pallatit të Kulturës si nga gjerësia ashtu edhe nga materialet e përdorur për ndërtimin e tyre. Gjithashtu edhe ekzistenca e harkut të pjesës lindore të kishës përbën faktin kryesor të ruajtjes së skeletit të kishës me gjithë transformimet e bëra. Kostandinos Gjakumis, Joan Stratobërdha, *Kisha e Lindjes së Hyjlindëses tek Pazari i Përmetit*, Tempulli, Nr. 9, Korçë, 2004, faqe 27.

[334]-Andrea Llukani, Erion Prifti, *Peshtani, rrënjë të thella në traditën ortodokse*, Ngjallja, qershor 2001, faqe 10.

[335]-Interesante është historia e kambanës së kësaj kishe. Pas vitit 1967 kambana u hoq nga kisha dhe përfundoi në fshatin Luftinjë, ku e përdornin për të mbledhur anëtarët e kooperativës. Në vitet e demokracisë me prishjen e sistemit kooperativist kambana u hoq nga pema ku kishte qëndruar e varur për shumë vjet. Kambanën e mori Hajro Latifi dhe e ruajti në shtëpinë e tij. Në vitin 1995 besimtari i devotshën Llukan Stavro u interesua dhe e gjeti kambanën, duke e sjellë në Tepelenë. Pasi e mbajti ca kohë në shtëpinë e tij ai e dorëzoi kambanën tek autoritetet kishtare të Tepelenës. Kambanës i mungojnë dy veshë nga katër që ka pasur dikur. Gjithashtu i mungon edhe pjesa metalike, që godiste kambanën për lëshimin e tingullit. Mbi kambanë gjendet mbishkrimi: *Industria shqiptare, Korçë, Spiro V. Naçe. Kambana e Katundit Peshtan Tepelenë 17.4.1938*. Llukan Stavro, Vasil Rrapi, *Toponimet e Peshtanit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2009, faqe 37.

në këtë vend tashti i thonë kodra e "Dëshmorëve të Kombit", vend në të cilin ndodhet edhe kisha, parashikohet që të bëhet një park i madh për kryeqytetin me liqenin artificial, kopshtin zoologjik, ambiente të tjera sportive dhe për dëfrime, hotele, bufera etj....me një fjalë kisha e "Shën Prokopit", nuk mund të qëndrojë më në atë vend, ku është ndërtuar dhe aq më tepër që do të bëhet më shumë vend dëfrimi dhe hareje, se sa vend faljeje, gjë kjo që e humbet kuptimin e adhurimit e faljes.... ". Më 20 tetor 1960 u hartua akti zyrtar i shpronësimit dhe menjëherë filloi zbrazja e kishës nga orenditë. Të gjitha objektet e shenjta, si ikonat, veshjet klerikale, disko-potirat, triqerët etj, u shpunë në kishën e "Ungjillëzimit". Froni dhespotik gjithashtu u vendos në kishën e "Ungjillëzimit"[336]. Në mars të vitit 1965 për shkak të planit urbanistik të qytetit u prish kisha e "Ungjillëzimit" në Tiranë. Mbi truallin e kishës u ngrit hoteli pesëmbëdhjetë katësh për të shuar njëherë e përgjithmonë kujtimin e kishës. Ndërsa më 21 mars 1965, u bë shenjtërimi i kishës së "Ungjillëzimit"[337] në Tiranë. Kisha u ndërtua nga ndërmarrja "21 Dhjetori" me shpenzimet e shtetit si kompensim i kishës me të njejtin emër që u prish nga plani rregullues i qytetit. Madje, Komiteti Ekzekutiv u urdhërua që të ndërtonte edhe selinë e kryesisë së kishës. Kisha u kthye në palestër ku stërviteshin gjimnastët e klubit sportiv "17 Nëntori"[338].

Në Elbasan, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit, Miti Rapo, me preteksin për të shmangur sëmundjen e brucelozës, më 3-4 qershor 1964 nuk lejoi të zhvillohej panairi në manastirin e Shën Gjon Vladimirit. Jo vetëm besimtarët nuk u lejuan të shkonin, por edhe personeli i manastirit nuk u lejua të meshonte[339]. Në vitin 1948 Instituti i Shkencave shpalli një listë paraprake me monumentet e kulturës që mbroheshin nga shteti[340]. Ndërmjet tyre ka qenë edhe manastiri i Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Ndonëse vendimi i Rektoratit të Universitetit të Tiranës i vitit 1963 e përfshiu kishën e manastirit të Shën Gjon Vladimirit në listën e monumenteve, që mbroheshin nga shteti, megjithatë në vitin 1967, manastiri i Gjon Vladimirit u kthye në repart ushtarak. Në ambientet e konakëve të manastirit kanë qenë rezervat e shtetit.

---

[336]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij,* Neraida, Tiranë 2004, faqe 55-60; Andrea Llukani, *Historiku i kishës së Shën Prokopit,* Le Radici, Anno 15, n.3, Giugno 2017, pagina 17.

[337]-Shenjtërimi i kishës së "Ungjillëzimit të Hyjlindëses" në Tiranë u bë me pjesëmarrjen e Kryeepiskop Paisit, Mitropolitit të Gjirokastrës Damjanit, Mitropolitit të Beratit Qirillit dhe të Episkopit Stefan Lasko. Gjithashtu mernin pjesë ikonom Marko Papajani, ikonom Thanas Grapshi, saqellar Petro Doçi etj. Besimtarët të paraprirë nga klerikët bënë tre litani dhe u futën në kishë, ku u zhvillua shërbesa e shenjtërimit. Projekti i kishës së re u realizua nga ing. Skënder Luarasi.

[338]-Atë Marko Papajani në kujtimet e tij ka shkruar për mbylljen e kishës së "Ungjillëzimit" në Tiranë: "Më datën 20 mars 1967 në mbrëmje kisha u mbyll, ndërsa më 7 prill 1967 u rihap duke i kryer rregullisht shërbesat për tu mbyllur përfundimisht më 31 maj 1967". Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij,* Neraida, Tiranë 2004, faqe 41-44.

[339]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1228, viti 1964, faqe 2; Melsi Labi, *Gjon Vladimiri, princi që u bë shenjt,* MHK, Tiranë, 2015, faqe 64-65; Melsi Labi, *Joan Vladimir, the prince that became saint,* MHK, Tirana 2016, page 71-72.

[340]-*Mbrojtja e monumenteve*, Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë, 1974, faqe 25; *Trashëgimia Kulturore akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2003, faqe 68.

Më shkurt të vitit 1967 të rinjtë durrsakë, të nxitur nga Komiteti Qendror i Partisë, duke zbatuar dekretin "Për luftën kundër fesë dhe paragjykimeve fetare" iu drejtuan manastirit të shën Vlashit[341]. Përfundimisht ata i vunë kazmën manastirit, duke e shkatërruar atë plotësisht[342]. Manastiri u kthye në repart ushtarak. Gjithashtu për ta shuar nga kujtesa e popullit emrin e manastirit, ia ndërruan emrin fshatit nga Shënvlash në Vrinë.

Manastiri i Llëngës në rrethin e Pogradecit në vitin 1948 është shpallur monument kulture[343], por me prishjen e kishave në vitin 1967 në mjediset e manastirit u vendos një repart ushtarak dhe vite më vonë zyrat e ndërmarrjes pyjore[344].

Në vitin 1967 një grup të rinjsh nga Fieri shkuan për të shkatërruar manastirin e Ardenicës, por ai u mbrojt prej Imzot Irine Banushit[345], i cili ndodhej i internuar në Ardenicë. Vendosja e repartit ushtarak në të i solli mjaft dëme. Konakët e manastirit u kthyen në depo dhe gazerma ushtarake[346]. Përsëri me ndërhyrjen e Imzot Irineut, manastiri u shpall monument kulture në mbrojtjen e shtetit. Meritë ka edhe teologu Theofan Popa, i cili në atë kohë punonte në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe kontribuoi mjaft për ruajtjen e kishave. Rreth vitit 1988-89 manastiri u hap si qendër turistike, ku kisha shërbente si muze, ndërsa godinat rrethuese të tij si bar, restorant, hotel, madje edhe disko.

Kisha e "Shën Kollit" në Elbasan në vitin 1980 u prish nga themelet dhe në truallin e saj u ndërtua një pallat banimi.

Më 14 korrik 1964 Kryeepiskopi Paisi Vodica i ka dërguar një letër kryetarit të Këshillit të Ministrave, shokut Mehmet Shehu, me anën e së cilës e vinte në dijeni mbi disa ngjarje që kishin ngjarë nëpër kishat dhe manastiret e Shqipërisë[347].

---

[341]-Më 2 shkurt 1967, që përkonte me të kremten e Ipapandisë rinia durrsake u drejtua për në Shën Vlash, ku u organizua një takim me banorët. Në takim u hodh ideja e kthimit të manastirit në qendër kulturore-shëndetësore. Fshatarët nuk e pranuan një gjë të tillë dhe pati edhe përleshje fizike. Disa persona u arrestuan dhe gjyqi iu bë në mjediset e shkollës Naim Frashëri. Madje nxënësit u vunë në rolin e prokurorit. Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 57-58.

[342]-Dhimitër Qosja, *50 vjet nga stuhia ateiste që u përpoq të shkatërronte besimin*, Ngjallja, shkurt 2017, faqe 1.

[343]-*Trashëgimia Kulturore akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë, 2003, faqe 79.

[344]-Gjergji Gusho, *Mbi përhapjen e krishtërimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit*, Pogradec 2000, faqe 111-118.

[345]-Irine Banushi u tha gjimnazistëve: “Historia nuk do të na e falë. Ky manastir nuk ka vetëm vlera fetare për kombin tonë, por edhe historike, pasi në 10 maj të vitit 1451 në manastir janë kurorëzuar heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti me Donikën”. Të rinjtë dhe mësuesit e tyre u bindën dhe manastiri shpëtoi nga shkatërrimi. *Irine Banushi-martir i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, nëntor 2018, faqe 9; Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 7.

[346]-Naun Kule, *Rrëfimet e Ardenicës*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1999, faqe 87.

[347]-Kryeepiskopi e vinte në dijeni Kryeministrin për një ngjarje të shëmtuar që kishte ndodhur ditën e Pashkës së vitit 1964 në Berat, ku disa policë u futën në altar dhe donit të arrestonin priftin me preteksin se i kishte rënë kambanës në orë jo të përshtatshme. Episkopi i Beratit erdhi në Tiranë dhe i raportoi Komitetit për Çështjet Klerikale. Në Divjakë është thirrur prifti nga sekretari i organizatës

Në Mitropolinë e Gjirokastrës manastiret e Dragotit, Cepos[348], Pepelit, Vanistrës etj., kanë shërbyer si reparte ushtarake. Madje manastiri i Dragotit vazhdon edhe sot e kësaj dite të shërbejë si pikë e grumbullimit të makinave të sekuestruara nga policia e shtetit[349]. Ndërkohë që një numër i konsiderueshëm i kishave u shkatërruan nga themelet: Kisha e Hyrjes në Tempull të së Tërëshenjtës, në Përmet, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës, në Delvinë, kisha e Shën Harallambit, në Sarandë, kisha e Fjetjes të së Tërëshenjtës, në Dhivër, kisha e Shën Gjergjit, në Tepelenë, kisha e Shën Athanasit, në Lukovë, kisha e Shën Dhimitrit, në Nivicë, kisha e Shën Jorgjit, në Kranë, kisha e Shën Athanasit, në Piqeras, kisha e Shën Donatit, në Vagalat, kisha e Shenjtorëve Anargjendë, në Grazhdan, kisha e Shën Nikollës, në Sminec, kisha e Lindjes së Tërëshenjtës, në Pogon, kisha e Metamorfozës së Zotit, në Biovizhdë, kisha e Shën Nikollës, në Zhepë, kisha e Profetit Ilia, në Draçovë, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës, në Kanikol, kisha e Shën Nikollës, në Strëmbec, kisha e Ipapandisë, në Gjinkar, kisha e Lindjes së Tërëshenjtës, në Badëlonjë, kisha e Shën Joan Prodhromit, në Lëshnicë, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës, në Grabovë, kisha e Shën Athanasit, në Peshtan, kisha e Shën Nikollës, në Kodër, kisha e Shën Nikollës në Paleokastër, kisha e Shën Athanasit në Mashkullorë, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës në Hundëkuq, Kisha e Shën Parashqevisë në Karjan, kisha e Shën Nikollës në Kakoz, kisha e Shën Parashqevisë në Dhoksat, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës në Këllëz, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës në Qestorat, kisha e Shën Minait në Tranoshishtë, kisha e Shën Nikollës në Stegopul, kisha e Shën Parashqevisë në Suhë, kisha e Trinisë së Shenjtë në Peshkëpinë e Poshtme, kisha e Taksiarkëve në Kakavi, kisha e Shën Athanasit në Dropull, kisha e Shën Nikollës në Haskovë, kisha e Fjetjes së Tërëshenjtës në Krioner të Dropullit, kisha e Shën Nikollës në Llongo të Dropullit, kisha e Shën Nikollës, në Krongo, kisha e Shenjtores Parashqevi, në Kostar, kisha e Shën Nikollës, në Memoraq, kisha e Shën Markut, në Rumanxa, kisha e Shenjtores Parashqevi, në Marafendi, kisha e Shenjtores Sofia, në Durmish, kisha e Shenjtorëve Theodhorë, në Qesarat, kisha e Trinisë së Shenjtë, në Komati, kisha e Shenjtores Parashqevi, në Shënandrea, kisha e Shën Vasilit, në Çaush, kisha e Shën Athanasit, në Eleftherohor, kisha e Shenjtores Parashqevi, në Mavropullo, kisha e Shën Vlashit, në Karahaxh, kisha e Trinisë së Shenjtë, në Shënvasil, kisha e Shenjtores Sofia, në Çorraj, kisha e Shën Jorgjit, në Metoq, kisha e Shën Nikollës, në Xarrë, etj[350].

---

bazë të partisë dhe në prani të kryetarit të këshillit popullor është urdhëruar të mos i bjeri më kambanës dhe të mos meshojë në kishën kryesore. Një ngjarje tjetër e shëmtuar ka ndodhur në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Dashnor Mamaqi i shoqëruar nga një oficer policie i quajtur Qerim Muka kanë hyrë në kishë dhe u tallën me sendet e shenjta dhe klerikët. Madje Dashnor Mamaqi e pyeti priftin: -Përse vijnë gratë këtu që të mbarsen? Jo, u përgjigj prifti. Ato mbarsem me burrat e tyre, këtu vijnë vetëm për tu lutur. Në fshatin Vrakë të rrethit të Shkodrës fshatarët shpërthyen dyert e kishës dhe e bënë hambar për të futur bereqetin.....Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Dosja Nr. 1228, viti 1964, fl.1-2.

[348]-Engjëll Serjani, *Përtej gurit të lartë të manastirit të Cepos,* "Shqip", 21 mars 2008, faqe 28.

[349]-Engjëll Serjani, *Lugina e Drinos, vendi i shenjtëruar i manastireve,* Shqip, 21 gusht 2014, faqe 21.

[350]-*Kisha të shkatërruara të Mitropolisë së Hirshme të Gjirokastrës*, Ngjallja, dhjetor 2014, faqe 4.

Në Mitropolinë e Beratit nga furtuna e egër ateiste e vitit 1967 janë prishur këto kisha: Kisha e Shën Dhimitrit në Berat[351], që ishte dhe kisha katedrale e qytetit, kisha e Shën Kollit në Sinjë, kisha e Shën Kostandinit dhe Helenës në Kondas, kisha e Shën Thanasit në Vërtop, kisha Fjetja e Hyjlindëses në Mbreshtan, kisha e Shën Sotirot në Konezbaltë, kisha e Shën Pjetrit dhe Pavlit në Poshnjë[352].

2.5 PROPAGANDA ATEISTE

Më 2 mars 1946, në Drejtorinë e Shtypit dhe Propagandës pranë Ministrisë së Shtypit, Propagandës dhe Kulturës Popullore, u krijua një komision, i cili u jepte "leje qarkullimi" librave të botuar deri në atë kohë në Shqipëri, si dhe atyre që vinin nga jashtë. Në përbërje të komisionit qenë Mahmut Meqemeja, punonjës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vasil Llazari, punonjës i Ministrisë së Kulturës, Dhimitër Shuteriqi, nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Flamur Nishani, punonjës i Mesagjerisë së Shtypit. Më 2 mars 1948 Gjykata e Rrethit të Tiranës, ndaloi qarkullimin e mbi 155 titujve, të cilët kishin përmbajtje "të dëmshme për popullin" dhe qenë kundra frymës së re demokratike. Tek titujt e ndaluar qenë edhe shumë libra fetarë. Ndërsa më 27.02.1950, Presidiumi i Kuvendit Popullor nxorri vendimin nr. 1150 për bllokimin e të gjitha llibrave të botuar apo të hyrë në Shqipëri përpara 29 nëntorit të vitit 1944. U lejua vetëm kalendari fetar, i cili botohej në shtypshkronjën shtetërore "Mihal Duri" në Tiranë.

Në prill të vitit 1945 Ministria e Arsimit lëshoi një qarkore, me anën e së cilës theksonte se mësimi i fesë nëpër shkolla nuk ishte i detyrueshëm. Gjithashtu mësuesit e fesë nuk do të ishin pjesë e stafit pedagogjik dhe pagesa e tyre do të bëhej në bazë të orëve të mësimdhënies nga komitetet ekzekutive. Disa muaj më vonë u miratuan tekstet që do të përdoreshin. Nuk kaloi shumë kohë dhe më 27 mars 1946 Ministria e Arsimit urdhëronte heqjen e mësimit të fesë dhe zëvendësimin e tij me lëndën e "Darvinizmit" dhe atë të "Njohuri të Marksizëm-Leninizmit", ndërsa më 6 qershor 1946 Këshilli i Ministrave me anën e një dekreti të posaçëm urdhëronte mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore fetare[353]. Dihet se për përgatitjen e kuadrit fetar Kisha Ortodokse ka pasur dy seminare[354]. Gjithashtu kohë pas kohe ka pasur botime të

[351]-Ksenofin Ilia, *Kishat e Beratit*, Ombra GVG, Tiranë 2006, faqe 57.

[352]-Kastriot Dervishi, *Kishat e shkatërruara orthodhokse në Mitropolinë e Beratit*, Kërkim, Nr. 15, Tiranë 2017, faqe 82-91.

[353]-Pirro Kondili, *Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste*, Ngjallja, gusht 2007, faqe 3-4; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1455, viti 1947, fl. 1.

[354]-Në vitin 1930 në Tiranë ka funksionuar seminari "Apostull Pavli", i cili u mbyll në vitin 1944 për mungesë fondesh. Fillimisht cikli i studimeve në seminar ishte për një periudhë 5-vjeçare, ndërsa duke filluar nga viti 1936 cikli i studimeve qe 8-vjeçar. Shkollimi në seminar ishte i kombinuar me Gjimnazin e Shtetit të Tiranës, ku kryheshin lëndët e kulturës së përgjithshme. Seminari ka qenë një shkollë e arsimit të mesëm me programme të miratuara nga shteti dhe kisha. Diploma që merrej në seminar njihej si brenda edhe jashtë vendit. Seminaristët kishin uniformën e tyre: rason dhe skufjen e zezë në kokë, ndërsa kur shkonin në gjimnaz vishnin kostum dhe kapele me strehë. Lëndët që zhvilloheshin në seminar qenë: Histori e Dhiatës së Vjetër, Histori e Dhiatës së Re, Katekizëm,

ndryshme periodike[355], me anën e së cilave informonte grigjën rreth zhvillimeve liturgjike, dogmatike dhe historike në qerthullin ortodoks. Për të çliruar popullin nga besimi fetar dhe zakonet prapanike, Partia e Punës ka zhvilluar një fushatë të gjerë propagandistike shkencore ateiste me anë të artikujve në shtyp, botimeve të librave me përmbajtje ateiste, emisioneve radiofonike etj[356].

Në vitin 1962, sektori i kulturës së partisë, i cili drejtohej nga Nexhmije Hoxha ndërmorri shpërndarjen e literaturës antifetare, të shoqëruar me një sërë botimesh me përmbajtje ateiste si p.sh: Hulusi Hako, *Feja e parë nën dritën e shkencës* (1962), Arif Gashi, *Parajsa dhe ferri* (1963), *Feja është opium për popullin* (1964), *Shkenca dhe feja* (1964), Ulvi Vehbiu, *Hipnoza dhe feja* (1964), *Darvinizmi dhe feja* (1967), *Feja lakuriq* (1967), Mina Qirici, *Çudirat e fesë* (1967), *Dom Lleshi dhe Zigur Efendiu* (1967), Zihni Sako, *Populli dhe feja* (1967), Sotir Melka, *Shkenca dhe feja janë të papajtueshme* (1968), *Dëmet e riteve dhe festave fetare* (1967), Hulusi Hako, *Akuzojmë fenë* (1968), *Gruaja dhe fëmija - viktimat më të ndjeshme të ideologjisë fetare* (1968), Ulvi Vehbiu, *Të ruajmë shëndetin: Sëmundjet psihike dhe feja* (1968), Sami Leka, *Biseda mbi fenë dhe dijen* (1970), Hulusi Hako, *Gjyq Zotit* (1972), Iljaz Gogaj, *Mbi rolin reaksionar të klerit në fushën e arsimit 1878-1939* (1972), Arif Gashi, *Lufta kundër fesë është luftë për formimin e njeriut të ri* (1974),

---

Shpjegim Ungjilli, Histori e Kishës, Patrologji, Dogmatikë, Moral, Apologjetikë, Omilitikë, Kurs pastoral, Arkeologji Biblike, Shpjegim meshe, Tipiko, Muzikë bizantine, Muzikë moderne. Ndërsa në Gjimnazin e Shtetit qenë këto lëndë: Gjuhë shqipe, Stilistikë-Letërsi, Aritmetikë, Gjeometri, Psikologji, Edukatë, Histori natyre, Fizikë, Shëndetësi, Histori politike, Gjeografi, Bujqësi, Gjuhë greke, Gjuhë frënge, Gjuhë italiane, Gjimnastikë. Cikli mësimor zhvillohej sipas programit, paradite në gjimnaz dhe pasdite në Seminar. Drejtor i Seminarit "Apostull Pavli" nga viti 1935-1944 ka qenë Dhimitër Beduli. Në vitin 1938 në qytetin e Korçës u çel seminari "Jovan Banka", i cili funksiononte me fondet e bamirësit Jovan Banka. Seminari "Jovan Banka" ka funksionuar deri në vitin 1941. Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 32; Kristofor Beduli, *Shkollat Teologjike-Hieratike*, Neraida, Tiranë 2001, faqe 15-21.

[355]-Një përmbledhje për periodikët e Kishës Ortodokse. Më 1 mars 1930 doli numri i parë i revistës së përdyjavshme "Kisha Ortodokse Shqiptare". Kjo revistë botohej në qytetin e Korçës, sepse në atë kohë ishte rezidenca e Kryesisë së Kishës. Me transferimin e zyrave të Kryesisë së Kishës nga Korça në Tiranë më 27 korrik të vitit 1930 revista u botua përsëri, por me emrin "Kisha Kombëtare". Administrator – Redaktor i kesaj reviste ishte V. Xhaxhka. Këtë rradhë ishte revistë e përjavshme dhe botohej në shtypshkronjën "Dielli" në Tiranë. Në vitin 1933 Seminari Kombëtar "Apostull Pavli" nxori revistën e përdyjavshme "Predikimi", e cila shtypej në shtypshkronjën "Gutenberg" në Tiranë. Kryeredaktor i kësaj reviste ishte Dhimitër Beduli, i diplomuar në Seminarin e Besarabisë, ndërsa përgjegjës ishte Kryesekretari i Mitropolisë Kristo Camberi. Nga artikujshkruesit kryesorë të revistës "Predikimi" mund të përmendim teologët Dhimitër Beduli, Irine Banushi, Theofan Popa, Mihal Ekonomi etj. Kohëzgjatja e kësaj reviste ishte shtatë vjet. Në mars të vitit 1940 K.O.A.Sh-i botoi revistën e përmuajshme "Jeta Kristiane". Kjo revistë shtypej në shtypshkronjën "Gutenberg" në Tiranë. Drejtor Përgjegjës i kësaj reviste ishte Kryedhjakon Petro Doçi. Revista "Jeta Kristiane" u botua deri më tetor të vitit 1944. Kristofor Beduli, *Botimet periodike të kishës sonë,* Ngjallja, tetor 1998, faqe 3,4; Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992, faqe 33.

[356]-*Çaste nga persekutimi ateist*, Ngjallja, shkurt 2019, faqe 9.

Hulusi Hako, *Ateizmi shkencor* (1983), Hamit Beqja, *Lufta për shkollën ateiste shqiptare* (1984), Edlira Çela, *Tradita afetare të popullit shqiptar* (1991) etj[357].

Në një takim që pati me intelektualët e Tiranës në tetor 1962 diktatori Enver Hoxha e trajtoi fenë si të papajtueshme me shkencën. Ai e cilësonte fenë si burimin e të gjitha zakoneve prapanike[358]. Propaganda ateiste u shtua. Në vigjile të të kremteve fetare Radio Tirana transmetonte emisione me përmbajtje ateiste[359], që drejtoheshin nga Sevet Pëllumbi. Ky fakt u prit me indinjatë nga besimtarët ortodoksë, të cilët e cilësuan atë si propagandë të kundërligjshme. Në vitin 1964 disa pedagogë të filozofisë i kërkuan një takim Foto Çamit, i cili në atë kohë punonte si specialist në sektorin e propagandës në Komitetin Qendror të PPSh-së. Qëllimi i takimit ishte që të ngrihej një grup pune për përgatitjen e një libri mbi propagandën ateisto-shkencore. Kështu u mundësua hartimi dhe botimi i librit "Feja është opium për popullin", ku trajtoheshin tema të përshtatura nga literatura sovjetike dhe aspak të ilustruara me shembuj nga realiteti shqiptar[360].

Më 27 shkurt 1967, Enver Hoxha u drejtoi një letër komiteteve të partisë në rrethe "Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare", me anën e së cilës i porosiste që të bindnin çdo njeri se "feja është opium për popullin"[361].

Masat kundër fesë duhej që të saksionoheshin edhe ligjërisht. Me anën e dekretit nr. 4337, datë 13.11.1967 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, u shfuqizuan të gjitha dekretet që aprovonin veprimtarinë fetare në vend dhe Shqipëria u shpall shteti i parë ateist në botë, që ndalonte çdo shprehje të besimit.

Në shtypin e kohës u botuan artikuj të shumtë, me anën e të cilëve demaskohej feja dhe klerikët. Ja disa prej tyre: "Feja na ka gënjyer tërë jetën", botuar tek revista "Shqiptarja e re", Nr. 4, viti 1967, "Populli gjithmonë ka qenë ateist", botuar në gazetën "Puna", 28 mars të vitit 1968, "Mbi paragjykimet fetare në krijimin e familjes së re", botuar në gazetën "Zëri i Popullit", 13 mars 1969, "Fakte që

[357]-Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Tiranë 2012, faqe 16-17.

[358]-Porosia e Enver Hoxhës ishte e prerë: "Qëndrimi ndaj fesë për komunistët ishte çështje parimore. Çdo komunist duhet të jetë ateist, sepse botëkuptimi fetar është i papajtueshëm me botëkuptimin marksist-leninist, që përbën bazën ideologjike të partisë sonë. Prandaj, kjo çështje nuk mund të lihet pa u vënë re dhe pa u ndalur. Në radhë të parë këtu është fjala për ti edukuar komunistët, për ti zhveshur nga çdo paragjylim e besim fetar, për ti kalitur të kapërcejnë çdo lëkundje, çdo nënshtrim për hir të "zakonit", të "traditës familjare" etj., nëpërmjet kritikës parimore e shoqërore në organizatat e partisë. Lëkundja ndaj besimeve fetare është shfaqe e oportunizmit ndaj ideologjisë reaksionare, prandaj dhe nuk pajtohet me figurën revolucionare të komunistit". Enver Hoxha, *Kundër fesë dhe zakoneve prapanike kërkohet një punë e organizuar*, në Enver Hoxha, Vepra, nr. 23, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1977, faqe 237; *Raport informativ për rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e saj të mëtejshëm*, Ngjallja, mars 2018, faqe 5.

[359]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr.1165, fl.10-11.

[360]-Leonard Veizi, *Si u ngrit propaganda komuniste në luftën e egër kundër besimeve fetare*, Metropol, 2 dhjetor 2007, faqe 16; Leonard Veizi, *Projektet "anti-Zot" të Ramiz Alisë*, Dita, 23 mars 2005, faqe 15.

[361]-*Letër e KQ të PPSh drejtuar komiteteve të partisë të rretheve "Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare"*, në Dokumente kryesore të PPSh, vëll. V, 1966-1970, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSh, "8 Nëntori", Tiranë, 1974.

demaskojnë klerin reaksionar", botuar në gazetën "Bashkimi", 10 qershor 1973, etj[362].

Më 11 maj të vitit 1971, në Tiranë u zhvillua një miting madhështor për miqësinë shqiptaro-kineze. Afrimi me Kinën komuniste shënoi kinezërimin e jetës së brendshme në Shqipëri, sipas modelit të revolucionit kinez. Kina ishte i vetmi aleat i Shqipërisë në atë kohë[363]. Në vitin 1972 diktatori Enver Hoxha mbajti nga Mati një fjalim propagandistik, i cili më pas u shoqërua me masa ndëshkuese. Sipas historianit Kastriot Dervishi masat e marra qenë si pasojë e fjalimit të udhëheqësit kinez Mao Ce Dun, më 16 maj 1966 "Mbi revolucionin kulturor në Kinë". Masat që u morën në këtë drejtim qenë: kufizimi i televizioneve të huaja, ndalimi i mbajtjes së mjekrës dhe flokëve të gjatë etj, pasi të gjitha këto vinin në kundërshtim me moralin socialist. Me imitimin e revolucionit kulturor kinez drejtuesit komunistë filluan një luftë intensive me anën e fletërrufeve, për të diskretituar klerikët dhe njerëzit që vazhdonin të kryenin ritet fetare në fshehtësi. Gjatë kësaj kohe u shkatërruan shumë objekte kulti[364].

Më 9 qershor të vitit 1973 në qytetin verior të Shkodrës u çel "Muzeu Ateist", i cili ishte në axhendën e delegacioneve të huaja[365] që vinin në Shqipëri. Kushtetuta e vitit 1976 saksionoi me ligj të posaçëm: "Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah propagandën ateisto-shkencore"[366]. Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë ku feja dënohej me ligj. Në nenin 55 të Kodit Penal të Republikës Pupullore Socialiste të Shqipërisë çdo lloj forme e ushtrimit të besimit dënohej me heqje të lirisë nga tre deri në dhjetë vjet[367].

2.6 PERSEKUTIMI I KLERIT

Dora e egër ateiste rëndoi fuqishëm mbi klerin ortodoks, duke shtuar vazhdën e krimeve të regjimit komunist. Klerikët u zhveshën, u burgosën[368] dhe u internuan, gjithashtu mjaft prej tyre u martirizuan. Numri i klerikëve ortodoksë që janë ekzekutuar ose kanë vdekur nga torturat apo janë burgosur e internuar arrin në rreth 42

[362]-Kastriot Dervishi, *Kur kërkohej krijimi i një feje komuniste,* 55, 25 tetor 2005, faqe 12-13.

[363]-*Çaste nga persekutimi ateist,* Ngjallja, shkurt 2019, faqe 9.

[364]-Kastriot Dervishi, *Fjalimi që solli revolucionin kulturor kinez në Shqipëri,* 55, 5 shkurt 2007, faqe 16-17.

[365]-Udhëtimet turistike qenë organizuar sipas të njenjtit shabllon. Në fillim vizitohej uzina e traktorëve në Tiranë, muzeu ateist në Shkodër, kombinati i çelikut në Elbasan etj. Rune Ottosen, *Turist në utopi,* Skanderbeg Books, Tiranë 2018, faqe 7.

[366]-Më 18 dhjetor 1976, Kuvendi Popullor miratoi Kushtetutën, e cila përforcoi mitin ideologjik të socializmit ideal. Sipas Kushtetutës së re shteti nuk njihte asnjë fe dhe përkrahte e zhvillonte propagandën ateiste për të rrënjosur në ndërgjegjen e njerëzve konceptin shkencor-materialist të ndërtimit të botës. Ligj Nr. 5506, datë 28.12.1976, Kushtetuta e Republikës Socialiste të Shqipërisë, neni 37; Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë 2004, faqe 400-401.

[367]-*Kodi Penal të Republikës Pupullore Socialiste të Shqipërisë*, 1 tetor 1977, neni 55.

[368]-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri,* Argeta LMG, Tiranë 2000, faqe 171.

persona[369]. U burgos Visarion Xhuvani[370] (Fig.1) (Fig.2) (Fig.3) në maj të vitit 1947 dhe u lirua në nëntor 1962. Kristofor Kisi u izolua në kishën e Shën Prokopit në gusht 1948 dhe vdiq në mënyrë misterioze (i helmuar) në qershor 1958. Irine Banushi (Fig.4) u dënua dy herë gjatë viteve 1946-1948 dhe 1956-1960 dhe më pas u internua[371] në manastiret e Shën Gjonit, Shën Vlashit e të Ardenicës. Atë Gjergj Suli, nga Lekli i Tepelenës (Fig.6) u ekzekutua më 14 janar 1948; atë Aleks Lipe[372], nga Kaludhi i Përmetit u ekzekutua më 1946; atë Kostandin Bozdo[373], nga Koshovica e Dropullit u dënua me vdekje më 30 shtator 1964; atë Nikolla Kalojani, nga fshati Fanar i Vurgut u ekzekutua në vitin 1969; atë Jani Kutilla, nga Himara u ekzekutua në prill 1968 etj. Disa klerikë kanë vdekur në burgjet dhe internimet e regjimit monist: atë Sotir Konomi, nga Mursia e Sarandës; atë Evangjel Boçi, nga Çarshova e Përmetit, vdiq gjatë procesit hetimor në dhjetor 1967; atë Kristo Papa, nga Sopiku i Sarandës ka vdekur në burgun e Burrelit më 1951; atë Mina Konomi, nga Zhepa e Përmetit, ka vdekur në burg më 1948; atë Theodhori Guli, nga Sotira e Dropullit është arrëstuar në vitin 1947 dhe ka vdekur në burgun e Burrelit; atë Jani Dashi, nga Çuka e Sarandës, ka vdekur gjatë viteve të internimit; atë Stavro Rexho, nga Dhivri i Sarandës, ka

[369]-Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione,* Ngjallja, mars 2017, faqe 6.

[370]-Gjatë 15 vjetëve të dënimit në Burgun e Burrelit, ndonëse në moshë të thyer Mitropoliti Visarion qëndroi me burrëri. Ja si e përshkruan Visarionin shkrimtari Agim Musta në librin "Mandelat e Shqipërisë". *-Nuk kisha veçse dy javë që ndodhesha në burgun e Burrelit, kur një mbrëmje dallova në sfondin e korridorit një njeri me raso të zezë, fytyrë dhe flokë të bardhë si dëbora, një Abat Faria i gjallë, që ecte i kërrusur nga pesha e viteve dhe e vuajtjeve.* Gjatë kohës së qëndrimit në burg, besimtarët dhe të afërmit druheshin të shkonin për vizitë te Visarioni, por kishte edhe nga ata që duke marrë parasysh të gjitha pasojat i shpinin ushqime, si për shembull papa Kozmai i Bestrovës dhe besimtari Vangjel Manushi. Kur doli nga burgu në vitin 1962 Visarioni ishte në moshën 75-vjeçare. Njeriu që iu gjend në këto momente kritike ishte Atë Erazmi Jorgo, i cili u kujdes për të duke i dhënë veshjet e veta klerikale. Në vjeshtën e vitit 1962 Visarioni u vendos në manastirin e Shën Gjonit, në Elbasan, ku kaloi vitet e fundit të jetës së tij, derisa vdiq më 15 dhjetor 1965. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 77; Andrea Llukani,*Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse,* "55", 21 maj 2004, faqe 18; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 259; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 259.

[371]-Irine Banushi vdiq më 25 nëntor 1973 pas një sëmundje të gjatë diabet-turbekuloz, që e pati marrë gjatë viteve të burgut dhe të internimit. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 77.

[372]-Atë Aleks Lipe është ekzekutuar më 4 korrik të vitit 1946 pas një gjyqi ushtarak. Ai u akuzua për një numër të madh fajesh, të cilat qenë vetëm inskenime të komunistëve. Kleriku Aleks Lipe ishte njeri me autoritet në Përmet, prandaj shihej me sy të keq nga regjimi komunist. Atë e akuzuan si "agjent i italianëve, gjermanëve dhe grekëve". Në predikimet e tij Atë Aleksi kritikonte ideologjinë komuniste, prandaj u quajt armik dhe duhej ekzekutuar. Lekë Tasi, *70 vjet më parë Atë Alek Lipe i ekzekutuar nga diktatura*, Kërkim, Nr.15, Tiranë 2017, faqe 67-70.

[373]-Atë Kostandin Bozdo ka lindur në fshatin Koshovicë, më 1902. Në vitin 1942 u hiroronis prift nga Mitropoliti i Gjirokastrës dhe shërbeu në fshatrat Koshovicë, Sofratikë, Selo dhe Klishar. Pasi kishte punuar shumë vjet me përkushtim Atë Kostandini mori ofiqin Stavrofor dhe u caktua përgjegjës i manastirit të Trinisë së Shenjtë së Pepelit. Më 30 shtator 1964 u dënua me vdekje, nën akuzën e tradhëtisë ndaj atdheut dhe u ekzekutua. *At Kostandin Bozdo,* Ngjallja, mars 2005, faqe 8.

vdekur në burgun e Burrelit më 1959; atë Petro Draçova, nga Rrëza e Përmetit është burgosur më 1946 dh eka vdekur gjatë viteve të vuajtjes së dënimit; atë Ligor Zografi, nga Korça është arrestuar më 1967 dhe ka vdekur gjatë procesit hetimor.

Klerikë të tjerë janë burgosur dhe më pas janë internuar: atë Jorgo Papa Taçi, nga Leshnica është arrestuar më 1947 dhe vuajti 10 vjet burg; atë Dhimitër Jatru, nga Grazhdani i Rrëzës së Sarandës është burgosur më 1946 dhe ka bërë 10 vjet burg; atë Theodhori Mitsiniko, nga Cerkovica e Rrëzës së Sarandës; atë Vasil Sini, nga Pepeli është arrestuar më 1946 dhe ka bërë 6 vite burg; atë Theodhos Papa, nga Cerkovica është arrestuar më 1968 dhe ka bërë 15 vite burg; atë Jani Nini, nga Kosina është arrestuar më 1952 dhe u dënua me afate të gjata burgimi[374].

Përgjegjësi kryesor i kësaj situate ka qenë Enver Hoxha, i cili mban përgjegjësi të plotë për pushkatimin[375] e 250 klerikëve shqiptarë dhe për burgosjen e 500 të tjerëve, ndërkohë që familjet e tyre u internuan dhe u përndoqën pa mëshirë. Lufta kundër fesë ishte porosi e Stalinit, të cilën Enver Hoxha e zbatoi me shumë fanatizëm. Ndonëse Çërçilli dhe Rusvelti e këshilluan që të tregohej më i matur me fenë, Enver Hoxha ndërseu komunistët që të shpiknin akuza të inskenuara për eleminimin e klerikëve[376].

Në një raport të vitit 1958 mbi aktivitetin e klerikëve në rrethin e Përmetit ndër të tjera thuhet: "Nga ana e klerit dhe e besimtarëve është zhvilluar aktivitet armiqësor me agjitacion dhe paropagandë dhe për të mbajtur pozitat e vjetra dhe influencën e fesë....Më aktiv nga përpunimet që ndjekim sot në drejtim të klerit ortodoks është atë Nasi, i cili ka zhvilluar agjitacion e propagandë kundër pushtetit dhe kolektivizimit të bujqësisë, por me rezervë"[377].

Ndërkohë që Sigurimi i Shtetit në rrethin e Përmetit kishte në kontroll operativ dy klerikë. Aktiviteti i tyre kontrollohej nga gjashtë bashkëpunëtorë të sigurimit. Midis bashkëpunëtorëve qenë edhe dy klerikë. Në planin e masave të sigurimit qenë këto drejtime kryesore: "Të vëmë në përpunim atë Janin, si njeri që paraqet interes për organet tona. Meqenëse do të bëhen zgjedhjet e këshillit kishtar, të studiojmë dhe me anë të B.P që kemi në radhët e klerit, të influencojmë që të zgjidhen në këto këshilla njerës të mirë. Të marrim masa për të shfrytëzuar më mirë agjenturën e sektorëve të tjerë në drejtim të klerit për të kontrolluar aktivitetin armiqësor që bëhet nën maskën e fesë. Të krijojmë një evidencë të plotë të njerëzve që janë marrë dhe merren me punë nëpër kisha e qendrat e faltoreve, të cilat nën këtë maskë mund të zhvillojnë aktivitet armiqësor që ndërlidhen me agjentë të zbulimeve të huaja etj"[378].

---

[374]-*Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990),* Ngjallja, dhjetor 2014, faqe 3-4.

[375]-*Si i pushkatuan 250 klerikët Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu,* Albania 9 mars 2005, faqe 10-11.

[376]-*Pas klerikëve, Enver Hoxha diskriminoi pakicat kombëtare,* Albania, 9 mars 2005, faqe 11.

[377]-Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur, (Përmeti 1943-1990),* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2016, faqe 370-371; Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 32, viti 1958, fl.12.

[378]-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 74, viti 1960; Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur, (Përmeti 1943-1990),* Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2016, faqe 372.

Dosja e atë Gjergj Sulit

Gjergj Suli (1893-1947) ka lindur më 12 mars 1893 në fshatin Lekël të Tepelenës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa arsimin e mesëm e përfundoi në gjimnazin "Zosimea" të Janinës. Në vitin 1922 emigroi në Amerikë, ku punoi për 12 vjet në Boston dhe Filadelfia. Atë Gjergji ishte veprimtar i shquar i Shoqërisë "Vatra" dhe kishte miqësi të ngushtë me Imzot Theofan Nolin[379]. Në vitin 1934 u kthye në Shqipëri, për të mbajtur lidhjet midis Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe asaj të diasporës. Gjithashtu shërbeu si klerik në fshatrat e zonës: Lekël, Labovë, Tërbuq, Hundkuq, Kodër, Peshtan etj. Të gjithë e donin dhe e respektonin, sepse atë Gjergji ishte i pjekur dhe i arsimuar. Me kulturën që zotëronte dinte t'i fitonte zemrat e njerëzve. Ai fliste disa gjuhë të huaja si greqisht, anglisht e italisht. Predikimet që bënte At Gjergj Suli me zërin e tij të ëmbël e melodioz, ndiqeshin me shumë dëshirë nga të krishterët. Kur predikonte atë Gjergji në Peshtan, te hajati i Shën Thanasit vinin edhe myslimanët për ta dëgjuar dhe për të dëgjuar këshillat e tij. Ishte njeri shumë i thjeshtë dhe i komunikueshëm me fshatarët e çdo moshe, sidomos me të rinjtë. Pas meshës bisedonte shtruar me popullin, duke u dhënë mendime të vlefshme për hallet që preokuponin fshatin. Nëpër gosti atë Gjergj Suli merrte këngëve që i ngrinte vetë. Në repertorin e këngëve të tij labçe bëhej fjalë për bukuritë e natyrës dhe për patriotët e dëgjuar të lëvizjes sonë kombëtare.

Shokë, seç na mori malli
Për një degë dunicë mali.
O shokë, malli ç'na mori
Për në Peshtan, nga Shën Kolli;
Atje ku prehet gjatori.
Gjatori me gjithë langua,
Ujët e ftohët në krua.
Ku këndojnë ata bilbila?!
Në Peshtan, atje në Vila.
Ku këndon qyqez e prillit?!
Në Peshtan te lule blirit.

Vendosja e regjimit komunist e vuri në shënjestër edhe atë Gjergjin, sepse kishte qenë në Amerikë dhe mbante korrespondencë me patriotët shqiptarë të

[379]-At Gjergj Suli shkoi në Amerikë më 3 prill 1912, i ndihmuar nga familja Duri. Më 1917 e gjer në fund të Luftës së Parë Botërore shërbeu në ushtrinë amerikane. Më 1919 mori pjesë në shoqërinë "Vatra" dhe u dallua si veprimtar i shquar i saj. Më 1922 zgjidhet sekretar i "Vatrës" për Degën e Filadelfiasë. Në qershor 1922 dorëzohet prift nga Peshkopi rus i Nju Jorkut Platoni dhe shërbeu në disa kasha: në Shën Elia të Jomestovnit, gjer më 29 nëntor 1929; në Shën Koll të Southbridge, 8 dhjetor 1929 deri më 30 shtator 1930; në Shën Pjetër e Pavël të Filadelfias, 1 tetor 1930-1934. Ai merrej me korin dhe me mësimin e fëmijëve të emigrantëve shqiptarë. Të gjitha këto veprimtari të larmishme e njohën nga afër me Fan Nolin, i cili i çmonte cilësitë e At Gjergjit si prift i zoti, organizator i shkëlqyer, aktivist i shquar i " Vatrës" në shërbim të atdheut dhe pedagog i aftë në punën me fëmijët. Lidhjet dhe korrespodencën me Fan Nolin i ruajti edhe pasi u kthye në Shqipëri më 1934. Jeta Gjergj Suli, Llukan Serafim Stavro, *At Gjergj Suli audhetar dhe klerik i shquar*, Argjiro, Gjirokastër 2014, faqe 19; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 109-110; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 151-152.

diasporës. Atë e arrestuan më 27 dhjetor të vitit 1946 me akuzën: "bashkëpunëtor i anglo-amerikanëve dhe kundërshtar i regjimit". Në gjyqin që u bë në 14 janar të vitit 1947 atë Gjergji u dënua me pushkatim[380].

Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës me Vendimin Nr. 242, date 17.11.1947 e dënoi me vdekje krahas mjaft nacionalistëve të tjerë. Gjykata e Lartë Ushtarake e Shqipërisë me Vendimin Nr. 215, datë 08.01.1948 miratoi vendimin e dënimit me vdekje të Gjykatës Ushtarake të Gjirokastrës. U pushkatua më 14 janar 1948 në Gjirokastër[381]. Kështu Lekli humbi birin e tij të dashur, Rrëza humbi një njeri të afërt e të respektuar, atdheu një patriot e intelektual të shquar dhe Kisha Ortodokse e Shqipërisë një klerik të ditur e të përkushtuar.

Xhelatët e kuq u habitën nga qëndrimi i atë Gjergjit, i cili e dorëzoi shpirtin te Perëndia duke bërë shenjën e kryqit[382]. Pushkatimi i At Gjergj Sulit më 14 janar të vitit 1948, në moshën 55-vjeçare. Askush nuk do ta harronte, edhe pse diktatura koministe s'lejonte të përmendej për të mirë emri, jeta dhe vepra e tij. Lekljotët s'i harruan krijimet dhe këngët e bukura që ai la pas. Ato i këndonin në festat familjare apo në takimet shoqërore, duke kujtuar me respekt, krijuesin e tyre, atë Gjergjin. Duke kënduar këngët e tij, lekljotët, peshtanakët dhe banorët e tjerë të Rrëzës shprehnin nderimin e dashurinë e mallin për njeriun e klerikun Gjergj Suli[383].

Persekutimi i teologut Theofan Popa

Në vitin 1954 Theofani (Fig.6) u martua me zonjën Eli Mano nga Korça[384]. Një fazë e rëndësishme për veprën e Theofanit janë vitet 1974-1980 kur ai merrej me ruajtjen e kishave dhe të manastireve që gëzonin statusin monument kulture. (Fig.7) Në këtë kohë ai punoi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës. Falë kulturës së lartë teologjike që e zotëronte me kompetencë, Theofan Popa ka bërë mjaft studime rreth artit mesjetar shqiptar, të cilat i ka botuar kryesisht në Buletinin e Shkencave

[380]-Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 259; Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007, page 259.

[381]-Me Vendimin Nr. 242, datë 17.11.1947 të Gjykatës Ushtarake Gjirokastër, është dënuar me vdekje për krijim organizate antikomuniste. Pushkatuar më 14.01.1948. Dëshmi: Me Vendimin Nr. 242,datë 17.11.1947 të Gjykatës Ushtarake Gjirokastër, At Gjergj Suli, i biri i Jakovit dhe i Vashos, vjeç 54, lindur dhe banues në Lekël, Tepelenë, me 7 vjet shkollë dhe 3 anglisht, i paraburgosur më 27.12.1946, është deklaruar fajtor për organizimin dhe veprimtarinë e tij si pjestar i organizatës. Ka ardhur në marrëveshje të plotë me armiqtë e shtetit tonë të çdo tipi të ndodhur jashtë shtetit për spiunazh, ardhur në kontakt me kriminelët e luftës duke i strehuar ata, për agjitacion e propagandë etj. Dhe në bazë të neneve 2 e 3(pikat 1;2;3;4;6;7;8;9;10;13;14) të Ligjës Nr.372, datë 12.12.1946 "Mbi fajet kundër shtetit", e dënon me vdekje. Me Vendimin Nr. 215, datë 08.01.1948 të Gjykatës Ushtarake është vendosur aprovimi i këtij vendimi.

[382]-Llukan Stavro, *At Gjergj Suli*, Ngjallja, janar 1999, faqe 9.

[383]-Jeta Gjergj Suli, Llukan Serafim Stavro, *At Gjergj Suli audhetar dhe klerik i shquar*, Argjiro, Gjirokastër 2014, faqe 20-21.

[384]-Eli ishte e bija e Nikollës, e datëlindjes 1930. Ata patën dy fëmijë, Dhimitraqi, i datëlindjes 1956 dhe Ana, e datëlindjes 1958; (Fig.8) Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 107.

Historike, që botonte Universiteti i Tiranës në atë kohë. Nga kolegët është vlerësuar si njeriu më i aftë përsa i përket artit kishtar[385].

Kolegët kishin cmirë nga puna e tij kërkimore e shkencore. Theofanin e akuzonin se shfrytëzonte detyrën shkencore për të bërë propagandë fetare. Në një mbledhje atë e pyetën: "A beson në Zot, apo jo?" Theofani iu përgjigj: "T'ju them se nuk besoj do t'ju gënjej dhe gënjeshtra nuk është në karakterin tim"[386].

Në dosjen[387] e tij ka shumë akuza të pabaza, si për shembull shfrytëzimi i punës shkencore për të bërë propagandë fetare në fshatrat ku shkonte. Në një shkresë që mban datën 27.02.1978 drejtuar Komitetit të Partisë së Rrethit dhe personalisht shokut Xhelil Gjoni, me temë: "Mbi demaskimin e Theofan Popës" ndër të tjera shkruhej: -*Theofan Popa, i biri i Dhimitrit dhe Vanthis, lindur në Elbasan, më 1914 nga familje zanatçinjsh, i paorganizuar, i padënuar, i martuar me fëmijë, me arsim të lartë, aktualisht pensionist dhe me banim në lagjen nr. 8, rruga Sami Frashëri, pallati 13, shk. 1, ap. 3. Në ngarkim të Theofanit disponojmë materiale të vërtetuara se zhvillon veprimtari armiqësore në formën e agjitacionit dhe propagandë kundër partisë dhe pushtetit popullor, si dhe në kohë e vende të ndryshme ka propaganduar pikëpamje fetare. Gjatë ndjekjes që i bëmë Theofanit rezultoi se edhe i biri i tij Dhimitri, vjeç 22, student në vitin e dytë të Institutit bujqësor, zhvillon veprimtari armiqësore kundër partisë dhe pushtetit.*

Duke parë se veprimtaria e tyre armiqësore u dokumentua me prova ligjore, vendosëm që Dhimitrin për efekt të rrezikshmërisë shoqërore ta arrestojmë, ndërsa të atin, Theofanin si moshë e kaluar ta demaskojmë. Kështu më datën 28.01.1978 pasi u arrestua Dhimitri, me porosi të Komitetit të Partisë së Rrethit, bisedues me Komitetin e partisë të Rajonit Nr. 2 dhe më datën 29.01.1978 kryesia e frontit e bllokut nr. 3, të lagjes nr. 8 organizoi demaskimin e tij. Në këtë mbledhje ishin ftuar shokë nga Instituti i Histori Gjuhësisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës si dhe disa studentë nga Instituti Bujqësor. Në mbledhje u lexua raporti që bënte fjalë për luftën e klasave, duke e konkretizuar me materialet në ngarkim të Theofanit, i cili nuk pranoi se kishte zhvilluar veprimtari armiqësore...[388].

Organizata e frontit vendosi përjashtimin e Theofan Popës nga fronti. Gjithashtu të internohet nga Tirana dhe të gjykohet nga organet e drejtësisë. Të hiqet nga lagja nr. 8, pasi ndodhet në afërsi të bllokut dhe të vendoset në një lagje tjetër.

Mënjëherë pas demaskimit publik, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë ngriti një komision të posaçëm për të shqyrtuar aktivitetin shkencor të Theofanit. Komisioni doli me raportin përkatës me temë: "Rreth veprimtarisë që ka kryer Theofan Popa për përvetësimin e materialeve arkivore shkencore dhe kishtare". Raporti është nënshkruar nga emra të njohur në fushën e historisë së asaj kohe, por për arsye etike nuk po i bëj publike. Ndër të tjera në raportin e datës 12 prill 1978 thuhej. -*Theofan Popa ka dëmtuar me qëllim arkivin shkencor të sektorit të arteve dhe veçanërisht*

[385]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 109.

[386]-Pirro Thomo, *Konseguent deri në fund në bindjet e tij,* Ngjallja, prill 2002, faqe 3.

[387]-Andrea Llukani, *Dosja e Teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 95.

[388]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 123; 124; 125.

artin kishtar shqiptar. Megjithëse i është bërë thirrje disa herë për të dorëzuar në sektor materialet arkivore shkencore: ikona, kryqe, daktilografime, përkthime, skeda, kartela, procesverbale, etj., por ai ka refuzuar. Në shtëpinë dhe bibliotekën e tij janë gjetur të vjedhura dhe të përvetësuara nga bibliotekat, nga kishat dhe institucionet fetare dhe shkencore mbi 200 libra, vepra dhe enciklopedi të ndryshme. Këto janë të ndaluara si reaksionare për të mos qarkulluar në asnjë vend. Në literaturën e gjetur të vjedhur nga vetë ai janë gjetur edhe materiale me përmbajtje reaksionare, me rrezikshmëri antisocialiste shoqërore dhe shkencore. Nuk ka dorëzuar me qëllime të caktuara materialet dhe dokumentat arkivore për të dëmtuar punën. Në kisha dhe institucione fetare ka marrë materiale me vlera në kundërshtim me urdhërin dhe rregullin dhe detyrat që i ishin dhënë për ti marrë ato me dëftesa dhe procesverbale të rregullta. Ka refuzuar për të inventarizuar dhe dorëzuar në rregull materialet e marra nga kisha dhe institucione fetare. Nuk i ka dorëzuar sektorit, drejtorisë dhe llogarisë së Institutit të Historisë regjistrat, inventarët, dëftesat, procesverbalet dhe të tjera, që përmbanin gjendjen e materialeve të marra nga kishat. Ka edukuar fëmijët e tij në kundërshtim me vijën, politikën dhe ideologjinë e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të pushtetit popullor. Nuk ka treguar drejt të dhënat biografike të jetës së tij, si rasti që ka qenë në Angli dhe të tjera. Ka mbajtur në shtëpinë dhe bibliotekën e tij literaturë, libra dhe enciklopedi reaksionare revizioniste të ndaluara e antisocialiste. Ka propaganduar ide dhe mësime fetare, të cilat janë të ndaluara me ligj në pushtetin tonë popullor. Për të gjitha këto dhe për ato që u ngritën në bllokun ku ai banon dhe në kolektivin e Institutit të Historisë del që veprimtaria e Theofan Popës është veprimtari armiqësore[389].

Në një raport të datës 10.07.1978 ndër të tjera përshkruhej gjendja shpirtërore e gruas së Theofanit, Elit, e cila pas atyre që i ndodhën qe dobësuar shumë: -*Kur ai (agjenti) e pyeti pse je dobësuar kaq shumë ajo i tha se si të mos dobësohem pas kaq fatkeqësive që na ranë mbi kokë. Dhimitraqi u arrestua dhe u dënua nga gjyqi me shtatë vjet burg, mua dhe vajzën na hoqën nga puna ku ishim dhe na caktuan punëtore krahu, Theofanin e demaskuan në mbledhjen e bllokut si propagandist fetar dhe i morën triskën e frontit dhe bibliotekën, bile blloku kishte kërkuar që ta hiqnin fare nga Tirana e ti thua përse u dobësove, bile jam shumë e fortë. Po Theofani si është e pyeti ai? Theofani mbahet më mirë se unë se ai mbështetet tek Zoti, e më jep kurajo dhe mua, megjithëse më kritikon vazhdimisht se për rrugën e keqe që kishte marrë Dhimitraqi fajtore jam unë për arsye se i plotësoja të gjitha tekat dhe nuk e kontrolloja djalin, gjë që më bën të vuaj më shumë...*[390].

Në raportin e datës 10.09.1980 agjenti ishte takuar me Theofanin, i cili i kishte folur për padrejtësitë që i janë bërë duke i arrestuar djalin. Ndër të tjera ai rrëfen: -*Arrestimin e djalit, Theofani e quajti mashtrim me anë dëshmitarësh të rremë. Por kjo do ta kalisi djalin dhe do ta pregatisi për jetën, ashtu siç ka kërkuar Theofani me bindje të krishtera dhe forcën e Zotit, i cili shfaqet dhe ndërhyn në çdo çast të jetës së*

[389]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 130;131.
[390]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 132.

përditshme dhe krijon mrekullitë e tij, që shumë nga ne nuk i kuptojmë dhe nuk i shohim....[391].

Në vitet e fundit të jetës së tij, Theofan Popa ka punuar me kohë të pjesshme në Arkivin e Shtetit. Koha e punës ishte tre orë në ditë, por Theofani nga entuziazmi që e karakterizonte punonte edhe tre orë të tjera pa pagesë. Gjatë viteve që punoi në Arkivin e Shtetit (1983-1985) Theofan Popa ka hartuar: 1-*Katalogu i kodikëve mesjetarë të Shqipërisë,* një dorëshkrim me rreth 107 faqe. 2-*Pasaporta të kodikëve të fondit 488,* një dorëshkrim me rreth 120 faqe. 3-*Miniaturat e kodikëve të Shqipërisë,* që është botuar pjesërisht. Duke u marrë me katalogimin e kodikëve, Theofan Popa ka bërë edhe identifikimin e miniaturave dhe vinjetave, që gjendeshin në to. Këta katalogë janë përgatitur nga Theofan Popa si mjet informimi arkivistik. Mbi bazën e tyre arkivistët kanë punuar për përgatitjen e pasaportave dhe inventarit të kodikëve[392]. Në inventarin e fondit 488[393] veç kodikëve janë edhe procesverbalet[394] e mbajtur për dorëzimin e kodikëve të mbledhur nga ekspeditat nëpër fshatra.

Theofan Popa ndërroi jetë më 30 dhjetor 1985 në Tiranë[395], duke na lënë imazhin e një njeriu, që gjithë jetën e tij ia kushtoi ruajtjes së vlerave të trashëgimisë sonë kulturore.

---

[391]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 134.

[392]-Shaban Sinani, *Beratinus*, Argeta-LMG, Tiranë, 2004, faqe 194.

[393]-Fondi 488 në AQSH është krijuar në vitin 1980 nga Theofan Popa. Ai është njohur publikisht edhe si fondi 888. Në AQSH ka qenë një rregull, që çdo fond kishte një numër reference për njehsim të brendshëm dhe një numër reference për citime në botime.

[394]-Procesverbal, për marrjen në dorëzim nga sh. Theofan Popa të tre kodikëve të gjetur gjatë ekspeditave nëpër fshatrat e vendit tonë, mbajtur sot, më datën 24.06.1975, në prezencë të sh. Theofan Popa, si dorëzues nga ana e Institutit të Historisë dhe të sh. Mediha Shuteriqi, si marrëse në dorëzim nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit. Iu dorëzuan shoqes Mediha, në sallën e Arkivit të Shtetit dorëshkrimet si pason: 1. Kod. (kodik) që përmban 49 omilie, me 431 fletë letre, me tekst në një kolonë, me 23 rreshta për faqe, me përmasa 21.5 cm x 15.6 cm. Kodikun e kemi gjetur në kishën e fshatit Liar të Zagorisë, në gusht të vitit 1973. 2. Kodik që përmban perikope ungjijsh, me 198 fletë pergamene, me tekst në një kolonë, me përmasa 24 cm x 15.5 cm dhe 24 rreshta për faqe. Kodiku nuk ruan as fletët fillestare, as edhe të fundit. Kodikun e kemi gjetur në kishën e Shën Mërisë të fshatit Bënjë të Përmetit. 3. Kodik kiriakodhromion ungjijsh / udhë përshkrues ungjijsh / me 293 fletë letre, me tekst në një kolonë, secila me përmasa 21 cm x 16 cm dhe me 24 rreshta për faqe, lidhur me kapakë dërrase, veshur me lëkurë. Kodikun e kemi gjetur dhe marrë nga kisha e Shën Kollit në Pogon të Gjirokastrës, më 25.08.1973. Ky procesverbal u bë në tri kopje. Një iu dorëzua shokut Theofan Popa, dorëzuesit të kodikëve, një iu dorëzua sektorit të arteve pranë Institutit të Historisë dhe një për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit. Tiranë, më 24.06.1975.

[395]-Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78.

2.8 KISHAT E SHPALLURA MONUMENT KULTURE

Persekutimi ndaj Kishës Ortodokse kishte nisur gradualisht shkallë shkallë. Kisha Ortodokse që prej vitit 1945 e deri më 1967 i është nënshtruar shtetëzimeve, konfiskimeve, me qëllim që të dobësohej ekonomikisht dhe duke u zbehur gradualisht deri në vitin 1967 që shënoi shuarjen e plotë të pasurisë kishtare[396].

Deri përpara miratimit të ligjit të Reformës Agrare të vitit 1945, komunitetet fetare administronin pronat dhe tokat e tyre, por pas miratimit të ligjit ata e humbën të drejtën e mbajtjes dhe të administrimit të pasurive, prej të cilave nxirrnin të ardhurat që u nevojiteshin. Dekretligji nr. 253, datë 27 maj 1946 e uli sipërfaqen e pronave të komuniteteve fetare deri në 10 hektarë[397].

Në vitin 1955 të gjithë manastiret që funksiononin në atë kohë në Shqipëri kishin rreth 550 dynymë tokë. Manastiret e Shën Kozmait dhe Ardenicës qenë katandisur vetëm me nga 30 dynymë tokë, ndërsa manastiri i Shën Gjon Vladimirit më 20 dynymë tokë. Varfërimi i manastireve ka ndikuar direkt në gjendjen ekonomike të kishës. Sipas një dukumenti të Kuvendit Populllor, i cili mban datën 1 janar 1967 Kisha Ortodokse kishte si pasuri të paluajtshme 600 kisha dhe tetë manastire. Këta të fundit kishin rreth 500 krerë bagëti. Gjithashtu zotëronin magazina me bereqet, bulmet, tagji për bagëtinë etj. Pranë manastireve kishte pemë frutore dhe vreshta. Ndërsa magazinat e kishave dispononin parafinë, vaj, dyllë etj.

Në vitin 1948 Instituti i Shkencave shpalli një listë paraprake me monumentet e kulturës që mbroheshin nga shteti, ndërsa në vitin 1963 Rektorati i Universitetit të Tiranës, me anën e një vendimi të posaçëm, miratoi përfundimisht listën e monumenteve në të gjithë vendin[398]. Vendimi i Rektorati i Universitetit të Tiranës i vitit 1963 hartoi listën e monumenteve, që mbroheshin nga shteti. Theofan Popa e kundërshtoi prishjen e shumë kishave, që mbanin statusin "Monument kulture". Ai gjithmonë theksoi rëndësinë e tyre për trashëgiminë tonë kulturore[399]. Së bashku me kolegët Gani Strazimiri, Aleksandër Meksi dhe Pirro Thomo arritën të shpëtonin rreth 120 kisha dhe manastire, duke u dhënë statusin e monumentit të kulturës[400]. Kishat dhe manastiret e mëposhtme ortodokse po i paraqes[401] të ndara sipas mitropolive:

1-Mitropolia e Tiranës dhe e Durrësit para vitit 1967 kishte 20 enori dhe dy manastire, ndërsa sot Mitropolia e Shenjtë e Tiranës dhe e Durrësit ka këto zëvendësi mitropolitane vendore: Tirana, Durrësi, Shkodra, Kavaja dhe Elbasani. Kishat e shpallura monument kulture të kësaj mitropolie sipas qyteteve janë: Kisha e Shën Premtes Çetë, Kavajë 1963, Bazilika e Shën Mëhillit Arapaj, Durrës, Bazilika në

[396]-Petrika Shalësi, *Dokumente që provojnë pronësi të Kishës,* Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.

[397]-Dekret-ligjë nr. 253, datë 27 maj 1946, mbi disa ndryshime të Ligjës e Shtojcë-Ligjeve të Reformës Agrare, neni, 2, 3, botuar në Gazetën Zyrtare, nr. 50, Tiranë, 4 qershor 1946, faqe 5.

[398]-Kastriot Dervishi, *Vendimi i 15 janarit 1963 i Rektoratit të Universitetit të Tiranës "Mbi shpalljen e monumenteve të kulturës",* 55, 15 gusht 2007, faqe 16.

[399]-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, nr. 3328, faqe 59.

[400]-Andi Rëmbeci, *Botime të mbishkrimeve kishtare në Shqipëri*, Kërkim, Tiranë, 2010, faqe 136.

[401]-Shënohet emri i kishës ose i manastirit dhe viti kur është shpallur monument kulture.

Kodrën e Tepes Elbasan, Kisha e Shën Joan Vladimirit Shënjon, 1948, Kisha e Shën Kollit Shelcan, 1948, Kisha e Shën Premtes Valësh, 1963, Kisha e Shën Mërisë Kala, 1963, Rrënojat e Kishës së Ungjillizimit Mjekës, 1970.

2-Mitropolia e Beratit para vitit 1967 kishte 80 enori dhe katër manastire. Mitropolia ka në juridiksion këto zëvendësi episkopale vendore: Berati, Vlora, Fieri, Lushnja. Kishat e shpallura monument kulture të kësaj mitropolie sipas qyteteve janë:

Lushnjë. Manastiri i Shën Mërisë Ardenicë, 1948, Kisha e Shën Thanasit Karavasta, 1963, Kisha e Shën Mërisë Bishqethëm, 1963, Kisha e Shën Kollit Toshkëz, 1963, Kisha e Shën Kollit Krutje e Sipërme, 1963, Kisha e Shën Todrit Kadipashaj, 1963.

Fier. Manastiri i Shën Mërisë Pojan, 1963, Kisha e Shën Kozmait dhe Shën Mërisë Kolkondas, 1963, Kisha e Shën Kollit Kurjan, 1963, Kisha e Shën Gjergjit Libofshë, 1963, Kisha e Shën Gjergjit Strum, 1970, Kisha e Shën Kollit Vanaj, 1963, Kisha e Shën Premtes Hoxharë, 1979, Kisha e Shënepremtes Sop, Rrënojat e Bazilikës së Ballshit, Bazilika A, B, C, D Bylis.

Berat. Kisha e Shën Mëhillit, 1948. Kisha e Shën Triadhës Lagjja Kala, 1948. Kisha e Shën Marisë Mbreshtan, 1979, Kisha e Shën Marisë Vllahernës Lagjja Kala, 1948, Kisha e Ungjillëzimt Kozarë, 1963, Kisha e Shën Kollit Perondi, 1963, Kisha e Shën Mitrit Debranik, 1970, Kisha e Shën Mitrit Poliçan, 1977, Kisha e Shën Todrit Lagjja Kala, 1948, Katedralja Fjetja e Shën Mërisë Kala,1948.

Vlorë. Manastiri i Shën Mërisë Zvërnec, 1963, Kisha e Manastirit të Panaiasë Dhërmi, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Mitrit Qeparo, 1963, Kisha e Marmiroit Pashaliman, 1963, Kisha e Sergjit dhe Bakut Himarë 1963, Kisha e Shën Mërisë së Athalit Himarë 1963, Kisha e Gjithshenjtorëve Himarë 1970, Kisha e shën Spiridhonit Vuno, 1963, Kisha e Ipapandisë Dhërmi, 1963, Kisha e Shën Mëhillit Vuno, 1963, Kisha e Mesodhisë Vuno, 1963, Mbeturinat e Kishës së Shën Stefanit Dhërmi, 1963, Rrënojat e Kishës së Shën Kollit Armen, 1963, Rrënojat e Kishës së Shën Ndreut Himarë, 1980, Rrënojat e kishës së Shën Gjergjit Brataj, 1980, Kisha e Shën Sotirës Vuno, 1979.

3-Mitropolia e Korçës përbëhet nga këto zëvendësi episkopale vendore: Korça, Kolonja, Leskoviku, Pogradeci. Kishat e shpallura monument kulture të kësaj mitropolie sipas qyteteve janë:

Korçë. Manastiri i Shën Prodhromit Voskopojë, 1948, Kisha e Manastirit të Shën Marisë Lubonjë, 1963, Kisha e Shën Thanasit Voskopojë, 1948, Kisha e Shën Mëhillit Voskopojë, 1948, Kisha e Shën Kollit Voskopojë, 1948, Kisha e Shën Marisë Voskopojë, 1948, Kisha e Shën Jovanit Boboshticë, 1963, Kisha e Shën Mitrit Boboshticë, 1963, Shpella e Maligradit, Kisha e Ristozit Mborje, 1948, Kisha e Shën Gjergjit Shipckë, 1963, Kisha e Shën Triadhës Lavdar i Oparit, 1963, Kisha e Shën Mitrit Bezmisht, 1970, Kisha e Shën Marisë Vithkuq, 1963, Kisha e Shën Mëhillit Vithkuq, 1963, Kisha e Shën Gjergjit Dardhë, 1970, Shpella e Shën Marisë Bezmisht, 1963, Kisha e Shëndëlliut Voskopojë, 1963.

Pogradec. Manastiri Shën Marenës Llëngë, 1948, Rrënojat e Kishës Paleokristian dhe mozaikët Lin, 1973, Rrënojat e Kishës Bizantine Lin, 1973.

4-Mitropolia e Gjirokastrës para vitit 1967, ka pasur 120 enori dhe 50 manastire. Mitropolia e Gjirokastrës përbëhet prej këtyre zëvendësive episkopale vendore: Gjirokastra, Pogoni, Delvina, Saranda, Himara dhe Përmeti. Kishat e shpallura monument kulture të kësaj mitropolie sipas qyteteve janë:

Gjirokastër. Manastiri i Shën Qirjakut dhe Julitës Dhuvjan, 1963, Manastiri i Shën Mërisë Goranxi, 1963, Manastiri i Ungjillizimit Vanishtë, 1963, Kisha e Manastirit të Shpërfytyrimit Mingul, 1963, Kisha e Manastirit të Shpërfytyrimit Çatistë të Pogonit, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Triadhës Pepel, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Ilias Jergucat, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Spilesë Tranoshisht, 1970, Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Koshovicë, 1977, Kisha e Manastirit të Shën Mëhillit Nivan, 1977, Kisha e Profet Ilias Stegopull, 1963, Kisha e Shën Mërisë në Drianos Zervat, 1963, Kisha Fjetja e Shën Mërisë Sopik, 1963, Kisha Fjetja e Shën Mërisë Zervat, 1963, Kisha e Shën Mërisë Labovë e Kryqit, 1963, Kisha e Shën Mërisë Peshkëpi e Sipërme, 1963, Kisha e Shën Mërisë Vrahogoranxi, 1963, Kisha e Shën Mërisë Derviçan, 1970, Kisha e Shën Mëhillit Mingul, 1963, Kisha e Shën Mëhillit 1963, Kisha e Shën Kollit Dhuvjan, 1963, Kisha e Shën Kollit Saraqinisht, 1963, Kisha e Shën Gjergjit Nokovë, 1963, Kisha e Shën Thanasit Poliçan, 1963, Kisha e Shën Thanasit Selo, 1977, Kisha e Shën Premtes Selckë, 1970, Kisha e Mezhanit Poliçan, 1963, Kisha Paleokristiane e Manastirit Nepravishtë, 1973, Kisha e Shpërfytyrimit 1963, Kisha e Shën Apostujve Hoshtevë, 1977, Rrenojat e Kishës së Shën Anës Derviçan, 1963, Rrënojat e Bazilikës paleokristiane Goricë, 1977, Kisha e Shënepremtes Hllomo, Kisha e Shën Mërisë Skore, Bazilika Paleokristiane Goricë, 1977.

Përmet. Kisha e Shën Premtes 1963, Kisha e Shën Mërisë Leusë, 1963, Kisha e Shën Mërisë Seran, 1963, Kisha e Shën Mërisë Kosinë, 1963, Kisha e Shën Sotirit Tremishtë, 1970, Kisha e Shën Mërisë Bënjë, 1970, Kisha e Shën Mërisë Okdunan, 1970, Kisha e Shën Dëllisë Buhal,

Sarandë. Manastiri Shën Gjergjit Demë, 1963, Manastiri Shën Mërisë Krorëz, 1963, Manastiri Shën Mërisë Kakome, 1963, Rrënojat e Manastirit të 40 Shenjtorëve, 1970, Kisha e Manastirit të Shën Kollit Mesopotam, 1948, Kisha e Manastirit të Shën Kollit Dhivër, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Mavrodhivrit Dhivër, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Thanasit Leshnicë e Poshtme, 1963, Kisha e Manastirit të Shën Triadhës Kardhikaq, 1970, Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Kameno, 1970, Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Krimanovës Piqer, 1963, Kisha e Shën Mërisë Melçan, 1970, Kisha e Shën Thanasit Pecë, 1970, Kulla e Manastirit Theollogos Cerkovinë, 1979, Kisha e Shën Gjergjit Leshnicë e Sipërme, 1963, Kisha e Shën Kollit Dhrovjan i Sipërm, 1970, Kisha e Shën Thanasit Sopik, 1963, Rrënojat e Kishës Çiflik, 1977, Rrënojat e Kishës së Kamenicës Palavli, 1970, Kisha e Shën Janit, Delvinë 2002[402].

[402]-*Trashëgimia kulturore, akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Tiranë 2003, faqe 57-100; *Mbrojtja e monumenteve*, "8 Nëntori", Tiranë 1974, faqe 18-54.

Theofan Popa ka një veprimtari të gjerë kërkimore e shkencore për evidentimin e vlerave historike të monumenteve të kulturës së popullit shqiptar. Pas ndalimit të lirisë fetare më 1967, Theofan Popa pati privilegjin që të siguronte një leje nga Universiteti i Tiranës për t'u marrë me kishat mesjetare të Shqipërisë. Ndërmjet viteve 1967-1975, Theofani u mor me grumbullimin e ikonave dhe të objekteve luturgjike kishtare, duke i shpëtuar ato nga shkatërrimi. Duke shkuar fshat më fshat dhe kishë më kishë, në shoqërinë e shoferit Ilia Nemçe[403], Theofan Popa arriti të mblidhte qindra ikona dhe objekte liturgjike kishtare. Gjithë këtë vëllim pune, sipas Pirro Thomos, Theofani e përballoi pothuajse i vetëm. Vetëm dikush që e di vendodhjen e kishave dhe në çfarë kushtesh janë mbledhur ikonat dhe objektet liturgjike, mund të çmojë punën kolosale që ka bërë Theofan Popa. Me ikonat dhe objektet liturgjike kishtare të mbledhura nga Theofan Popa[404], më 26 prill 1980, u hap Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë. Muzeu u ngrit në mjediset e kishës "Burimi Jetëdhënës". Ikonat qenë grumbulluar nga kishat e rrethit të Korçës në xhaminë e Mirahorit dhe prej aty u transportuan në mjediset e muzeut. Gjithashtu më 27 shkurt 1986, me ikonat dhe objektet liturgjike kishtare të mbledhura nga Theofan Popa u hap në Berat muzeu "Onufri". Një pjesë e madhe e ikonave, të mbledhura nga Theofan Popa, aktualisht gjendet në fondet e Muzeut Historik Kombëtar. Ikonat qenë grumbulluar fillimisht në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe në vitin 2004 kaluan në pronësi të Muzeut Historik Kombëtar[405]. Fondi i ikonave përbëhet nga rreth 700 objekte: ikona, pjesë të ikonostaseve, objekte liturgjike etj. Me ikonat e përzgjedhura nga ky fond, në vitin 1999, në Muzeun Historik Kombëtar u hap pavijoni i ikonave pasbizantine, me rreth 70 ikona[406]. Në vitin 2017 pavijonit iu shtuan rreth 20 objekte liturgjike kishtare[407].

[403]-Shoferi Ilia Nemçe në një kumtesë të mbajtur më 18 dhjetor 1999, në mjediset e Muzeut të Artit Mesjetar në qytetin e Korçës, ku u zhvillua një konferencë me temë: *Kisha përkujton në 20-vjetorin e fjetjes, birin e saj, Theofan Popa* ndër të tjera tha: *-Rreth viteve 60-të punoja si shofer i kino-filmit, duke shfaqur filma dokumentarë nëpër fshatrat e rrethit të Korçës. Ndërkohë nga sektori i kulturës të Komitetit Ekzekutiv të rrethit më ngarkojnë me detyrë të shoqëroja një studiues për të mbledhur ikonat dhe objektet kishtare nëpër kishat e zonës së Korçës. Sapo u prezantuam, unë i thashë se jam agjiorit, sepse që i vogël kam shoqëruar babanë kur punonte nëpër manastiret e Malit të Shenjtë. Që atëhere me Theofanin lidhëm një miqësi të madhe. Falë punës së tij u mblodhën dhe u shpëtuan me mijëra ikona dhe objekte kishtare, të cilat siç thoshte Theofani përbëjnë memorien historike të popullit tonë.* Ilia Nemçe, *Si u njoha me Theofan Popën*, Kumtesë në konferencën në kujtim të Theofan Popës, organizuar në Muzeun e Artit Mesjetar, Korçë më 18.11.1999.

[404]-Andrea Llukani, *Kontributi i Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Le Radici, Anno 16, n. 3, Settembre 2018, pagina 16; Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Dritëhije Nr. 1, Tiranë 2018, faqe 66-87.

[405]-Andrea Llukani, *Kontributi i teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, Le Radici, Anno 15, n. 5, Dicembre 2017, pagina 8.

[406]-Ylli Drishti, *Ikona. Koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar Shek. XIV-XIX*, Mali Pleshti, Tiranë 2017; Ylli Drishti, *Icons. Collection of the National History Muzeum, Tirana, Albania 14th-19th centuries*, Mali Pleshti, Tirana 2017.

[407]-Dorian Koçi, Andrea Llukani, *Pavijoni i ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar*, (dorëshkrim i pabotuar), Tiranë, 2018, faqe 148-159.

2.9 KISHA E NËNDHESHME

Megjithë përndjekjet e propagandën ateiste, besimi te Zoti mbeti gjallë në shpirtin e popullit. Kjo dukej me sakrificën e martirëve të shumtë klerikë e laikë, të cilët u burgosën, u pushkatuan, u përndoqën por nuk e mohuan Perëndinë. Kisha e nëndheshme funksiononte, në kushtet e një përndjekjeje nga shteti ateist. Madje, kishte prej tyre që pa marrë parasysh rreziqet e panumërta, vazhduan ta mbanin të ndezur flakën e besimit me veprime konkrete, siç ishin atë Kozmai[408], (Fig.9) i cili me Ungjillin e fshehur në një trastë të vjetër shkonte nga qyteti në qytet për të pagëzuar në fshehtësi dhe për të kryer shërbesat e shenjta. Petro Xhuveli[409] u kishte bërë katekizëm disa fëmijëve dhe priste papa Kozmanë që t'i pagëzonte në Dhërmi. Ata u pagëzuan në fshehtësi në një shtëpi të krishterë, megjithë survejimin e organeve të sigurimit të shtetit[410].

[408]-Kozma Qirjo (1922-2000) ka lindur në Bestrovë të Vlorës më 10 dhjetor 1922. Babai i tij quhej Jorgji ndërsa e ëma Zoica. Pasi përfundoi shkollën në Nartë u mor me punë të ndryshme. Më 25 prill të vitit 1945 u hirotonis dhjak nga Imzot Visarioni, në Kishën e "Shën Vlashit" në qytetin e Vlorës. Po atë vit më 29 prill u dorëzua në gradën priftërore në Kishën e "Shën e Dielës" në Nartë. Atë Kozmai ishte famulltar në Kishën e "Pesë Martirëve" në Bestrovë, ku ka shërbyer deri në mbylljen e kishave, në shkurt të vitit 1967. Pas kësaj punoi si punëtor, në ullishtë për 14 vjet, por në fshehtësi nuk i ndërpreu për asnjë çast Shërbesat e Shenjta, jo vetëm në Vlorë, por edhe në qytete të tjera, si në Korçë, Tiranë etj, ku ishte në lidhje të ngushta me të gjithë ata besimtarë që guxuan të sfidonin ateizmin e imponuar të shtetit komunist. Gjatë viteve të persekutimit ateist (1967-1991) ka pagëzuar në fshehtësi rreth 3000 besimtarë nga e gjithë Shqipëria. Hapjen sërish të kishave në vitin 1991 ai e priti me gëzim të madh, duke falenderuar nxehtësisht Perëndinë, që i dha mundësinë të rivishte rrobën e nderuar të klerikut ortodoks. Ardhja e Fortlumturisë së Tij, Imzot Anastasit, ishte një moment i shënuar jo vetëm për rimëkëmbjen e shpejtë të ortodoksisë shqiptare, por edhe sepse i dha mundësinë të jepte përvojën e tij, sa në seminar aq edhe në Këshillin e Përgjithshëm Kishtar etj. Më pas u bë Ikonom Stavrofor dhe gjatë gjithë këtyre viteve ka qenë zëvendës episkopal për Dioqezën e Beratit. Më 23 korrik ai u hirotonis Episkop i Apollonisë. Episkop Kozmai fjeti më datën 12 gusht të vitit 2000. Shërbesa e përmortshme u zhvillua në Kishën e "Shën Todrit" në qytetin e Vlorës, me pjesëmarrjen e Kryeepiskopit Anastas, Mitropolitit të Beratit, Ignati, Imzot Joanit, klerikëve të zonës dhe besimtarëve të shumtë. Episkop Kozmai u varros në fshatin e lindjes, Bestrovë, pranë hierores së kishës së "Pesë Martirëve". At Spiro Bulika, *Bariu i mirë (Episkop Kozmai),* botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2005, faqe 60-62.

[409]-Petro Xhuveli (1909-1999) ka lindur më 1909 në Qeparo, ku mori edhe mësimet e para. Në vitin 1919, në moshën dhjetëvjeçare, vëllai i tij i madh Epaminonda e mori në Athinë ku përfundoi gjimnazin e djemve në vitet 1926-1928. Më pas ai u diplomua për mësues dhe që nga viti 1928 punoi në arsim derisa doli në pension më 1960. Gjatë mësimdhënies në fshatrat e rrethit të Vlorës ai u njoh me atë Kozmain nga Bestrova, Koço Fështin, Theofan Popën etj, të cilët i ndihmonte me përkthimet që bënte nga greqishtja. Që nga viti 1950 dhe deri sa ndërroi jetë Petro Xhuveli ka përkthyer rreth 70 libra fetarë, nga të cilët vetëm njëri mundi ta shohë dritën e botimit në vitin 1997 në Athinë. Ky libër titullohet "Jeta e Përjetshme". Në vitet e lirisë fetare Petrua ushtroi detyrën e epitropit në manastirin e Shën Dhimitrit dhe në kishat e fshatit Qeparo. Gjithashtu ai ishte psalt e predikues dhe zhvillonte mësimet e katekizmit me fëmijët. Ndërkohë vazhdoi punën me përkthimet dhe artikujt që i botoi në gazetën "Ngjallja". Duke punuar gjithë jetën për Perëndinë, Petro Xhuveli ndërroi jetë më 7 maj 1999. Vasil Kaskadami, *Mësuesi i Qeparoit,* Ngjallja, qershor 1999, faqe 11; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 232.

[410]-Atë Spiro Bulika, *Xha Petroja nga Qeparoi,* Ngjallja, korrik 2002, faqe 9-10.

Motrat Cico[411] nga Korça, (Fig.11) të cilat e kishin kthyer shtëpinë e tyre në një kishë të vogël, luteshin vazhdimisht. Theofan Popa kontribuoi në shpëtimin e shumë sendeve të shenjta dhe të ikonave. Koço Fështi[412], Vangjel Plepi dhe Petro Zheji[413] vazhduan të ndiqnin në fshehtësi shërbesat fetare dhe të pagëzonin fëmijët e tyre tek atë Kozmai. Një nga të pagëzuarit në fshehtësi është edhe Joan Pelushi[414],

[411]-Motrat Cico. Dhimitra Cico lindi në vitin 1911 në qytetin e Korçës në një familje shprestare. Që në fëmijëri u edukua me frikë Perëndie, duke ia kushtuar jetën Krishtit. Dhimitra së bashku me të motrën Marikën në vitin 1939 qenë nismëtaret për krijimin e korit të kishës së Shën Gjergjit në Korçë. Motrat Cico e kishin kthyer shtëpinë e tyre në një manastir të vërtetë. Aty mblidheshin gratë dhe bënin lutje të gjata. Motra Dhimitra u fliste për jetë shenjtorësh dhe të vërtetat e besimit ortodoks. Rihapjen e kishave Motrat Cico e pritën me gëzim të madh. Shtëpia e tyre u kthye në qendër kishtare për qytetin e Korçës. Ato së bashku me gratë shprestare luteshin ditë e natë sa herë që kisha jonë kalonte vështirësi. Motër Dhimitra fjeti më 21 shtator 1996, ndërsa Marika më 26 mars 2005. Kjo e fundit arriti që të bëhej murgeshë duke marrë emrin Marjam. Protoprezviter Jani Trebicka, *Një jetë e kushtuar Perëndisë*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 2; Berta Dhimitri, Motra jonë e dashur Dhimitra, Ngjallja, tetor 1996, faqe 2.

[412]-Koço Fështi (1916-2005) ka ka lindur në Peshtan më 1916. Ai ka qenë nga besimtarët më të devotshëm të Kishës Ortodokse. Në vitet e persekutimit të kishës, Koço mbante lidhje me të krishterët e fshehtë si atë Kozmain, Petro Xhuvelin, Dhimitër Bedulin, Joan Pelushin, Theofan Popën, motrat Cico etj. Zoti Fështi ka qenë nga nismëtarët e hapjes së Kishës Katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë. Ai u zgjodh në këshillin e parë kishës, ku me përvojën e tij modeste dha një ndihmesë shumë të çmuar. Kujtimi i Koço Fështit do të mbetet përjetë në zemrat e besimtarëve të Kishës Katedrale të Ungjillëzimit, si imazhi i njeriut të urtë dhe të ditur, që ulej gjithnjë në karrigen e parë nga krahu i djathtë dhe psalte me shpirt troparet e Liturgjisë Hyjnore. Besimtari Koço Fështi që në rininë e tij, e kishte mësuar përmendësh Liturgjinë Hyjnore. Koço Fështi jo vetëm që predikonte fjalën e Perëndisë kudo ku shkonte, por afroi në kishë mjaft bashkëfshatarë të tij, si për shembull Erion Priftin, Andrea Llukanin dhe Kristo Kumen. Në qerthullin ortodoks Koço Fështi gëzonte respekt të veçantë, jo vetëm përsa i përket ngritjes së tij teologjike, por sepse ishte shumë i njerëzishëm dhe korrekt. Më 30 tetor 2005 besimtari i devotshëm Koço Fështi me origjinë nga Peshtani i Tepelenës, fjeti përgjithmonë më Zotin në moshën 90-vjeçare. Andrea Llukani, *Nismëtarët*, Tiranë 2005, faqe 61-62.

[413]-Petro Zheji ka qenë një intelektual disident, që nuk pajtohej me regjimin. Që në vitet e rinisë, Petros iu mohua e drejta e ushtrimit të profesionit. Pasi e lanë ca kohë pa punë, më pas e detyruan të punonte si përkthyes me normë. Atë e syrgjynosën në burg dhe në psiqiatri, ku vetëm për hir të Zotit ia doli mbanë të mbijetonte. Petro ka përkthyer këto vepra *Kristologjia, Hyrje në alegoritën, Don Kishotin, Vitet e zemërimit, Zoti president, Papa jeshil* etj. Kontributi i tij për gjuhën shqipe është shumë i çmuar. Nga librat e tij në lëmin e gjuhësisë përmendim *Sanskrinishtja dhe shqipja, Gjuhët e vjetra dhe shqipja, Gjuhët moderne dhe shqipja, Universaliteti i gjuhës shqipe* etj. Petro Zheji është një intelektual i mirfilltë, i cili meriton të njihet nga brezi i ri, sepse është paradigma e njëriut shpresëtar, që diti ta ruante besimin gjatë viteve të diktaturës. Lluka Qafoku, *Disa fjalë mbi personalitetin e Petro Zhejit*, Tempulli Nr.3, Korçë 2001, faqe 108-110.

[414]-Joan Pelushi (1956-) ka lindur në Tiranë më 1 Janar të vitit 1956 në një familje bektashiane, e cila nuk shihej me sy të mirë nga rregjimi komunist. Babai i tij konsiderohej "armik" dhe ka qenë i burgosur politik. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Tiranë. Në vitin 1975, kur Joani ishte në vitin e fundit të gjimnazit një shok i dha një Bilël në frëngjisht. Leximi i Shkrimit të Shenjtë dhe librave të tjerë fetarë bëri që Joani të pranonte krishterimin. Në vitin 1979 u pagëzua në fshehtësi nga prifti i patrembur Atë Kozmai, në shtëpinë e këtij të fundit. Joani filloi të merte pjesë në takimet që organizonin të krishterët e fshehtë. Pas përfundimit të gjimnazit punon në Spitalin Psiqiatrik të Tiranës. Në vitin 1990, ai shkoi në SHBA dhe kreu studime teologjike në Fakultetin e "Kryqit të Nderuar" në Boston falë një të drejte studimi të caktuar nga shqiptarët e Amerikës në përkujtim të Imzot Fan Nolit. Kur ishte student ai hyri në kontakt me Kryeepiskopin Anastas, i cili u bë ati i tij shpirtëror. Më 1993 u gradua nga kjo shkollë Master në studimet teologjike dhe më pas u kthye në Shqipëri, ku filloi të

(Fig.10) i cili sot mban titullin Mitropolit i Korçës. Athina Angjellopulu mbajti të ndezur kandilin e kishës së Shën Todrit në qytetin e Vlorës. Muri i shtëpisë së saj përkonte me ajodhimën e kishës, e cila ishte kthyer në repart të Mbrojtjes nga Zjarri. Në shtëpinë e saj grumbulloheshin të krishterët e fshehtë Petro Xhuveli, Mihal Papa, Miti Rrapi, Toli Bubuni, Gori Dumani, Koço Fështi, Sotiraq Andoni, Koço Duni, Klearko Sava, Leni Beli, Harikli Beduli, Evgjeni Ballabani, Joan Pelushi, Dhimitër Musho etj, ku luteshin dhe prisnin papa Kozmanë që t'i kungonte me trupin dhe gjakun e Krishtit. Ky i fundit celebronte Liturgjinë Hyjnore gjatë natës në shtëpinë e tij në Bestrovë dhe herët në mëngjes nisej për në shtëpinë e Athinasë, ku e prisnin të krishterët e fshehtë. Në shtëpinë e Dr. Llukës grumbulloheshin për t'u kunguar Kristina Dumi, Rina Sheshi, Qirio Bezhani, Koço Qirinxhi, Spiro Duni, Eftali Sota, Jako Qirjako, Zaharulla Marko etj. Papa Kozmai shkonte edhe nëpër qytete të tjerë të Shqipërisë për të vizituar të krishterët e fshehtë. Në Durrës vizitonte Vasil Papastavrin, Vangjel Plepin etj, në Fier shkonte në shtëpinë e Petro Demajt, ndërsa në Elbasan tek Leonora Xhuveli. Në Korçë shkonte te motrat Cico, Pavlina Prifti, Grigor Mulla, Janaq Janku, Goli Remcka, Vito Buçka etj. Në Himarë shkonte në shtëpinë e Petro Xhuvelit. Në Tiranë shkonte te Koço Fështi, Dhimitër Beduli, Spiro Findiku, Kristina Papajani, Theofan Popa, Petro Zheji, Joan Pelushi etj[415].

Në shtëpinë e atë Marko Papajanit[416], (Fig.12) në Tiranë mblidheshin për të celebruar shërbesat fetare të krishterët e fshehtë Vlash Semini, Dhimitër Beduli,

---

kontribuojë në Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, duke dhënë mësim në Seminarin Teologjik "Ngjallja". Imzot Joani ka dhënë lëndën e Dogmatikës dhe të Dhiatës së Vjetër. Më 27 shkurt 1994 u hirotonis dhjak nga Kryeepiskopi Anastas dhe më 4 dhjetor 1996 u dorëzua në gradën priftërore. Më 1995 u kthye në SHBA për të ndjekur studimet pasuniversitare në Fakultetin e "Kryqit të Nderuar", me bursë nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe në vitin 1996 mori Masterin e dytë në teologji. Më 19 nëntor 1996 ai u bë Arkimandrit dhe përveçse jepte mësim në Akademinë Teologjike, ku ishte dhe nëndrejtor i saj, punoi në shumë detyra kishtare. Më 18 korrik 1998 u hirotonis dhe më 20 korrik 1998 u fronëzua si Mitropolit i Korçës. Imzot Joani ka përkthyer shqip disa libra teologjikë. Gjithashtu Mitropoliti i Korçës Joani ka botuar artikuj të shumtë në gazetën "Ngjallja", ka referuar kumtesa nëpër simpoziume shkencore brenda dhe jashtë vendit duke përfaqsuar me dinjitet Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Me kujdesin e tij del revista "Tempulli", me nivel të pëlqyeshëm. Andrea Llukani, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, (Nga vitet apostolike deri në ditët tona)*, Tekno Paper, Tiranë 2005, faqe 247-248.

[415]-Atë Spiro Bulika, *Bariu i mirë (Episkop Kozmai)*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2005, faqe 25.

[416]-Marko Papajani (1905-1990). Atë Marko ka lindur në fshatin Pevelan të Mokrës më 1 korrik 1905. I ati quhej Jovan dhe e ëma Gliqeria. Pas përfundimit të shkollës së fshatit, Marko ndihmonte babanë gjatë kryerjes së shërbesave fetare. Pasi martohet, ai transferohet në Tiranë ku ushtronte zanatin e muratorit. Duke ndjekur traditën e familjes më 28 nëntor 1930 u dorëzua dhjakon nga Kryeepiskop Visarioni, ndërsa më 2 korrik 1934 u hirotonis prift në Kishën e "Ungjillëzimit" në Tiranë. Në dhjetor të vitit 1942 mori ofiqin e "Ikonomit". Me prishjen e kishave në vitin 1967 Atë Marko arriti që në fshehtësi të merrte miron, të shenjtat, veshjet, librat liturgjikë etj, dhe i vendosi në njerën dhomë të shtëpisë, të cilën e ktheu në kishëz. Të krishterët e fshehtë Vlash Semini, Dhimitër Beduli, Theofan Popa, Petro Zheji, Dhjakon Spiro Findiku, Koço Fështi, Eleni Papajani, Elpiza Xhimitiku etj, mblidheshin për të zhvilluar shërbesat fetare në shtëpinë e atë Markos. Fjeti përgjithmonë më 3 shkurt të vitit 1990. Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 78; Kristofor Beduli, *Atë Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 5-7.

(Fig.13) Theofan Popa, Petro Zheji, dhjakon Spiro Findiku, Koço Fështi, Eleni Papajani, Elpiza Xhimitiku etj[417]. (Fig.14)

[417]-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004, faqe 7.

KREU I TRETË
RINGJALLJA E KISHËS
(1990-1991)

Historike është dita e 9 majit të vitit 1990, kur u hoq nga Kodi Penal, Neni 55 me anën e të cilit "propaganda fetare konsiderohej si krim kundër shtetit" dhe për këtë akt parashikohej dënimi deri në 10 vjet burg[418]. Gjithashtu në gusht të vitit 1990 në qytetin e Shkodrës u mbyll "Muzeu Ateist", duke shënuar hapin e parë drejt lirisë fetare[419]. Menjëherë filluan nga funksionimi kishat, që kishin mbetur ende në këmbë. Klerikët që i kishin mbijetuar regjimit celebruan shërbesat e para fetare në Berat, Korçë, Tiranë etj. Më 14 gusht të vitit 1990, u rihap kisha e Shën Marisë[420] në Boboshticë të Korçës, e cila ishte kthyer në stallë dhish. Mesha e parë pas persekutimit[421] u celebrua në manastirin e Kryeengjëjve në Derviçan të Gjirokastrës, më 16 dhjetor 1990. Më 22 dhjetor 1990 u meshua në kishën e Shën Spiridhonit[422] në lagjen Goricë të Beratit. Më 31 mars 1991 u celebrua liturgjia e parë në kishën katedrale të Ungjillëzimit[423] në Tiranë. Më 23 prill 1991 u meshua[424] në kishën e Shën Gjergjit në Durrës, e cila ishte kthyer në restorant, ndërsa më 4 qershor 1991 atë Spiro Veli celebroi liturgjinë hyjnore në manastirin e Shën Gjonit në Elbasan.

---

[418]-Neni 55: "Agjitacioni e propaganda fashiste, antidemokratike, fetare, luftënxitëse, antisocialiste, si edhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje të literaturës me përmbajtje të tillë për të dobësuar ose minuar shtetin e diktaturës së proletariatit, dënohet: me heqje të lirisë nga tre gjer në dhjetë vjet. Po këto vepra, kur janë kryer në kohë lufte ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen: me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje". *Kodi Penal të Republikës Pupullore Socialiste të Shqipërisë*, 1 tetor 1977, neni 55.

[419]-Zef Mirdita, *Krishtenizimi ndër shqiptarë*, Zagreb 1998, faqe 233.

[420]-Sotir Bambuli, *Në vitin 1990 ra këmbana në Shën Marinë e Boboshticës*, Ngjallja, tetor 2000, faqe 2; Sotir Bambuli, *17 mars-Liturgjia e parë në Korçë*, Ngjallja, prill 1996, faqe 10; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 223-224.

[421]-Liturgjia hyjnore u krye prej atë Mihal Dakos, i cili ishte dorëzuar në gradën priftërore në vitin 1959 prej Mitropolitit të Gjirokastrës, Damianit. Atë Mihal Dako i përkiste brezit të klerikëve që mbijetuan pas persekutimit ateist. Ndonëse në moshë të thyer ai u përkushtua tërësisht në kryerjen e shërbesave fetare. Dhimitër Beduli, *Përmes shkrimeve*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 79; Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprrhje lirie në Shqipërinë komuniste*, Ngjallja, shtator 2019, faqe 10.

[422]-Ilia Zaka, *Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtare në Berat*, Berat 2009, faqe 13-24; Ksenofin Ilia, *Kishat e Beratit*, Ombra GVG, Tiranë 2006, faqe 43; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 227-228.

[423]-Nasi Hobdari, *Liturgjia e parë Hyjnore, në kishën e shndërruar në palestër*, Ngjallja, prill 2006, faqe 9; Nasi Hobdari, Lekë Tasi, *5-vjetori i Liturgjisë së parë*, Ngjallja, prill 2006, faqe 10; Nasi Hobdari, Llazar Pjeshkazini, Lekë Tasi, *Ringjallja e Kishës së Ungjillëzimit në Tiranë*, Maluka, Tiranë 2007, faqe 7-11; Dhimitër Beduli, *Përmes shkrimeve*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 80; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 7-13; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 212-213; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014, faqe 229-233.

[424]-Dhimitër Beduli, *Përmes shkrimeve*, Ngjallja, Tiranë 2015, faqe 80.

3.1 SHËRBESAT E PARA NË KORÇË

Kambana e parë filloi të kumbonte gëzueshëm më 14 gusht të vitit 1990, në Kishën e Shën Marisë në Boboshticë. Ndonëse kisha ishte kthyer në stallë dhish, besimtarët Sotir Bambuli, Jovan Joco, Vasilika Napoloni, Koço Xhoxhi, Thomaq Greço, Fredi Niço, Thoma Tasho etj nxorën me tonelata pleh dhe përgatitën kishën për t'u celebruar liturgjia hyjnore[425]. Besimtarët korçarë në krye me Sotir Bambulin[426], i datëlindjes 14 mars 1930, ishin pararendësit e hapjes së kishave. Ata duke mos marrë parasysh rreziqet punuan dhe kontribuan për hapjen e kishave në rrethin e tyre. Në gazetën lokale "Koha" u lëshua kushtrimi: "Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u bën të ditur, si pushtetarëve lokalë, ashtu e kryesive të kooperativave bujqësore, fermave shtetërore, si më poshtë:

1-Të gjitha ndërtesat e kishave, manastireve, stallave, mullinjve dhe të tjera, që janë kthyer në depo, stalla kafshësh a vatra kulture duhet t'u dorëzohen këshillave kishtarë, se janë pronë e popullit.

2- Atje ku janë shitur vendet e kishave ose stallat që janë ndërtuar me materialet e kishave apo manastireve, kryesitë e kooperativës duhet t'u rikthejnë të hollat blerësve, ndërsa objektet dhe trojet t'u jepen këshillave kishtare.

3- Tokat, pemët që janë rrotull kishave, varrezave ose manastireve, nuk ka të drejtë t'i shesë ose t'ua ndajë anëtarëve të kooperativës ose qytetarëve të tjerë, se edhe ato janë pronë e popullit, e fshatit ose e qytetit përkatës.

4- Në çdo fshat të ruhen ndërtesat ekzistuese të kishave, manastireve, stallave, mullinjve, ndërtesa të tjera dhe të fillojë ndërtimi ose rindërtimi nga kryesitë e këshillave kishtare.

5- Kush ka ruajtur materiale kishtare, si lipsana, kryqe, epitafe, ikona, kambana, të dorëzohen në çdo mitropoli ose të vihen në dijeni ku ndodhen. Materialet e dorëzuara do të ruhen dhe do t'i dorëzohen kishës që i takon.

---

[425]-Sotir Bambuli, *Në vitin 1990 ra këmbana në Shën Marinë e Boboshticës,* Ngjallja, tetor 2000, faqe 2.

[426]-Sotir Bambuli ka lindur në Boboshticë të Korçës më 13.03.1930 në një familje të vjetër boboshtare. Ai studioi për Matematikë Fizikë në Institutin e Tiranës. Kontribuoi si mësues në të gjithë zonën e Korçës duke arritur rezultate të larta me klasat që punoi, pavarësisht vështirësive të kohës. Ishte i lidhur thellë me artin dhe kulturën. Shkroi disa vepra teatrale, të cilat u vendosën në skenë në kohën e monizmit dhe në të cilat shpesh herë kishte mesazhe të fshehura në lidhje me besimin tek Zoti. Në vitin 1990 menjëherë pas vendimit të qeverisë për lirinë e fesë hapi Kishën e Fjetjes së Hyjlindëses në fshatin e tij Boboshticë, i ra kambanës së fshatit dhe me besim të plotë tek Zoti, kreu me sukses organizimin e këshillave kishtarë në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Në 17 03 1991 në mbledhjen e përgjithshme të Këshillave Kishtarë u zgjodh Kryetar i Këshillave Kishtarë të të gjithë Shqipërisë detyrë të cilën e dorëzoi me ardhjen e Kryepiskopit Anastas në Shqipëri. Që prej atëhere u përqëndrua në mirëmbajtjen dhe rimëkëmbjen e kishave të fshatit. Sotir Bambuli vdiq më 24.06.2019 ditën e Shën Joan Pararendësit. *Ndërroi jetë kryetari i parë i këshillave kishtarë pas monizmit z. Sotir Bambuli*, Ngjallja, qershor 2019, faqe 11.

6- Të ngrihen këshillat kishtare në çdo fshat nga 3-5 veta nga njerëz të ndershëm. Të bëhet një mbledhje me pleqtë e fshatit dhe të njoftohet ngritja e këshillave kishtare, e kryesive të tyre në çdo qytet dhe të merren udhëzime për çdo problem"[427].

Më 6 janar të vitit 1991, atje ku dikur ishte kisha e Shën Triadhës, kleriku 85-vjeçar atë Kosta Kotnani celebroi shërbesën e Bekimit të Ujit. Ndonëse mungonte gjithshka, entuzjazmi i besimtarëve ishte i madh. Motrat Cico nxorën nga sunduku një palë veshje kleriku gjithë arna, besimtari Jani Trebicka[428] solli një kryq, të cilin e kishte derdhur fshehurazi në fonderi dhe në këto kushte u zhvillua shërbesa e parë pas persekutimit. Më 18 janar 1991 atë Kozmai erdhi nga Bestrova për të meshuar në murret e kishës së rrënuar të Shën Thanasit, ndërsa më 2 shkurt të vitit 1991, ndonëse temperatura shënonte 18 gradë nën zero, atë Kosta Kotnani kremtoi ditën e Ipapandisë[429].

Më 14 mars të vitit 1991 filloi të funksiononte Kisha e "Shën Dëllisë" në Korçë, e cila ishte kthyer në kafene, ndërsa më 17 mars 1991, u celebrua liturgjia e parë në këtë kishë, me pjesëmarrjen e klerikëve atë Kristo Raci, atë Kosta Kotnani si dhe të delegatëve të ardhur nga gjithë rrethet me popullsi orotodokse.

3.2 MBAJTËSIT E KRYQIT

Më 17 mars të vitit 1991 në Kishën e "Shën Dëllisë", në qytetin e Korçës u zhvillua mbledhja, në të cilën u themelua shoqata "Mbajtësit e Kryqit". Nismëtarët qenë atë Kozma Qirjo, atë Gaqo Pjetri, atë Kristo raci, atë Kosta Kotnani, dhjak Spiro Findiku, dhjak Vangjel Xoxe, Sotir Bambuli, Dhimitra Cico, Berta Dhimitri, Grigor

[427]-Sotir Bambuli, *Lajmërim*, Koha, 31 maj 1990.

[428]-Jani Trebicka (1952-) ka lindur në Korçë më 30 shtator 1952 dhe rrjedh nga një familje thellësisht besimtare, prej së cilës u edukua që në vogëli me frikë Perëndie. Mbyllja e kishave e gjeti në moshën 15-vjeçare, por në rrethin e tij festat fetare vazhdonin të kremtoheshin rregullisht. I formuar me këtë traditë së bashku me shokë dhe miq ai shkonte për pelegrinazh në vende të shenjta si në Shën Konstandin e Bradvicë, Shën Marenë e Dishnicë, ku i luteshin Zotit. Duke punuar si fonditor ai derdhte kryqe dhe ua shpërndante të afërmve ose i linte nëpër kishat e shkatërruara që t'i merrnin besimtarët ortodoksë, që i frekuentonin fshehurazi. Në kremtimin për herë të parë të Ujit të Bekuar më 6 janar 1991 në vendin ku më parë ndodhej Kisha e Shën Triadhës, Jani Trebicka ishte ndër organizatorët. Më pas u zgjodh llogaritar i kishës, por dëshira e tij ishte të bëhej prift. Kështu me ardhjen në Shqipëri të Fortlumturisë së Tij Kryeepiskopit Anastas si Eksark i Patriarkanës Ekumenike ishte dhjaku i parë që u hirotonis nga dora e tij më 28 korrik 1991 përjashta te shkallët e Mitropolisë. Ndërsa më 24 nëntor 1991 u dorëzua prift. Përkushtimi ndaj detyrës së shenjtë, aftësia e shpresëtaria e tij bënë që në shkurt të vitit 1993 ai të zgjidhet nga Këshilli i Përgjithshëm i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Epitrop i Përgjithshëm Arkiheratik i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Gjithashtu me formimin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Protopresviter Jani Trebicka u zgjodh Kryesekretar i Përgjithshëm. *Të ardhmen e Kishës sonë Orthodhokse Autoqefale e shoh me optimizëm*, ngjallja, qershor 1994, faqe 9; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 130-131; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 122-123.

[429]-Mihal Sonellari, *Përkujtimi i ringjalljes së Kishës në ditën e Ortodoksisë*, Ngjallja, mars 2006, faqe 2.

Mulla, Jani Trebicka etj. Në këtë mbledhje historike kishte pjesëmarrës nga e gjithë Shqipëria, të cilët gjetën mikpritjen e familjeve ortodokse korçare. Mbledhja filloi me një lutje të shkurtër dhe në vijim e mori fjalën Sotir Bambuli, i cili lexoi projekt-programin e shoqatës[430].

Jani Trebicka raportoi për punën e shoqatës në organizimin e funksionimin e kishave dhe në vijim raportuan delegatët e Beratit, Pogradecit, Lushnjës, Durrësit etj. U lexua përshëndetja e teologut Dhimitër Beduli dhe në përfundim të mbledhjes u zgjodh kryesia e shoqatës. Vendimet e mbledhjes së parë të shoqatës "Mbajtësit e Kryqit" qenë: 1-Të bëhen përpjekje për të sjellë si eksark patriarkal Imzot Anastasin, sepse kishë pa episkop nuk ka. 2-Deri më 10 prill 1991 të dërgohen pranë kryesisë së shoqatës emrat e klerikëve që jetojnë. 3-Gjithashtu deri më 10 prill 1991 të dërgohet lista e kishave ekzistuse dhe e atyre të shkatërruara. 4-Të grumbullohen librat kishtarë nga arkivat familjare. 5-Minoritetet do ta zhvillojnë Liturgjinë në gjuhën e tyre amtare. 6-Të merren nga muzetë ikonat, ikonastaset, kambanat, fronet dhespotike etj. 7-Të ngrihen këshilat kishtare nëpër fshatra dhe qytete. 8-Në çdo kishë të vendoset një arkë ku besimtarët të hedhim kontributet e tyre. 9-Klerikët të mbajnë rason dhe kamillafin. 10-Të gjenden psaltët e mbetur dhe të përgatiten psaltët e rinj. 11-Sipas traditës, nëpër kishat tona do të këndohet muzika bizantine. 12-Të dalë kalendari kishtar. 13-Klerikët që kanë mbetur duhet të meshojnë edhe nëpër fshatra. 14-Të gjenden të rinj, të cilët do të dorëzohen priftërinj. 15-Sipas traditës të ekzistojë harmonia ndërfetare. 16-Në ditën e 17 marsit, çdo vit do të celebrohen liturgji anembanë Shqipërisë për të kujtuar ditën e rilindjes së kishës sonë.

Në fund të mbledhjes u zgjodh Këshilli i Kombëtar i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë[431]. Kryetar i Këshillit Kombëtar u zgjodh Sotir Bambuli. Këshilli u ngarkua me detyrën për të nduhmuar në çeljen e kishave ortodokse në mbarë vendin[432].

3.3 RIHAPJA E KISHËS SË SHËN SPIRIDHONIT NË LAGJEN GORICË TË BERATIT

Më 20 nëntor 1990 një grup besimtarësh të lagjes Goricë të Beratit vendosën të rihapin kishën e Shën Spiridhonit. Një përfaqësi e tyre e përbërë nga Lili Karabina, Zoi Samarxhiu, Palush Pushi, Petraq Thanasi, Petraq Simsia, Vangjush Mile dhe Mikela Oço shkuan për të marë leje tek sekretari i komitetit të partisë Stathi Kavaja. Në vijim grupi nismëtar shkoi tek shtëpia e kryetares së këshillit popullor të lagjes Lediana Zhara, e cila pa hezitimin më të vogël ua dha çelësat e kishës. Kisha e Shën Spiridhonit ishte kthyer në depo, ku magazinoheshin materiale ndërtimi, kazma, lopata, çimento, gëlqere, rërë, trarë etj. Në pjesët anësore të kishës qenë vendosur

[430]-Sotir Bambuli, *17 mars-Liturgjia e parë në Korçë,* Ngjallja, prill 1996, faqe 10.

[431]-Thimi Lapi, *Një përvjetor domethënës i kishës së ringjallur*, Ngjallja, mars 2006, faqe 9-10.

[432]-*Takimi i parë i këshillave kishtarë të vendit tonë pas fitimit të lirisë fetare*, Ngjallja, mars 2019, faqe 12.

rafte, në të cilat kultivohej krimbi i mëndafshit. Binarët e skelave kishin dëmtuar afreskët e kishës.

Sapo morën çelësat nismëtarët filluan pastrimin e kishës. Nismën e mori Mikela Oço, i cili u pasua nga Pirro Angjeliu, Dhimitër Topi, Peçi Musha, Ilia Angjeliu, Vangjeli Bojaxhiu, Eftali Përroi, Pandi Shulla, Kela Baboçi etj. Grupi nismëtar vendosi që kisha të rihapej më 12 dhjetor të vitit 1990 ditën kur kremtonte Shën Spiridhoni[433], por duheshin ende shumë materiale, të cilat do të mundësonin funksionimin e kishës. Besimtarët filluan të ofronin atë çka kishte shpëtuar nga përndjekja e egër ateiste. Palush Pushi dhuroi ikonën e Darkës Mistike, ndërsa Petraq Simsia kishte ruajtur kryqin e kishës së Shën Spiridhonit. Grupi nismëtar kontaktoi me dhjakun Vangjel Xoxe, i cili e pranoi ftesën. Menjëherë me kontributin financiar të besimtarëve u blenë pëlhurat e duhura dhe rrobaqepësi Sotiraq Tapia qepi stolinë e dhjakut. Por që të celebrohej Liturgjia Hyjnore nevojiteshin disko-potirët e shenjtë, siç quhen në gjuhën kishtare. Këto u siguruan nga besimtari Jorgji Naço, i cili i kishte ruajtur me shprestari për vite me radhë, sepse babai i tij Fone Naço, kishte qenë epitrop i kishës së Shën Spiridhonit. Të shenjtat i shpunë në kishë dhe ia treguan dhjak Vangjelit, i cili shprehu keqardhjen duke thënë se këto nuk mjaftonin. Duhej patjetër antimisi i shenjtë. Mellani Naço e kishte fshehur antimisin e kishës së Shën Spiridhonit në sëndukun ku kishte rrobat e pajës. Dhjak Vangjeli me Zoi Samarxhiun shkuan në shtëpinë e psaltit Ilia Thimi Koçi, i cili u dhuroi ungjillin dhe apostullin. Më 22 dhjetor 1990 besimtarët kishin mbushur kishën e Shën Spiridhonit në Lagjen "Goricë" të Beratit, madje në këtë ditë të shënuar kishte pjesëmarrës edhe të feve të tjera. Të gjithë prisnin me padurim të fillonte Liturgjia Hyjnore, por dhjak Vangjel Xoxe doli tek dera e bukur dhe tha: “Unë jam dhjak dhe nuk më lejohet të celebroj Liturgjinë Hyjnore, por kërkoj miratimin tuaj”. Në vijim ai pyeti besimtarët e pranishëm në kishë: “a jam i denjë”, “a jam i denjë”, “a jam i denjë” dhe ata iu përgjigjën njëzëri “i denjë”, “i denjë”, “i denjë”. Atëhere dhjakon Vangjel Xoxe filloi të lëçiste litanitë e meshës hyjnore.

Meqenëse dhjakon Vangjeli duhej të dorëzohej në gradën priftërore, grupi nismëtar vendosi që ai të shkonte në Athinë. Në qershor 1991 një grup besimtarësh Vangjel Çapi, Palush Pushi, Petraq Simsia dhe Petraq Thanasi shkuan në Moni Pendeli në Athinë. Më 25 qershor 1991 u krye dorëzimi i dhjak Vangjelit në prift nga Eksarku Anastas. Përveç përfaqësisë së ardhur nga Berati qenë të pranishëm edhe sekretari i përgjithshëm i K.O.A.Sh-it Aleko Dhima dhe kryetari i shoqatës Mbajtësit e Kryqit Sotir Babuli[434].

[433]-Ksenofin Ilia, *Kishat e Beratit*, Ombra GVG, Tiranë 2006, faqe 43.

[434]-Ilia Zaka, *Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtare në Berat*, Berat 2009, faqe 13-24.

3.4 RIHAPJA E KATEDRALES SË UNGJILLËZIMIT NË TIRANË

Kisha katedrale e Ungjillëzimit në Tiranë u rihap më datën 4 mars 1991. Pararendësit e rihapjes së katedrales qenë dhjakon Spiro Findiku[435], Nasi Hobdari[436] (Fig.1) dhe Llazar Pjeshkazini[437]. (Fig.2) Kisha ishte në një gjendje të mjerueshme si në mjediset e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtmet. (Fig.3) Klubi Sportiv 17 Nëntori kishte bërë disa shtesa dhe ndryshime për të përmbushur nevojat e tij. (Fig.4) Salla kryesore e kishës ishte si mos më keq nga mosvënia dorë mbi të. Suva të rrëzuara, çatia pjesërisht e rrënuar dhe lagështira ishte e pranishme kudo, dritaret me xhama të thyer etj. Pluhuri i përzier me lagështirën kishte fëlliqur muret dhe ndotur parketin e dyshemesë. Afresket e pikturuara me mjeshtëri nga motrat Zengo i kishin lyer me një shtresë të trashë gëlqereje që të mos dukeshin, megjithatë lagështira kishte mundur të zbulonte fytyrat e katër ungjillorëve, të cilët qenë pikturuar në kubenë e kishës. Amvoni i kishës dhe llambadarët e mëdhenj qenë dëmtuar nga keqbërësit. Ballkoni ku qëndronte kori ishte shndërruar në magazinë. Kambaneria nuk qe dëmtuar falë propozimit të shefit të Klubit 17 Nëntori, Lame Konomi për t'u përdorur

[435]-Spiro Findiku (1916-1998) ka lindur në Tiranë, më 24 nëntor të vitit 1916. Familja Findiku ka qenë e lidhur me problemet e kishës. Spiro u hirotonis dhjak në vitin 1966, detyrë të cilën e kreu vetëm për një vit. Hapjen e kishave më 1991 e priti me entuzjazëm të madh. Dhjakon Spiro Findiku ishte pararendësi i rihapjes së Kishës së Ungjillëzimit. Ai ka meritë të veçantë për marrjen e çelësave të kishës si dhe për pajisjen e saj me orenditë që gjendeshin në muze dhe kinostudio. Dhjakon Spiro fjeti më 23 shkurt të vitit 1998. Ceremonia e përmortshme u krye në Katedralen e Ungjillëzimit, me pjesëmarrjen e klerikëve dhe besimtarëve të shumtë. Kristofor Beduli, *Fjeti Dhiakon Spiro Findiku*, Ngjallja, mars 1998, faqe 3,4.

[436]-Nasi Hobdari ka lindur në Tiranë, më 10 janar 1926. Ai ka qenë një nga pararendësit e rihapjes së kishës së Ungjillëzimit. Duke vazhduar traditën e familjes, Nasi solli në kishë të birin Niko Hobdarin, i cili punoi që në fillimet e kishës dhe në vijim në punimet restauruese të këmbanores ku u aksidentua. Nasi ka qenë epitrop dhe në vijim që nga data 21 shtator 1992 u emërua nga Këshilli i Kishës si sekretar-llogaritar i kishës. Më datën 15 prill të vitit 2002, Nasi Hobdari u largua me dëshirën e tij nga detyra e Sekretar-Llogaritarit. Nasi Hobdari ka qenë bamirës me zemër të madhe, sepse ka sponsorizuar disa libra kishtarë, ndër të cilët mund të përmendim: *Krishterimi në Shqipëri, Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranë, Ringjallja e kishës së Ungjillëzimit në Tiranë* etj. Gjithashtu në kujtim të rihapjes së kishës ka botuar artikuj në të përmuajshmen *Ngjallja*. Bamirësi Nasi Hobdari dhe dhënë donacione për kishën e *Ungjillëzimit* në Tiranë. Gjithashtu ka kontribuar në themelimin e komunitetit të Shën Astit në Toronto të Kanadasë. Në qerthullin ortodoks për Hobdarët flitet me respekt të veçantë. Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 206-207; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 15-16; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 178-179.

[437]-Llazar Pjeshkazini (1952-) ka lindur më 25 qershor të vitit 1952, në Tiranë. Ai qenë që në momentin e parë që u hap kisha dhe një nga mbështetësit e Kryeepiskopit Anastas. Mbledhja e parë e grupit nismëtar për rihapjen e kishës së Ungjillëzimit ishte menduar që të zhvillohej në shtëpinë e familjes Pjeshkazini, por numri i besimtarëve pjesëmarrës ishte shumë i madh, prandaj u pa e arsyeshme që të merrej me qera një sallë në Pallatin e Kulturës. Duke vazhduar traditën e familjes Llazari ka dhënë kontributin e tij në punët ndërtuese dhe mbarëvajtjen e kishës, si edhe në librarinë e kishës derisa doli në pension. Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 188; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 16; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 178.

nga alpinistët për ngjitje dhe zbritje. Dyshemeja ishte e shtruar e gjitha me parket dhe nëpër mure qenë ngulur ganxha, të cilat shtrëngonin veglat gjimnastikore. Kishte shumë punë për t'u bërë, u lëshua kushtrimi për ndihmë. Besimtarët (Fig.5) (Fig.6) që iu përgjigjën të parët thirrjes qenë: Niko Hobdari, Filip Nito, Spiro Vojo, Spiro Bejleri, Petrika Shalësi, Todi Janku, Dhimitraq Kobuzi, Milto Mima, Lekë Tasi[438], Aleko Dhima, Gazmend Leka, Pavllo Hobdari, Koçi Paci, Minella Mihali, Dhimitraq Kobuzi, Petrika Trako, Niko Kavaja, Kristaq Tasho, Andrea Llukani[439], Krisanthi Zoto, Drita Papajani, Llazar Nushi, Prokop Shundi, Leonidha Kllapi, Sandër Çoka, Thoma Valera, Grigor Laçka etj.

Fillimisht u munduam ta sillnim kishën në gjendje të paraqitshme, prandaj puna e parë qenë pastrimet, u hoq parketi i vjetër dhe u bënë mjaft rregullime të tjera. Na duhej ikonostasi, i cili kushtonte mjaft, prandaj menduam që me dërrasën e parketit, të përshatur në kuadrate 3X3 metra të bënim një ikonostas të thjeshtë. Gjithashtu ajodhima qe e sheshuar në një nivel me pjesën tjetër të kishës dhe e mbushëm me zhavor e beton me qëllim që ta ngrinim mbi kuotën e përgjithshme të dyshemesë ashtu siç kishte qenë dikur. Hyrja kryesore e kishës ishte e murosur, prandaj biseduam me shefat e Klubit 17 Nëntori për ta shembur, sepse po afronin pashkët. Përveçse përkushtimit vullnetar të besimtarëve që punonin pa shpërblim na duheshin edhe fonde financiare për materialet që nevojiteshin, prandaj u bëmë thirrje të krishterëve që të na ndihmonin. Menjëherë si në "Paravolinë e vejushës së varfër" shprestarët ortodoksë ofruan atë që kishin për rikonstruksionin e kishës. Ndihma në të

[438]-Lekë Tasi rrjedh nga një familje intelektualësh të persekutuar në kohën e monizmit. Z. Tasi u aktivizua që në ditët e para të rihapjes së kishës. Në vijim punoi në Sekretariatin e Feve pranë zyrës së Kryeministrit, si përfaqësues i komunitetit ortodoks. Ai ka shkruar artikuj në gazetën Ngjallja dhe ka përfaqësuar denjësish K.O.A.Sh-in në debate televizive. Në vitin 2004 ka botuar romanin *Korridori me vetrat*, ndërsa më 2009 botoi librin *Grabiani rrëzë kodrave*, ku përshkruan me mjaft ndjenjë skena, personazhe dhe histori nga vitet e internimit. Lekë Tasi ka studiuar për violinçel dhe në vitet 1946-1967 ka punuar si violinçelist në Orkestrën e Radios dhe Filarminisë. Pasioni i tij është piktura. Ndonëse me një kulturë autodidakte Z. Tasi është bërë i njohur dhe i vlerësuar në rrethet artistike të artit pamor. Lekë Tasi ka realizuar shumë tablo, ku ndër më të spikaturat janë *Pashkë në Sheshin Skënderbej, Kinema Rozafat, Trafik në Rrugën e Kavajës, Kodra në mes të Tiranës* etj. Llambi Bido, *Provokimi i surreales*, Standard, 10 korrik 2007, faqe 16-17; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 183-184; Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 19.

[439]-Andrea Llukani ka lindur në Tiranë, më 18 dhjetor 1966. Studimet e larta i ka përfunduar në Universitetin Kombëtar "Kapodistria" të Athinës. Gjithashtu ka studiuar në Institutin "Gëte" dhe është specializuar në "Pravoslavna Akademia", të Çekisë. Gjatë viteve 1998-2002, ka qenë pedagog në lëndën e Historisë së Krishtërimit, ndërsa më 2001-2002 ka qenë drejtor i radios "Ngjallja". Prej vitit 2003 deri më 2013 ka qenë Përgjegjës i Personelit të Kompanisë "Global Petroleum Albania". Aktualisht është Përgjegjës i Sektorit të Konservimit të Koleksioneve në "Muzeun Historik Kombëtar". Prej vitit 2002 është anëtar në International Federation of Jurnalists dhe më 2006 anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Andrea Llukani ka botuar 50 libra, disa prej tyre i ka përmbledhur në 12 vepra. Gjithashtu ka shkruar artikuj në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit: "Global Challenge", "Diskutime", "Studime Muzeologjike", "Dritëhije", "Emanthia", "Albanon" etj. Andrea Llukani është anëtar i redaksisë së revistave shkencore "Studime muzeologjike" dhe "Dritëhije". Prej vitesh është kryeredaktor i gazetës dygjuhëshe shqip-italisht "Rrënjët", "Le Radici".

holla dhanë: Krisanthi Zoto, Gaqo Bushaka, Petraq Roko, Ollga Karafili, Vasil Loli, Fiodor Prifti, Miti Theodhosi, Luiza Stasoli, Dhimitër Gjika, etj. Të gjitha pengesat u kapërcyen vetëm falë vullnetit dhe përkushtimit të besimtarëve. Nasi Hobdari dhe dhjakon Spiro vajtën në Kinostudio dhe në Muzeun Etnografik ku mund të gjenin materiale të nevojshme për mjediset e kishës. Me ndërmjetësinë e Petraq Ramës takuan drejtorin Teodor Laço, i cili kontribuoi për kthimin e objekteve kishtare. Froni episkopal ishte dëmtuar, prandaj besimtari Todi Janku u muar me riparimin e tij. Kandilat u pastruan nga Milto Mima dhe Prokop Shundi, por ato që ishin nxirë nga mospërdorimi Llazar Pjeshkazini i shpuri për t'i pastruar te Artistikja Migjeni bë repartin e enëve të bakrit, ku u lanë me acid dhe pasi luçiduan u llakuan. Atë Gaqo kishte një kryq bronxi me Krishtin e gozhduar dhe e solli në kishë. Filip Nito dhe Dhimitër Kobuzi morën përsipër të hapnin 12 gropa, tek të cilat do të vendoseshin shufrat tek udha në mes të kishës aty ku kalojnë priftërinjtë gjatë Hyrjes së Madhe.

Niko Hobdari siguroi kordonin e kuq 40 metërsh, i cili u pre në copa dymetroshe dhe u vendos në shufra nga Thoma Valera dhe Andrea Llukani. Për veshjen e ikonostasit me letër imituese dhanë kontributin e tyre Sandër Çoka dhe Lekë Tasi. Gazmend Leka pikturoi skenën e Kryqëzimit të Krishtit. Ikonat e para që u vendosën në ikonostas i solli dhjakon Spiro Findiku nga shtëpia. Besimtari Koço Zoto solli nga Greqia gjashtë kandile për ikonostasin, një temianicë dhe një kryq. Ing. Petrika Shalësi, Spiro Beleri, Vane Mazniku dhe Qirjo Nikolla u morën me meremetimet e mureve të kishës. Përveç burrave nuk duhet mohuar kontributi i grave shprestare, të cilat pastronin kishën dhe kujdeseshin për gjithçka. Midis tyre mund të veçojmë: Elpiza Xhimitikun, Amalia Maçin, Kristanthi Zoton, Luiza Sastolin, Drita Papajanin, Tefta Kuqen, Evanthi Manglaran, Zografa Kokthin, Florika Papajanin, Dr. Keti Noçkën etj[440].

Në mëngjesin e 31 marsit 1991 kambana e kishës së Ungjillëzimit kumboi gëzueshëm duke i ftuar besimtarët në kishë. Liturgjia hyjnore u kryesua nga atë Gaqo Petri, me pjesëmarrjen e dhjak Spiro Findikut dhe kryedhjakon Sotir Kanxherit, zëri i ëmbël i të cilit kumboi përsëri në kishën katedrale të Ungjillëzimit. Në rolin e kryepsaltit ishte teologu Dhimitër Beduli me psaltët Petro Ketri[441], Niko Kavaja dhe

[440]-Nasi Hobdari, Llazar Pjeshkazini, Lekë Tasi, *Ringjallja e Kishës së Ungjillëzimit në Tiranë,* Maluka, Tiranë 2007, faqe 7-11.

[441]-Petro Ketri (+2002) nga Sinica e Korçës ka qenë ndër të parët që ka psalur në Kishën katedrale të Ungjillëzimit në Tiranë pas rihapjes së kishës. Ndonëse në moshë të shkuar Xha Petro vinte rregullisht në kishë gjatë të kremteve, zinte vendin në psaltir dhe i psalte Perëndisë. Këtë punë e bënte falas pa shpërblim nga kisha. Vitet e fundit ka qenë psalt tek kisha e Shën Prokopit në Tiranë. Një të dielë marsi të vitit 2002 Petro Ketri erdhi si gjithnjë për të psalur në kishë, lëçiti Apostullin me zërin e tij melodioz, u kungua me trupin dhe gjakun e Krishtit dhe porsa mbërriti në shtëpi, dorëzoi shpirtin tek Perëndia. Të dielën që pasoi mungesa e Petros në psaltir ra në sy të besimtarëve, të cilët kishin mbushur kishën e Shën Prokopit. Në fund të predikimit ftova besimtarët e pranishëm që të luteshin për shpirtin e Petro Ketrit, i cili i psali Perëndisë deri në momentin e fundit të jetës. Ka qenë diçka shumë mallëngjuese për mua dhe besimtarët e pranishëm. Emocionet që kam përjetur nuk do t'i harroj kurrë, sepse kam pasur respekt për psaltin e urtë Petro, me të cilin më lidhnin kujtimet e ditëve të para të rihapjes së Kishës Katedrale të Ungjillëzimit. Nasi Hobdari, *Nderim për psaltin Petro Ketri*, Ngjallja, prill 2002, faqe 2; Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 233;

Kristaq Tasho. Liturgjia hyjnore u zhvillua në praninë e shumë besimtarëve që kishin mbushur kishën. Në këtë ditë të shënuar u ftuan përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe Trupi Diplomatik i Akreditуar në Republikën e Shqipërisë[442].

Në liturgjinë hyjnore me rastin e rihapjes së kishës predikimin e mbajti teologu Dhimitër Beduli. Në vijim përshëndetën: përfaqësuesi i Komunitetit Bektashian Musa Mara, përfaqësuesi i Komunitetit Mysliman Islam Kadëna, Sekretari për problemet fetare të Partisë Demokratike Galip Kallajxhiu dhe Ambasadori Rumun George Miku[443].

3.5 VIZITA E ATË ARTURIT

Më 6 qershor 1991 erdhi për vizitë Kancelari i Kishës së Shën Gjergjt në Boston, atë Artur Liolini, (Fig.7) i shoqëruar nga dhjakonët Denis Schutte dhe Viliam Poist. Për të pritur delegacionin e diasporës në aeroportin e Rinasit dolën atë Gaqo Pjetri, kryedhjakon Sotir Kanxheri, dhjakon Spiro Findiku, Nasi Hobdari, Aleko Dhima etj. Në pritjen e atë Arturit kishin dalë edhe përfaqësues nga komunitetet fetare, të cilët i uruan mirëseardhjen. Delegacioni i diasporës u vendos në Hotel Dajti. Pasdite erdhën në kishë ku u pritën nga klerikët dhe besimtarët e pranishëm. Atë Arturit i bëri përshtypje kori i kishës[444], i cili sapo ishte ngritur me kontributin e Xhorxhi Doçit. Ky i fundit kishte grumbulluar disa këngëtarë nga Teatri i Operas dhe Baletit dhe nën drejtimin e dirigjentit Eno Koço kishin filluar të mësonin himnet e Liturgjisë Hyjnore. Pasi vizituan ambjentet e kishës, teologu Dhimitër Beduli u foli shkurtimisht për traditat e komunitetit ortodoks.

Më 8 qershor 1991 në Katedralen e Ungjillëzimit atë Artur Liolini, i ndihmuar nga dhjakon Denisi, atë Gaqo dhe kryedhjakon Sotiri pagëzuan rreth 106 fëmijë. Më datën 9 qershor 1991 atë Arturi meshoi në Katedralen e Ungjillëzimit. Kisha ishte e mbushur me besimtarë, gjithashtu kishte pjesëmarrje edhe nga komunitetet e tjera fetare. Në emër të komunitetit ortodoks teologu Dhimitër Beduli i uroi mirëseardhjen: "I përndershëm atë Artur, ardhja juaj mes nesh si përfaqësues i Kryeepiskopatës Ortodokse Shqiptare të Amerikës dhe mesha solemne që kryesoni, janë për Kishën tonë Ortodokse Autoqefale dhe veçanërisht për komunitetin ortodoks të Tiranës një ngjarje historike. Meshimi juaj i sotëm më kujton në radhë të parë meshën e parë në

Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011, faqe 21; Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012, faqe 182.

[442]-Nasi Hobdari, *Liturgjia e parë Hyjnore, në kishën e shndërruar në palestër*, Ngjallja, prill 2006, faqe 9.

[443]-Nasi Hobdari, Lekë Tasi, *5-vjetori i Liturgjisë së parë*, Ngjallja, prill 2006, faqe 10.

[444]-Kori i kishës katedrale të Ungjillëzimit, Tiranë përbëhej nga këngëtarë profesionistë si për shembull: Pandi Zguro, Gjergj Sulioti, Shpresa Terezi, Niko Vasili, Xhorxhi Doçi; nga artistë veteranë si Drita Papajani, Tefta Kuqi, Kristaq Tasho, Keti Cico, Sofika Kola, etj. Repertori përbëhej nga pjesë kishtare të kompozitorëve ortodoksë si Çajkovski, Imzot Noli, K. Lara, Th. Gaqi. Këta dy të fundit kanë kompozuar pjesë që këndohen për Pashkë. Disa nga pjesët që këndohen në Liturgjinë Hyjnore janë "Himni Keruvik", "Mëshirë paqeje" etj. Kristina Hanxhari, *Për mua përsosja do të ishte krijimi i korit me zë engjëllor*, Ngjallja, dhjetor 1994, faqe 4.

gjuhën shqipe që u bë më 22 mars të vitit 1908 në Boston të Amerikës prej të parit prift ortodoks shqiptar Theofan Stilian Nolit si dhe vendosjen prej tij të gurit të parë themeltar për Autoqefalinë e Kishës sonë Ortodokse Shqiptare".

Atë Arturi në fjalën e tij theksoi se kishte qenë në shumë vende të botës, por entuzjazmin që gjeti në Shqipëri nuk e kishte hasur askund. Gjatë ditëve qëndrimit në atdhe, atë Arturi meshoi në shumë qytete të Shqipërisë. Qeveria shqiptare kishte vënë në dispozicion të tij një automjet të parkut të delegacineve. Në shoqërinë e Nasi Hobdarit dhe të Aleko Dhimës bënë një vizitë në Shkodër ku u pritën nga ortodoksit me në krye Aleksandër Petanin. Vizitat vazhduan në Durrës, Berat, e Boboshticë, që ishte edhe vendi i origjinës së atë Arturit. Më datën 25 qershor u zhvillua një mbledhje në Hotel Dajti, për mbarvajtjen e kishës. Aty u fol për ndihmën që mund të jepte diaspora, për literaturën kishtare aq të nevojshme në atë kohë dhe në fund u prek problemi i Eksarkut Patriarkal që pritej të vinte së shpejti në Shqipëri[445].

[445]-Andrea Llukani, *Kisha në diktaturë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.

KREU I KATËRT
DOKUMENTE

4.1 STATUTI
I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË
BERAT 1922

Neni I. Kisha ortodokse Autoqefale e Shqipërisë pjesë e pandarë e së shenjtës Kishë të përgjithshme Autoqefale të të gjithë ortodoksve përbëhet prej banorëve të shtetit shqiptar që i besojnë Krishtit dhe pohojnë simbolin e shenjtë të fesë dhe pranon gjithë ata sa pranon Kisha e Shenjtë e Krishtit Ortodokse Lindore themelonjësi dhe kryezot, të cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jesu Krishti. Kisha sundohet prej episkopëve kanonikë duke ruajtur pa ndryshim, si dhe gjithë kishat e tjera ortodokse të Krishtit kanonet e shenjta Apostolike e Sinodike si dhe gojdhënat e shenjta.

Neni II. Në shtetin shqiptar paria ma e naltë kishtare do të jetë sinodi i përhershëm i përbërë prej peshkopësh kanonikë nën kryesinë e një mitropoliti. Ky sinod do të ketë titullin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe do të qëndrojë në kryeqytet.

Neni III. Kisha Ortodokse Autoqefale gjer sa të mbarohen gjithë sa përmbledh nyja II do të sundohet prej një këshilli të përbërë prej klerikësh dhe laikësh nën kryesinë e një kleriku që do të ketë titullin: “Kryetar i Këshillës së Lartë sundimtare të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë. Kjo këshillë do të qëndrojë në Korçë dhe do të ketë vulën me kryqin në mes dhe dy dega dafinash për anash e rrotull. Shkronjat Këshilla e Lartë e Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë dhe viti 1922.

Neni IV. Anëtarët klerikë të kishës së përzierë do të jenë de fakto zëvendëset e rregullt të qendrave e mitropolive të Korçës, Beratit, Durrësit dhe Gjirokastrës të emruar nga Kongresi. Kryetari i Këshillës së përzjerë dhe laikët do të zgjidhen prej Kongresit.

Neni V. Këshilla e lartë do të hyjë në marrëveshje negociatë me patriarkanën e Shenjtë Ekumenike dhe me Patriarkanat e tjera e me këshillat e tjera Autoqefale Ortodokse për njohjen e Kishës sonë zyrtarisht si bijë dhe motër Ortodokse Autoqefale.

Neni VI. Këshilla e lartë do të përkujdeset për të sjellë Brenda 2 vjetëve të paktën 2 episkopë kanonikë me pëlqimin e saj nga Patriarkana Ekumenike ose nga kishat e tjera simotra.

Neni VII. Këshilla e lartë do të kontrollojë dhe do të rregullojë gjith pasuritë e kishave e të manastireve, e pasuritë e tjera për qëllime bamirësie.

Neni VIII. Anëtarët klerikë të këshillës së lartë të mbështëtur në të drejtën kanonike dhe rregulloren në fuqi të Kishës së Madhe do të kenë gjith ato të drejta në Sinod. Sa për administratën e për të zgjedhurit e Episkopatave kjo punë u lihet anëtarëve laikë të bashkuar me anëtarë klerikë.

Neni IX. Episkopët që kanë për të ardhur do të jenë ipso-jure anëtarë të Këshillës së lartë, por të bëjnë be para Këshillës së lartë në këtë mënyrë: “Betohem me ndërgjegje priftërore para Perëndisë se do të jem besnik i shtetit shqiptar dhe statutit të tij dhe Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë duke ruajtur kurdoherë ligjet e shtetit dhe kanonet apostolike të Sinodit të Kishës së Madhe Ortodokse. Këta episkopë do të vendosen nëpër ato episkopata ku e sheh të udhës Këshilla e Lartë e Kishës.

Neni X. Gjuha e kishës është shqipja, por meqenëse disa nga kleri e nga koret nuk janë të stërvitur në gjuhën kishtare dhe në anën tjetër mungojnë mjetet e duhura u jepet e drejta të vazhdojnë në gjuhën e gjertanishme, duke u përkujdesur me sa është e mundur të këndohej në gjuhën e kishës këto: 1- Paqësoret, të cilat përmbledhin dhe lutjet për shtetin e për kishën. 2- Ungjillin, Apostullin dhe predikime për to. 3-Ati ynë, dhe sa mund të shtojnë me kohë.

Neni XI. Këshilla e Lartë Kishtare do të bashkojë episkopatat më të ardhmen të gjitha ato vise që mbeten brenda kufirit të shtetit shqiptar që kanë qenë pjesë mitropolirash të tjera të mbetura jashtë kufirit.

Neni XII. Paga mujore e Kryetarit të këshillit të lartë Kishtar, të anëtarëve, shkronjësve dhe të personelit tjetër të nevojshëm, si dhe të zyrave do të ketë kjo këshillë do të ekonomisen dhe do të caktohen sipas një rregullore të veçantë.

Neni XIII. Librat shqipe kishtare që janë përdorur gjer më sot do të përdoren prapë gjer sa të trajtohet sinodi episkopal, i cili do të vendosë për vazhdimin e përdorimit të tyre. Këta libra do të kenë vulën e Këshillës së Lartë të Kishës. Librat e reja që do të mund të botohen gjer sa të trajtohet sinodi, këto do të përdoren me qëllim të përkohshëm të Këshillit të Lartë të Kishës.

Neni XIV. Ky statut përveç nyjave 2 do të jetë në fuqi gjer sa të trajtohet Sinodi Episkopal i përbërë prej 4 episkopësh brenda 3 muajve do të mbledhë Asamblenë Kishtare dhe do të bëjë statutin e përhershëm mbi bazën e popullsisë duke ju mbështetur një rregulloreje të posaçme për zgjedhjet.

4.2 RREGULLORJA E KISHËS SHQIPTARE

Neni 1. Kisha Orthodhokse autoqefale kombëtare e Shqytpniës përbahet prej të katër Episkopatavet; të Korçës, Durrsit, Beratit dhe të Gjinokastrës me kufit qi kan pasur gjer më sot me titullin Mitropolit. Viset qi janë shkëputur nga Mitropolit e tjera qi gjinden jasht kufinit të Shqipniës dispozohen si mbas nenit 11 të statutit.

Neni 2. Këto Episkopata do të sundohen pas rregulloreve të patriarhijës Ikumenike Ierarhiqisht kështu qi, Zavendësi për sa u përket çashtjevet të rrethit tyre do të drejtohen zavendësvet të përgjithshëm ose Episkopevet dhe këta Këshillës së Lartë Kishtare.

Neni 3. Detyrat e Kryetarit të Këshillës së lartë Kishtare janë këto: 1. Të përkujdeset për mbarëvajtjen të Kishës duke ruajtur e duke mbrojtur gjithë kanonet e shenjta të Apostojvet të mbledhjevet Ikumenike të ligjavet të armonopollit të dhikonemiës dhe të nomollogjis të patriarkiës ekumenike si dhe për të gjitha ato çështje të cilat sipas ligjit veprues të shtetit janë në kompetencën e gjykatoreve Kishtare. 2. Mbledhjet i kryeson Kryetari, në mos u ndodhtë ky, vendin e tij e zë aji qi vjen pas nga shkalla hierarkike të Episkopatave. 3. Mbledhja qi të jetë legale do të ketë ma tepër se gjysma të anëtarëvet.

Neni 4. Vendimet janë ligjore e të fuqishme kur merren me shumicën e votave, në rastë të njivetësije fiton ana e Kryetarit.

Neni 5. Këshilla Kishtare do të mblidhet doemos dy herë në vit në gjasht muaj nji herë, Shenmitërit e Shëngjergjit dhe jashtëzakonisht kur t'a shofi të nevojshme Kryetari.

Neni 6. Nji anëtar i Këshillës së lartë qi nuk ndodhet për shkak të arsyshëm në dy periudha me radhë quhet i rrëzuar dhe në vend të tij zgjidhet tjatër prej popullsis e Episkopatës qi përfaqëson.

Neni 7. Arkëtarin ka të drejtë t'a zgjedhi Këshilla tue i marrë garancië prej tij. Zgjedhja e personalit tjetër do të jetë në dorë të Kryetarit. Arkëtari nuk ka të drejtë të pagoj pa nënshkrimin e Kryetarit si edhe Kryetari nuk ka të drejtë të urdhënojë pagesa jasht buxhetit pa vendimin e Këshillit.

Neni 8. Çdo Episkopatë paguan në arkën e këshillës Kishtare nga: fr. Ari për shtëpi në vit. Mënyra e të mbledhurit i lihet Këshillës.

Neni 9. Kryetari do të paguhet për çdo muej 400 fr. Ari, anëtarët Klerik nga 300 fr. Ari, Anëtarët Llaik do të paguhen vetëm në periudhat të mbledhjeve kështu; anëtarët Llaik qi banojnë në qendër nga 250 fr. Ari, ato të Episkopatavet të tjera qi janë jasht qëndrës nga 350 fr. Ari, veç shpenzimeve të udhëtimit me konditën qi paga të fillojë me të nisurit për udhë; dhe muejin e fundit do t'a marrin të plotë qoftë qi nuk e kan përmbushun. Kryeshkronjësi do të paguhet 300 fr. Ari, shkronjësi i dytë 200 fr.ari, ftuesi 100 fr. Ari, shërbëtori 60 fr. Ari, për shpenzime zjari drit, të mobiluar dhe të tjera të pa pandehura si dërgimi i Komisionit të Patrikanës ose gjetkë 15.000 fr. ari (vazhdojnë nënshkrimet e Deleg).

Berat, 17-9-922.

4.3 STATUTI
I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË
KORÇË 1929

Gjithë kleri dhe populli Orthodhoks i Mbretërisë Shqiptare, i përfaqësuar prej Delegatëve fuqiplotë të mbledhur në Kongresin e Dytë që u mbajt në Korçë, voton me një zë statutin definitiv të Kishës Orthodhokse Shqiptare, të prokllamuar Autoqefale në Kongresin e Beratit më datë 12 Shtator 1922.

KAPTINA I
KISHA

Art. 1. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së Shenjtës Kishë të Përgjithshme dhe Apostolike, përbëhet prej tërë banorëve të Mbretërisë Shqiptare që i besojnë Krishtit dhe pohojnë Simbolin e Shenjtë të Fesë Orthodhokse (to simvolon tis pisteos) dhe ruan të patundshme gjith sa pranon Kisha e Shenjtë Lindore e Krishtit, Themelonjës e Krye i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jisu Krishti.

Art. 2. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë është e bashkuar dogmatisht dhe shpirtërisht me të gjitha Patriarhit' e Shenjta dhe me Kishat Orthodhokse Autoqefale dhe ruan, pa ndonjë ndryshim, si të gjitha Kishat e tjera Orthodhokse të Krishtit, burimet e besimit, shkrimet e shenjta dhe gojëdhanat e Hirshme (Again Grafin qe Hieran Paradhosin) si dhe kanonet e Shenjta Apostolike dhe Sinodike.

Art. 3. Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja.

Art. 4. Autoriteti më i lartë i Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare është Sinodhi i Shenjtë Peshkopal i përbërë prej Peshkopëve aktivë të çdo Dhioqeze, prej Ikonomit të Madh Mitrofor dhe i kryesuar prej Mitropolitit të Qendrës, Kryepeshkopit të gjithë Shqipërisë.

Titulli zyrtar i Sinodhit është: "Sinodhi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë". Peshkopata e Qendrës merr titullin "Mitropoli" dhe titullari i saj quhet Mitropolit i asaj Dhioqeze dhe Kryepeshkop i gjithë Shqipërisë, Peshkopët e tjerë mbajnë titullin Peshkop dhe Dhioqezat e tyre Peshkopata.

Art. 5. Kisha Orthodhokse Shqiptare është person juridik dhe trashëgon të gjithë titujt dhe të drejtat e komuniteteve Orthodhokse të gjertanishme.

KAPTINA II
SINODHI I SHENJTË DHE DETYRAT E TIJ

Art. 6. Sinodhi i Shenjtë: Rregullon Kishën Autoqefale të Shqipërisë për sa i përket besimit, adhurimit (Latria), disiplinës Kishtare, organizimit dhe administrimit

të brendshëm të Kishës në bazë të dogmave dhe të kanoneve të Shenjta dhe në konformitet me Ligjet e Shtetit;

Ushtron kontrollimin mbi veprimet e Peshkopëve dhe të organeve të Kishës, sipas rregullave Kishtare; themelon dhe mban Shkolla Fetare;

Harton programet e tyre dhe i mbikëqyr me anën e Peshkopëve;

Përkujdeset për edukatën fetaro-Kombëtare, për kulturën dhe për të kryerit e detyrave të Klerikëve e të Murgjve;

Kujdeset për edukatën fetare të popullit Orthodhoks me anën e predikimeve Kishtare, të mësimeve Fetare edhe të redaktimit e të botimit të librave dhe të revistave Fetare.

Art. 7. Asnjë libër nuk mund të përdoret në Kishë pa pëlqimin zyrtar të Sinodhit, kështu dhe në shkollë për mësimet e fesë Orthodhokse pa pëlqimin zyrtar të Sinodhit dhe të Ministrisë s'Arësimit.

Art. 8. Librat e Kishës që janë përkthyer do të këqyren prej Sinodhit, i cili e ka për detyrë të kujdeset sa më shpejt për përkthimin dhe botimin e atyre librave të Kishës që mungojnë.

Art. 9. Sinodhi i Shenjtë detyrohet të vejë re që çdo vepër e paraqitur me anë botimesh, gravurash, çfaqjesh theatrale ose kinematografike dhe konferencash publike të mos cënojë ose çnderojë dogmat dhe dispozitat e Orthodhoksisë ose përgjithësisht Klerin si dhe format e tij dhe, n'e paftë t'arsyeshme të kërkojë ndërhyrjen e autoritetevet në konformitet me ligjet e Shtetit.

Kryesia e Sinodhit me pëlqimin e anëtarëvet vendos t'u japë diploma merite atyre që i kanë shërbyer çështjes Kishtare.

MBLEDHJA E SINODHIT TË SHENJTË

Art. 10. Sinodhi mblidhet rregullisht dhe medoemos një herë në vit. Koha e mbledhjes është ipso fakto data 1 Tetor. Mbledhja do të mbajë jo më pak se 15 ditë dhe jo më tepër se një muaj. Kryepeshkopi, për nevoja të domosdoshme dhe me pëlqimin e shumicës së anëtarëve, provokon dhe mbledhje të jashtëzakonshme të Sinodhit. Kryetari çel dhe mbyll mbledhjet.

Art. 11. Sinodhi ka kuorum kur ndodhen prezentë gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Po kurdoherë mbledhje legale mund të bëhet vetëm kur përveç Kryepeshkopit ndodhen dhe dy anëtarë të tjerë.

Në mungesë të Kryepeshkopit, në rast që ky është pushuar, Sinodhi kryesohet prej më të vjetrit në dorëzim; në raste të tjera Sinodhi kryesohet prej Peshkopit t'autorizuar nga Kryetari me kompetencë të caktuar.

Art. 12. Vendimet e Sinodhit merren me shumicë votash.

Në rast njësie provokohet një mbledhje e dytë, në të cilën, në qoftë se ka përsëri njësi votash, paravlen ana e Kryetarit.

Art. 13. Sinodhi ka dhe një Sekretar të Përgjithshëm, i cili proponohet prej Sinodhit dhe emërohet me dekret të Kryepeshkopit. Cilësit'e Sekretarit të Përgjithshëm caktohen në Rregulloren e Administrimit të përgjithshëm.

KAPTINA III
PESHKOPATAT

Art. 14. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ndahet në katër Peshkopata:

a) Peshkopata e Korçës, Përmetit, Voskopojës, Leskovikut dhe Kolonjës.
b) Peshkopata e Durrësit, Tiranës, Shkodrës, Kavajës, Elbasanit, Shpatit, Gorës, Mokrës, Pogradecit dhe Dibrës.
c) Peshkopata e Beratit, Vlorës, Myzeqesë dhe Kaninës.
ç) Peshkopata e Gjinokastrës, Delvinës, Dropullit, Pogonit dhe Himarës, me kufijtë që ka pasë gjer më sot gjithsecila prej këtyre.

Kufijtë e Peshkopatave mund të ndryshohen me proponimin e Sinodhit, me pëlqimin e Qeverisë dhe me dekret Mbretnor.

Qendra e Kishës Autoqefale caktohet me dekret mbretnor. Gjersa të dalë dekreti relativ Kryesia e Kishës qëndron në Korçë.

Peshkopë pa Dhioqezë nuk mund të jenë më tepër se dy.

Art. 15. Kryepeshkopi zgjidhet prej Sinodhit për gjithë jetën e tij. Në rast që Kryepeshkopi i zgjedhur prej Sinodhit nuk pëlqehet prej Mbretit, Sinodhi detyrohet të zgjedhë një tjetër, të cilin i a paraqit Mbretit për pëlqim dhe dekretim. Të gjithë këto veprime për zgjedhje, propozim dhe refuzim mbahen sekrete.

Gjithë në këtë mënyrë zgjidhen dhe Peshkopët e tjerë.

CILËSITË E PESHKOPËVE

Art. 16. Kryepeshkopi, Peshkopët, Zëvendësit e tyre lokalë, Ikonomi i Madh Mitrofor, Sekretari i Përgjithshëm i Sinodhit, si dhe ndihmësit e Zëvendësit Klerikë të Kryepeshkopit dhe të Peshkopëve, duhet të jenë prej gjaku e gjuhe Shqiptarë, si edhe të kenë nënshtetsinë Shqiptare.

Art. 17. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e Shqipërisë që do të dorëzohen, përveç cilësive t'Artikullit 16 duhet të kenë dhe cilësitë që kërkojnë kanonet e Kishës, si dhe të kenë mbaruar një Fakultet Theollogjie.

Në rast nevoje, gjer më pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, mund të dorëzohet Peshkop edhe ay që ka dipllomë fakulteti drejtësie, filologjie ose të një Seminari Orthodhoks në gradë Liceu.

Art. 18. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e tjerë më parë se të fillojnë në detyrën e tyre detyrohen të bëjnë betimet e shënuara më poshtë, një përpara Mbretit, një përpara Sinodhit të Shenjtë.

Betimi përpara Mbretit është:

Betohem dhe premtoj mbi nderin t'im (si Kryepeshkop ose Peshkop) përpara Perëndisë se do të jem kurdoherë besnik i Mbretit të Shqiptarëvet, i Atdheut dhe i Statutit të Mbretërisë. Detyrohem të ve në be në këtë mënyrë dhe gjithë Klerikët që do të dorëzohen prej meje.

Betimi përpara Sinodhit është:

Betohem mbi ndërgjegjen t'ime (Kryepeshkopale ose Peshkopale) përpara Perëndisë se do të ruaj besnikërinë kundrejt dogmave, kanoneve dhe rregullave Kishtare që përmbajnë bashkimin dogmatik fetar dhe soilidarësinë me Patriarhitë dhe Kishat Orthodhokse Autoqefale të botës.

TRANSFERIME

Art. 19. Kryepeshkopi dhe Peshkopët janë të përjetshëm në Dhioqezat e tyre përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut.

Art. 20. Peshkopët mund të transferohen me vendimin e Sinodhit dhe pas pëlqimit e dekretimit Mbretëror.

PUSHIME

Atr. 21. Pushimi i Kryepeshkopit, i Peshkopëvet dhe i Ikonomit të Madh Mitrofor bëhet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinare dhe për arësye ekstraordinare.

a) Për faje të rënda dogmatike e kanonike gjykohen prej një këshille dymbëdhjetë vetash, përveç Kryetarit, të përbërë prej gjithë anëtarëve të Sinodhit të Shenjtë, përveç të akuzuarit prej Peshkopëve Titullarë dhe prej graduatësh Klerikë gjer në numrin e sipërcaktuar, gjashtë prej të cilëve i zgjedh i akuzuari. Vendimi jepet me tri të katërtat e votavet e me vota të fshehta, pasi të dëgjohet më parë apologjia e të akuzuarit.

b) Për faje ordinare Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi Madh Mitrofor pushohen në rast dënimi kundër lirisë personale në një ndëshkim më tepër se një vit dhe sikur këtij ndëshkimi të mos i jetë shtuar ndalimi nga ofiqet publike; dhe kur dënohen me burgim të rëndë, ose me dënime të fajeve relative për fallsifikim, vjedhje, mashtrim, keqpërdorim besimi dhe atentate kundër zakoneve të mira.

Në këto raste dhe Sinodhi detyrimisht vendos pushimin e tyre.

c) Për arsye ekstraordinare, të shpjeguara drejt për drejt e me dekret mbretëror Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për veç rasteve të përmendura në paragrafin e sipërm, largohen me një herë nga detyra me dekret mbretëror.

Në rast dekretimi largimi prej detyre i Kryepeshkopit, ky zëvendësohet me një herë prej Peshkopit më të vjetër në dorëzim; në rast dekretim largimi të një Peshkopi, Kryepeshkopi emëron me një herë Zëvëndësin e përgjithshëm.

Në rast pushimi të tillë brenda dyzet ditëve ipso fakto, mblidhet Sinodhi i cili bashkë me pushimin e të larguarit, vendos zgjedhjen e Peshkopit për përmbushjen e Dhioqezës vakante.

Në rast pushimi të Kryepeshkopit, për çfarëdo arësye, ky ka të drejtë të marrë një rrogë të përmuajshme prej pesëqind frangash ari.

Gjithashtu në rast pushimi për çfarëdo arsye të Peshkopëvet dhe të Ikonomit të Madh Mitrofor, këta marrin nga një rrogë të përmuajshme prej 300 fr. ari.

Art. 22. Kryepeshkopi, Peshkopët dhe Ikonomi i Madh Mitrofor, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e

tyre Peshkopale, kanë të drejtë t'i paraqisin kanonikisht dhe me të shkruar dorëheqjen e tyre Sinodhit, i cili vendos. Po Sinodhi mundet edhe motu proprio të çfaqi mejtimin mbi sëmundjen ose pleqërinë e tyre pas një raporti prej pesë mjekësh të zgjedhur dy prej Sinodhit vetë, dy prej të sëmurit dhe një prej Drejtorisë së P. të Shëndetësisë.

Në qoftë se Kryepeshkopi ose Peshkopët nuk japin dorëheqjen brenda dy javëve prej datës së komunikimit, Sinodhi me një herë emëron një ndihmës Peshkop, i cili merr përsipër administrimin e Peshkopatës. Kryepeshkopi dhe Peshkopët të deklaruar të pamundur mbajnë titullin e tyre dhe përmenden në Kishë e në ceremonitë e Shenjta prej ndihmësit Peshkop dhe prej gjithë Klerit, po nuk ushtrojnë asnjë veprim administrativ dhe nuk marrin asnjë pjesë aktive n'administrimin e Kishës. Në qoftë se Doktorët raportojnë pamundërinë e tyre, ata japin dorëheqjen duke marrë nga arka e përgjithshme e Kishës një shpërblim të përmuajshëm për Kryepeshkopin gjashtëqind franga ari, dhe për Peshkopët katërqind fr. ar.

DETYRAT E PESHKOPËVE

Art. 23. Kryepeshkopi dhe Peshkopët në Dhioqezat e tyre janë autoriteti Kishtar dhe ushtrojnë të gjitha detyrat që janë caktuar në kanonet e Shenjta, në rregulloret Kishtare dhe në këtë Statut. Ata janë në juridiksionin e Sinodhit dhe ekzekutojnë vendimet dhe urdhërat e tij, sipas dispozitave të këtij Statuti.

Për çdo kundërvajtje ose pakujdesi në detyrat e tyre Kishtare janë përgjegjës përpara Sinodhit. Në gusht të çdo viti janë të detyruar të paraqesin një raport të veprimeve të tyre dhe të gjendjes së Peshkopatës. Ky raport këndohet përpara Sinodhit dhe mosparaqitja e tij konsiderohet si një shkelje detyre.

Art. 24. Kryepeshkopi dhe Peshkopët në Dhioqezat e tyre, si në Qendër ashtu dhe në rrethet e saj, ushtrojnë të gjitha detyrat të imponuara prej kanoneve Kishtare; Celebrojnë Misteret e Shenjta; Predikojnë fjalën e Shenjtë; konsakrojnë Kishat e Shenjta; përkujdesen që të përmbushin të gjitha shërbesat fetare, sipas dispozitave tipike relative; përkujdesen për zbukurimin e hijshëm të Kishave si dhe të Ikonave të Shenjta, vendosja e të cilave kërkon autorizimin e tyre të mëparshëm; përkujdesen për enët e petkat e Shenjta dhe për çdo gjë tjetër që përdoret në Kishë.

Art. 25. Kryepeshkopi dhe Peshkopët detyrohen të shëtisin një herë në vit nëpër Dhioqezat e tyre për përmbushjen e detyrave Peshkopale.

Kryepeshkopi për Dhioqezën e tij mund t'ia ngarkojë këtë detyrë ndihmësve Peshkopë ose në mungesë Zëvendësit të tij.

Art. 26. Asnjë Peshkop nuk mund të largohet prej Dhioqezës së vet pa marrë leje nga Kryetari i Sinodhit dhe gjithashtu nuk mund të qëndrojë në Peshkopatën e një peshkopi tjetër pa autorizimin e këtij.

Art. 27. Kryepeshkopi dhe Peshkopët emërojnë Zëvendësit e Tyre në konformitet me Artikullin gjashtëmbëdhjetë (16) të këtij Statuti.

Art. 28. Ikonomi i Madh Mitrofor është i detyruar të kryej çdo mision që i ngarkohet prej Sinodhit dhe merr pjesë në të me të gjitha të drejtat e çdo anëtari.

Në rast që mbetet vakant vendi i Ikonomit të Madh Mitrofor, nuk zëvendësohet me tjetër person dhe ky ofiq suprimohet.

KAPTINA IV
MASA DISIPLINORE

Art. 29. Kryepeshkopi dhe Peshkopët, për gabime të lehta Kishtare të Klerikëve dhe të Murgjve që ndodhen në juridiksionin e tyre, pasi të dëgjohet më parë i akuzuari, kanë të drejtë të ndëshkojnë në mënyrë të prerë dhe pa tjetër formalitet procedure:

a) me qortim;

b) me pezullim (argji) nga çdo shërbim fetar gjer më pesëmbëdhjetë ditë.

Për këto ndëshkime Peshkopi mban një procesverbal, i cili ruhet në arkivat e Peshkopatës.

Art. 30. Në qendrën e çdo Peshkopate ekziston një Këshillë Kishtare disiplinore, e cila gjykon fillimisht për faje fetare Klerikët dhe Murgjit që ndodhen në juridiksionin e saj ose qëndrojnë n'atë Peshkopatë. Kjo Këshillë Kishtare përbëhet prej Peshkopit vetë si kryetar dhe prej katër Priftërinjve si anëtarë. Këta emërohen dhe pushohen prej Peshkopit dhe emërimi ose pushimi i tyre i njoftohet Sinodhit.

Kryepeshkopi dhe Peshkopët mund të formojnë Këshillën Kishtare disiplinore edhe jashtë Qendrës. Vendimet merren me shumicë votash. Kur Kryepeshkopi dhe Peshkopët ndodhen të penguar, vendin e tyre e zënë zëvendësit Klerikë. Kjo Këshillë përbëhet kurdoherë prej pesë anëtarësh dhe plotësohet në mungesë me ndonjë prej tyre.

Art. 31. Këshilla Kishtare ka të drejtë të japë këto ndëshkime:

a) Qortim

b) Pezullim (argji) nga çdo shërbesë fetare jo më tepër se një vit;

c) Prerje rroge të shoqëruar me ose pa pezullim gjer në një vit.

Ndëshkimet me qortim dhe me pezullim (argji) gjer më 40 ditë janë të prera; të tjerat janë të apelueshme nga ana e t'akuzuarit përpara Këshillës disiplinore të përhershme në qendrën e Kishës.

Në qoftë se një klerik akuzohet për një faj të rëndë që provokon skandal, Kryepeshkopi ose Peshkopi mund t'a ndalojë këtë me një herë nga shërbesa fetare po jo më tepër se dy muaj.

KAPTINA V
KËSHILLA DISIPLINORE E PËRHERSHME

Art. 32. Në qendrën e Kishës krijohet një Këshillë Disiplinore e përhershme që përbëhet prej Kryepeshkopit si Kryetar dhe prej katër anëtarëve, Peshkopë ose Klerikë graduatë, të zgjedhur prej Sinodhit. Ky zgjedh katër anëtarë suplementarë për të zëvendësuar anëtarët në rast mungese.

Kur Sinodhi ndodhet i hapur, detyrën e kësaj Këshille e përmbush ai vetë.

Të gjitha vendimet e Këshillës Disiplinore të përhershme merren me shumicë votash.

Art. 33. Këshilla Disiplinore e përhershme gjykon:

a) Apelisht dhe defitinivisht vendimet e apelueshme të këshillave disiplinore të Peshkopatave;

b) Fillimisht fajet e rënda të cilat, pas vendimit të Këshillës Disiplinore Peshkopale, sjellin dënime më të mëdha se ato të shënuara në artikullin 30, si dhe fillimisht çgradimin definitiv (katheresin).

Vendimet e dhëna fillimisht prej Këshillës Disiplinore të përhershme apelohen përpara Sinodhit.

Art. 34. Apeli i vendimeve të dhëna prej Këshillës Disiplinore të peshkopatave dhe të Këshillës disiplinore të përhershme bëhet brenda 30 ditëve prej datës në të cilën i komunikohet të dënuarit vendimi. Ky komunikim do t'i bëhet të interesuarit brenda 15 ditëve prej datës së vendimit.

Kërkesa e apelit i dorëzohet Kryetarit të Këshillës që dha vendimin, i cili brenda 15 ditëve e dërgon në Këshillën Disiplinore të përhershme.

Art. 35. Sinodhi gjykon a) Apelisht dhe definitivisht të gjitha vendimet e dhëna Këshillës Disiplinore të përhershme; b) Peshkopët dhe Ikonomin e Madh Mitrofor për faje të lehta.

Vendimet e dhëna prej Këshillave Disiplinore me pezullim zbatohen menjëherë.

Art. 36. Kryepeshkopi për faje të lehta dhe të rënda Kishtare gjykohet përpara Këshillës së formuar sipas artikullit 21 a.

Art. 37. Të gjitha vendimet që sjellin pushimin e Kryepeshkopit, të Peshkopëve dhe të Ikonomit të Madh Mitrofor i paraqiten Mbretit për dekretim.

Art. 38. Ekzekutimi i dënimit për çgradim (katheresis) të klerikëve bëhet sipas kanonevet Kishtare dhe i dënuari me çgradim detyrohet të nxjerrë petkat fetare dhe shenjat e tjera të ofiqit, për ndryshe dënohet në bazë të artikullit 214 të Kodit Penal.

KAPTINA VI
ORGANIZIMI I ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Art. 39. Kishat, Manastiret dhe pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme si dhe ato të komunitetit Orthodhoks janë të siguruara në komformitet me ligjet e Shtetit.

Art. 40. Burime financiare të Kishës janë:

a) Të ardhurat e Kishave dhe të Manastireve si dhe të pasurive të komunitetit Orthodhoks;

b) Subvensioni i dhënë prej shtetit për ndihmën e kishës;

c) Pagesa fakultative si dhe çdofarë dhurate ose ndihme e dhënë prej Shqiptarëve.

Art. 41. Kryepeshkopi dhe Peshkopët e çdo Dhioqeze kanë të drejtë të mbledhin ndihmat fakultative të zakonshme për dobinë e Kishës ose personale të tyre nga çdo familje Orthodhokse, siç do të caktohet në rregullore.

Art. 42. Asnjë pasuri e patundshme kishtare ose manastiriale si edhe e komunitetit Orthodhoks nuk mund të jetërsohet pa vendimin e Këshillës Mikst, për ndryshe jetërsimi është i pavlefshëm.

Mënyra e administrimit dhe e çfrytëzimit të pasurive të tundshme dhe të patundshme si edhe mënyra e shitjes së pasurive të tundshme të Kishave, Manastireve dhe komuniteteve Orthodhokse caktohet në Rregulloren e përgjithshme t'administrimit.

Art. 43. Autoritetet e Kishës Autoqefale detyrohen t'i paraqesin kur të kërkohen, inspektorit të Ministrisë së Drejtësisë të gjitha llogaritë e t'ardhurave e të të prishurave. Në rast që konstatohet se është bërë abuzim, kundërvepronjësit dërgohen në gjyq prej Ministrisë së Drejtësisë dhe dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

KAPTINA VII
KËSHILLA MIKST

Art. 44. Për administrimin dhe kontrollimin e pasurive të Kishave, të Manastireve, të komuniteteve Orthodhokse të çdo lloji dhurate dhe ndihme si dhe të subvensionit të shtetit krijohet në Qendrën e Kishës një këshillë me emrin "Këshilla Mikst" e përbërë prej të gjithë anëtarëve të Sinodhit dhe prej katër Laikësh, një për çdo Dhioqezë, nën kryesinë e Kryepeshkopit.

Të zgjedhurit e Laikëvet në fjalë dhe kompetenca si dhe të drejtat e tyre do të caktohen në Rregulloren e administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale.

Për këtë herë katër anëtarët laikë zgjidhen prej kongresit.

Rregullorja e administrimit të përgjithshëm do të elaborohet prej Këshillës Mikst së cilës do t'i shtohen edhe katër anëtarë laikë një prej çdo Dhioqeze të zgjedhur po prej këtij kongresi. Në Rregulloren do të caktohen rrogat dhe shpërblimet e Kryepeshkopit, Peshkopëve dhe Ikonomit të Madh Mitrofor si dhe të nëpunësve të tjerë klerikë dhe laikë; do të formulohet mënyra e zgjedhjeve të Pleqësive Kishtare (Dhimogjerondive) dhe të kujdestarëve të Kishave e të Manastireve.

Kjo Rregullore do të elaborohet prej Këshillës Mikst, të formuar si më sipër, brenda gjashtë muajve pas datës së dekretimit të këtij Statuti.

Art. 45. Këshilla Mikst harton për çdo vit buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës, një kopje e të cilit i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë për veprimet e parapara në dispozitat e Rregullores së përgjithshme t'administrimit.

Art. 46. Pasuritë e tundshme dhe të patundshme që u janë lënë komunitetevet Orthodhokse, Kishave ose Manastireve me një qëllim mirëbërës të caktuar, ndodhen nën kontrollimin e Kishës e cila përkujdeset për të kryerit e qëllimit dhe për ekzekutimin e dëshirës së dhuronjësit.

Art. 47. Pranë Kryekishës krijohet Arka e përgjithshme në të cilën hyjnë të gjitha të ardhurat e Kishës sipas artikullit 40 dhe prej kësaj bëhen pagesat sipas Rregullores së administrimit.

Art. 48. Çdo zëvendës lokal bashkë me Pleqsinë Kishtare harton Buxhetin preventiv të përvitshëm për të gjitha të ardhurat dhe të prishurat të juridiksionit të tij për pasuritë e komunitetevet Orthodhokse dhe për pasuritë dhe të ardhurat e Kishavet. Ky buxhet i dërgohet Peshkopatës kompetente gjer më një gusht. Peshkopata, pasi të mbledhë buxhetet e të gjithë Dhioqezës së saj, me vërejtjet e duhura, ia dërgon Qendrës brenda 30 ditëve.

Art. 49. Për çdo Manastir hartohet një buxhet i veçantë, i cili më një gusht i paraqitet Peshkopatës dhe kjo ia dërgon Qendrës me vërejtjet e duhura dhe bashkë me buxhetet e tjera për aprovim.

Art. 50. Viti financiar i Kishës fillon më një janar dhe buxheti preventiv i dërgohet çdo Peshkopate përpara kësaj date.

Buxheti konsumativ hartohet brenda muajit mars për të ardhurat dhe të prishurat e vitit të shkuar. Ky buxhet, bashkë me tepricën e t'ardhuravet, i dërgohet çdo Peshkopate brenda muajit mars. Teprica e t'ardhurave të Manastireve i dërgohet Qendrës në çdo 6 muaj.

Art. 51. Në qendrën e Kishës ndodhet një Këshillë ekonomike e përhershme që përbëhet prej Kryepeshkopit dhe katër laikëve. Këta të fundit zgjidhen prej Këshillës Mikst dhe detyrat e tyre caktohen në Rregullore.

Art. 52. Në Arkën e Përgjithshme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nuk mund të mbahen më tepër se katër mijë fr. ari, teprica depozitohet në një nga Bankat Shqiptare n'emrin e saj dhe tërhiqet sipas dispozitave të Regullores s'administritimit.

Art. 53. Rregullorja e Administrimit të përgjithshëm për të hyrë në fuqi, duhet të aprovohet nga Ministria e Drejtësisë.

KAPTINA VIII

Art. 54. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë detyrohet në çdo meshë të bëjë lutje për Mbretin, për gjithë Kombin Shqiptar dhe për ushtrinë.

Art. 55. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë n'asnjë mënyrë nuk mund të pranojë, në çdo emër qoftë, dhurata nga një fuqi e huaj dhe veprimi i kundërt shkakton zbatimin e dispozitave të ligjës mbi fajet politike.

Art. 56. Sinodhi do të veprojë për përmirësimin që kërkojnë konditat shoqërore të sotme mbi sa u përket zakoneve fetare.

Art. 57. Asnjë klerik nuk mund të funksionojë fenë orthodhokse në Shqipëri pa qenë i emëruar dhe i lidhur me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Art. 58. Të gjithë ata Klerikë për të cilët flet artikulli 16 dhe që ndodhen në shërbim të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilët nuk kanë konditat e lypura prej atij artikulli, që ditën e aprovimit të këtij Statuti janë të pushuar nga funksioni Fetar klerikal.

Art. 59. Asnjë laik ose Murg nuk mund të dorëzohet Prift ose Dhjak pa pasur pëlqimin e Sinodhit dhe pa pasur diplomën e Seminarit Orthodhoks.

Art. 60. Të gjitha marrëdhëniet që do të ketë Kisha Autoqefale e Shqipërisë me Qeverinë Mbretërore do të bëhen me anën e Ministrisë së Drejtësisë.

Art. 61. Çdo Peshkopatë ka vulën e saj në të cilën do të jetë shkruar: Peshkopata e (Emri i Dhioqezës).

DISPOZITAT E FUNDIT

Art. 62. Në rast herezie të një pjese ose të gjithë popullsisë Orthodhokse të një krahine, Kishat, Manastiret dhe pasuritë e tyre i mbeten Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Art. 63. Në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshohen, të modifikohen ose të abrogohen artikujt 1,2, e 3.

Art. 64. Mund të ndryshohen me vendim të Këshillës Mikst bashkë me Këshillën e përhershme artikujt: 10; 14 a, b; 25; 40; 48; 49; 52 e 60.

Dispozitat e tjera të këtij Statuti mund të ndryshohen me vendim të një kongresi tjetër.

Ky statut i paraqitet Qeverisë për të marrë formën ligjore.

Korçë, 29 Qershor, 1929.

4.4 RREGULLORJA
E ADMINISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KISHËS

Organizimi i brendshëm i Kishës dhe administrimi i pasurive të manastireve, të kishave dhe të komuniteteve fetare, si dhe të çdo lloj dhurate ose ndihme që bëhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

KAPTINA I
KËSHILLI MIKST

Art. 1-Autoriteti m'i lartë për administrimin dhe kontrollimin e pasurive është Këshilli Mikst, i cili e ushtron kompetencën e tij me anën e Këshillit Ekonomik të Përhershëm, sipas detyrave dhe të drejtave që i caktohen në këtë Rregullore.

Art. 2.-Këshilli Mikst formohet sipas dispozitave relative të Statutit.

Anëtarët laikë zgjidhen në këtë mënyrë:

Peshkopi i çdo Dioqeze një muaj më parë se të mbarojë periudha e anëtarëve të Këshillit Mikst, provokon, me anë deklarate, kandidaturën e çdo besniku që ka cilësitë e kërkuara prej artikullit 3 për anëtar të Këshillit Mikst. Kandidaturat pranohen brenda 15 ditëve prej datës së deklaratës.

Peshkopi emrat e kandidatëve u a komunikon të gjitha pleqësive kishtare të Dioqezës së tij me anën e zevendësve lokalë.

Pleqësitë kishtare, me vendim të tyre, zgjedhin një prej kandidatëve të paraqitur.

Vendimi i dërgohet Qendrës së Peshkopatës me anë të zëvendësve.

Pleqësia Kishtare e Qendrës së Peshkopatës (Dhimogjerondia) deklaron për anëtar'të Këshillit Mikst kandidatin që ka fituar shumicën e votave. Në rast njësie votash, Pleqësia Kishtare e Qendrës heq shortin midis atyreve që kanë vota të njëshme.

Çdo anëtar zgjidhet për dy vjet dhe mund të rizgjidhet për periudhën e dytë po jo dhe për të tretën.

Art.3.-Anëtarët laikë duhet të kenë mbaruar një shkollë të mesme të plotë dhe të kenë të gjitha cilësitë që kërkohen për nëpunësit e Shtetit.

Art.4.-Kompetenca e Këshillit Mikst është:

a) të caktojë mënyrën e përgjithshme për administrimin e pasurive të Kishave, të Manastireve, të komuniteteve Orthodhokse, të çdo lloj dhurate dhe ndihme si dhe të subvencionit të Shtetit;

b) të kontrollojë të gjitha veprimet e Këshillit Ekonomik të Përhershëm;

c) të vendosë mbi jetërsimin e pasurive;

ç) të hartojë buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës, një kopje e të cilit i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë në konformitet me dispozitat e ligjës së administrimit të pasurive të komuniteteve për aprovim.

MBLEDHJET E KËSHILLIT MIKST

Art. 5.-Këshilli Mikst detyrohet të mblidhet një herë në vit në kohën kur ndodhet i mbledhur Sinodhi, sipas thirrjes së Kryetarit.

Kryepeshkopi, në rast pune të jashtëzakonshme, që i përket kompetencës së Këshillit Mikst, e mbledh këtë pasi të marrë pëlqimin e shumicës së anëtarëve.

Art. 6.-Mbledhjet e Këshillit Mikst kryesohen prej Kryepeshkopit.

Këshilli Mikst ka quorum kur ndodhen tre laikë dhe tre klerikë midis të cilëve përmblidhet dhe Kryetari.

Vendimet merren me shumicë votash. Në rast njësie, paravlen ana e Kryetarit.

KAPTINA II
KËSHILLI EKONOMIK I PËRHERSHËM

Art. 7.-Këshilli Ekonomik i Përhershëm formohet sipas artikullit 51 të Statutit dhe anëtarët e tij zgjidhen për tre vjet.

Pas mbarimit të këtij afati, anëtarët laikë mund të zgjidhen pasi të kalojë një periudhë tre vjetësh prej ditës së mbarimit të afatit të tyre.

Anëtarët laikë duhet të kenë të gjitha cilësitë që kërkohen për nëpunësit e Shtetit.

Art. 8.-Këshilli Ekonomik i Përhershëm emëron administratorët e Manastireve të cilët janë klerikë dhe mbajnë titullin Igumen. Kryetari dekreton emërimin e tyre, duke pasur vetëm arsye shpirtërore.

Igumeni merr rrogën që caktohet në buxhet.

KAPTINA III
KËSHILLI IGUMENAL

Art. 9. –Këshilli Igumenal përbëhet prej Igumenit dhe dy laikëve, një prej qytetit dhe një prej fshatit më t’afërm të manastirit.

Anëtarët laikë të këtij këshilli zgjidhen si pason:

Peshkopi paraqet gjashtë kandidatë, tre prej fshatit në të cilin ndodhet Manastiri dhe tre prej qytetit më t’afërm, Qendër Peshkopate ose Qendër zëvendësie. Kandidatët e fshatrave i paraqiten pleqësive të fshatrave përkatëse të cilat prej të treve zgjedhin dy; kandidatët e qyteteve i paraqiten pleqësive kishtare të qytetit përkatës dhe ajo prej të treve zgjedh dy. Të katër kandidatët të zgjedhur në këtë mënyrë i paraqiten Këshillit Ekonomik të Përhershëm, i cili prej tyre zgjedh dy, një prej qytetit dhe një prej fshatit.

Art. 10. – Kompetenca e Këshillit Igumenal është:

a) të kqyrë mbarëvajtjen dhe rregullin e Manastirit, të administrojë pasuritë e tij, sipas urdhërave hierarkike;

b) të vërë në ankand çdo shfrytëzim pasurie të tundshme dhe të patundshme;

c) të shesë në ankand, sipas ligjeve të ankandeve, produktet dhe frytet e përmotshme. Në rast nevoje, Këshilli Igumenal mban të drejtën të bëjë shitje pa

ankand të produkteve dhe të fryteve të përmotshme një herë në çdo 2 muaj dhe vetëm kur shuma nuk kapërcen të 150 (njëqind e pesëdhjetë) fr. ari.

ç) të mbledhë të ardhurat, arkëtar i të cilëve do të jetë anëtari laik prej qytetit. Ky paguan me urdhër-pagese të nënshkruar prej Igumenit, në bazë të vendimit të Këshillit Igumenal, i cili e ka për kompetencë të caktojë shumën e përmuajshme për nevojat e ditës.

d) të mbajë libra kontabilteti të rregullshme për të cilat ka një ndihmës llogaritar me shpërblim të caktuar në buxhetin e Manastirit;

dh) të vendosë mbi nevojën e jetërsimit të pasurive të patundshme, i cili përmbarohet pasi vendimi të aprovohet prej Këshillit Mikst.

Këshilli Igumenal dorëzon në çdo gjashtë muaj t'ardhurat në Arkën e Përgjithshme dhe gjithashtu paraqet një raport relativ.

Art. 11.- Në fund të çdo adjudikate Këshilli kompetent, me anën e Kryetarit të tij, duhet të lidhë kontratë me sipërmarrësin dhe ta vërtetojë në noteri. Shpenzimet përkatëse rëndojnë mbi sipërmarrësin me gjithë taksat shtetërore dhe komunale të lypura prej ligjeve.

MBLEDHJET E KËSHILLIT IGUMENAL

Art. 12. – Këshilli Igumenal mblidhet një herë në muaj rregullisht dhe, në rast nevoje, dy herë.

Art 13. – Peshkopi ruan mbi Igumenin të gjitha të drejtat kanonike për disiplinën kishtare si dhe për lejimin ose pushimin e meshimit për arësye kanonike dhe të justifikuara.

KAPTINA IV
PLEQËSITË KISHTARE

Art. 14. – Pleqësitë kishtare (Dhimogjeronditë) të qytetit përbëhen prej gjashtë vetash dhe zgjidhen për dy vjet.

Zgjedhja e këtyre Pleqësive bëhet në mënyrën indirekte si pason:

Prej 1 gjer më 1000 frymë zgjidhen katër për çdo 250 frymë;
Prej 1001 gjer më 2000 frymë zgjidhen tre për çdo 250 frymë;
Prej 2001 gjer më 3000 frymë zgjidhen dy për çdo 250 frymë;
Prej 3001 e lart zgjidhet një për çdo 250 frymë;

Art. 15. – Zgjedhësit e parë që të mundin të votojnë duhet të kenë të gjitha ato cilësi që kanë zgjedhësit e parë në zgjedhjen parlamentare dhe të jenë në rregull me pagesat fakultative dhe llogaritë kishtare.

Art. 16. – Zgjedhësit e dytë duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën shqipe dhe të jenë 25 vjeç e lart.

Art. 17. – Pleqtë (dhimogjerondët) duhet të dinë të shkruajnë dhe të këndojnë gjuhën shqipe dhe të jenë 30 vjeç e lart.

Art. 18. – Pleqësitë Kishtare të katundevet përbëhen prej priftit të fshatit dhe dy laikësh. Këta të fundit zgjidhen prej popullit të katundit për dy vjet dhe zgjedhjet e tyre konfirmohen prej Peshkopit.

Mbledhjet e Pleqësive Kishtare të fshatrave mbahen nën kryesinë e priftit.

Kompetenca e tyre është si ajo e Pleqësive të qyteteve.

Pleqësitë kishtare të katundeve zgjedhin dy kandidatë për kujdestar. Këta i paraqiten Peshkopit, i cili emëron një prej tyre.

Art. 19. – Administrimi i pasurivet të kishave dhe të komunitetevet fetare bëhet prej Peshkopit ose Zëvendësit të tij së bashku me Këshillat Kishtarë të qytetevet ose të katundeve.

Art. 20. – Kompetenca e Pleqësive Kishtare është:

a) të emërojë kujdestarët (epitropët e Kishave)
b) të zgjedhë priftërinjtë dhe dhjakët duke votuar për këtë punë dhe kujdestarët e Kishës përkatëse në të cilën emërohen prifti ose dhjaku;
c) të kqyrë mbarëvajtjen dhe rregullin e Kishës, të administrojë pasuritë e saj sipas urdhërit hirarkik dhe të veprojë sipas artikullit 10 të kësaj Rregulloreje.

Në emërimin e priftërinjve dhe të dhjakëve, Peshkopi mban veton për arësye shpirtërore, të cilat nuk detyrohet t'i bëjë të njohur asnjeriu dhe në asnjë mënyrë.

ç) të hartojë buxhetin preventiv të çdo viti dhe t'ia dërgojë Peshkopatës sipas artikullit 48 të Statutit.

Art. 21.- Në rast neglizhence të rëndë ose mosmarrëveshjeje të Pleqësive, dërgohet si inspektor një prej Qendrës mbi raportin e të cilit Këshilli Ekonomik i Përhershëm vendos duke pasur të drejtë të shpërndajë Pleqësinë e vjetër dhe të zgjedhë një të re.

Kujdestarët e Qendrave të Peshkopatës pushohen për neglizhencë të rëndë prej Pleqësisë Kishtare dhe ata jashtë Qendrës prej Peshkopit, pas propozimit të Këshillave Kishtare lokale.

Art. 22. – Pleqësitë Kishtare si dhe ato Igumenale veprojnë sipas buxhetit të përgjithshëm t'aprovuar prej Këshillit Mikst.

Art. 23. – Peshkopi ruan veton për psaltët dhe kishtarët.

KAPTINA V
KUJDESTARËT

Art. 24. – Kujdestarët e Kishave të qyteteve dhe të katundeve emërohen prej Pleqësive Kishtare relative, dekretohen prej Peshkopit kompetent dhe janë dy për secilën kishë. Në kishat që kanë popullsi të madhe emërohen dhe dy ndihmës kujdestarë. Koha e vazhdimit të tyre është dy vjet dhe shërbejnë darovisht.

Art. 25. – Të drejtat e kujdestarëve janë:

a) të marrin pjesë në Këshillin e Pleqësive Kishtare për zgjedhjen e priftërinjve dhe të dhjakëve;
b) të emërojë dhe të pushojë, së bashku me Pleqësitë Kishtare, psaltët dhe kishtarët;

Vendimet dekretohen prej Peshkopit kompetent. Organizimi i Koreve mbetet në kompetencën e Peshkopëve.

c) të kujdesen për mirëmbajtjen e Kishës, të shpenzojnë sipas buxhetit të caktuar dhe të kujdesen për shtimin e t'ardhurave;

ç) t'inkasojë t'ardhurat dhe çdo katër muaj të paraqesë një raport për gjendjen e Kishës dhe të personelit të saj.

Kujdestarët e kishave të katundeve si dhe arkëtarët e Këshillës së kujdestarëve të qyteteve janë të detyruar t'i dorëzojnë të hollat në çdo tre muaj Arkëtarit të Pleqësisë Kishtare të vendit.

Arkëtarët e Pleqësisë Kishtare tepricat e të gjitha të ardhurave ia dërgojnë Arkëtarit të Qendrës së Peshkopatës në fund të çdo viti.

Në rast që teprica kalon 2000 (dy mijë) fr. ari, këto depozitohen në një nga Bankat shqiptare më të afërme.

Regjistrat do të bëhen prej Qendrës në formë të njëshme, do të shpërndahen ndër Dioqeza dhe do të vërtetohen prej Peshkopit.

Art. 26. – Çdo Pleqësi Kishtare emëron prej gjirit të saj arkëtarin. Kur kujdestarët janë më tepër se një, Peshkopi emëron arkëtar njërin prej tyre; në rast se është i vetëm, ky ipso facto mbetet arkëtar.

Arkëtari i Këshillit të kujdestarëve do t'i dorëzojë tepricat e kishës, sipas buxhetit, në Arkën e Pleqësisë kishtare lokale. Kjo ia dorëzon Arkës së Qendrës së Dioqezës, e cila ia dorëzon Arkës së Përgjithshme. Peshkopët tepricat i dorëzojnë një herë në vit në Qendër.

Art. 27. – Kujdestarët detyrohen të regjistrojnë të gjitha të ardhurat hollësisht në libra zyrtare të dërguara posaçërisht prej Kryesisë.

Art. 28. – Priftërinjtë mund të transferohen për arësye të jashtëzakonshme prej Peshkopit të Dioqezës dhe me pëlqim të Kryepeshkopit.

KAPTINA VII
ANËTARËT E SINODHIT

Art. 29. – Mitropoliti i Qendrës dhe Kryepeshkopi merr një rrogë të përmuajshme prej 800 (tetëqind) fr. ari dhe një shpërblim përfaqësimi prej 300 (treqind) fr. ari në muaj.

Peshkopët kanë nga një rrogë të përmuajshme prej 600 (gjashtëqind) fr. ari.

Ikonomi i Madh Mitrofor ka një rrogë të përmuajshme prej 400 (katërqind) fr. ari dhe 100 (njëqind) franga ari si shpërblim i anëtarit të Sinodhit të Shenjtë.

Peshkopët titullarë (pa Dioqezë) kanë një rrogë prej 400 (katërqind) fr. ari në muaj.

Në rast se një Peshkop mban zëvendësinë e një Peshkopate tjetër, merr dhe gjysmën e rrogës së Peshkopit që zëvendëson.

PERSONELI

Art. 30. – Sekretari i Përgjithshëm ka rrogë të përmuajshme fr. ari 300 (treqind) në muaj.

Llogaritari i Përgjithshëm ka rrogë të përmuajshme 250 (dyqind e pesëdhjetë) fr.ari.

Sekretari 160 (njëqindegjashtëdhjetë);

Kopisti 150 (njëqind e pesëdhjetë);

Dhjaku ose nën Dhjaku i kryesisë 120 (njëqind e njëzet);

Dy shërbëtorët nga 100 për çdo njeri;

Predikonjësi i Përgjithshëm 300 (treqind).

PERSONELI I KËSHILLIT MIKST

Art. 31. – Për mbledhjet e rregullshme të Këshillit Mikst çdo anëtar laik për shpërblim dhe shpenzimet e udhëtimit merr 400 (katërqind) fr.ari.

Për mbledhjet e jashtëzakonshme çdo anëtar laik merr shpenzimet e udhëtimit dhe 20 (njëzet) fr.ari. në ditë.

ANËTARËT E KËSHILLIT EKONOMIK TË PËRHERSHËM

Art. 32.- Çdo anëtar i Këshillit Ekonomik të Përhershëm merr 10 (dhjetë) fr. ari për çdo mbledhje.

PERSONELI I PESHKOPATAVE

Art. 33. – Sekretari i Peshkopatave merr një rrogë të përmuajshme prej 200 (dyqind) fr. ari;

Dhjaku ose nëndhjaku i çdo Peshkopate 100 (njëqind);

Shërbëtorët 80 (tetëdhjetë).

Zëvendësit lokalë klerikë marrin nga 30 (tridhjetë) fr. ari.

Për subvencionin e priftërinjvet vihet në dispozitë një shumë prej 30.000 (tridhjetmijë) fr. ari.

Për përmbushjet e Seminarit lihen në dispozitë 40.000 (dyzetmijë) fr. ari.

Art. 34. –Këshilli Mikst në hartimin e buxhetit është i detyruar të caktojë shumën e të hollave të duhura për të dërguar dhe për të përmbajtur në një nga fakultetet theollogjike dy gjer më katër studentë.

Për botimin e revistës lihen në dispozitë 600 (gjashtëqind) fr. ari.

CILËSITË E PERSONELIT

Art. 35 – Predikonjësi i Përgjithshëm dhe Instruktori duhet të jetë i diplomuar prej një fakulteti theollogjie dhe, në rast nevoje, këtë vend mund t'a zerë dhe një nga graduatët klerikë të provuar në zotësi.

Art. 36 – Sekretari i Përgjithshëm duhet të ketë mbaruar një shkollë të mesme dhe duhet të dijë një gjuhë të huaj të Oksidentit.

Llogaritari i Përgjithshëm duhet të ketë mbaruar një shkollë tregtare ose një shkollë të mesme;

Sekretari duhet të ketë mbaruar një shkollë qytetëse;

Sekretari i Dioqezave duhet të ketë mbaruar një shkollë qytetëse.

EMËRIMET

Art. 37 – Predikonjësi i Përgjithshëm emërohet me vendimin e Sinodhit dhe me dekretimin e Kryepeshkopit.

Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe pushohet sipas Statutit.

Llogaritari i Përgjithshëm emërohet dhe pushohet prej Këshillit Ekonomik të Përhershëm.

Dhjaku ose nën Dhjaku i Kryesisë, kopisti dhe shërbëtorët emërohen dhe pushohen prej Kryepeshkopit.

Sekretarët e Dioqezave emërohen dhe pushohen prej Pleqësive Kishtare dhe dekretohen prej Peshkopit kompetent.

Dhjaku ose nëndhjaku dhe shërbëtorët emërohen dhe pushohen prej Peshkopit.

DETYRAT E TYRE

Art. 38. – Detyrat e Predikonjësit të Përgjithshëm dhe të Instruktorit të klerit janë:

a) të predikojë Fjalën e Perëndisë, sipas instruksioneve të marra nga Kryesia;

b) të stërvitë klerin në gjuhën amtare dhe në rregullën kishtare për sa u përket shërbesave të hirshme;

c) të përmbushë çdo mision për inspektimin e manastireve dhe kishave si dhe çdo mision tjetër kishtar të ngarkuar prej Kryesisë.

Art. 39. – Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm janë:

a) të rregullojë të gjitha veprimet e sekretarisë për të cilat është përgjegjës përpara Kryetarit;
b) të mbajë procesverbalet e mbledhjeve si dhe të gjithë korrespodencën
c) të përkujdeset për mirëmbajtjen e arkivave dhe të protokollit me anën e dipendeteve të tij.

Art. 40. – Detyrat e Sekretarit janë:

a) të zbatojë urdhërat e Sekretarit të Përgjithshëm;
b) të mbajë në rregull arkivat dhe protokollin;
c) të mbajë korrespondencën private të Kryesisë dhe të përmbajë çdo punë që i përket Zyrës së tij.

Art. 41. – Detyrat e Llogaritarit të Përgjithshëm janë:

a) të zbatojë urdhërat e Sekretarit të Përgjithshëm për sa u përket të ardhurave dhe të prishurave;

b) të përkujdeset për zbatimin e plotë të buxhetit.

c) të jetë në dispozitë të Këshillit Mikst dhe të Këshillit Ekonomik të Përhershëm për sa u përket llogarive;

ç) të mbajë në rregull regjistra dhe dëftesë-pagesat për mungesën e të cilave është përgjegjës;

d) të jetë në korrespondencë me Dioqezat për sa i përket buxhetit;

dh) të lëshojë dëftesë-pagesat në bazë të vendimeve të Këshillave përkatëse. Dëftesë-pagesat duhet të jenë të nënshkruara prej tij dhe prej Kryepeshkopit. Gjithashtu nënshkruhen prej tij dhe prej Kryepeshkopit urdhër-pagesat ose urdhër-marrjet.

Art. 42. – Kopisti ekzekuton të gjitha urdhërat që merr prej Kryesekretarit.

Art. 43. – Të gjithë funksionarët e Kishës janë të detyruar të punojnë sipas orarit të zyrave qeveritare.

Art. 44. – Arkëtari inkason të ardhurat dhe paguan me mandat-pagese si më sipër.

Art. 45. – Për shkak mospërmbushjeje detyre, autoritetet kompetente për emërimin e tyre kanë të drejtë të përdorin më parë qortimin, pastaj gjobitjen me një pjesë të rrogës dhe më në fund pushimin prej pune.

KAPTINA VIII
PAGESAT FAKULTATIVE

Art. 46. – Pagesat fakultative shkojnë në Arkën e Përgjithshme të Kishës. Peshkopët janë përgjegjës për mbledhjen e pagesave fakultative.

Për të përmbushur sa më mirë dhe në mënyrën më efikase këtë detyrë, këta do të jenë në bashkëpunim me Pleqësitë Kishtare të Qendrave si dhe të katundeve.

Art. 47. – Pagesat fakultative do të paguhen prej çdo Orthodhoksi të Krishterë të martuar.

Art. 48. – Pagesat fakultative do të jenë një gjer më pesë fr. ari. në mot.

Klasat e komunitetit orthodhoks që paguajnë janë: e para, e dyta, e treta. Përveç këtyre, Këshillat Kishtare caktojnë dhe një klasë nderi. Klasa e parë paguan pagesë-fakultative pesë fr.ari, klasa e dytë dy franga ari dhe e treta një fr. ari.

Klasa e nderit paguan sipas dëshirës.

Art. 49. – Klasat e ndryshme caktohen prej Pleqësive Kishtare, të cilat i dërgojnë përfundimin Këshillit Ekonomik të Përhershëm.

Art. 50. – Pagesat mblidhen prej klerikësh ose laikësh që do të caktohen prej Peshkopit. Prej të ardhurave fakultative 10 (dhjetë) për qind i mban Peshkopi dhe 10 (dhjetë) përqind kleriku ose laiku që ngarkohet për mbledhje.

TË NDRYSHME

Art. 51. –Klerikët të çdo grade të cilët ndodhen pa punë dhe që s'kanë mjetet e jetesës së tyre dhe jetojnë duke lypur ose në një mënyrë që cënon dinjitetin e gradës së tyre, dërgohen me vendim të Këshillit Disiplinor peshkopal në një nga Manastiret.

Art. 52. –Manastiret që nuk janë në gjendje financiare të përmbajnë Igumenin dhe t'u bëjnë ballë shpenzimeve të ndryshme, pasuritë e tyre të tundshme dhe të patundshme deklarohen me vendim të Këshillit Ekonomik të përhershëm, si pjesë e pandarë e Manastirit më t'afërm.

Art. 53. –Priftërinjtë që janë në shkallë të përdorin gjuhën shqipe në meshë, në rast që nuk konformohen me urdhërat e Kryetarit të Sinodhit për përdorimin e gjuhës shqipe në Kishë, pushohen nga shërbimi i tyre administrativisht dhe humbasin çdo të drejtë relative me shërbimin e tyre të gjertanishëm.

Ky pushim bëhet me vendim Kryepeshkopal.

Art. 54. –Psaltët dhe koret, në rast që nuk konformohen me urdhërat e Kryetarit të Sinodhit për përdorimin e gjuhës shqipe në kishë, pushohen menjëherë nga shërbimi i tyre.

Art. 55. – Kjo Rregullore, pas tre vjetësh, mund të modifikohet prej Këshillit Mikst së bashku me Këshillin Ekonomik të përhershëm në konformitet me Statutin.

Art. 56. – Kjo Rregullore i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë për aprovim.

Korçë, 20 korrik 1929

4.5 DORËHEQJA

Më 29 maj 1936 gazeta "Arbënia" botoi të plotë aktin e dorëheqjes së Kryetarit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë, Fortlumturisë së Tij, Visarion Xhuvanit

E vërteta mbi dorëheqjen paraqitet nga vetë Visarioni duke radhitun shkaqet të cilat e shtynë të bajë këtë veprim. Këto u paraqitën në mbledhjen e Sinodit të Kishës Autoqefale të Shqipnisë më datë 27 Maj 1936, në nji mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilën asistuen përveç anëtarëve të Sinodit dhe anëtarët laikë të këshillit Mikst.

Kryehirësia e tij, duke çelun mbledhjen, deklaroi se që prej shumë kohe ka dashun të jepte dorëheqje se asht shumë i lodhun dhe ka nevojë për qetësim. Por, ma së fundi ky mendim i tij u forcue ma tepër dhe vendosi që në këtë mbledhje të japë dorëheqjen e tij nga detyrat e kryetarit të kishës. Sinodi i Shenjtë, pasi dëgjoi deklaratat e kryepiskopit, pranoi dorëheqjen. Pas kësaj, duke marrë fjalën Episkopi i Korçës Imzot Kristofori, shfaq *hidhënimin e Sinodit të Shenjtë* për dorëheqjen e kryehirësisë së tij dhe e siguroi atë, se dhe pas largimit të tij nga detyra, Sinodi do ta konsiderojë si prezent dhe ka për t'a quejtun gjithnji si vëlla dhe bashkëpunëtor në çdo çeshtje relative në mbarëvajtjen e Kishës Autoqefale.

Prologu i dorëheqjes

Sinodi i Shenjtë dhe Këshilli Mikst asht thirrun me qëllim që t'i paraqitet akti i dorëheqjes dhe llogaria për vitin 1935-1936. Dëshiruem t'i paraqitnim dorëheqjen nji këshilli ma të gjanë, ma të plotë, nji Asambleje ose nji Komiteti Panortodoks të Shqipnisë të zgjedhun në 1000 vetë një delegat, ashtu siç m'u dorëzue kjo detyrë. Në atë mbledhje të japim shpjegimet e nevojshme për çdo punë dhe çdo pikë. Statuti i Kishës, që ka marrë formën ligjore e Shtetnore me anë të ligjit të shtetit mbi Komunitetet fetare nuk parashef dorëheqje kryepiskopale, përveç në raste pleqnie ose sëmundje që e bajnë të pazotin për detyrën, prandaj nuk parashef as procedurën e dorëheqjes si kjo e jona.

Ju lutem nxehtësisht të gjithëve të pranoni dorëheqjen tonë dhe të vendosni kanonikisht për forcimin dhe mbarëvajtjen e besimit, mbi sa duhet relativisht në këtë largimin tonë nga detyra.

Përveç Patriarkisë së Stambollit ku statuti lejonte ndërrimin e kryetarit të kishës të quejtun Patrik Ekumenik dhe Kryepiskopi i Kostandinopolit, si jemi zgjedhë edhe Ne këtu, për gjithë jetën dhe vdes mbi fronin kryepiskopal, dhe largohet vetëm për ato arsye që parashef Statuti i Kishës Sonë.

Asht e vërtetë se asnji nga shkaqet, nga ato që parashef Statuti, nuk ekziston, por modestija jonë ka nevojë me dhanë dorëheqje Ne si KryeJerark Ortodoks Kombëtar dhe i pari në historinë e kësaj kishe, mund të thyhemi por kurrë nuk përulemi. Arsyet do t'i paraqesim shkurtimisht në tre shkresa A,B,C.

Lëvizjet për dorëheqjen tonë

U fol dhe u shkrue botënisht se tre persona laikë provokuen nënshkrime nga ana e popullit me një shkresë në të cilën kërkojnë ndryshimin e personit tonë si kryetar i

kishës, dhe në vend të tij të vihej nji ma i ditun dhe ma patriot. Me këtë janë solidarizue dhe dy jerarkë (dhespotë të tjerë), të cilët kanë mbledhun firma në popull, në dioqezat e tyne. Kjo asht shkelje bese për mue dhe thyemje disipline si para normës fetare dhe para Mbretit.

Sa për ndryshimin e statutit, ne kemi qenë dakord për t'i ba ndryshime, sa për mue nuk e quej të drejtë të jap asnji shpjegim. Ne, që kemi drejtue kishën për 17 vjet, njihemi botënisht. Që nga viti 1919 jam marrë me punë politike, shoqënore, kam veprue si klerik, si deputet, senator, si gazetar, kemi marrë pjesë në partina politike, për to mund të fjalosemi si pro dhe kundra.

Kërkesat e kryesisë së këshillit kishtar dhe Dhimogjerundisë së Korçës duheshin ba në mënyrë të rregullt, sipas Statutit e jo në formë kaosi dhe anarqie, qoftë dhe ajo e zavendësimit tonë.

Dorëheqja nuk duhet të ketë nuancat e injorimit nga shteti, nga populli dhe nga frikësimi se do më vrasin. Nuk duhet të besohet se japim dorëheqje për këto tri arsye:

1. Pse gjoja m'u imponue prej shtetit

2. Pse gjoja na u imponue prej popullit.

3. Pse gjoja u frikësuem se do na vrasin të huejt po të mos jepnim dorëheqje.

Sa për ndërhymjen e shtetit ne e kemi thanë sheshazi dhe zyrtarisht se kur shteti nuk ka të drejtë ne nuk i bindemi dhe nuk i përulemi. Në këtë rast nuk kemi asnji ndërhymje.

Sa për imponimin nga populli, kjo nuk na ban aspak të japim dorëheqje. Inisiativa në emën të popullit asht marrë nga nji pakicë e vogël që ka punue me ne.

Mendimin për dorëheqje e kam që më 1932 por kam pasun frikë se mos keqkuptohemi, prandaj nuk e kam paraqitun se mos mendohej se e humbëm kurajon, ose se mos mendohet se Visarioni që asht i siguruem për tanë jetën po heq dorë se u tremb. Sot uroj, që kisha, me largimin tim, do të jetë në rrugë ma të mbarë.

Shkresa A

Shkaqet kryesore të dorëheqjes

1. Për me lehtësue shtetin tonë në punët politiko-religjioze për interesat e përgjithshme të kombit.

2. Për me lehtësue marrëdhaniet ose të njoftunit e kishës sonë nga kishat greke, siç asht Patriarkana e Istambullit, që ka me lehtësue ndofta organizimin sa ma mirë ose zbatimin e organizimin e plotë të kishës tonë, sepse do të lejojë të vinë pranë kishës tonë gjithë ata persona që i duhen e janë kompetentë, që rrojnë disa vite që janë larg dhe nuk ndihmojnë.

3. Mbasi shpresojmë se kryetari i kishës do të ndihmohet ma shumë se ne prej të gjithëve për mbarëvajtjen e kishës. Ne, të ndihmuem nga Mbreti, bamë organizimin definitiv që nuk ka qenë ba që nga krijimi i kishës Bizantine prej Kostandinit të Madh këtu e 1700 vjet ma parë.

Shkresa B

Gjendja e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë prej vitit 1929-1936

Pse asht shumë e vështirë dhe e pamundun me vazhdue detyrën episkopale:

1. Nuk kemi aspak mjete për mësimin e besimit (shkolla, ndërtesa etj).

2. Nuk kemi mjete për të paktën 3-4 Episkopë kompetentë të domosdoshëm për çdo dioqezë, as për 4-5 predikonjës të rinj për popullin, 20 zavendësa episkopi, 5 për çdo dioqezë.

3. Nuk kemi mjete për mbajtjen e 400 priftnave, të cilët vuejnë për bukë e për veshje.

4. Nuk kemi mjete për mbajtjen e një seminari kombëtar të paktën prej 20 studentëve.

5. Nuk kemi mjete për të mbajtë disiplinën e autoriteteve të nalta të kishës, sidomos të jerarqisë. Nuk zbatohen vendimet.

6. Nuk kemi pas asnji herë dhe nuk kemi përkrahjen e atyne 3-4 personave që përbajnë gjithë personalitetin politik ortodoks në Shqipni.

7-8 Nuk kemi fondet e nevojshme, as nga shteti, as nga pasunitë e manastireve , na lufton tash disa vjet.

9. Nuk kemi mjete për përkthimin dhe botimin e disa librave për unifikim ma të mirë kishtar, për qëllimin kombëtar të kishës.

10. Nuk kemi mjete për të realizue lidhjet me kishat e kolonive shqiptare të Amerikës, Rumanisë, Bullgarisë, Turqisë.

11. Nuk kemi mjete për ruejtjen e antikiteteve të 720 kishave të mëdha e të vogla.

12. Nuk kemi mjete për me u ba ballë organizatave dhe komploteve që demoralizojnë disiplinën fetare të klerit e të popullit.

13. Të gjitha këto mungesa janë paraqitun që nga viti 1922 dhe deri në 1936 por ndihma nga Qeveria dhe persona të veçantë ka qenë e pamjaftueshme. Këto janë shfrytëzue për të na paraqitun si të paaftë.

Pse dhe si na luftojnë për 17 vjet rresht të interesuemit kundërshtarë.

1. Nuk mohojmë shërbimet e mëdha që kanë ba por shënojmë se: thonë se Ne jemi i pari dhe i vetmi klerik teollog që muermë iniciativën zyrtarisht dhe botnisht e prej vitit 1929 në Shqipni, në Elbasan etj. dhe jashtë në Ballkan, Belgrad, Sofje (1919) dhe në Rumani më 1920 për Autoqefalinë e Kishës Ortodokse, punë e cila në vend që të na bashkojë dhe forcojë elementin ortodoks të Shqipnisë, thonë se e dobësoi dhe e përçau, dhe prandaj predikojnë mëni kundra personit tonë.

2. Se që në vitin 1919 shkelëm gjithë Shqipninë që në Shkodër deri në Gjinokastër për të përgatitun Kongresin e Beratit që proklamoi KOASH, kundra pengimeve kolosale të pakapërcyeshme.

3. Jemi i vetmi klerik teollog që muermë pjesë dhe proklamuem Kongeresin e Beratit më 1922 dhe të Korçës më 1929.

4. Thuhet se ne izoluem elementin ortodoks fqinj dhe u bamë shkak që të dobësohen në mënyrë të konsiderueshme ndjenjat fetare të popullit Ortodoks, mbasi nuk vazhduen ma lidhjet me Patriarkanën Ekumenike të Stambollit.

5. Mbasi ne, me veprat tona, u bamë shkak që të mos subvencionohet kisha dhe kleri prej burimeve të hueja, siç thuhet prej burimeve të hueja, sepse ne vetëm me anën tonë dhe me përkrahjen e Mbretit e të një numri të pakët patriotësh formuem të parin Sinod Kombëtar më 1929.

6. Se ne, me stabilizimin e gjuhës shqipe në të gjitha kishat, thuhet se hidhënuem atë pjesë të popullit ortodoks, e cila, me përdorimin e gjuhës greke në kishë nuk shihte ndonjë dam ose nevojë për zavendësimin e saj me gjuhën kombëtare, ashtu si nuk sheh pjesa katolike e muhamedane ndonjë dobi a nevojë për zavendësimin e gjuhëve të hueja në shërbesa fetare.

7. Shfrytëzojnë edhe pikën tjetër të veprimit tonë patriotik, sepse Ne stabilizuem në të gjitha kishat e Shqipnisë lutje të rregullt prej të gjithë klerit, në çdo shërbesë fetare në kishë dhe jashtë kishës, lutjet për Mbretin, ushtrinë dhe gjithë kombin, sepse mbreti nuk asht i krishtenë, ose zyrtarisht si mbret asht afetar.

8. Thuhet kundra personit tonë, se duke mos dhanë dorëheqje, kemi damtue interesat e shtetit e të kishës, pavarësisht nga përpjekjet tona për ta njoftun zyrtarisht gjithë bota kristiane, veç asaj greke, duke marrë pjesë në mbledhje Internacionale Kishtare në të gjithë shtetet e Ballkanit dhe në shumë vise të Evropës si në Londër, Zvicër etj.

9. Tri katër herë në vit njerëz që janë në kontakt me Këshillin Ministruer hapin fjalë se mbreti po e heq kryetarin e Kishës nga puna dhe po e pushon nga detyra. Këto lajme damtojnë punën tonë dhe prestigjin e kishës që kryesoj.

10. Në interes të kombit dhe të shtetit kemi ba disa shpenzime të aprovueme nga shteti, por ato nuk janë shlye, dhe janë ba shkak për sulme ndaj nesh.

11. Më 1933 shteti premtoi se do të jepte subvencione prej 100 000 fr. ari dhe kështu aprovoi buxhetin e kishës prej 35. 000 fr. ar, deri më sot nuk ka pague diferencën prej 65. 000 fr.ar. Kjo i ka krijue kishës një borxh prej 100 000 fr. ar.

12. Ekplloatojnë edhe pikëpamjen se qenia ime si kryetar i kishës pengon dhuratën e Jovan Bangës prej 100 000 fr. ar të depozituem në Bankën Kombëtare të Greqisë, e cila mund të merret po të hiqet Visarioni dhe po të hapet seminari ortodoks në Korçë në vend të gjimnazit grek.

13. Thonë se jemi dënue prej Patrikut të Konstandinopolit sepse kemi proklamue Kishën Autoqefale, formuem Sinodin e parë kombëtar, vumë në shërbim të kishës gjuhën kombëtare shqipe, lutjet për Mbretin Zog, ushtrinë dhe kryepiskopin ortodoks të Shqipnisë, nga të gjithë Patriarkët dhe kryepiskopët e tjerë ortodoksë, jogrekë.

14. Kundër meje janë ngritun jo vetëm anmiqtë e regjimit por edhe miqtë që kanë ofiqe të nalta duke përhapun mendimin se jemi vegël e Mbretit dhe e ministrave muhamedanë, të na paraqisin si njeri të të huejve e jo të Atdheut e Mbretit tonë.

Me se i kemi ba ballë deri sot nevojave financiare të kishës.

Kemi sot plot 90 muej që jemi kryetar i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë. Gjatë kësaj kohe kam pasë: 1. Rrogën , 2. Shpërblime, 3. Shpenzime reprezantimi, 4. Udhëtimi, sipas buxhetit të kishës dhe prej Këshillit Ministror gjithsej 70 napolona në muej. Kemi jetue me 25 napolona ari në muej, kështu që për 90 muej të shërbimit tonë, nga 45 napolona bajnë 4050 napolona, prej këtyne 860 napolona i kemi disponue për banesën tonë private për ne dhe prindët në kryeqytet në nji kodër, kursimi prej 3250 napolona i asht dhanë kishës hua pa kamatë brenda këtyne vjetëve, dhe kjo i ka përdorun për këto qëllime të nalta fetare dhe kombëtare:

1. Për Kongresin e dytë pan ortodoks të Kishës, llogaritë e të cilit u kontrolluen dhe u vërtetuen prej Ministrisë së Drejtësisë, sipas aktit Ministerial që ka kisha në dorë.

2. Për botimin e librave të shenjta kristiane në gjuhën shqipe: Ungjilli i Madh, Apostoli, Libri i të kremteve të mëdha, shërbesa e meshës së hyjnueshme dhe Shërbesa e Vojit të bekuem.

3. Për botimin e librave të mësimit të fesë: 1. Histori e Dhiatës së Re, 2. Histori e Dhiatës së Vjetër, 3. Kateqizma, 4. Lutjesore e Vogël, 5. Botimi i predikimeve për çdo të dielë dhe revistën për gjithë kohën e gjatë që kaloi.

4. Për mbajtjen e seminarit kombëtar që nga viti 1920 deri 1936.

5. Për mobilimin e ndërtesës së kryesisë së kishës që e gjetëm bosh fare.

6. Për misionet fetare kombëtare të dituna prej autoriteteve kishtare dhe prej atyne të shtetit.

Për të gjitha këto kemi dokumente nga komisionet e kontrollit të kishës dhe të këshillave mikste për çdo vit siç dëshmojnë buxhetet preventive.

Shkresa C

Satisfaksioni ynë moral

Si po e dorëzojmë kishën:

Tue marrë parasysh se çdo ditë që po kalon gjendja e kishës nga pikëpamja e sigurimit të dogmës së besimit ashtu dhe nga pikëpamja e zhvillimit të mësimit të saj shpirtnor, shoqnor, kombëtar asht tue shkue keq e ma keq, se nuk kemi gjetë përkrahjen për t'i kaluem, bindem se qëndrimi i matejshëm do të qe ambicioz dhe egoist. Gjatë qëndrimit tim 7 vjeçar në krye të kësaj detyre u krijue përshtypja se po thellohej përçamja që nuk do të jetë as në dobi të besimtarëve dhe të kombit, e cila do të shkaktonte zemërimin për regjimin dhe Atdheun në pikëpamje të politikës së Atdheut dhe në interes të popullit e të klerit ortodoks, e quej për detyrë që të mos vonohem në dorëheqjen time, sipas paralajmërimeve të bame nji herë në vitin 1932, dy herë në vitin 1933, nji herë në vitin 1934, nji herë në vitin 1935 dhe disa herë në vitin 1936.

Shtoj se për shkak të aktivitetit të jashtëzakonshëm dhe të paprajtun gati ditë dhe natë, edhe të nji punimi mendor, si dhe bisedave të shumta e të randa publike e private brenda nji kohe 17 vjeçare, që nga viti 1919, që jemi tue punue për Ortodoksinë shqiptare në lidhje me interesat e nalta të kombit, dhe gjendja e jonë shëndetësore, na imponojnë nji shplodhje të plotë nga çdo punë mendore dhe aktivitetet botues.

Tue u ngushëllue me faktin se po e dorëzojmë kryepiskopatën ortodokse të Shqipnisë krejt të pacënueshme si në dogmat e shenjta të besimit ashtu edhe në pikëpamje të autoqefalisë dhe të patriotizmës, dhe tue dashë me shpresue me bindje sa ma të plotë se Testamentin e Shenjtë fetaro-kombëtar që ne e muermë të pacënuem dhe po e dorëzojmë të pacënuem, dhe me ma shumë lavd dhe nder, se kisha kombëtare e jonë e Shenjtë e Zotit në Shqipni me përkrahjet tona personale sot, ç'prej vitit 1931, asht e njoftun dhe e konsiderueshme në gjinin e gjithë kishave kristiane të botës me pjesëmarrjen e saj plot prestigj e dinjitet të rrallë, në të gjitha mbledhjet e mëdha Pan-Kristiane në Ingliterë, në Danimarkë, në Zvicër, në Bukuresht, në Sofje,

në Jugosllavi, në Herceg Novi dhe sidomos në urimet dhe bekimet që Kisha jonë e Shenjtë Ortodokse Autoqefale Kombëtare ka marrë vazhdimisht prej Patriarkut të Shenjtë Serb Varnave, prej Patrikut të Shenjtë Rumun Miron, prej Kryepiskopit fort të Lumnueshmit të Polonisë Dhionis, prej Kryetarit të Sinodit të Shenjtë të Bullgarisë, fort të Lumnueshmit, Kryepiskopit Neofit, ashtu edhe prej Kryepiskopit të Sofjes Stefan. Mjerisht vetëm nga kishat e jashtme greke, me hidhnim po shënojmë se nuk qe e mundun të kuptohemi mirë, me gjithë dëshirën e sinqertë dhe përpjekjet që kemi ba për këtë punë.

Gëzohem se me përpjekjet tona personale së shpejti do të mbarojnë studimet teologjike 4 shqiptarë të mirë dhe 22 djelmosha të tjerë shpresëdhanës do të mbarojnë seminarin tonë kombëtar 5 vjeçar.

Kisha asht pajisun me librat e shenjta për shërbime fetare në gjuhën kombëtare shqipe si: Ungjilli i Madh, Apostulli, Libri i shërbesës së meshës, Libri i të kremteve të mëdha, Libri i shërbesave dhe Evqelive për fëmijë dhe të rinj janë përkthyem dhe hartuem disa libra, të shumta janë dhe librat që duhen për forcimin e besimit ortodoks si: 1. Histori e Dhiatës së Vjetër, 2. Histori e Dhiatës së Re, 3. Kateqizma kristiane, 4. Lutësori i Vogël, 5. Libri i mistereve, 6. Histori kishtare, 7. Dogmatikë, 8. Apollogjetikë, 9. Misionari, 10. Omiletikë, 11. Shpjegime ungjijsh, 12. Paterologji, 13. Moral, 14. Kurs Pastoral, 15. Arkeologji biblike.

Ndjejmë detyrë dhe gëzim se asnji element nga ata që përbajnë tanësinë Ortodokse të Shqipnisë nuk asht ankue dhe nuk u mjerue botnisht as vetvetiu prej sundimit shpirtnor, si ata grekofonë, vllahofonë dhe ata të paktë sllavofonë, kurrë në asnji rast dhe në asnji vend brenda gati 8 vjetësh të sundimit tonë nuk ka pasë asnji ankim kundrejt sundimit tonë shpirtënor.

Në kallnorin e vitit 1929 muermë kishën në dorëzim pa asnji rregull e organizim administrativ të duhun të pasunive kishtare dhe të manastireve. Vumë të gjitha forcat duke studjue intensivisht gjendjen dhe po e dorëzojmë me nji organizim të plotë e të përshtatshëm nga çdo pikëpamje. Mjafton të mos mungojë si deri sot vullneti i mirë për zbatimin prej kompetentëve, punë të cilat po të realizohen, do t'i sjellin kishës posibilitet të sigurtë me qenë financiarisht e zonja për misionin e vet indipendent.

Le të na lejohet të përgëzohemi jo vetëm me klerin dhe popullin besnik të kishës sonë por edhe me gjithë kombin përsa i përket qëndrimit kundrejt politikës sonë, në raste të ndryshme krizash që ndodhën gjatë 7 vjetëve të drejtimit tim. Unë mbajta qëndrimin e nji Ati të vërtetë shpirtnuer, që asht i njishëm për të gjithë dhe nuk bekon nji palë nga bijtë e tij, tue mallkue disa të tjerë të grigjës së tij, kur këta ndodhen në divergjencë politike e shoqnore në mes të tyne me të drejtë ose jo, as që gëzohem kur nji palë qajnë dhe as impresionohem kur të tjerët manifestojnë triumfin e tyne, por lutem për paqe e vllaznimin e të gjithëve. Me asnji rast nuk jemi largue nga gjini i popullit kurrë. Edhe kur kemi qenë jashtë kemi ardhun me urgjencë në Shqipni.

Lavdi Zotit në asnji rast nuk munguem të ngrehim zanin nalt dhe të mbajmë nalt dinjitetin e detyrueshëm e mospërfilljen ndaj asnji dami dhe rreziku mbi kryet tonë kundrejt dhe ma të fuqishmëve të botës për me vërtetue me fakte të gjalla dhe të paharrueshme që Ne, që kryesuem Kishën e Zotit në Shqipni, kemi detyrën e një profeti jo të parathanë, por kurajor të guximit të patrembshëm dhe të çdo sakrifice për

me mbrojtë kundra cilitdo qoftë rrezikun e besimit shpirtnor dhe patriotik dhe dashamirë të mbretnisë që asht urdhën dhe detyrë kryesore e Ortodoksisë, e vërtetue më çdo kohë, në çdo vend dhe në çdo rast. Dhe në atë ma të frikshmen.

Nuk kemi pushue të lutemi për Mbretin, pse kështu asht dhe urdhën i Ungjillit të Shenjtë, fjala e hyjnueshme që na zbuloi Zoti na thotë ashtu. Detyra për paqen dhe lumtuninë, jo vetëm për besimin dhe për Kishën, por edhe për Atdheun asht urdhën i zotit për ne.

Epilogu

Falenderojmë dhe lusim bekimin e Zotit për të gjithë klerikët e dioqezave që punuen me mue, të kishave e manastireve, që nuk më dhanë shkak për masa disiplinore por me gjithë vuejtjet e tyne financiare dhe ditunitë e tyne të pakta janë dallue për nder të madh në besën e shpresën e vërtetë të devotshme e të plotë, që rrallë gjendet aq thellë në shpirtnat e çdo vendi tjetër.

Shfaq mirënjohje për Mbretin dhe gjithë autoritetet shtetënore që na ndihmuen, shfaq mirënjohje për tri persona që ndihmuen dhe që duhet të mbeten në historinë e Kishës Shqiptare për formimin e Sinodit të parë Ortodoks Shqiptar, për Patrikun serb Dhimitri dhe mbretin jugosllav Aleksandri I, me episkopin e tyre Viktor.

Në territorin e Patriarkisë dhe të mbretnisë në fjalë Ne muermë gradën episkopale prej Jerarkisë Ruse pa asnji interes, kondicion e koncesion dhe pastaj me episkopin Viktor formuem këtë Institut të Naltë që i duhej popullit ortodoks dhe fesë së tij në Shqipni me të vetmin qëllim dhe ideal ortodoks, pa asnji megallomani dhe lakmi as nga ana e shqiptarëve, as nga ana e jugosllavëve, dhe vetëm për forcimin e idealit kombëtar shqiptar, për të cilin asht e domosdoshme Kisha Ortodokse e Shqipnisë të jetë Autoqefale dhe Kombëtare, ashtu si e vazhdoi dhe e konsolidoi modestia jonë bashkë me gjithë anëtarët e Sinodit të parë shqiptar që u formue më 1929 dhe me gjithë bashkëpunëtorët e çmueshëm.

Në bazë të vendimit mbretnor dhe të Sinodit të Shenjtë besoj se detyrën do t'ia dorëzoj episkopit të Korçës K. Kissit.

Ai që do të zejë vendin tim nuk do të ketë asnji herë asnji pengesë nga ana ime, veç ndihme dhe përkrahje.

Preokupacioni ynë asht që të studjojmë shkrimet e shenjta dhe me u marrë me punë të lehta sipas fuqisë përsa i përket filantropisë, atdhedashunisë, paqes , vllazënimit të të gjithë kombeve dhe kryesisht të kombit shqiptar. Kemi me jetue larg çdo okupacioni për çdo punë politike, as politiko-religjioze.

Uroj me gjithë shpirt Kryepiskopin e ri.

I lutem të gjithëve të më ndjejnë për çdo pakënaqësi ose zemërim që u kemi shkaktue me dashje ose pa dashje.

Rroftë kryepiskopi i ri i dytë i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipnisë.

Rroftë Kombi, Rroftë Mbreti.

O Zoti ynë Jisu Krisht, ndihmoje gjithmonë botën edhe ne, rueje të pacënueshme Grigjën e ortodoksisë së Shqipnisë, rueje nga çdo rrezik koloninë dhe nga mësymje kombesh vendin tonë si prej çdo përçamje të keqe vllaznore kurdoherë.

AMIN

Visarion

4.6 TOMI PATRIKAL DHE SINODIK MBI BEKIMIN E AUTOQEFALISË SË KISHËS ORTODOKSE NË SHQIPËRI

VENIAMINI, me mëshirë të Perëndisë,
Kryepiskop i Konstandinopojës, Romës së Re dhe Patrik Ekumenik
Nr. 609 prot.

Kisha e Shenjtë e Krishtit, si një nënë e dhembshur, duke shfaqur hapur përkujdesjen dhe interesimin saj të pandërprerë kundrejt popullit të shpresëtarëve, nuk rresht së zbatuari detyrën e kujdesimit të shenjtë çdo herë me mënyrën e përshtatshme sipas kohës dhe vendit. Kur është e nevojshme, blaton dhuratat e saj më të begata për plotësimin e nevojave që dalin, në mënyrë që adminstrimi i punëve kishtare të bëhet për ta pa pengesa dhe frytshmëria më Zotin, e cila është padyshim qëllimi i kujdesimit dhe i drejtimit kishtar, të jetë më e madhe. Kështu pra edhe tani, meqenëse të krishterët shpresëtarë orthodhoksë të të bekuarit prej Perëndisë Shtet të ri Shqiptar iu drejtuan Fronit tonë të Shenjtë Apostolik Patrikanor dhe Ekumenik, nën strehën e fuqishme të të cilit, si trashëgimi e vyer, prej shekujsh kanë gjetur mbrojtje e, me hirin e Krishtit, në vreshtin e Tij kanë gjetur shpëtim, morën guximin t'i drejtohen Atij, si një nëne të dhembshur, duke parashtruar nevojat e tyre të tanishme kishtare, me urimin e ngrohtë dhe kërkesën që zona e tyre kishtare të bekohet dhe të shpallet provincë kishtare më vete, e pavarur, autoqefale, përderisa në kushtet e reja të situatës së atjeshme politike vetëm ky organizim mund të ndikojë për mirë në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e punëve kishtare dhe të jetë i mjaftë të sigurojë e të përçojë përparimin e pandërprerë të tyre në përparimin në tërësi të Shtetit të bekuar Shqiptar. Vetë Shteti i perëndimbrojtur Shqiptar, duke u kujdesur në mënyrë të besueshme për mbarëvajtjen pa pengesa e të lirë të nënshtetasve të vet, ka ofruar garanci për mëvetësinë dhe lirinë e plotë të Kishës Ortodokse, e cila gjendet brenda kufijve të tij. Prandaj dhe modestia jonë, së bashku me fort të nderuarit dhe të shenjtët Mitropolitë dhe fort të ndershmit bashkëmeshtarë dhe vëllezër më Shpirtin e Shenjtë, duke shqyrtuar me interesim plot dashuri kërkesën e tyre birësore dhe me udhërrëfyes dispozitat e kanoneve të shenjta dhe rendin e praktikën kishtare, vendosëm të pranojmë me dashamirësi kërkesën që na drejtuan bijtë tanë shpirtërorë të Krishterë Orthodhoksë të Shqipërisë dhe të japim nga ana jonë bekimin dhe miratimin për organizimin e pavarur dhe autoqefal të punëve të tyre kishtare.

Duke gjykuar pra edhe sinodikisht më Shpirtin e Shenjtë, urdhërojmë dhe shpallim në këto çaste të hareshme që të gjitha eparkitë dhe komunitetet orthodhokse që përfshihen në të perëndishpëtuarin Shtet Shqiptar të jenë këtej e tutje të bashkuara në një organizim të pavarur e autoqefal kishtar me emërtimin "Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë". Kjo Kishë, e cila është motra jonë shpirtërore, të rregullojë e të administrojë këtej e tutje çështjet e saj kishtare në mënyrë të pavarur e autoqefale sipas rendit dhe të drejtave sovrane edhe të Kishave të tjera Ortodokse Autoqefale, të ketë dhe të njohë si autoritet suprem administrativ kishtar Sinodin e Shenjtë, të

përbërë prej Kryepriftërinjve ortodoksë kanonikë të Shqipërisë, me Kryetar të tij çdo herë Fort të Hirëshmin Kryepiskopin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë. Për zbatimin e unitetit të shenjtë kanonik me Fronin tonë fort të Shenjtë Apostolik Patrikanor Ekumenik dhe me të gjitha Kishat Ortodokse Autoqefale, si dhe për ta dëshmuar këtë, Hirësia e Tij Kryepiskopi i çdohershëm i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë ka për detyrë që, sipas rendit të Kishës së Shenjtë Ortodokse, të njoftojë për zgjedhjen dhe hipjen e tij në fron nëpërmjet Letrave fronëzuese edhe Kishën tonë të Madhe të Krishtit, edhe të gjitha Kishat Ortodokse Autoqefale motra. Po ashtu duhet të bëjë për këtë qëllim homologjinë dhe premtimin e parashikuar në lidhje me zbatimin e padevijueshëm të besimit dhe shpresëtarisë ortodokse prej Kishës së Shenjtë që drejton dhe që i është besuar, dhe të gjithçkaje tjetër që Kanonet e Shenjta e Hyjnore dhe rendi i Kishës së Shenjtë Ortodokse urdhërojnë, si dhe të kujtojë sipas rendit në diptikë emrin e Patrikut Ekumenik dhe të Patrikëve të tjerë fort të shenjtë dhe të Kryetarëve Fort të Hirshëm të Kishave të Shenjta Ortodokse Autoqefale. Urdhërojmë gjithashtu që edhe Kisha Ortodokse Autoqefale motër e Shqipërisë të marrë Miron e Shenjtë prej Kishës sonë të Madhe të Krishtit.

Po ashtu, rekomandojmë që, për çështje apo paqartësi të një natyre të përgjithshme kishtare, të cilat i kapërcejnë caqet e juridiksionit të Kishave Autoqefale në veçanti, Hirësia e Tij Kryepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë t'i drejtohet Fronit tonë fort të Shenjtë Ekumenik, nëpërmjet të cilit realizohet kungimi me çdo Episkopatë të orthodhoksëve, shpjegues të drejtë të së vërtetës, duke kërkuar në këtë mënyrë mendimin dhe opinionin e vlefshëm të Kishave motra. Duke gjykuar pra në këtë mënyrë, gjë që pasqyrohet edhe në ato çka vendosëm dhe miratuam në mbledhjen e rregullt sinodike të 12 prillit të këtij viti, vërtetojmë për të gjitha kohët edhe nëpërmjet këtij Tomosi Patrikanor e Sinodik të shkruar e të nënshkruar në Kodikun e Kishës sonë të Madhe të Krishtit, i cili i është lëshuar dhe dërguar njëkohësisht me përmbajtje të njëjtë e të pandryshuar edhe Hirësisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, vëllait tonë të dashur dhe bashkëmeshtartit, zotit Kristofor, Kryetar i Sinodit të Shenjtë të Kishës së Shenjtë Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Urojmë që Perëndia, me hirin dhe mëshirën e të parit dhe të Madhit Kryeprift e Bariut Krisht, të mbështesë gjithmonë të themeluarën me sukses Kishë Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe të shtojë e të përçojë drejt saj hirin dhe bekimin e Tij për lavdi të emrit të Tij të Shenjtë e në dobi të tërësisë shpresëtare të saj, si dhe në të njëjtën kohë për ngazëllimin e të gjitha Kishave të shenjta Autoqefale motra.

Në vitin shpëtimtar 1937, muaji prill (12), Epimenezi V.

Shprehet Patriku i Konstandinopojës

+VENIAMIN

+ Maksimi i Halkidhonës,

+ Polikarpi i Prusës,

+ Gjermanoi i Sardës dhe Pisidhisë,

+ Leoni i Theodhorupolit,

+ Meleti i Kristupolit,

+ Gjermanoi i Enit,

+ Ioakimi i Dherkës,
+ Thomai i Pringjiponezit,
+ Genadi i Iliupolit,
+ Konstandini i Irinupolit,
+ Dhorotheu i Laodhikisë.

4.7 TOMI PATRIARKAL PËR KRIJIMIN E EPISKOPATËS SË GJIROKASTRËS

Ky dokument vërteton qartë për autoqefalinë e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe hedh poshtë nga pikëpamja kanonike çdo pretendim që mund të kenë qarqe ose individë të caktuar brenda ose jashtë vendit, për përkatësinë e dioqezave dhe mitropolive të saj, pra të autoritetit dhe sovranitetit të saj kishtar.

+Veniamini me mëshirë të Perëndisë, Kryepiskop i Konstandinopojës, i Romës së Re dhe Patrik Ekumenik.

Kisha ka për detyrë të saj të kujdeset për drejtimin dhe zgjidhjen e të gjitha çështjeve kishtare dhe duke patur të drejtën e vjetër të krijimit apo të suprimimit të dioqezave, sipas nevojave të çdo kohe, të rregullojë pjesërisht apo tërësisht qenien dhe qeverisjen e tyre. Meqënëse edhe në këtë rast, në mbledhjen e tanishme të Sinodit u pa se një pjesë e Mitropolisë së Shenjtë të Drinopolit e Gjirokastrës, pas shpalljes në kohët e fundit të pavarësisë së Mbretërisë Shqiptare, përfshihet në territorin e saj, u gjykua se është më e dobishme dhe më e përshtatshme me gjendjen e tanishme, të shkëputet nga kjo pjesa tjetër e dioqezës së shenjtë të lartpërmendur dhe të nderohet e të ngrihet në dioqezë kishtare më vete, sot për sot nën vartësi dhe drejtim nga Froni ynë i Tërëshenjtë Patriarkal, Apostolik dhe Ekumenik dhe që në të ardhmen të bëjë pjesë edhe kjo në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që po formohet. Modestia jonë, duke gjykuar bashkë dhe me mitropolitët tanë të hirshëm, vëllezërit tanë të dashur bashkëmeshtarë më shpirtin e shenjtë, vendosëm dhe caktuam sinodikisht që: Pjesa e Mitropolisë së Tërëshenjtë të Drinipolit dhe Gjirokastrës, që ndodhet në Mbretërinë e Shqipërisë, të jetë që tani e tutje dioqezë kishtare më vete, me nderimin dhe vlerësimin e një aspirate dhe me emrin: "Episkopatë e Hirshme e Gjirokastrës", kryeprifti i vendosur në të me zgjedhje kanonike të emërohet: "Episkop i Hirshëm i Gjirokastrës" duke gëzuar të gjitha të drejtat që u takojnë kryepriftërinjve në aktivitet. Prandaj, si dëshmi, vërtetim dhe konfirmim të qëndrueshëm të atyre që gjykuan dhe vendosën kishtarisht, u bë dhe Tomi ynë Patriarkal e Sinosik, i regjistruar dhe i nënshkruar në Kodikun e Kishës sonë të madhe e të Shenjtë të Krishtit.

Në vitin shpëtimtar 1937, muaji mars (30), periudhë e V-të.

Shprehet Patriku i Konstandinopojës

+VENIAMIN

+ Maksimi i Halkidhonës,

+ Polikarpi i Prusës,

+ Gjermanoi i Sardës dhe Pisidhisë,

+ Leoni i Theodhorupolit,

+ Meleti i Kristupolit,

+ Gjermanoi i Enit,

+ Ioakimi i Dherkës,

+ Thomai i Pringjiponezit,

+ Genadi i Iliupolit,

+ Konstandini i Irinupolit,
+ Dhorotheu i Laodhikisë.

4.8 VISARION XHUVANI KËRKON FALJE

Në 17 prill të vitit 1937 Visarioni i drejtohet me letër Mitropolitit të Trapezundës Imzot Krisanthios, me anë të së cilës i lutet që të ndërhyjë në Patriarkanën Ekumenike të Stambollit, që ajo të heqi dorë nga zhveshja e funksioneve të tij. Me anë të kësaj letre i drejtohet Patrikut Ekumenik Veniaminit të I. Të dyja letrat ja dorëzoi Imzot Krisanthos më 28 prill 1937 ambasadori i Shqipnisë në Athinë Rauf Fico. Tekstet e letrave kanë shpëtuar dhe ruhen në arkivin e mitropolitit të Trapezundës dhe janë botuar më 1972.

"Hirësisë së Tij Mitropolitit të Trapezundës Zotit Krisanth, përfaqësues i Patriarkanës në Athinë.

I përnderuemi!

Tani, kohët e fundit, në mënyrë jozyrtare, u njoftuem për ekzistencën e aktit patriarkal, lidhun me çveshjen tonë nga funksionet.

I drejtojmë thirrje mençurinë, dashunisë, njohunive dhe aftësisë suej lidhun me njohjen e problemeve kishtare greko-shqiptare, dhe kompetencës suej, lidhun me çeshtjet që kanë të bajnë me problemet fetare ortodokse në Shqipni, si dhe me predispozicionin tuej karakteristik për të ndihmue.

Ju siguroj se nuk kemi asnji qëllim që të marrim përsipër ndonji detyrë kishtare në Shqipni, madje asnji lloj detyre tjetër, duke e konsiderue veten se kemi dhanë dorheqje përgjithmonë.

I lutem Hirësisë tuej që të kini mirësinë të ndërhyni për heqjen e këtij akti kishtar, që unë të meritoj besimin patriarkal dhe dashuninë, duke përfitue nga falja e përvuejtun ndaj meje të kryesisë së kishës, të cilën unë, nëpërmjet Hirësisë tuej, me përulje ju drejtoj patrikut të përkohshëm ekumenik lutjen e maposhtme.

Veniaminit të parë Patrikut ekumenik. Shumë i shenjtënuemi!

Njohja nga ana e Patriarkanës ekumenike dhe bekimi me dhanien e autoqefalisë kishës shqiptare, për të cilën unë kam qenë iniciator duke veprue në mënyrë të përvuejtun, dhe duke kryem detyrën time të shenjtë pasi mbarova studimet universitare teologjike. Kam besim të plotë ndaj mbarëshenjtënisë tuej. Lidhun me paqtimin dhe forcimin e besimit tonë lind nevoja absolute, që për këtë të interesohet Patriarkana Ekumenike, sidomos për këtë vend të vogël.

Të kuptuemit e sakrificës së naltë prej nesh dhe të deklaratave zyrtare, për sedrën e Patriarkanës ekumenike, janë shoqnue me lutje të përsëritshme nga ana e juej. Asht bindja ime, se gjithmonë jemi vetëm për besimin tonë të shenjtë të dashun, si dhe për interesat e besnikëve ortodoksë-në emën të Zotit, të Shqipnisë.

Kemi besim dhe bindje, se personi ynë i përvuejtun asht i tillë, që beson te e vërteta dhe kjo gja asht e njohun nga të gjithë. Në bazë të këtyneve u shtymë që t'ju drejtohemi:

1. Të besojmë që tani, për faktin se kemi veprue me dashje ose pa dashje, duke i shkaktue pakënaqësinë Patriarkanës së shenjtë Ekumenike, kundra së cilës nuk u kundërvumë dhe nuk duem të kundërvihemi. Duke i kërkue të falun, dhe në mënyrë të përvuejtun të heqi vendimin e marrë për çeshtjen tonë nga të gjitha funksionet dhe për mendimet e pikëpamjet që janë shprehun kundra meje.

2. Të shprehim hidhnimin tonë të thellë për hidhnimin që i shkaktuem Patriarkanës.

3. Të kërkojmë bekimet tueja të çmueme të Patriarkanës së shenjtë Ekumenike për përvuejtësinë tonë sikurse dhe mbrojtjen e bekimit tuej.

4. Të puthim me devocion të plotë dhe me përkushtim dorën tuej të djathtë të patriarkut tonë.

5. Të shprehim sigurimin tonë të sinqertë, respektin e thellë dhe të sinqertë, si dhe mirënjohjen tonë të sinqertë, të cilën duhet ta kemi gjithmonë ndaj Patriarkanës Ekumenike dhe ndaj personit tuej të përkohshëm, duke e çmuem këtë dashuni si dhe mundësinë si i përvuejtun t'i nënshtrohemi asaj.

Me dashuni kristiane dhe me nderime
Kryepiskopi Visarion.

Mitropoliti i Trapezundës, Hirësia e tij Krisanthi, në 18 maj të vitit 1937, i kthen përgjigje Visarionit dhe e njofton se Sinodi Ekumenik i Patriarkanës së Kostandinopojës ka hequn vendimin për zhveshjen, por me konsensus kishte mbetun mendimi se emnimi si kryeprift asht ba në mënyrë kundërstatutore.

Po në këtë datë Patriku Veniamini i I njofton me letër K. Kisin, që kishte zavendësue Visarionin, se asht hequn vendimi për zhveshjen e funksioneve të Visarionit, por ai i kishte lanë kompetencë kishës shqiptare që ajo të vendosë për titullin që do t'i jepte, por në mënyrë kategorike përjashtonte mundësinë që Visarioni të mbante titullin e kryepiskopit të Tiranës.

Në letrën e datës 18 maj 1937 që Veniamini I i dërgon Kristofor Kisit ndër të tjera thuhet:

... " u fal prej nesh, nëpërmjet lutjes që na drejtoi në muejin e kaluem, në prill të 1937, lidhun me heqjen e dënimit për zhveshjen e tij nga funksionet, mbasi na u drejtue me lutje.

Në letër nënvizohet mendimi, se ata besojnë në pendesën e Visarionit, por quejnë të paligjshëm emnimin e tij si kryeprift dhe kërkojmë që ai të mos quhet më Kryepiskopi i Tiranës.

I jepet të drejtë Sinodit të Tiranës për të vendosun lidhun me detyrat që duhet të kryej Visarioni.

Megjithëse u fal, duhet të plotësojë edhe diçka tjetër, të bisedojë ballasi me atë që e fali, apo me atë që e ndoqi për nji kohë kaq të gjatë. T’i shpjegojë atij arsyet që e shtynë për të ndërmarrë nji veprim të tillë, motivet që e imponuen të qëndrojë gjatë në krye të kësaj detyre, që ishin sa fetare po aq edhe kombëtare, të ngjashme me kishat simotra të Ballkanit.

Në gusht të vitit 1937 Visarioni vete në Stamboll dhe kërkon nga Patriku të pritet prej tij për të shprehun falënderimet. Patriku Veniamini i I e pranon në audiencë. Para tij Visarioni mban këtë fjalim:

"I mbarë shenjtënuemi!

Jam mirënjohës ndaj providencës hyjnore dhe e lavdëroj shpëtimtarin dhe zotin tonë Jisu, që pat mirësinë, që unë njeriu i vogël, të kem nderin e tij të madh, të mund të paraqitem përpara mbarë shenjtënisë dhe hyjnisë së Patrikut Ekumenik Veniaminit të I. Falenderoj në mënyrë të përzemërt mbarë shenjtëninë për mirësinë e çmueme që pati ndaj kryeklerikut Visarion shqiptar, njeriut të vogël. Në personin e shenjtënisë tuej me gëzim shumë të madh dhe me emocion, në mënyrë të përvuejtun përshëndesim dhe përqafojmë, jo vetëm të parën e të gjitha kishave ortodokse të shenjta të gjithësisë, por edhe Patrikun e qendrës së madhe spirituale dhe nacionale nëpër shekuj të helenizmit të arsimit grek, të letërsisë kishtare, të zanit dhe të përvuejtësisë të jerarkëve të shenjtë të shkëlqimit të mbarë ortodoks, Patrikun e qendrës spirituale kombëtare të helenizmit, ndaj të cilit gjithë njerëzimi dhe sidomos shumë i vogli i detyrojmë mirënjohjen tonë dhe përmirësimin që na jepni lidhun me qytetnimin dhe patriotizmin fisnik. Shumë i shenjtënuemi, shumë lehtë qe e mundun që të fitoja bekimet e çmueme patriarkale dhe të Sinodit nëpërmjet letrave të patriarkanës të dërgueme në muejin maj të këtij viti.

Nuk ju përgjigja duke ju falenderue me shkrim sepse preferova, që në vend të letrave të thata, të paraqitesha para jush dhe të komunikoja personalisht drejtpërdrejt me ju, gja për të cilën ju falenderoj.

Ngjarjet që kanë ndodhun gjatë këtyne muejve të fundit, kanë ba që vetëm sot të mund të plotësoj dëshirën time të zjarrtë, për komunikimin e drejtpërdrejtë dhe personal me mbarë shenjtëninë tuej dhe me kryepriftëninjtë e shenjtë të Sinodit.

Providenca e shenjtë nëpërmjet Zotit Jisu Krisht le ta ruejë shëndetin e shenjtënisë suej dhe për nji kohë të gjatë le të mbajë të ngritun përsëri lavdinë dhe triumfin e ortodoksisë dhe të bashkimit të të gjithë atyne që sundojnë në mënyrë triumfale dhe sidomos në Fronin e Patriarkanës Ekumenike."

Po atë ditë i shkroi një letër mitropolitit të Trapezundës, Hirësisë së tij Krisanthit, duke u lutun të falenderojë nga ana e tij Ministrinë e Jashtme të Greqisë dhe Kryepiskopin e Athinës. I dërgoi dhe një kopje të fjalimit që mbajti para Patrikut.

"Të nderuemit mitropolitit të Trapezundës, Z. Krisanth!

Shumë i nderuemi dhe besnik në Krishtin, Vëlla!

Me kohë mora letrën e përndershmënisë suej të shumëndritun, e cila qe diçka shumë e vlefshme nga çdo pikëpamje spirituale dhe të ndjenjave.

Në vend të shkrimit të thatë, dhe të përgjigjes në këtë mënyrë, unë do të gjej rastin të vij e të marr kontakt personalisht e të komunikoj me përndershmëninë tuej, në mënyrë që t'ju shpreh juve ato që duhen.

Për hir të Zotit u ba e mundun që të vete në Kostandinopojë dhe kështu të më jepet mundësia që të shpreh drejt për së drejti personalisht, nderimet dhe falenderimet e mija të mbarëshenjtënuemit dhe të hyjnuemit Patrikut Ekumenik zotit Veniamin .

Duke u bazue në mirësinë tuej, të cilën pata rastin ta vërtetoj dhe ta çmoj kur u njohëm në Tiranë, marr guximin t'i lutem përndershmënisë suej që të dorëzoni e transmetoni nga ana ime Ministrisë së Jashtme të Greqisë, dhe kryepiskopit të Athinës sa ma poshtë:

"Në çaste kur pas nji kohe prej shumë vjetësh u krijue midis Patriarkanës Ekumenike dhe meje, për hir të zotit u nderova duke e ba të mundun që të komunikoj me atë, duke u pritun në mënyrë të përzemërt nga shenjtënia e tij Veniamini i I. Ai sikurse dihet nëpërmjet Sinodit të Shenjtë më njohu rregullsinë e gradës të episkopit mue që jam nji njeri i vogël, me emocion të shenjtë dhe me mirënjohje kujtoj çfarëdo mbrojtje me vlerë dhe përkrahje morale që më asht dhanë nga kisha greke, nga shteti dhe nga institucionet arsimore të shenjta, dmth nga shkolla e Rizarit, dhe nga shkolla teologjike e universitetit të Athinës, kështu, pra, për hir të frymës bujare qytetnuese të helenizmit, t'u shërbejë interesave dhe nevojave të kishës ortodokse, si dhe shtetit të atdheut tonë veçanërisht të dashun të Shqipnisë.

Për këtë arsye përfitoj nga rasti që nëpërmjet përndershmënisë tuej, përfaqësuesit të kishës së madhe të Greqisë, të shpreh ndjenjat e mirënjohjes së thellë dhe të kujtimeve të pavdekshme dhe fisnike, të cilat i ruej ndaj mbretnisë greke, kishës greke, arsimit grek, dhe njëkohësisht kundrejt Zotit të mbarëfuqishëm, urime me gjithë zemër për begatinë e kombit grek dhe kishës greke, dhe posaçërisht të lut zotin tonë Jisu Krisht që ta ruejë mbretin e grekëve Jorgjin e II për të mirën e helenizmit, sikurse dhe të paqes dhe të bashkëpunimit vëllazënor të popujve miq të Ballkanit, ndërmjet të cilëve vend ma të afërt kanë marrëdhania e kombit grek me kombin shqiptar, të cilit në emën të zotit përvujtësia e jonë asht djali i vogël

Me pëqafime vëllaznore të përzemërta dhe me dashuni e vlerësim,

kryeklerik Visarioni

Kostandinopojë 5 gusht 1937

4.9 LIGJI MBI KOMUNITETET FETARE

(Dekret-ligjë Nr.743 Datë 26.11.1949)

Presidiumi i Kuvendit Populor

S H P A L L

Dekret-ligjën me titull e përmbajtje si vijon:

Neni 1.

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit.

Neni 2.

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë besimet, si komunitete fetare, janë të ndara nga Shteti.

Neni 3.

Në konformitet me nenin 16 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë është i ndaluar përdorimi i Kishës dhe i fesë për qëllime politike si edhe formimi i organizatave politike me baza fetare.

Neni 4.

Në konformitet me nenin 13 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë është i ndaluar çdo provokim urrejtje fetare.

Neni 5.

Asnjeri nuk mund të ndiqet, as t'i kufizohen të drejtat e tija civile dhe as të përjashtohet nga detyrimet e tij që i imponojnë ligjet e Shtetit, për shkak se i përket njërit apo tjetrit besim ose pse nuk bën pjesë në asnjë besim. Kjo vlen edhe për funksionarët fetarë të besimeve të ndryshme.

Neni 6.

Komunitetet fetare janë të lira të organizohen dhe të ushtrojne liritë dhe shërbimet fetare në bazë të dogmave, kanoneve dhe statuteve të tyre në qoftë se këto nuk vijnë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira.

Neni 7.

Komunitetet fetare që mund të organizohen dhe të funksionojnë duhet të njihen nga Shteti. Njohja bëhet me aprovim të Statutit të tyre nga Presidiumi i Kuvendit Popullor mbi propozim të Qeverisë.

Neni 8.

Me përjashtimin e sektit bektashian që formon komunitet fetar më vehte, sektet e ndryshme fetare bëjnë pjesë në komunitetin fetar përkatës. Sektet fetare organizohen dhe veprojnë në bazë të traditave dhe rregullave të tyre në qoftë se këto nuk vijnë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, me rendin publik dhe zakonet e mira. Rregulloret e sekteve fetare pasi të pranohen edhe nga organi më i lartë fetar në të cilin bën pjesë duhet të aprovohen dhe nga Këshilli Ministror. Me këtë aprovim sektet fetare fitojnë cilësinë e personit juridik në vehte.

Neni 9.

Çdo komunitet fetar duhet të ketë një Kryesi që do të jetë përgjegjëse përpara Shtetit. Lidhjet në mes të Kommiteteve fetare dhe të qeverisë bëhen me anë të kryesisë së Këshillit Ministerial.

Neni 10.

Komunitetet fetare munt të ndërtojnë dhe të hapin për nevojat e tyre faltore si dhe të ushtrojnë publikisht dhe në vënde të hapta ceremonitë, shërbimet dhe procesionet e tyre fetare duke iu nënshtruar ligjeve të përgjithshme të Shtetit dhe rregulloreve administrative.

Neni 11.

Komunitetet fetare mund të thërresin Kongrese, sinode, konferenca dhe mbledhje të tjera të përgjithshme ose lokale për çështje të besimit të tyre duke iu nënshtruar ligjeve të përgjithshme të Shtetit dhe rregullave administrative.

Neni 12.

Komunitetet fetare me aktivitetin e tyre duhet të zhvillojnë në besimtarët ndjenjën e besnikërisë ndaj pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe të përforcojnë bashkimin kombëtar.

Neni 13.

Kryetarët e Komuniteteve fetare, funksionarë fetarë dhe të gjithë personat në shërbim të komuniteteve fetare duhet të jenë shtetas shqiptarë besnikë të popullit dhe të Shtetit, të ndershëm të dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat civile. Kryetarët e komuniteteve fetare dhe të sekteve fetare, kryemuftiu, myftinjtë, dhe nënmyftinjtë, kryegjyshi dhe gjyshërit, kryepsikopi, episkopët dhe arkimandritët, arkipeshkvi dhe ipeshkvit dhe ndihmësat e tyre imediate, pasi të zgjidhen ose të emërohen nga organet fetare kompetente duhen të aprovohen nga Këshilli Ministerial. Kryetarët e sekseve fetare të ndryshme pasi të zgjidhen ose të emërohen nga organet në bazë të rregullores së tyre duhet të aprovohen nga Kryesia e Këshillit Ministerial. Funksionaret fetarë që kane raporte kanonike me vëndet e jashtme nuk mund të hyjnë në shërbim pa qënë të autorizuar më parë nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14.

Komunitetet fetare nuk mund të ushtrojne asnjë lloj juridiksioni. Në konformitet me dogmat dhe kanonet e tyre ata mund të kenë vetëm organe disiplinore për funkisonarët fetarë dhe personelin tjetër në shërbim të tyre. Organizimi dhe proçedura për organet disiplinore caktohet në Stautin e komunitetit fetar. Dënimet disiplinore e dhëna mbeten pa ndonjë efekt në qoftë se janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira.

Neni 15.

Kryetarët e komuniteteve fetare, funksionarët fetarë si dhe të gjithë funksionarët e tjerë në shërbim të instituteve të ndryshme fetare, që shkelin ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira ose që zhvillojnë ndonjë aktiviet anti demokratik, pamvarësisht nga përgjegjësia tjetër, me propozim e Kryesisë së Këshillit Ministerial mund të pezullohen nga shërbimi ose të pushohen. Pezullimi apo pushimi bëhet menjëherë nga organi fetar kompetent me të marrë propozimin e kryesisë së Këshillit Ministerial. Në qoftë se organi fetar kompetent nuk merr vendim për

pezullimin ose pushimin e funksionarit fetar, ky largohet nga detyra në mënyrë administrative.

Neni 16.

Komunitetet fetare nxjerin të ardhura dhe bëjnë shpenzime në bazë të buxheteve të tyre të përgatitura në konformitet me statutet e tyre. Kur komunitetet fetare kanë nevojë, Shteti mund t'i ndihmojë materialisht. Komunitetet fetare, buxhetet e tyre ja paraqisin Këshillit të Ministrave për aprovim. Veprimataria financiare e komuniteteve fetare kontrollohet nga organet financiare të Shtetit po në atë mënyrë që kontrollohen të gjitha organizatat shoqërore të vendit.

Neni 17.

Komunitetet fetare nuk mund të hapin ose të mbajnë shkolla të arsimit të përgjithshëm. Me autorizimin e Këshillit Ministerial ato mund të hapin dhe të mbajnë shkolla të mesme ose të larta fetare për përgatitjen e funksionarëve fetarë. Organzimi dhe programet e instituteve shkollore fetare caktohen me rregullore të veçantë të aprovuar nga Këshilli Ministerial. Dërgimi i të rinjve për studime në shkollat fetare jashtë Shtetit lejohet vetëm me autorizimin e Këshillit Ministerial.

Neni 18.

Të gjitha organet e komuniteteve fetare detyrohen t'i dergojnë menjherë për dijeni Kryesisë së Këshillit Ministerial letrat pastorale (mesazhet), qarkoret me karakter të përgjithshëm dhe çdo botim publik të botuar prej tyre. Këshilli Ministerial mund të ndalojë shpalljen, shtypjen dhe shpërndarjen e letrave, qarkoreve dhe botimeve të sipërme në qoftë se janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira.

Neni 19.

Organet drejtonjës qendrore të komuniteteve fetare duhet të jenë të regjistruara në Kryesinë e Këshillit Ministerial, kurse organet dejtonjëse të degëve lokale dhe sekteve fetare të ndryshme duhet të jenë të regjistruar në Këshillat popullor lokale duke u shënuar emër për emër antarët e organve drejtonjëse.

Neni 20.

Në raportet midis komuniteteve fetare dhe organeve të Pushtetit ose administratës shtetnore si dhe në sekretariatin e komuniteteve fetare të ndryshme si gjuhë zyrtarë do të përdoret gjuha shqipe. Në raportet midis komuniteteve fetare me besnikët e tyre si dhe në ushtrimin e ceremonive dhe të shërbimeve fetare mund të përdoren edhe gjuhë të tjera.

Neni 21.

Të përmendurit e organeve më të larta të pushtetit dhe të komuniteteve fetare mund të bëhen vetëm sipas formulës së aprovuar më parë nga Këshilli i Ministrave.

Neni 22.

Komunitetet fetare duhet t'i njoftojnë Kryesise së Këshillit të Ministerial mbishkrimet, shenjat simbolike dhe vulat që përdorin.

Neni 23.

Formimi i shoqatave dhe i organizatave me qëllime fetare morale si dhe botimi i librave për mësim fetar iu shtrohen ligjeve të përgjithshme të Shtetit dhe rregulloreve administrative. Aktiviteti i shoqatave dhe organizatave fetare duhet të

zhvillohet në baza kombëtare duke ju shërbyer interesave të popullit dhe të Shtetit dhe funksionarët e tyre duhet të jenë besnik të popullit dhe të Shtetit. Edukimi dhe organizimi i fëmijëve dhe të rinjëve në konformitet me nenin 28 të Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë, bëhet nën kujdesin e veçantë të Shtetit dhe prandaj nuk mund të merren me këtë veprimtari komunitetet fetare dhe funksionarët e tyre.

Neni 24.

Komunitetet fetare nuk mund të hapin spitale, jetimore dhe institute të tjera analoge. Institutet e llojit të mësipërm që mund të ekzistojne ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Dekret-ligje, shtetëzohen pa shpërblim me gjithë pasuritë e tyre të luajtëshme dhe të paluajtëshme dhe kalojnë nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë ose të Drejtorisë për Kujdesin Social.

Neni 25.

Komunitetet fetare mund të kenë lidhje me komunitete fetare, institute, organizata dhe persona zyrtarë që kanë qëndrën ose banimin jashtë Shtetit, vetëm me autorizimin e mëparshëm të Këshillit Ministerial dhe me anë të Ministrisë së Jashtme.

Neni 26.

Komunitetet fetare ose degët e tyre (urdhëra, shoqata, misione fetare etj) që kanë qëndrën e tyre jashtë Shtetit nuk mund të hapin në Republikën Popullore të Shqipëris degë të tyre (urdhëra, misone, institute mirëbërësie etj), dhe ato që ekzistojnë mbyllen brenda një muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Dekret-ligje.

Neni 27.

Komunitetet fetare nuk mund të marrin ndihma materiale dhe dhurata nga vëndet e huaja në çdo formë e në çdo mënyrë që të jetë as të dërgojnë në këto vënde, veçse me autorizimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 28.

Komunitetet fetare që kanë pasuri në vëndet e huaja, kur lidhin marëveshje për këto pasuri përfaqësohen nga Minisria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë. Gjithashtu kjo Ministri mbron në vëndet e huaja interesat fetare të shtetasve shqiptarë

Neni 29.

Pasuria e komuniteteve fetare të çdukura ose të atyre që ju hiqet njohja i kalon Shtetit.

Neni 30.

Qëndrat e komuniteteve fetare caktohen me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Neni 31.

Çdo provokim për urrejtje fetare që bëhet me anë të fjalës, shtypit ose me mënyra të tjera, dënohet me privim të lirisë jo me pak se një vit dhe me gjer në 10.000 lekë.

Neni 32.

Kushdo që me dhunë apo me frikësim ndalon shtetasit ose komunitetet fetare të njohura të ushtrojnë lirisht besimin e tyre dhe të kryejnë ceremonitë dhe shërbimet fetare që nuk shkelin ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira, dënohet me

privim të lirisë gjer në një vit. Po me këtë dënim dënohet edhe ay që në mënyrën e sipërme shtëngon ndonjë person që të marrë pjesë në ceremonitë dhe shërbimet fetare të ndonjë besimi.

Neni 33.

Kushdo që formon organizata politike me baza fetare si dhe ay që me anë të fjalës së shtypit ose me mënyra të tjera duke përdorur kishën dhe fenë për propagandë kundra pushtetit popullor dhe masave të mara prej tij dënohet, në qoftë se vepra nuk formon ndonjë faj më të rëndë, me privim të lirisë jo më pak se një vit.

Neni 34.

Kryetarët e komuniteteve fetare si dhe të gjithë funkionarët e tjerë fetarë që fillojnë nga detyra pa qenë aprovuar rregullitsht emërimi ose zgjedhja e tyre e sipas dispozitave të kësaj Dekret-ligje si dhe ata që janë të pushuar nga detyra fetare e vazhdojnë t'a ushtrojnë këtë, dënohen me privim të lirisë gjer më 3 vjet.

Neni 35.

Komunitetet fetare detyrohen që brënda 3 muajve nga hyrja në fuqi të kësaj Dekret-ligje t'i paraqesin Këshillit Ministerial për aprovim Statutet e tyre të rregulluara në konformitet me dispozitat e kësaj Dekret-ligje. Në qoftë se statutet e paraqitura përmbajnë dispozita në kundërshtim me ligjet e Shtetit, rendin publik dhe zakonet e mira, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund të kërkojë heqjen e tyre. Në qoftë se komuniteti nuk konformohet me këtë, Presidiumi i Kuvendit Popullor mund t'a refuzojë aprovimin e Statutit.

Neni 36.

Brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Dekret-ligje organet udhëheqëse qëndrore të komuniteteve fetare të ndryshme detyrohen t'i paraqesin Kryesisë së Këshillit Minsiterial një listë me emrat e të gjithë funksionarëve fetarë të komunitetit të tyre. Këta mund të mbeten në detyrat e tyre në qoftë se nuk ka asnjë kundërshtim nga ana e Kryesisë së Këshillit Ministerial. Kundërshtime mund të bëhen për ata funksionarë fetarë që nuk i kanë cilësitë e kërkuara prej kësaj Dekret-ligje.

Neni 37.

Kjo Dekret-ligjë hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë më 26 Nëntor 1949, Nr. i Dekretit: 963.

Për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë

S e k r e t a r i: **K r y e t a r i:**

(Sami Baholli) d.v. *(Dr.Omer Nishani) d.v.*

4.10 STATUTI
I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË
TIRANË 1950

(Dekret Nr. 1065 datë 4 Maj 1950, Gazeta Zyrtare 21 Qershor 1950 Nr. 38)

Neni 1. I gjithë kleri dhe populli Orthodhoks i Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesë e pandarë e Kishës së Shenjtë, të Përgjithshme dhe Apostolike, është person juridik dhe përbëhet prej të gjithë Orthodhoksëve që banojnë brënda territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe prej atyre Shqiptarëve Orthodhoksë që banojnë jashtë Atdheut dhe ruan të paprekshme, si të gjitha Kishat e tjera Orthodhokse, parimet dogmatike, kanonet e hirëshme apostolike e sinodhike, si edhe traditën e shenjtë.

Neni 2. Marrëdhëniet e Kishës me Shtetin, të përcaktuara në artikullin 16 të Statutit Themeltar të Republikës Popullore të Shqipërisë, kryhen në konformitet me dispozitat përkatëse të Ligjit në fuqi mbi Komunitetet fetare.

Neni 3. Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja, por në shërbimet fetare mund të përdoren edhe gjuhë të tjera.

Neni 4. Krahas me zhvillimin e ndjenjave fetare Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë do të zhvillojë në besimtarët dhe ndjenjat e besnikërisë ndaj Pushtetit të popullit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, si edhe ndjenjën e Atdhe-dashurisë dhe të përforcimit të Bashkimit Kombëtar. Prandaj gjithë funksionarët dhe personeli i saj, duhet të jenë shtetas, të ndershëm, besnikë të popullit dhe të Atdheut dhe të gëzojnë të gjithë të drejtat civile.

Neni 5. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë do të mbajë lidhje bashkëpunimi dhe do t'i shtojë e përforcojë këto lidhje me ato Kisha Ortodokse motra, të cilat interpretojnë dhe praktikojnë drejt parimet e larta ungjillore mbi paqen dhe vëllazërimin e vërtetë ndërmjet popujve të mbarë botës.

Neni 6. Lutjet që bëhen në Kishë gjatë meshimeve dhe ceremonive të tjera fetare për Autoritetet Shtetnore, formulohen prej Kryesisë së Kishës dhe vihen në përdorim, mbasi më parë të merret pëlqimi i Autoriteteve kompetente të Shtetit.

Neni 7. Asnjë klerik nuk mund të ushtrojë funksionet e fesë Orthodhokse në Shqipëri, pa qënë i emëruar dhe i lidhur me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

ORGANIZIMI

Neni 8. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë e organizuar si Kryepiskopatë me titull: "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë", simbas rregullave kanonike dhe administrative përfshin:

1) Mitropolinë e Tiranës-Durrësit me këto zëvendësi mitropolitane lokale:

a) Të Tiranës; b) Të Durrësit; c) Të Shkodrës; ç) Të Kavajës, d) Të Elbasanit.

2) Episkopatën e Beratit me këto zëvendësi Episkopale Lokale:

a) Të Beratit; b) Të Vlorës, c) Të Fierit, ç) Të Lushnjës.
3) Episkopatën e Gjirokastrës me këto zëvendësi Episkopale Lokale:
a) Të Gjirokastrës; b) Të Delvinës; c) Të Sarandës; d) Të Himarës; dh) Të Përmetit.
4) Episkopatën e Korçës me këto zëvendësi episkopate Lokale:
a) Të Korçës, b) Të Kolonjës, c) Të Leskovikut, ç) Të Pogradecit.

Neni 9. Me vendim të Këshillit Mikst, mund të krijohen episkopata për Shqiptarët Orthodhoksë jashtë shtetit, të varura nga Kisha Shqiptare mëmë.

SINODHI I SHENJTË

Neni 10. Sinodhi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, i përbërë prej episkopëve efektivë, nën Kryesinë e Mitropolitit të Qëndrës, Kryepiskopit të gjithë Shqipërisë, është autoriteti më i lartë për të gjitha çështjet dogmatike, kanonike dhe spirituale, si dhe për ato çështje që hyjnë në sferën e kompetencës së tij.

Neni 11. Kompetencat e Sinodhit të Shënjtë janë:
a) Të kryejë misionin e shënjtë dhe të ruajë unitetin dogmatik, kanonik, të traditës së shënjtë dhe të kultit me të gjitha patriarhitë e shenjta dhe me Kishat Orthodhokse Autoqefale.
b) Të ruajë unitetin dogmatik, kanonik, të traditës së shenjtë dhe të kultit në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
c) Të shqyrtojë çdo çështje dogmatike, kanonike të traditës kishtare dhe të kultit dhe të zgjidhi këtë në konformitet me doktrinën e Kishës Orthodhokse Lindore.
ç) Të zgjedhi Kryepiskopin dhe Episkopët në konformistet me kanonet e shenjta dhe traditën kishtare, si dhe në konformitet me dispozitat ligjore në fuqi; dhe të lëshojë qarkoret përkatëse për fronëzimin e Kryepiskopit.
d) Të vendosi mbi lutjet për dorëheqjen e anëtarëve të tij.
dh) Të gjykojë me kompetencë ekskluzive dhe në komformitet me dispozitave të kanoneve të shenjta dhe të ligjeve përkatëse në fuqi anëtarët e tij për shkelje dogmatike dhe kanonike.
e) Të gjykojë çështjet që kanë të bëjnë me katherizim (zhveshje) të ndonjë kleriku.
ë) Të udhëzojë e të mbikëqyri që aktiviteti i organeve ekzekutive në dioqeza të kryhet konform rregullave ligjore.
f) Të vendosi mbi çështjet e çdo natyre që hyjnë në kompetencën e tij, si dhe mbi ato që s'janë caktuar me anë ligjesh, Statuti ose Rregulloresh si kompetencë e ndonjë organi tjetër kishtar.
g) Të interpretojë për të gjitha organet kishtare dispozitat e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të Administrimit.
gj) Të thërrasi Kongrese Kishtare, kur e lypin nevojat e larta të Kishës.

Neni 12. Në mungesë të Kryetarit, për çfarëdo arsye të justifikuar, Sinodhi i Shenjtë kryesohet prej episkopit titullar më të vjetër në hirotoni.

Neni 13. Sinodhi i Shenjtë mblidhet detyrimisht një herë në vit dhe jashtëzakonisht sa herë e lyp nevoja.

Neni 14. Thirrja dhe caktimi i rendit të ditës, bëhet prej Kryetarit të Sinodhit një muaj më përpara. Për mbledhje të jashtëzakonshme, afati mund të jetë më i

shkurtër. Ne qoftë se kryetari refuzon, për cilindo arrësye, të thërrasi mbledhjen e detyrueshme të Sinodhit, ai mblidhet detyrimisht brenda 15 ditëve nga data e kërkesës, kur një gjë e tillë kërkohet të paktën prej dy anëtarëve të tij me shkresë dhe pasi të ketë kaluar afati vjetor i mbledhjes së detyrueshme të Sinodhit. Në qoftë se kryetari refuzon, për cilëndo arrësye, të thërrasi Sinodhin në mbledhje të jashtëzakonshme, ai mblidhet detyrimisht kur një gjë e tillë kërkohet me shkresë, të paktën prej dy anëtarëve të tij, brënda një muaji nga data e shkresës.

Neni 15. Sinodhi i Shenjtë konsiderohet i mbledhur rregullisht kur ndodhet prezent gjysma plus një e numrit të të gjithë anëtarëve. Ai merr vendime të vlefshme me votën e shumicës së thjeshtë të anëtarëve dhe në rast barazie votash, paravlen ana e Kryetarit.

Neni 16. Kandidatë për Episkopë, përveç cilësive që kërkojnë kanonet e Kishës duhet të jenë të diplomuar prej nji Fakulteti Teologjik orthodhoks. Por, në mungesë Kandidatësh episkopë të diplomuar prej një fakulteti teologjik, mund të dorrëzohen episkopë dhe kandidatë, të cilët nuk kanë një kulturë të tillë, por që janë të dalluar në veprimtari kishtare dhe patriotike dhe që janë të aftë si autodidaktë.

Neni 17. Kryepiskopi dhe episkopët, kur bëhen anëtarë efektivë të Sinodhit të Shenjtë betohen përpara tij me këtë formulë betimi:
“Betohem mbi ndërgjegjjen time përpara Perëndisë se do të ruaj besnikërinë, ndaj dogmave, kanoneve dhe traditave kishtare orthodhokse, ndaj popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, dhe ndaj parimeve demokratike të konsakruara me anë të Statutit të saj themeltar.

Neni 18. Episkopë titullarë efektivë pa dioqezë ekzistuese, nuk mund të jenë më tepër se një.

Neni 19. Sinodhi ka një sekretar të përgjithshëm të zgjedhur prej tij me propozim të kryetarit, nga i cili dhe dekretohet.

Neni 20. Çdo botim me përmbajtje fetare kishtare, nuk mund të vihet në përdorim në Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, pa pëlqimin dhe aprovimin e Sinodhit të Shenjtë.

Neni 21. Sinodhi i shenjtë do të punojë për edukimin e klerit dhe të besimtarëve, në mënyrë që të luftohen dhe të zhduken supersticionet.

Neni 22. Asnjë laik ose murg nuk mund të dorëzohet prift ose dhjak pa patur pëlqimin e Sinodhit të Shenjtë.

Neni 23. Asnjë gradë nderi (ofiq kishtar) nuk mund t’i jepet priftërinjve, cilido qoftë aktiviteti i tyre, pa propozim të titullarit respektiv dhe aprovimin përkatës, të Sinodhit të Shenjtë dhe në komformitet me dispozitat përkatëse të Rregullores së Përgjithëshme të Administrimit.

KRYEPISKOPI

Neni 24. Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë është Kryetar i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Neni 25. Kryepiskopi është i pari në Jerarhët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Mitropolit i Dhioqezës së Tiranës-Durrësit.

Neni 26. Kryepiskopi gëzon të gjitha të drejtat e parapara në kanonet e shënjta, në këtë Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme të administrimit, si dhe në Ligjën mbi Komunitetet Fetare.

Titulli i tij është: Kryehirësia e Tij, Kryetari i Kishës Orthodhokse Autoqefale, Mitropolit i Tiranës, Durrësit dhe Kryepiskop i gjithë Shqippërisë.

Kujtimi i tij (fimi) në shërbesat kishtare bëhen konform kanoneve të shenjta dhe zakonit të Kishës sonë.

Neni 27. Kryepiskopi ka këto detyra:

a) Thërret dhe kryeson organet Qendrore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

b) Vë në zbatim vendimet e organeve Qendrore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

c) Përfaqëson Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë para Autoriteteve dhe kudo që e lyp nevoja, personalisht ose me anë të deleguarish.

ç) Mban lidhje me Kishat e tjera Orthodhokse për çështjen kishtare nëpërmjet kanalit të paraparë nga ligja mbi Komunitetet fetare.

d) Lëshon letra pastorale për të gjithë Kishat Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, duke iu përmbajtuar dispozitave përkatëse të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

dh) Dërgon këshilla vëllazërore jerarhëve të kishës dhe pajton mosmarrëveshjet eventuale ndërmjet tyre.

e) Kujdeset për kryerjen sa më parë të formaliteteve të nevojshme për plotësimin e dioqezave vakante, brenda 40 ditëve.

f) Dorëzon (hirotonis) bashkë me episkopë të tjerë dhe konform kanoneve të shenjta, episkopët.

g) Lëshon qarkoret e emërimit për fronëzimet e episkopëve.

gj) Emëron zëvendës episkopalë të përgjithshëm provizorë, kur fronet episkopate mbeten vakante duke iu përmbajtur dispozitave përkatëse të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

j) Afati qëndrimit te nje dioqezë vakante me një zëvëndës episkopat të përgjithshëm provizor, caktohet në Rregulloren e Përgjithshme të administrimit.

i) Pranon ankesat e paraqitura eventualisht kundër titullarëve të dioqezave dhe disponon për hetime, me anën e një kleriku anëtar të Sinodhit, rezultatin e të cilave ia parashtron Sinodhit të Shenjtë.

j) Ushtron dhe çdo të drejtë tjetër që i është akorduar me anë kanonesh, ligjesh dhe rregulloresh.

Neni 28. Përveç sekretarit të përgjithshëm dhe personelit tjetër, i cili parashikohet në Rreguloren e Përgjithshme të Administrimit me dispozita të posaçme, Kryepiskopi ka edhe një episkop ndihmës, i cili është anëtar i Sinodhi pa mbajtur përgjegjësinë e administrimit të ndonjë dioqeze dhe kryen çdo detyrë që i ngarkohet mga Kryepiskopi, duke u titulluar në hymnin e tij si Episkopi i Apollonisë.

EPISKOPI

Neni 29. Episkopi titullar është organi drejtues i një dioqeze dhe gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara nga kanonet e shenjta, nga ky Statut dhe nga Rregullorja e Përgjithshme e Administrimit, si dhe nga ligjet përkatëse në fuqi.

Neni 30. Të drejtat dhe detyrat e episkopit janë:

a) Të drejtojë dioqezën brenda kufijve të caktuar nga kanonet dhe rregullat në fuqi.

b) Të përfaqësojë dioqezën para Autoriteteve Shtetnore lokale dhe kudo që e lyp nevoja, personalisht ose me anë të deleguarish prej tij.

c) Të dorëzojë (hirotonisi) priftërinjtë dhe të japi ofiqe klerikale me pëlqim përkatës të Sinodhit.

ç) Të heqi vërrejtjen dhe të qortojë klerikë të dioqezës së tij për faje të vogla dhe të pezulojë këta nga funksionet e tyre për fajet që përbëjnë skandal, deri sa kjo çështje të gjykohet nga gjykata spirituale.

d) Të vizitojë, të paktën, një herë në vit dioqezën e tij, për të kontrolluar ecjen e punëve kishtare dhe për të dhënë udhëzime përkatëse, duke i bërë një raport Sinodhit të Shenjtë mbi konstatimet e kryera.

Neni 31. Episkopi gëzon dhe çdo të drejtë tjetër që i është ngarkuar me anë kanonesh, ligjesh dhe rregulloresh, si edhe ato që do të caktohen më hollësisht në Rregulloren e Përgjithëshme të Administrimit.

Neni 32. Episkopi është i detyruar të qëndrojë vazhdimisht në dioqezë, me përjashtim kur merr pjesë në mbledhjen e Sinodhit të Shenjtë ose në mbledhje të tjera zyrtare, si dhe kur ndoshet me leje.

ZËVENDËSIA MITROPOLITANE DHE EPISKOPALE LOKALE

Neni 33. Zëvendësia mitropolitane ose episkopale Lokale është një rreth administrativ kishtar që përfshinë një numur famullish të një dioqeze.

Neni 34. Kryepiskopi, nën cilësinë e mitropolitit të qëndrës dhe të titullarit të dioqezës Tiranës-Durrësit, emëron në qëndrën e çdo zëvendësie mitropolitane lokale të juridiksionit të dioqezës së tij zëvendës mitropolitan lokal klerik, i cili administron zëvëndësinë mitropolitane lokale në emër të mitropolitit, nën udhëzimet e tij direkte dhe në konformitet me dispozittat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit dhe të ligjeve përkatës.

Në të njëjtën mënyrë veprojnë dhe titullarët e dioqezave të tjera, duke emëruar secili në qëndrën e çdo zëvendësie episkopale lokale të juridiksionit të dioqezës një zëvendës episkopal klerik, i cili administron zëvendësinë episkopale lokale në emër të titullarit të dioqezës, nënë udhëzimet e tij direkte dhe në komformitet me dispozitat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit dhe të ligjeve përkatëse.

Neni 35. Zëvendësi mirtopolitan ose episkopal lokal kryeson mbledhjet e këshillit kishtar (Dhimogjerondisë) të qytetit të qëndrës së zëvendësisë motropolitane ose episkopale lokale dhe kujdeset që urdhrat, vendimet dhe dispozitat e autoriteteve kishtare më të larta, si dhe dispozitat ligjore përkatëse, të vihen në zbatim në të gjitha kishat e juridiksionit të tij.

Neni 36. Zëvendësi mitropolitan ose episkopal lokal ushtron dhe çdo të drejtë tjetër që parashikohet në dispozita të veçanta të Rregullores së përgjithshme të administrimit.

FAMULLITË DHE FAMULLITARËT

Neni 37. Famullija është bashkimi kishtar i besnikëve klerikë dhe laikë, të fesë orthodhokse, që banojnë në një territor të caktuar (katund apo qytet).

Neni 38. Çdo famulli, ka të drejtë të ketë nji ose më shumë famulltarë, simbas numrit të besnikëve dhe të kishave të famullisë dhe simbas gjëndjes së saj ekonomike.

Neni 39. Famullitarët zgjidhen nga këshillat kishtare të dala nga gjiri i popullit të çdo famullije dhe aprovohen prej titullarit përkatës. Por, në katunde ku grumbullimi i besnikëve bëhet më kollaj mund të zgjidhen direkt nga populli.

Neni 40. Në katunde famullitari është kryetari i këshillit kishtar (kujdestarisë kishtare).

Neni 41. Famullitari në katunde është përgjegjës për të vënë në zbatim dispozitat e këtij Statuti, të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit dhe të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

Neni 42. Kur në një famulli shërbejnë më teper se një famullitar, numri i familjeve që shërbehen prej tyre, ndahet në propocion të barabartë.

Neni 43. Dispozita më të hollësishme mbi famullitë dhe famullitarët, caktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit.

KËSHILLAT KISHTARE
Këshilli Mikst, këshilli ekonomik, këshillat kishtare të qyteteve dhe të katundëve, Këshillat manastiriale.

Neni 45. Organi më i lartë i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për të gjitha çështjet administrative-ekonomike, si dhe për çdo çështje tjetër që nuk hyn në sferën e kompetencës së Sinodhit të Shenjtë, është Këshilli Mikst, i përbërë prej titullarëve të dioqezave ekzistuese, të cilët janë vetvetiu anëtarë të tij, dhe prej katër anëtarësh laik, një për çdo dioqezë, nën Kryesinë e Kryepiskopit, për një periudhë prej katër vjetësh. Episkopi ndihmës merr pjesë në Këshillin Mikst me votë konsultative.

Neni 46. Mënyra e zgjedhjes së katër anëtarëve laikë të Këshillit Mikst si dhe kompetencat dhe të drejtat e tyre, caktohen hollësisht në Rregulloren e Administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Për këtë herë, katër anëtarët laikë të Këshillit Mikst, zgjidhen prej Kongresit.

Neni 47. Këshilli Mikst harton Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë si dhe Rregulloren mbi sigurimin e klerit, në komformitet me dispozitat e këtij Statuti dhe me dispozitat ligjore në fuqi duke ia parashtruar Këshillit Ministerial për aprovim.

Neni 48. Këshilli Mikst shqyrton buxhetin vitit të kaluar dhe harton buxhetin preventiv për vitin e ardhshëm. Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë para gjykatave e përfaqëson një anëtar laik i Këshillit Mikst i deleguar ad hok prej tij. Ky,

përveç të drejtave të tjera, ka edhe të drejtën të bëjë pajtime, të deferojë pranojë ose të referojë benë deçizore si dhe të emërojë përfaqësues ligjor përpara gjykatave, me po ato të drejta, ose me të drejta më të pakta.

Neni 49. Këshilli Mikst i thirrur prej Kryetarit, mblidhet zakonisht nji herë në vit dhe jashtëzakonisht sa herë që e lyp nevoja. Ai merr vendime me shumicë të thjeshtë votash dhe konsiderohet i mbledhur rregullisht kur ndodhen prezent, përveç kryetarit dhe katër anëtarë, në propocion dy klerikë dhe dy laikë. Në rast barazie votash, paravlen ana e Kryetarit.

Neni 50. Këshilli Mikst mund të modifikojë nene të këtij Statuti që nuk u referohen dogmave, kanoneve dhe traditës së shenjtë; gjithashtu mund të bëjë dhe shtesa nenesh. Por, për të qënë këto modifikime dhe shtesa të vlefshme, duhet një kuorum të paktën prej 7 anëtarësh dhe një vendim i marrur, të paktën prej 6 anëtarësh.

Neni 51. Pranë Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë funksionon një Këshill Ekonomik i Përhershëm, i përbërë prej Kryepiskopit dhe prej katër anëtarësh, në propocion një klerik dhe tre laikë, nga një për çdo dioqezë, nën Kryesinë e Kryepiskopit.

Neni 52. Këshilli Ekonomik është organ i Këshilllit Mikst për administrimin ekonomik të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë gjatë vitit financiar dhe është përgjegjës përpara tij. Anëtarët e Këshillit Ekonomik zgjidhen prej Këshillit Mikst për nji periudhë prej katër vjetësh. Këshilli Ekonomik konsiderohet i mbledhur rregullisht kur, përveç kryetarit ndoshen prezent dhe tre anëtarë. Ai merr vendime të vlefshme me shumicën e tre anëtarëve prezent.

Neni 53. Komtetencat dhe detyrat e Këshillit Ekonomik, caktohen shprehimisht në Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit.

Neni 54. Funksionet e Sekretarit të Këshillave Mikst dhe Ekonomik, i kryen sekretari i përgjithshëm i Sinodhit.

Neni 55. Komuniteti Orthodhoks i çdo qyteti zgjedh nji këshillë kishtare lokale (Dhimojerondi), e cila kryesohet prej zëvendësit mitropolitan ose episkopat lokal dhe administron famullitë e qytetit dhe pasuritë e tyre të lujshme dhe të palujtshme. Në këtë këshillë merr pjesë dhe një famullitar me të drejtë vote, i deleguar prej klerit të atij qyteti. Këshilli kishtar i qytetit mund të zgjidhet nga brenda ose jashtë gjirit të tij dy deri tre kujdestarë për çdo kishë të qytetit, të cilët janë përgjegjës para tij dhe administrojnë kishën në emër të tij.

Neni 56. Në çdo katund zgjidhet një këshillë kishtare (kujdestari), e përbërë prej dy deri katër anëtarësh laikë, nën kryesinë e famulltarit, e cila administron kishën ose kishat e katundit dhe pasuritë e tyre të lujtshme dhe të paluajtshme.

Neni 57. Çdo manastir drejtohet dhe administrohet nga një këshillë manastiriale (igumeniale) nën kryesinë e nji igumeni ose administratori klerik, të emëruar nga titullari i dioqezës, e cila këshillë është përgjegjës përpara organeve ekonomike që qëndrës dhe titullarit të dioqezës respektive, për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të manastirit, si dhe për mirëmbajtjen e tij.

Neni 58. Në këshillat kishtare kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen gjithë banorët orthodhoksë të Republikës Popullore të Shqipërisë, që kanë mbushur moshën ligjore.

Neni 59. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave kishtare të qyteteve (Dhimogjerondive) të anëtarëve të këshillave kishtare të katundeve (kujdestarive) dhe të anëtarëve të këshillaave manastiriale (igumeniale), si edhe kompetencat dhe detyrat e tyre, caktohen në dispozita të posaçme të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit, në komformiet me frymën e këtij Statuti dhe dispozitat ligjore në fuqi.

PASURITË KISHTARE

Neni 60. Të gjitha pasuritë që u përkasin: Kryepiskopatës, episkopataave, zëvendësive metropolitane ose episkopate lokale, famullive dhe manastireve, përbëjnë pasuritë kishtare.

Neni 61. Pasuritë që disponojnë kishat e komuniteteve orthodhokse të qyteteve dhe të katundeve, janë pasuritë e tyre dhe administrohen në konformistet me dispozitat e Rregullores në fuqi. Kjo vlen dhe përsa u përket pasurive që disponojnë manastiret.

Neni 62. Nga pikpamja e destinimit të sajë, pasuria kishtare dallohet: në pasuri gjërash të shenjta dhe në pasuri të zakonshme. Pasuri gjërash të shenjta është ajo që përbëhet prej gjërash dhe objektesh të destinuara për kultin hyjnor. Këto s'mund të shiten, ose mund të dhurohen me vendim të këshillave kishtare.

Neni 63. Shtimi, shitja dhe administrimi i pasurisë kishtare, kontrolli dhe verifikimi i saj bëhet në konformitet me dispozitat ligjore përkatëse dhe dispozitat e posaçme të Rregullores së Përgjithshme të Administrimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

MBI TË ARDHURRAT DHE SHPENZIMET

Neni 64. Shpenzimet për mbajtjen e kultit, përballohen nga kontributet vetëdashëse të besnikëve dhe nga të ardhurat e vetë kishës ose manastirit, ndërsa rrogat e meshtarëve dhe të nënpunësve si dhe shpenzimet e ndryshme në qëndrat e dioqezave dhe zëvendësit e tyre mvartëse, përballohen nga të ardhurat kishtare dhe nga sumbvensioni eventual i Shtetit.

SIGURIMI I KLERIT

Neni 65. Pranë Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë krijohet "Fondi i sigurimit të Klerit", i cili ka për qëllim të sigurojë të gjithë klerikët e Shqipërisë në raste pa aftësije për të kryer misionin e shenjtë dhe dalje në pension, si edhe familjet e tyre në raste vdekjeje.

Neni 66. Fondi i sigurimit të klerit drejtohet dhe administrohet nga Këshilli Mikst në bazë të dispozitave të një rregulloreje të posaçme të hartuar nga Këshilli Mikst, konform dispozitave ligjore përkatëse.

PREGATITJA E KLERIT, KONFERENCAT DHE BOTIMET

Neni 67. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, duhet të mbajë shkolla fetare për përgatitjen e funksionarëve të saj fetarë.

Neni 68. Dispozitat mbi organizimin e një shkolle të mesme fetare dhe mbi programet e funksionimit të saj, caktohen në një rregullore te veçantë të hartuar nga Sinodhi i Shenjtë dhe të aprovuar nga Këshilli Ministerial.

Neni 69. Për perfeksionimin e priftërinjve në kryerjen e misionit kishtar dhe për t'iu dhënë këtyre sqarime rreth problemeve aktuale që i referohen aktivitetit dhe rolit të Kishës për të mirën e shoqërisë dhe të popullit, zhvillohen herë pas here konferenca, të cilat kryesohen nga vetë titullari ose një i deleguari i tij, ose nga zëvendësi i tij lokal i autorizuar posaçërisht, por gjithmonë nën porosinë direkte të titullarit.

Neni 70. Për zhvillimin e konferencave, duhet të kërkohet më parë leja përkatëse nga ana e Atoriteteve komtetentë në konformitet me dispozitat ligjore në fuqi mbi mbledhjet publike.

Neni 71. Pranë Kryesisë së Kishës duhet të botohet nji revistë fetare e përmuajshme, me përmbajtje të dobishme për kishën, klerin dhe popullin. Konditat e funksionimit dhe të organizimit të revistës fetare, caktohen hollësisht në Rregulloren e Përgjithëshme të Administrimit.

Neni 72. Në botimin e revistës fetare, do të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Komunitetet fetare.

MASAT DISIPLINORE

Neni 73. Në qendrën e çdo dioqeze funksionon një gjykatë spirituale e përbërë prej titullarit të dioqezës si kryetar dhe dy klerikëve të graduar si anëtarë, për të gjykuar në formë të prerë, brenda 30 ditëve nga data e kryerjes së fajit, të gjithë klerikët e juridiksionit të dioqezës, për faje të lehta gjer në 15 ditë argji, me ose pa prerje rroge, dhe për faje që përbëjnë skandal gjer në një muaj me ose pa të drejtë rroge. Procedura që do të ndiqet për gjykimin e këtyre fajeve, caktohet në Rregulloren e Përgjithshme.

Neni 74. Për të gjitha fajet dogmatike dhe kanonike dhe shkeljet disiplinore, që e kalojnë kompetencën e gjykimit dhe të ndëshkimit nga ana e titullarit, është kompetent Sinodhi i Shenjtë, i cili gjykon dhe vendos në formë të prerë mbi fajet e përcaktuara si për anëtarët e tij ashtu edhe për çdo klerik ose murg.

Neni 75. Kur një anëtar i Sinodhit gjykohet për çdo faj të tilllë, ai vetë nuk merr pjesë si anëtar i Sinodhit. Mbi këtë flitet më hollësisht në rregullore.

Neni 76. Për çdo llij ndëshkimi, vendimet e Sinodhit mirren me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 77. Kryetari i Sinodhit, ose Sinodhi, kur kryetari është vetë i akuzuar, pezullon me një herë nga funksionet e tij çdo funksionnar të Kishës, klerik dhe laik, kur një gjë e tillë kërkohët nga autoritetet kompetentë të Shtetit për shkelje të dispozitave të nenit 15 të ligjës mbi Komunitetet fetare.

Neni 78. Vendimet e Sinodhit për masa disiplinore, do t'u konfirmohen dispozitave përkatëse të nenit 14 të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

Neni 79. Çdo klerik i katherizuar (çpriftëruar) me vendim të Sinodhit detyrohet të heqi uniformën fetare dhe ndalohet të kryejë shërbime fetare.

Neni 80. Mënyra e procedurës së gjykimit të çështjeve disiplinore, që i referohen kompetencës së Sinodhit, si dhe dispozitat të tjera përkatëse, caktohen hollësisht në Rregulloren e Përgjithshme të Administrimit.

MBISHKRIMET, SHENJAT SIMBOLIKE DHE VULAT NË PËRDORIM

Neni 81. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka këto mbishkrime:
a) Për Kryesinë. “Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Kryesia e Sinodhit të Shenjtë”.
b) për Dioqezat: “Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Episkopata e .....
c) Për zëvendësitë metropolitane ose episkopate lokale “Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Mitropolia ose episkopata e .....zëvendësija metropolitane ose episkopate lokale e.....”.

Neni 82. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë si shënjë simbolike ka “Mitrën episkopate me kryq”.

Neni 83. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka në përdorim këto vula:
a) Për kryesinë e kishës: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; Kryepiskopata.
b) Për episkopatat: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; episkopata e.....
c) Për zëvendësitë metropolitane lokale mvartëse të Kryepiskopatës: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; zëvendësia episkopate e.....
ç) Për zëvendësitë Episkopale mvartëse të episkopateve: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; zëvendësia episkopate e.....
d) Për të gjitha famullitë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; famullia e.....
dh) Për të gjithë manastiret: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë; manastiri i .....

Neni 84. Vulat e përmendura në gërmat s,b,c,ç,d,dh të nenit 83 kanë në mes një kryq.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE TRANZITORE

Neni 85. Në mungesë episkopësh titullarë, në krye të një dioqeze mund të zgjidhet në të njëjtën mënyrë nji klerik i dalluar me titulll: “Zëvendës Episkopal i Përgjithshëm”, i cili porsa kohë që administron dioqezën vakante, ka po ato të drejta që ka edhe një episkop titullar, si edhe të njënjtën të drejtë anëtarësie në Sinodh, me përjashtim të atyre kompetencave që i përkasin ekskluzivisht gradës episkopate. Edhe ky jep të njënjtin betim përpara Sinodhit të Shenjtë.

Neni 86. Me plotësimin e një dioqeze vakante me anën e një episkopi titullar, zëvendësi episkopat i përgjithshëm i saj, e humbet të drejtën e administrimit të dioqezës së plotësuar, por mbetet anëtar i rregullt i Sinodhit dhe në dispozicion tëtij, me votë konsultative.

Neni 87. Anëtarët e Sinodhit, për çdo rast largimi nga funksionet e tyre, gëzojnë të drejtën e pensionit, me përjashtim të rastit kur këta pushohen për faje dhe veprimtari anti-kishtare dhe anti-patriotike.

Neni 88. Gjatë vitit, për çdo çështje që nuk lypin mbledhje të jashtëzakonshme të Sinodhit dhe të Këshillit Mikst, Kryepiskopi mund të kërkojë mendimin dhe pëlqimin e anëtarëve të tyre me korrespodencë. Personeli i Kryepiskopatës dhe i episkopateve, si dhe detyrat e tija caktohen me dispozita të veçanta të Rregullores se Përgjithshme të Administrimit.

Neni 89. Për caktimin e rrogave të funksionarëve dhe të nënpunësve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, ndiqet kriteri që ndiqet edhe për funksionarët dhe nënpunësit e Shtetit, në komformitet me dispozitat ligjore përkatëse.

Neni 90. Në rast mbledhjeje, anëtarëve të këshillave ju paguhen djeta në konformistet me dispozitat ligjore përkatëse. Për anëtarët e këshillave që mund të mos kenë ndonjë nënpunësi, dietat caktohen nga Kryesia e Kishës, nëse nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore për dietat e kësaj kategorie.

Neni 91. Për sigurimin e jetesës së jerarhëve që nuk gëzojnë të drejtë pensioni, kisha nuk merr ndonjë angazhim, në qoftë se këta nuk shkojnë në një nga manastiret që u cakton Sinodhi i Shenjtë.

Neni 92. Ky Statut është i përpiluar në bazë të parimeve dhe të dispozitave të përgjithshme që përmbahen në kanonet e Kishës dhe në komformitet me dispozitat përkatëse të Statutit Themeltar të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Ligjës mbi Komunitetet fetare, për të përcaktuar mënyrën simbas së cilës Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë rregullon, drejton dhe administron çështjet e saja fetare, është dhe mbetet i detyrueshëm për krejt Kishën Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, pasi më parë të aprovohet nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

4.11 RREGULLORJA
E ADMINISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË KISHËS

Organizimi i brendshëm i Kishës dhe administrimi i pasurive të manastireve, të kishave dhe të komuniteteve fetare, bëhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Zhvillimi në besimtarët i ndjenjave të besnikërisë ndaj Pushtetit të popullit dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe i ndjenjës së atdhe-dashurisë dhe të përforcimit të bashkimit kombëtar, që është një detyrë kryesore, patriotike dhe shoqërore, e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, kryhet me anën e shëmbëllës personale të të gjithë punonjësve të saj dhe nëpërmjet të një aktiviteti të saj të gjallë dhe të pandërprerë, i cili konsiston në mbrojtjen pa kushte të indipendencës, të sovranitetit dhe të integritetit tokësor të Atdheut, në ruajtjen e fitoreve të popullit, në realizimin e çdo plani dhe programi që ndërmirret për lumturinë e popullit dhe të shoqërisë në përgjithësi, si dhe në nxitjen e kauzës së shenjtë të paqes në mbarë botën.

Neni 2. Lidhjet që mban Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë me kishat orthodhokse morta, që praktikojnë dhe interpretojnë drejt parimet e larta Ungjillore mbi dashurinë, paqën dhe vëllazërimin e vërtetë ndërmjet popujve, janë lidhje bashkëpunimi të gjithanshëm dhe kryesisht lidhje shpirtërore nga më vëllazëroret, të cilat arrihen nëpërmjet një bashkëpunimi kultural sa më të ngushtë dhe të pandërprerë dhe një bashkëpunimi të vazhdueshëm rreth çështjesh dhe problemesh të përbashkëta, dhe që lypin një kuptimshmëri reciproke dhe një përballim dhe zgjidhje të përbashkët, dhe që synojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e orthodhoksisë së vërtetë, në denoncimin e mashtrimit të parimeve të krishterimit, në skqarimin dhe lumturinë e besimtarëve orthodhoksë dhe në të mirën e shoqërisë në përgjithësi.

Përpjekjet e përbashkëta për mbrojtjen e paqes, e cila është një nga parimet bazë të krishterimit, dhe pa të cilën nuk mund të ekzistojë jetë dhe lumturi, zënë vendin e parë dhe kryesor në këto lidhje bashkëpunimi.

KAPTINA E I
KËSHILLI MIKST

Neni 3. Këshilli Mikst është organi më i lartë për administrimin e pasurive, të lujtshme dhe të paluajtshme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Neni 4. Këshilli Mikst administron të gjitha pasuritë e lujtshme dhe të paluajtshme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë me anë të Këshillit Ekonomik të Përhershëm.

Neni 5. Anëtarët laikë zgjidhen në këtë mënyrë: Titullari i çdo dioqeze dy muaj përpara zgjedhjeve për anëtarë të Këshillit Mikst, provokon, me anë shpallje,

kandidaturën e çdo besniku që ka cilësitë e kërkuara prej nenit 6 të kësaj Rregulloreje. Kandidaturat pranohen brenda 15 ditëve nga data e shpalljes. Titullari, emrat e kandidatëve ua komunikon këshilla të qyteteve dhe katundeve të juridiksionit të tij me anën e zevendësve lokalë, të cilat zgjedhin një prej kandidatëve të paraqitur.

Rezultatet i dërgohet qendrës së episkopatës me anë të zëvendësve lokalë, e cila deklaron për anëtar të Këshillit Mikst kandidatin që ka fituar shumicën e votave, duke i njoftuar emrin e tij Kryesisë së Kishës. Në rast barazie votash, shpallen zgjedhje të reja.

Neni 6. Anëtarët laikë duhet të jenë madhorë, shtetas shqiptarë dhe të besimit orthodhoks.

Neni 7. Këshillit Mikst ka sidomos këto kompetenca: Të ruajë dhe të mbrojë interesat dhe të drejtat e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

a) Të drejtojë dhe të rregullojë çështjet administrative, kishtare, kulturave dhe ekonomike të të gjithë Kishës.

b) Të mbajë institucionet kulturore të kishës dhe të caktojë mjetet për mbajtjen e tyre, duke iu konfirmuar Nenit 17 të Ligjës mbi Komunitetet fetare.

c) Të vendosë mbi titullin e dioqezave, mbi kufijtë tokësorë të tyre, të zëvendësive të tyre, si dhe mbi themelimin e dioqezave të reja.

d) Të kujdeset për mbarë-vajtjen, kontrollin dhe shtimin e pasurisë së lujtëshme dhe të palujtëshme, e cila është pronë e përgjithshme e kishës.

e) Të gjejë mjetet e nevojshme për mbajtjen e kishave të vobegëta, si dhe për rindërtimin e atyre që janë dëmtuar.

f) Të zgjedhë anëtarët e Këshillit Ekonomik të Përhershëm;

g) Të shqyrtojë raportin vjetor të përpiluar nga Këshilli Ekonomik i përhershëm dhe të caktojë masat që duhen marrë për drejtimin e mirë të punëve kishtare.

h) Të shqyrtojë dhe të aprovojë buxhetin preventiv të përgjithshëm të Kishës.

j) Të akordojë bursa për studime fetare.

k) Të hartojë organikën e përgjithshme të Kishës.

KËSHILLI EKONOMIK I PËRHERSHËM

Neni 8. Këshilli Ekonomik i Përhershëm, si organ ekzekutiv i Këshillit Mikst, ka këto kompetenca: Të administrojë me anën e organeve vartëse pasuritë e lujtëshme dhe të palujtëshme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

l) Të verifikojë buxhetet konsumativë të Kishës dhe të fondit të sigurimit të personelit klerik dhe t'ia parashtrojë këto për aprovim Këshillit Mikst bashkë me raportet shkoqitës.

m) Të hartojë projekt-buxhetin preventiv vjetor dhe t'ia parashtrojë për shqyrtim dhe aprovim Këshillit Mikst.

n) Të vërë në zbatim vendimet e Këshillit Mikst mbi administrimin e pëgjithshëm të pasurive kishtare.

o) Të propozojë masa për forcimin e disiplinës financiare kishtare.

p) Të vendosë rreth përdorimit të drejtë të fondeve të caktuar.

q) Të kujdeset për mbarë-vajtjen, kontrollin dhe shtimin e pasurisë së lujtshme dhe të paluajtshme të Kishës.
r) Të hartojë raportin e përgjithshëm vjetor mbi punën e kryer, mbi të metat e konstatuara dhe të propozojë masat që duhet të merren.
s) Të shqyrtojë dhe të aprovojë buxhetet konsumativë dhe preventivë të komuniteteve lokale të qyteteve dhe të manastireve.

Neni 9. Këshilli Ekonomik mblidhet zakonisht një herë në muaj dhe jashtëzakonisht sa herë që lyp nevoja.

Neni 10. Anëtarët e Këshillit Ekonomik, për punën e kryer, shpërblehen me orë, simbas ligjeve financiare.

KËSHILLAT KISHTARE TË QYTETEVE DHE KATUNDËVE

Neni 11. Këshillat kishtare lokale (dhimogjeronditë), janë organi ekzekutiv dhe administrativ i mbledhjes së famullisë dhe zgjidhen nga gjiri i saj. Këto veprojnë nën kryesinë e titullarëve të episkopateve ose zëvendësive metropolitane apo episkopate lokale dhe shërbejnë darovisht.

Neni 12. Këshillat Kishtare lokale (dhimogjeronditë) të qyteteve, përbëhen prej katër deri gjashtë vetash, përveç kryetarit, nga të cilët njëri klerik, dhe zgjidhen për dy vjet nga gjiri i mbledhjes së famullisë, me vota të hapta dhe direkte.
At dhe bir, vëllezërit, bashkëshortët, vjehrri dhe dhëndri, s'mund të jenë bashkë anëtarë këshilli.

Neni 13. Këshillat kishtare të katundeve, përbëhen prej priftit të katundit si kryetar dhe prej dy deri katër anëtarësh laikë, dhe zgjidhen për dy vjet.

Neni 14. Anëtarët e këshillave kishtare, nuk mund të jenë njëkohësisht dhe anëtare të këshillave manastiriale, me përjashtim të manastireve që administrohen direkt prej katundit.

Neni 15. Titullari i episkopatës, ose zëvendësit mitropolitanë apo episkopalë lokalë, dy muaj para se të mbarojë periudha e antarëve të këshillit kishtar, shpallin zgjedhje të reja.

Neni 16. Zgjedhjet do të bëhen mbas një muaji nga dita e shpalljes, në të cilat kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë besimtarët, pa dallim seksi; që kanë moshën madhore dhe që gëzojnë të drejtën e votimit konform me ligjet përkatëse të Shtetit.

Neni 17. Zgjedhjet mbikqyen nga një komision prej tre vetash nën kryesinë e titullarit të episkopatës, zëvendësit, ose një famullitari të deleguar.

Neni 18. Nga gjiri i mbledhjes propozohen 8-10 kandidatë për këshillat kishtare të qyteteve dhe 4-8 për këshillat kishtare të katundeve, të cilët vihen në votë një nga një sipas rradhës që janë propozuar, dhe nga këta gjysma e kandidatëve që do të fitojnë votat më të shumta do të përbëjnë këshillin kishtar. Përfundimi i zgjedhjeve i njoftohet titullarit të episkopatës.

Neni 19. Anëtari klerik i këshillit kishtar zgjidhet prej klerikëve të qytetit dhe nga gjiri i tyre.

Neni 20. Këshilli kishtar mblidhet zakonisht një herë në muaj dhe jashtëzakonisht sa herë që e lyp nevoja.

Neni 21. Mbledhjen e këshillit kishtar të qyteteve ose të katundeve e provokon kryetari, por në qoftë se gjysma e anëtarëve e kërkojnë me shkrim që të bëhet një mbledhje, ai është i detyruar që të thërrasi këshillin menjëherë.

Neni 22. Mbledhja është e vlefshme, kur ndodhen prezent më tepër se gjysma e anëtarëve, dhe vendimet mirren me shumicën e thjeshtë të votave, si për këshillat kishtare të qyteteve ashtu dhe për ato të katundeve.

Neni 23. Çdo anëtar i këshillit kishtar që nuk merr pjesë në mbledhjet tre herë me rradhë për arsye të pa justifikuara, quhet iso fakto dorëheqës dhe vendin e tij e zë ai që në zgjedhjet ka marrrë votat më të shumta.

Neni 24. Këshillat kishtare lokale kanë këto kompetenca: Të kujdesen për inventarizimin e rregullt të pasurisë së lujtshme dhe të paluajtshme të kishave.

t) Të kujdesen për ruajtjen dhe shtimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të kishës.

u) Të interesohen për mbarëvajtjen e ndërtesave kishtare dhe për ruajtjen e kishave, sidomos të sendeve me vlerë arkeologjike, dhe për pajisjen e kishave me sende të nevojshme si: Ikona, libra, veshje të shenjta dhe me gjithshka nevojitet për shërbesat kishtare.

v) Të zgjedhin, në qoftë se vendet nëpër qytete janë vakante, famulltarin, dhjakonin dhe psaltët. Ndër katundet famulltari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e famullisë. Në emërimin e priftërinjve dhe të dhjakonëve episkopi ruan veton për arsye shpirtërore.

vv) Të zgjedhin dhe të mbikqyrin kujdestarinë kishtare në kryerjen e detyrave të saj.

x) Të emërojnë dhe të pushtojnë shërbesat e kishave, ndërsa organizimi i koreve mbetet në kompetencën e titullarëve.

y) Të gjejnë mjetet e nevojshme për ndreqjen ose riparimin e kishës dhe të ndërtesave të saj, të destinuara për kultin hyjnor.

z) Të interesoshen për përmirësimin e gjëndjes ekonomike të personelit kishtar.

aa) Të propozojnë dhe të kërkojnë aprovimin e Këshillit Ekonomik të Përhershëm mbi përdorimin e fondeve disponibël të kishës, përveç rasteve me karakter urgjent.

bb) Të shqyrtojnë në mbarim të vitit financiar buxhetin konsumativ dhe t'ia paraqisin këtë bashkë me një raport shkoqitës Kryesisë së Kishës me anë të episkopatës, e cila duhet të shfaqi mendimin e saj relativ.

cc) Të hartojë buxhetin preventiv vjetor dhe t'ia paraqitin këtë për aprovim Këshillit Ekonomik, nëpërmjet qëndrës së episkopatës.

Të krijojnë bibliotekën e famullisë, duke e pajisur me libra të dobishme.

KUJDESTARITË KISHTARE

Neni 25. Këshilli Kishtar i Qytetit zgjedh jashtë gjirit të tij dy deri tre kujdestarë për çdo kishë për një periudhë prej dy vjetësh, të cilët aprovohen prej titullarit kompetent dhe shërbejnë darovisht.

Neni 26. Të drejtat dhe detyrat e kujdestarëve të kishës janë: Të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Kishtar me votë konsultative.

dd) Të përkujdesen për tërë pasurinë e lujtshme dhe të palujtshme të kishës sipas iventarit.
ee) Të inskasojë kontributet kishtare dhe t'ia dorëzojnë sekretar-llogaritarit lokal kundrejt dëftese të rrregullt, për t'i derdhur në bankë.
ff) Të përkujdesen për ndërtesat kishtare dhe oborrin e Kishës që të mbahen në gjëndje të mirë, duke i bërë propozime për këto Këshillit Kishtar.

KËSHILLAT MANASTIRIALE (IGUMENIALE)

Neni 27. Këshilli manastirial (igumenial), përbëhet prej igumenit ose administratorit klerik dhe prej tre anëtarëve laikë, prej katundeve më të afërme të manastirit. Në rast se manastiri ndodhet afër qytetit, njëri anëtar zgjidhet nga qyteti.

Neni 28. Anëtarët e këshillit manastirial (igimenial), zgjidhen për një periudhë prej dy vjetësh, prej katundeve ose këshillit kishtar të qytetit respektiv, jashtë gjirit të tij.

Neni 29. Emrat e anëtarëve të këshillit manastirial, i njoftohen me anë të zëvendësit lokal titullarit të episkopatës, i cili aprovon.

Neni 30. Këshilli manastirial mblidhet zakonisht një herë në muaj dhe jashtëzakonisht sa herë që e lyp nevoja, thirret prej administratorit klerik ose igumenit i cili e kryeson dhe ky ka kuorum kur ndodhen prezent dy anëtarë përveç kryetarit.

Neni 31. Kompetencat e këshillit manastirial janë:

Të përkujdeset për mbarë-vajtjen e manastirit dhe për mirë funksionimin dhe përparimin e tij të gjithanshëm.
gg) Të vendosë mbi jetërsimin e pasurisë manastiriale, mbasi më parë të mirret aprovimi i këshillit Ekonomik të Përhershëm; me aprovim të Këshillit Ekonomik vendoset gjithashtu edhe blerja e ndonjë pasurije, kur shifet se kjo është në dobi të manastirit.
hh) Të emërojë ose të pushojë personelin e manastirit, me përjashtim të administratorit klerik.
ii) Të hartojë buxhetet konsumative dhe preventive të manastirit, të cilët ia paraqesin zëvendësisë lokale nga ku varet.

Neni 32. Këshilli manastirial funksionet e tij ekonomikë-financiarë i kryen në bazë të instruksioneve të dhëna nga Kryesia e Kishës dhe në konformitet me ligjet përkatëse në fuqi.

KAPTINA II
KRYEPISKOPI DHE EPISKOPËT

Neni 33. Kryepiskopi dhe episkopët, përveç të drejtave dhe detyrave që parashikohen në nenin 27 dhe 30 të Statutit, janë të përhershëm dhe nuk mund të transferohen veçse në raste të jashtëzakonshme kur Sinodhi i Shënjtë e sheh të arsyeshme.

Neni 34. Afat i qëndrimit të një dioqeze vakante me një zëvendës episkopal të përgjithshëm provizor, për të cilën flitet në nenin 27 gërma h të Statutit, caktohet në tre muaj.

Neni 35. Pushim i Kryepiskopit dhe i episkopëve, bëhet për faje të rënda dogmatike dhe kanonike, për faje ordinere dhe për arsye extraordinere.

Për faje të rënda dogmatike dhe kanonike gjykohen prej Sinodhit të Shenjtë, në komformitet me nenin 11, gërna dh, të Statutit. Vendimi jepet me shumicë votash, pasi të dëgjohet më parë apologjia e të akuzuarit, i cili detyrohet ta paraqitë këtë me shkrim ose ta bëjë verbalisht brënda pesë ditëve nga data e njoftimit.

Kryepiskopi, episkopë dhe gjithë funksionarrët e tjerë në shërbim të kishës, që shkelin ligjet e Shtetit, rendin publik ose zakonet e mira dhe që zhvillojnë ndonjë aktivitet anti-demokratik, pavarësisht nga përgjegjësia tjetër, me propozimin e Këshillit Ministerial mund të pezullohen ose të pushohen nga detyra.

Neni 36. Kryepiskopi dhe anëtarët e Sinodhit, për shkak sëmundje kronike ose pleqërije, të cilat nuk u përmetojnë të përmbushin detyrat e tyre, kanë të drejtë t'i paraqesin kanonikisht dhe me të shkrojtur dorëheqjen e tyre Sinodhit të Shenjtë.

Sinodhi i Shenjtë ka të drejtë të shkarkojë nga detyra Kryepiskopin, sinodhikët, ose çdo klerik tjetër, kur konstaton se për shkak sëmundje kronike ose pleqërije, këta nuk janë në gjëndje të përmbushin detyrat e tyre. Pa aftësija në punë provohet kurdoherë me raport mjekësor.

Neni 37. Kryepiskopi, episkopët, episkopët titullarë dhe zëvendësit e tyre, gëzojnë të drejtë lejeje të zakonshme 30 ditë në vit, ndërsa zëvëndësit mitropolitanë ose episkopalë lokalë dhe priftërinjtë, 15 ditë në vit.

KAPTINA III
ZËVENDËSIT MITROPOLITANË DHE EPISKOPALË LOKALË

Neni 38. Kompetencat e zëvendësive mitropolitanë dhe episkopalë lokalë janë:

Të drejtojnë aktivitetin pastoral, kultural dhe shoqëror të klerikëve të juridiksionit të tyre.

Të zbatojnë vendimet dhe urdhërat e organevesuperiore.

Të kujdesen që famullitë vakante të juridiksionit të tyre të mos mbeten pa famulltarë, për kryerjen e shërbesave fetare.

Të bëjnë mbledhje të përmuajshmë me klerin e juridksionit të tyre dhe t'i japin udhëzimet e nevojshme për kryerjen e misionit të tij fetaro-patriotik, duke mbajtur dhe proces verbalet përkatëse.

T'i parashtrojnë një raport të hollësishëm qëndrës së episkopatës në fund të çdo tremujori, mbi gjëndjen e juridiksionit të tyre.

Të inspektojnë të paktën dy herë në vit, të gjitha famullitë e juridiksionit të tyre, për të kontrolluar dhe konstatuar për së afërmi gjendjen e kishave, të manastireve dhe parakliseve, duke ia raportuar rezultatin episkopatës së tyre.

Të mbajnë protokoll të rregullt për të gjitha veprimet, duke sistemuar aktet dhe arshivën e zëvëndësisë së tyre.

Të interesohen përmbajtjen e plotë të inventarit të përgjithshëm të kishave dhe të manastireve të juridiksionit të tyre, një kopje të të cilit t'ia dërgojnë qëndrës së episkopatës.
jj) Të interesohen për mbajtjen në rregull dhe në regjistrat përkatëse të llogarive të kishave dhe të manastireve të juridiksionit të tyre, me anë të sekretar-llogaritarëve, në komformitet me udhëzimet financiare.
Të kujdesen për mbajtjen në rregull të regjistrave të pagëzimeve, të kurorëzimeve dhe të varrimeve të të gjithë juridiksionit të tyre.
kk) Të kryesojnë këshillin kishtar lokal (Dhimogerondinë) dhe çdo mbledhje që ka të bëjë me zgjedhjet.

KAPTINA IV
FAMULLTARËT

Neni 39. Famulltari është udhëheqësi shpirtëror i besnikëve të famullisë.

Neni 40. Kompetencat e famullitarit janë këto:
Të vërë në zbatim të gjitha dispozitat e Statutit, të Rregullores, të vendimeve dhe urdhrave të organeve shtetërore kishtare në lidhje me famullinë.
Të thërrasë dhe të kryesojë këshillin kishtar ndër katundet, kurse në qytete ky kryesohet prej titullarëve ose zëvendësve të tyre lokalë.
Të mbajë një regjistër të të gjithë besnikëve të famullisë së tij.
Të mbajë shënime mbi pagëzimet, kurorëzimet dhe varrimet të cilat detyrohet në fund të çdo muaji t'ia dorëzojë zëvendësisë lokale nga ku varet.
Të kryejë shërbimet fetare simbas rregullave dhe traditës së Kishës.
Të kujdeset për mbajtjen ne rregull të llogarive të kishës së katundit ku shërben, në komformitet me udhëzimet financiare, dhe të mbajë në rregull arshivën e kishës mbi të gjithë korrespodencën që zhvillohet ndërmjet organeve superiore.
Të mbajë kronikën e kishës në të cilën shënon ngjarjet historike.
ll) Të kujdeset për mirë-mbajtjen e orendive dhe të robeve të shenjta.
Të njoftojë zëvendësinë metropolitane ose episkopate nga ku varet për çdo herezi, ose anomali që mund të ngjasë në famullinë e tij.

Neni 41. Për t'u dorëzuar (hirotonisur) në gradën e dhjakonit ose priftit një kandidat duhet:
Të jetë i krishterë orthodhoks dhe i pagëzuar sipas rregullave të Kishës Orthodhokse Lindore.
Të ketë cilësitë shpirtërore të parapara nga kanonet e shenjta.
mm) Të mos ketë të meta trupore dhe të gëzojë shëndet të plotë.
nn) Të jetë shtetas shqiptar dhe të gëzojë të gjitha të drejtat civile dhe politike.
Të ketë mbaruar nje seminar ose shkollë të mesme dhe në mungesë tëkëtyre, të ketë aftësi të mjaftueshme autodidakti.

Neni 42. Dokumentat që duhet të paraqitë kandidati për t'u dorëzuar, janë:
Dëshminë e rrëfimit nga ati shpirtëror, me anë të së cilës vërtetohet aftësia e tij shpirtërore.
Çertifikatën shkollore të vërtetuar rregullisht.

oo) Çertifikatë lindjeje
pp) Raport mjekësor mbi gjendjen shëndetësore.
qq) Çertifikatë mirë-sjellje të lëshuar nga organet shtetërore kompetente.
rr) Çertifikatë penaliteti nga prokuroria publike.
Deklaratën e gruas, të vërtetuar nga Këshilli Popullor kompetent, me anën e së cilës ajo do të deklarojë se pranon dorëzimin e bashkëshortit të saj në gradën klerikale.
Vendimin e famullisë ose të Këshillit Kishtar për zgjedhjen e kandidatit. Një kandidat mund të dorëzohet dhe pa vendim të fammullisë ose Këshillit Kishtar, por ky do të dërgohet si famullitar pasi të mirret më parë vendimi i famullisë ose i këshillit përkatës.
Lutjen e tij për t'u dorëzuar (hirotonisur).

Neni 43. Të gjitha këto dokumenta i përcillen titullarit të episkopatës, i cili pasi i studion dhe aprovon kandidatin, ia përcjell kryesisë së kishës me shënimet e rastit, e cila duhet të interesohet që pranimi ose mospranimi i tij të vendoset brenda 40 ditëve.

KAPTINA V
ADMINISTRATORËT E MANASTIREVE (IGUMENET)

Neni 44. Kompetencat e administratorit klerik (igumenit) të një manastiri janë:
Të përkujdeset për mbarë-vajtjen dhe përparimin e manastirit, si dhe për mbajjtjjen e një disipline të përshtatshme për një qëndër të tillë qetësie shpirtërore.
Të kryejë të gjitha shërbimet fetare në konformitet me rregullat, kanonet dhe zakonet kishtare.
Të administrojë pasurinë e manastirit simbas urdhrave hieratike dhe në konformitet me vendimet e këshillit manastirial (igumenial) duke kujdesur që të zhvillohet frutikultura, apikultura dhe zanate të ndryshme për prodhimin e sendeve të shenjta që përdoren në kisha.
Të kujdeset për mbajtjen e llogarive të manastirit konform me udhëzimet financiare.
ss) Të inkasojë të ardhurat dhe të kryejë shpenzimet në komformitet me buxhetin e aprovuar nga Këshilli Ekonomik.
Të mbajë dhe të ruajë arshivën e manastirit.

KAPTINA VI
PREGATITJA E KLERIT KONFFERENAT DHE BOTIMET

Neni 45. Pregatitja e klerit bëhet në seminare ose shkolla të mesme fetare, në kurse të shkurtra perfeksionimi dhe me ane konferencash.

Neni 46. Konferencat zhvillohen në bazë të një programi të hartuar nga seksioni i kulturës dhe të aprovuar nga Sinodhi i Shenjtë.
Kurse mund të zhvillohen dhe me psaltirit, me qëllim që të perfeksionohen, në degën e tyre.

Neni 47. Kryesia e Kishës nxjerr një revistë të përmuajshme si organ zyrtar të saj, me titull “Orthodhoksia” dhe me përmbajtje fetare-kulturore dhe kombëtare të dobishme për klerin dhe besimtarët.
Revista nxirret nga seksioni i kulturës me drejtor përgjegjës të caktuar nga Sinodhi i Shenjtë.

Neni 48. Pajtimi vjetor i revistës caktohet me vendim të posaçëm të Këshillit Ekonomik të Përhershëm..

KAPTINA VII
PERSONELI I KRYESISË DHE I EPISKOPATAVE

I. ORGANIKA

Neni 49. Në komformitet me Nenin 28 të Statutit, Kryepiskopi ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga:
Një episkop ndihmës
tt) Një Sekretar i Përgjithshëm i Sinodit
uu) Një Kryedhjakon

Neni 50. Pranë Kryesisë së kishës funksionojnë edhe këto seksione:
Seksioni i administratës, që përfshin:
vv) Referentin e personelit
vuv) Arshivist-protokollistin
xx) Nënpunësin e ekonomatit-inventarit
yy) Kopistin
zz) Shoferin
aaa) Korrierin
bbb) Shërbyesin
ccc) Seksioni i kulturës që përfshin:
ddd) Shefin e kulturës
eee) Predikatorin
fff) Referentin e kulturës
ggg) Seksioni ekonomiko-financiar, që përfshin:
hhh) Shefin e llogarisë
iii) Llogaritarin
jjj) Referentin për pasuritë kishtare dha manastiriale

Neni 51. Seksionet e sipër-treguara udhëhiqen nga Kryesia e Kishës nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Sinodhit.

Neni 52. Çdo episkopatë ka këtë personel:
Sekretar
kkk) Dhjakon
lll) Predikator
mmm) Kopist-Arshivist-Protokollist
nnn) Shërbyes

Neni 53. Në çdo zëvendësi metropolitane ose episkopatë lokale, përveç zëvëndësit ka edhe një sekretar-llogaritar lokal.

II EMËRIME

Neni 54. Episkopi ndihmës, i parashikuar në nenin 28 të Statutit, emërohet nga Sinodhi i Shenjtë në komformitet me kanonet e shenjta.

Neni 55. Nënpunësit e Kryesisë së kishës dhe të episkopateve, emërohen dhe pushohen si më poshtë:

Shefi i Seksionit të kulturës, predikatoret, referenti i personelit dhe referenti i kulturës, emërohen dhe pushohen nga Kryesia e Kishës me pëlqimin e Sinodit.

ooo) Shefi i llogarisë, referenti i pasurive kishtare dhe manastiriale dhe llogaritari, emërohen dhe pushohen nga Kryesia e Kishës me pëlqimin e Këshillit Mikst.

Sekretarët e episkopateve, emërohen dhe pushohen prej titullarëve respektivvë, me pëlqim të Kryesisë së Kishës.

ppp) Gjithë nënpunësit e tjerë të Kryesisë së Kishës dhe të episkopateve, emërohen dhe pushohen prej titullarëve respektivë.

Sekretar-llogaritarët e zëvendësive metropolitane ose episkopate likale emërohen dhe pushohen nga Këshilli-Kishtar (dhimogjerondia) i zëvendësisë dhe aprovohen prej titullarit përkatës, por titullari kur konstaton se një sekretar-llogaritar nuk i kryen detyrat e tij, ka të drejtë ta pezullojë menjëherë dhe të kërkojë pushimin e tij nga Këshilli Kishtar.

III.- DETYRAT

Neni 56. Sekretari i Pergjithshëm i Sinodhit, i cili është njëkohësisht dhe Sekretar i Përgjithshëm i Kryesisë së Kishës, ka këto detyra:

Kryen gjithë punët administrative të Kryesisë së Kishës.

Mban proçes-verbalet e mbledhjeve të Sinodhit dhe të këshillave të larta të kishës.

qqq) Kryen çdo lloj detyre që i ngarkohet nga këshillat e larta të kishës dhe nga Kryepiskopi.

rrr) Ka për detyrë, nji herë në vit, t'i paraqesë Këshillit Mikst të Kishës një raport vjetor mbi veprimtarinë administrative, me propozimet përkatëse.

Neni 57. Shefi i Seksionit të kulturës ka këto detyra:

Botimin e revistës së Kishës dhe të librave të tjera me përmbajtje fetaro-morale.

sss) Pregatitjen e materialit të predikimit të fjalës së Zotit ndër kisha për të diela dhe të kremte, nën kontrollin e Kryesisë së Kishës.

ttt) Kujdesjen që kishat të jenë të pajisura me orenditë kishtare dhe librat kishtarë. Krijimin e bibliotekave ndër zëvendësitë metropolitane dhe episkopate lokale.

Pregatitjen e lëndës për konferencat, për ngritjen kulturore të klerit dhe të psaltëve, nën kontrollin e titullarëve.

Përkthimin e librave për letërsinë kishtare.

Dhe në përgjithësi merret me çdo problem kulturor kishtar që preokupon kishën.

uuu) Një herë në tre muaj e ka për detyrë t'i paraqiti Kryesisë së Kishës një raport mbi veprimtarinë kulturore me propozimet përkatëse.

Neni 58. Detyrat e shefit të seksionit ekonomiko-financiar janë:

Të kujdeset për mbajtjen e kontabilitetit simbas rregullave financiare.

vvv) Të japë të gjitha elementet kontable për përpilimin e buxhetit vjetor.

Të ndjekë me kujdes dhe të kontrollojë herë pas here zbatimin e përpiktë të buxhetit të përgjithshëm, si edhe të buxheteve lokale.
vvvv) Të studiojë dhe t'i referojë Këshillit Ekonomik çdo masë që ka lidhje me përmirësimin ekonomik të Kishës.
Të kujdeset për mbajtjen e inventarit të pasurisë kishtare.
Të japë udhëzimet dhe sqarimet përkatëse në lidhje me dispozitat që kanë të bëjnë me kontabilitetin.
Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me fondin e sigurimit të klerit.

Neni 59. Detyrat e referentit të personelit janë:
Të mbajë evidenca të rregullta dhe biografitë e personelit kishtar, klerik dhe laik.
Të interesohet për mbajtjen në evidencë të personelit klerik dhe laik.

VI.- GRADAT KISHTARE TË NDERIT

Neni 60. Në konformistet me Nenin 23 të Statutit, priftërinjve jepen këto grada nderi:
Saqellar
xxx) Ekonom
yyy) Ekonom Stavrofor

Neni 61. Gradat e nderit, që përmenden në nenin 60, germat a,b,c, jepen me propozim të titullarit respektiv dhe me aprovimin e Sinodhit të Shenjtë, në këto raste:
Kur konstatohet se është shembull në besë, në sjellje dhe në kryerjen e shërbimeve fetare.
Kur me inisiativën dhe punën e tij ka ndërtuar ndonjë kishë.
Kur ka treguar aktivitet për mbrojtjen e të drejtave të Kishës Orthodhokse dhe për mbrojtjen e Atdheut.
Kur tregon aftësi dhe aktivitet të gjallë administrativ.
Kur me përpjekje tëmëdha arrin të bëhet një predikatore i mirë i fjalës së Zotit.

KAPTINA VIII
SIGURIMI I KLERIT

Neni 62. Pranë Kryesisë së kishës krijohet "Fondi i Sigurimit të Klerit", i cili ka për qëllim të sigurojë të gjithë klerikët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Neni 63. Fondi i sigurimit të klerit përbëhet nga:
5% mbi rrogat e personelit klerik që derdhet nga punëdhënësi në fund të çdo muaji.
zzz) 2% mbi të ardhurat bruto të kishave dhe të manastireve, të cilat derdhen nga këto në mbarim të çdo tremujori.
aaa) Nga kontributi vullnetar 1% mbi rrogën bazë që derdhin klerikët e siguruar në fund të çdo muaji.

Neni 64. Konsiderohet si rrogë bazë, rroga që i paguhet klerikut nga Kryesia e Kishës plus shpërblimin që ai merr nga katundi, qoftë ky shpërblim edhe në natyrë; me përjashtim të tihirave (rasëshmeve).

Neni 65. Sigurimi i klerit përfshin:

Shpërblime në të holla në rast pasftësie të përkohshme për punë, për klerikët e siguruar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre.
Shpërblime suplementare në të holla për ushqim dhe paisjen e fëmijës me sendet e nevojshme dhe për shpenzime varrimi, si për të siguruarin ashtu edhe për pjesëtarët e familjes së tij.
Pensione në rast paaftësije të përhershme për punë (invaliditet) dhe ndihmë familjare në rast vdekjeje të të siguruarit.

Neni 66. Kleriku i siguruar që bëhet i pa aftë për punë, për shkak sëmundje, ka të drejtë për një shpërblim në të holla për të gjitha ato ditë pune që ndodhet i sëmurë, në masën që parashikohet për nënpunësit e siguruar detyrimisht nga Shteti.

Neni 67. Kleriku i siguruar kui i lind një fëmijë, ka të drejtë në një shpërblem fiks dhe një sasi që parashikon ligja për të siguruarit detyrimisht nga Shteti, për lindje, për pajisjen e fëmijës me sendet e nevojshme dhe për ushqimin e fëmijës për 9 muaj, në qoftë se ka punuar jo më pak se 6 muaj në punë të pandërprerë para lindjes.

Neni 68. Shpërblimi për lindje nuk jepet në këto raste:
Kur kleriku i siguruar është larguar pa leje nga puna, ose kur është pushuar nga puna për faje të parashikuara në Statutin e Kishës dhe në këtë Rregullore.
Kur rroga mujore e klerikut të siguruar në muajin e fundit para lindjes kalon masën e parashikuar nga dispozita përkatëse e Ligjës mbi sigurimet shoqnore.
Kur nëna banon në fshat dhe familja në të cilën bën pjesë realizon fitime nga ekonomia bujqësore dhe paguan tatim-fitime.
Kur fëmija lind i vdekur.

Neni 69. Kur lindin dy ose më shumë fëmijë, shpërblimi për lindje për secilin fëmijë simbas dispozitave të mësipërme.

Neni 70. Kur kleriku i siguruar vdes, pjesëtarët e familjes së tij kanë tëdrejjtë në një shpërblim për varrim, në masën që parashikohet nga Ligja për të siguruarit detyrimisht nga ana e Shtetit.

Neni 72. Pjesëtarë të familjes në ngarkim të klerikut të siguruar, konsiderohen këta: Fëmijët e lindur me martesë ose të adoptuar, vëllezërit dhe motrat nën 16 vjeç, ose nën 20 vjeç kur vazhdojnë mësimet në ndonjë institut shkollor.
Prindërit e klerikut të siguruar që janë në ngarkim efektiv të tij dhe gruaja.

Neni 73. Shpërblimet për paaftësi të përkohshme për punë (sëmundje, barrë, lindje) si edhe shpenzimet e varrimit duhet të kërkohen brenda tre muajve nga data në të cilën ka lindur e drejta.

Neni 74. Shpërblimet e përmendura në nenin 65, germa a, paguhen në bazë të faturës ose dëftesës së spitalit apo martenitetit, e cila duhet të jetë e shoqëruar dhe me raportin e mjekut. Kur është rasti për pjestarin e familjes, përveç të dëftesës dhe raportit, duhet dhe një çertifikatë nga gjendja civile, me anën e së cilës vërtetohet qenia e personit në ngarkim të klerikut të siguruar.

Neni 75. Shpërblimet e përmenduar në nenin 65, germa b, paguhen në bazë të çertifikatës së lindjes.

Neni 76. Shpërblimi për shpenzime varrimi që përmenden në nenin 70 dhe 71, paguhet në bazë të çertifikatës së vdekjes.

PENSIONET

Neni 77. Në mbështetje të së drejtës kanonike dhe të traditës kishtare, simbas së cilës kleriku është i përhershëm në detyrë, ky nuk mund të dalë në pension për shkak pleqërije, por vetëm për shkak paaftësije në përmbushjen e detyrave të tij.
Sasia e shpërblimit do të paguhet në masën e parashikuar nga Ligja mbi sigurimet shoqërore shtetërore për invalidët e kategorisë së parë.

Neni 78. Kur kleriku i siguruar vdes qoftë me vdekje natyrale qoftë aksidentalisht, familjes së tij mund ti jepet një ndihmë vjetore në sasinë që do të caktohet nga Këshilli Mikst për çdo vit.

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 79. Një këshillë kishtare, e cilësdo gradë qoftë, ose një këshillë manastiriale, apo anëtarë të tyre, mund të revokohen edhe para mbarimit të afatit për të cilin janë zgjedhur, me kërkimin e Kryesisë së kishës apo të titullarëve të episkopateve, ose me kërkimin e dy të tretave të zgjedhësve.

Neni 80. Kjo Rregullore mund të modifikohet vetëm me vendim të Këshillit Mikst.

Neni 81. Mënyra e procedurës së gjykimit të çështjeve disiplinore që i referohen gjykatave spirituale dhekompetencës së Sinodhit, si edhe dispozita të tjera përkatëse, do të caktohen hollësisht në një rregullore tëposaçme të hartuar nga Sinodhi i Shenjtë.

Neni 82. Kjo rregullore e përpiluar në konformistet me dispozitat e Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Ligjës mbi Komunitetet fetare, hyn në fuqi pasi më parë të aprovohet nga Këshilli Ministror.

4.12 REZOLUCIONI I KONGRESIT III TË KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

Më 5-10 shkurt 1950 u mbajt në Tiranë Kongresi i III-të i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Kongresi u mbajt në një kohë kur populli shqiptar, i çliruar qysh prej 6 vjetësh në sajë të fitores së shkëlqyer të Ushtrisë Sovjetike të lavdishme, të prirë nga gjeniali Stalin, dhe në sajë të luftës së tij heroike Nacional-Çlirimtare, të prirë nga komandanti ynë i dashur Gjeneral Armate Enver Hoxha, ka përmbysur regjimet antipopullore të tiranisë, të shtypjes dhe të çfrytëzimit, duke marrë pushtetin në duart e veta dhe ka dërrmuar me vendosmëri shembullore gjithë tentativat e tradhëtarëve dhe të armiqve të tij të brendshëm e të jashtëm, që synojnë në mënyrë sistematike dhe djallëzore ti rrëmbëjnë këtë fitore të lavdishme, të korrur me aq sakrifica dhe privacione dhe me mijëra dëshmorë e heronj.

U mbajt në një kohë kur vendi ynë, i prirë nga qeveria jonë demokratike, nga partia jonë e punës dhe shoku Enver, dhe me ndihmën e paçmueshme të Bashkimit Sovjetik e të madhit Stalin, dhe me ndihmën e demokracive popullore, ka arritur suksese të mëdha në zhvillimin dhe lulëzimin e tij të gjithanshëm dhe i mobilizuar totalisht për realizimin e planeve të shtetit, ndërton i qetë bazat e socializmit.

U mbajt në një kohë kur atdheu dhe populli ynë, nën udhëheqjen e partisë dhe të shokut Enver, nanë radhitur vendosmërisht në kampin e patundshëm demokratik dhe anti-imperialist, të prirë nga Bashkimi i lavdishëm Sovjetik dhe i madhi Stalin, kamp, i cili rritet e forcohet nga dita në ditë, ndërsa kampi anti-demokratik e imperialist, që përfshin forcat e errësirës, dhe të skllavërisë, me në krye imperializmin amerikano-anglez, po gryhet e dërmohet nga dita në ditë, nën presionin e fortë të forcave të paqes dhe të grevave të përditshme dhe nën peshën e rëndë të kontradiktave të brendëshme.

U mbajt, fundi, në një kohë kur mbarë njerëzimi përparimtar është radhitur në kampin unik të paqes, të dashurisë dhe të vëllazërimit, ku e ka vendin dhe kisha jonë e rilindur dhe ku bëjnë pjesë kishat përparimtare të botës, me në krye Kishën e Madhe Ortodokse Ruse.

Kongresi, pasi dëgjoj referatin e kryetarit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, mbi gjendjen e saj që prej kohëve të lashta e deri më sot dhe programin e ri të kishës së rilindur, si edhe diskutimet e delegatëve të kongresit, dënon me një zë të gjithë veprimtarinë armiqësore të ushtruar prej udhëheqësve të deridjeshëm në dëm të saj, të popullit dhe të atdheut tonë, aprovon unanimisht rrugën dhe vijën ndërtimtare që ka caktuar udhëheqja e saj e sotme, si edhe Statutin e ri të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, duke caktuar njëkohësisht këto detyra:

1) Sinodi, si kokë drejtuese dhe udhëheqëse e kishës sonë, të punojë në mënyrë të atillë që kisha të jetë e masave, ashtu siç e lypin parimet demokratike të orthodhoksisë, ashtu siç është karakteri dhe destinacioni i saj. Të punojë në një drejtim të atillë që kisha të vihet në shërbim të interesave të besimtarëve, të atdheut dhe të mbarë popullit shqiptar. Që kisha të bëhet një instrument i dobishëm në zgjidhjen e problemeve aktuale të shoqërisë, një qendër ku të farkëtohen e të nxiten

ndjenjat e atdhedashurisë, të vëllazërimit dhe të unitetit kombëtar, një faktor lumturie për mbarë popullin tonë.

Të aktivizohet në një mënyrë të atillë, që kisha të orientohet e të drejtohet në rrugën që shpie drejt kampit unik të paqes, të dashurisë dhe të vëllazërimit ndërmjet popujve, në krye të të cilit kamp qëndron Bashkimi i Lavdishëm Sovjetik dhe i Madhi Stalin dhe ku bëjnë pjesë vendosmërisht gjithë popujt përparimtarë e paqedashës dhe gjithë kishat përparimtare, me në krye Kishën e Madhe Ortodokse Ruse. Ky është kampi shpëtimtar që u siguron popujve dhe kishave të tyre lirinë dhe pavarësinë, kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, që synojnë të skllavërojnë popujt dhe të mbytin liritë e tyre. Të aktivizohet në një mënyrë të atillë që kisha dhe punonjësit e saj të qëndrojnë vendosmërisht dhe me vigjilencë përkrah popullit shqiptar dhe pushtetit të tij, kundër çdo armiku të jashtëm e të brendshëm, dhe të punojnë me ndërgjegje në drejtimin e respektimit të plotë të ligjeve dhe të urdhëresave të pushtetit tonë popullor dhe të realizimit të planeve.

Vetëm me një drejtim të tillë nga lart, të ndërmarrë në radhë të parë nga Sinodi dhe nga këshillat e larta, kisha do të hyjë në rrugën e drejtë dhe dobiprurëse për popullin dhe klerin popullor dhe do të japi nji kontribut të çmueshëm në kauzën e drejtë e të paqes, të dashurisë dhe të vllazërimit të popujve.

2) Gjithë funksionarët e kishës, klerikë dhe laikë, gjithë priftërinjtë dhe gjithë personeli kishtar, si edhe gjithë anëtarët e këshillave kishtare të qyteteve dhe të katundeve, të jenë njerëz me ndjenja të larta patriotike, të jenë njerëz të ndershëm, të ushqejnë një dashuri të pakufishme për Republikën tonë Popullore, për Qeverinë tonë Demokratike, për Partinë tonë të Punës dhe udhëheqësin e saj të ndritur, shokun Enver, për Bashkimin e Lavdishëm Sovjetik dhe të madhin Stalin, për Demokracitë Popullore motra dhe për gjithë kampin unik të njerëzimit përparimtar e paqedashës.

Të dallohen në mënyrë të veçantë për këto ndjenja të larta dhe në këtë drejtim të edukojnë, të drejtojnë dhe të udhëzojnë edhe popullin. Gjithashtu të denoncojnë me forcë çdo tentativë të armiqve të jashtëm e të brendshëm të popullit dhe të atdheut tonë dhe të nxisin vigjilencën e besimtarëve në këtë drejtim. Të bëhen shembull personalisht në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe urdhëresave për realizimin e planeve të shtetit, duke edukuar në këtë rrugë edhe besimtarët.

3) Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë të mbajë lidhje bashkëpunimi të ngushtë dhe ti shtojë e ti përfocojë dita ditës këto lidhje në radhë të parë me Kishën e Madhe Ortodokse Ruse dhe me kishat orthodhokse motra të demokracive popullore. Në këtë drejtim duhet të udhëzohet, gjithnjë e më tepër kisha e jonë për të marrë dritë.

4) Kongresi falenderon nga zemra Qeverinë Demokratike, Partinë tonë të Punës dhe Shokun Enver dhe u shpreh ndjenjat e mirënjohjes së thellë për përkrahjen dhe ndihmën e madhe morale dhe materiale që i kanë dhënë dhe po i japin vazhdimisht Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, në përmbushjen e detyrave të saj karshi popullit dhe atdheut.

5) Të ruhen dhe të mbahen mirë kishat dhe manastiret tona si edhe sendet me vlerë që këto disponojnë, dhe të vihen përpara përgjegjësisë personale këshillat dhe i gjithë personeli drejtues i tyre, jo vetëm për mirëmbajtjen e tyre, por edhe për administrimin ekonomik të tyre, në mënyrë që të ardhurat e tyre të shkojnë në dobi të

tyre, të klerit dhe të besimtarëve. Të zbatohet një kontroll i shëndoshë dhe i rreptë financiar dhe të aplikohet një sistem unik në mbajtjen e llogarive, në konformitet me rregullat dhe dispozitat financiare, në mënyrë që të evitohen abuzimet dhe shpërdorimet e lekut të besimtarëve dhe të faltoreve të tyre, nga njerëz të pandërgjegjshëm. Të ndalohet në mënyrë kategorike mbajtja e pareve të kishave dhe të manastireve nëpër xhepat e arkëtarëve dhe të administratorëve të tyre, sikur këto të ishin të ardhura nga pronat e tyre, siç bëhej shpesh në të kaluarën, dhe të punohet sistematikisht në forcimin e ndërgjegjes se të ardhurat e institucioneve fetare janë të ardhura kolektive për një qëllim dhe destinacion të përbashkët fetar, filantropik dhe social.

6) Të luftohet si një mjet i dëmshëm dhe përçarës i unitetit kishtar mentaliteti dhe fryma e moderuar e lokalizmës që karakterizon, aty këtu, disa komunitete orthodhokse lokale, të cilat i shikojnë çështjet dhe problemet e përbashkëta kishtare nën prizmin e interesit lokal, sidomos në punët financiare dhe të nxitet dhe të ngrihet lart ideali i solidaritetit dhe i ndihmës së një komuniteti më të varfër nga një komunitet në gjendje ekonomike më të shëndoshë, në mënyrë që me anën e ndihmave reciproke, të mund të mbahen kisha të varfëra, të rindërtohen kisha të djegura dhe të përballohen nevoja të ndryshme ekonomike, të domosdoshme për mirëqënien e kishës dhe të punonjësve të saj në përgjithësi. Bile, në këtë drejtim kishat duhet të aktivizohen në një veprimtari më të gjerë sociale, duke ndihmuar strehët varfërore dhe foshnjore, si dhe azilet për pleqt dhe spitalet dhe duke akorduar bursa për studentë të vobektë. Një veprimtari e kishave në këtë drejtim, është aplikimi në jetë i anës praktike të krishterimit që i shërben shoqërisë në mënyrë pozitive dhe që përbën një pjesë të shëndoshë të destinacionit social të një enti fetar.

7) Duhet të jenë meshtarë të ndershëm dhe të ndërgjegjshëm. T'ju shërbejnë besimtarëve duke qenë gjithmonë të gatshëm dhe në krye të detyrës së tyre fetare për tu përmbushur besimtarëve nevojat e ndryshme fetare që këta kanë, kur kjo iu kërkohet dhe kurdo që iu kërkohet. Në këtë drejtim meshtarët nuk duhet të harrojnë për asnjë minutë se janë ushtarë të kishës, shërbëtorë të besimtarëve dhe se detyra e tyre kryesore konsiston në plotësimin e nevojave fetare të besimtarëve.

8) Të edukohen famulltarët dhe besimtarët në mënyrë që këta të frymëzohen nga idealet e larta të dashurisë ndaj të tjerëve, të cilitdo besimi qofshin dhe kjo dashuri të jetë spontane e pakufishme dhe të ushqehet jo vetëm për njerëzit prej një gjaku, race dhe kombi, por për gjithë popujt pa asnjë dasi.

9) Mbasi konstatohet mungesa e librave për shërbesat fetare, sidomos pas dëmeve të shkaktuara ndër faltoret nga ana e okupatorit gjatë lëvizjes nacional-çlirimtare, i cili nuk ka respektuar as objektet e shenjta, ikonat etj, që përdoren në kult. Kongresi i rekomandon kryekishës të marrë masat e duhura për pajisjen e kishave me librat e duhura të nevojshme për kryerjen e shërbesave fetare.

10) Kongresi çmon inisiativën e lartë për ngritjen në kryeqytet të një selije të denjë të kryesisë së Kishës sonë Orthodhokse Autoqefale dhe falenderon komunitetin orthodhoks të Tiranës për këtë inisiativë. Njëkohësisht u rekomandon të gjithë komuniteteve të dioqezave të ndryshme që, duke ndjekur shembullin e komunitetit

orthodhoks të Tiranës të kontribuojnë brenda mundësive të tyre, për realizimin e kësaj inisiative, e cila do të plotësonte një nevojë vitale të kishës sonë.

11) Kongresi zgjodhi Këshillin Mikst, i cili së bashku me Sinodhin, janë organet më të larta të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në drejtimin dhe administrimin e saj, konform dispozitave dhe frymës së Statutit të ri dhe konform vijës dhe parimeve të reja të aprovuara dhe të përcaktuara nga Kongresi.

Kongresi i III-të i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

4.13 KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

(Tiranë 5 Korrik 1950)

(Nene që lidhen me komunitetet fetare)

Neni 14

Të gjithë shtetasit janë njësoj përpara ligjës. Ata kanë për detyrë të konformohen me Kushtetutën dhe me ligiet. Nuk njihet asnjë privilegj për shkak origjine, pozite, pasurie ose shkallë kulture.

Neni 15

Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Ç'do akt që sjell privilegje, ne favor të shtetasve ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundra Kushtetutës dhe sjell me vehte dënime të parashikuara me ligjë. Është kundra Kushtetutës dhe dënohet me ligjë çdo provokim për të mbjellur urrejtje dhe grindje në mes të kombësive, racave dhe feve.

Neni 18

Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdoren për qëllime politike. Gjithashtu ndalohen organizatat politike me bazë fetare. Shteti munt të ndihmojë materjalisht komunitetet fetare.

Neni 25

Shteti u garanton shtetasve të drejtën e punës me një shpërblim sipas sasisë dhe cilësisë së punës që japin. Shteti u siguron shtetasve të drejtën e pushimit me kufizimin e orëve të punës, me dhënien e një pushimi të përvitëshëm të paguar dhe me krijimin e sanatoriumeve, shtëpive pushimi, klubeve, etj. Gjithashtu shteti, me anë të sigurimeve shoqërore, u siguron shtetasve mjetet materjale për jetesë në pleqëri dhe në rast sëmundje dhe humbje të aftësive për punë.

4.14 MBI APROVIMIN E NDRYSHIMIT TË PARAGRAFIT TË DYTË TË STATUTIT TË KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË

(Dekret Nr. 3030, datë 12. 1. 1960)

Në mbështetje të nenit 7 të Dekretit

Nr. 743 datë 26-1-1949 "Mbi komunitetet fetare"

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Vendosi:

I. Aprovohet ndryshimi i paragrafit të dytë të nenit 49 të Statutit të Kishës Ordhodokse Autoqefale të Shqipërisë në këtë mënyrë: "Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë para gjykatave e përfaqësojnë me të gjitha të drejtat ligjore titullarët e dioqezave, seicili në juridiksionin e dioqezës së vet, personalisht ose me anë përfaqësuesish ligjorë të emëruar prej tyre"

II. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 12 janar 1960

Dekret nr. 3030

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR

TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI — KRYETARI

Sami Baholli — Haxhi Lleshi

4.15 MBI DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.743 DATË 26.11.1949 “MBI KOMUNITETET FETARE”

(Dekret Nr.3660, datë 10.4.1963)

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës së Republikës Populllore të Shqipërisë. Me propozimin e Qeverisë; Presidiumi i Kuvendit Populllor. Nxjerr këtë dekret: Dekret mbi disa ndryshime në dekretin nr.743 dtë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”

Neni 1

Në dekretin nr.743 datë 26.11.1949, aprovuar me ligjin nr.773 datë 16.1.1950 “Mbi komunitetet fetare” bëhen ndryshimet që vijojnë:

1. Paragrafi i parë dhe i katërt i nenit 7 ndyshohen përkatësisht si më poshtë: “Komunitetet fetare, që të mund të organizohen dhe të funksionojnë duhet të njihen nga shteti. Njohja bëhet me aprovimin e Statutit të tyre nga Këshilli i Ministrave. Njohja e Komunitetit fetar mund të revokohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kur me veprimtarinë e tij, Komuniteti fetar ka shkelur ligjet, rendin juridik dhe zakonet e mira”.

2.Neni 30, ndryshohet si më poshtë: “Qendrat e Komuniteteve fetare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën zyrtare.

Për Presidiumin e Kuvendit Populllor të Republikës së Shqipërisë

Sekretari	Kryetari
Sami Baholli	Haxhi Lleshi

4.16 MBI ÇFUQIZIMIN E DISA DEKRETEVE

(Dekret Nr. 4337, datë 13.11.1967)

Në mbështetje të nenit 58, pika 6, të Kushtetutës;
Me propozimin e qeverisë;

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR I
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
VENDOSI**

Neni 1

Dekreti Nr. 743 datë 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare", siç është ndryshuar me dekretin Nr. 3660 datë 10.4.1943; dekreti nr. 1064 datë 4.5.1950 "Mbi aprovimin e statutit të komunitetit mysliman shqiptarë"; dekreti Nr. 1065 datë 4.5.1950 "Mbi aprovimin e statutit të kishës autoqefale të Shqipërisë"; dekreti Nr.1066 datë 4.5.1950 "Mbi aprovimin e statutit të komunitetit bektashian shqiptarë"; dekreti nr.1322 datë 30.7.1951 "Mbi aprovimin e statutit të kishës katolike të Shqipërisë", çfuqizohen.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Bilbil Klosi

KRYETARI
Haxhi Lleshi

4.17 VENDIM NR. 6, DATË 15.I.1963 I REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS "MBI SHPALLJEN E MONUMENTEVE TË KULTURËS"

Vendim

Rektorati i Universitetit Shstetëror të Tiranës, në mbështetje të nenit 3 të dekretit nr. 586, datë 17.3.1948 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të enteve natyrale të rralla" si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 9.4.1955, në bazë të të cilit Universiteti Shtetëror i Tiranës autorizohet që të aprovojë në lista të posaçme monumentet e kulturës që vihen në mbrojtjen e shtetit dhe duke marrë parasysh vlerën historike, shkencore dhe artistike të monumenteve që përmenden në listën bashkëngjitur vendosi:

Ti shpallë këto objekte që vihen nën mbrojtjen e shtetit sipas nenit I të dekretit nr. 586, datë 17.3.1948, "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla". Vendimi i Institutit të Shkencave për nxjerrjen e listës së parë të monumenteve që vihen nën mbrojtjen e shtetit (botuar në Gazetën Zyrtare nr. 93, datë 16 tetor 1948) mbetet pa fuqi.

Rektori
Kahreman Ylli

4.18-DEKRET NR. 5339, DATË 23.09.1975 "MBI NDËRRIMIN E EMRAVE DHE TË MBIEMRAVE TË PAPËRSHTATSHËM"

Me qëllim që të ruhen dhe të forcohen traditat kulturore përparimtare dhe të vihen emra e mbiemra me përmbajtje të shëndoshë politike, ideologjike e morale, në mbështetje të nenit 58, pika 6 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë

Vendosi:

Neni 1. Shtetasit që kanë emra të papërshtatshëm në vështrimin politik, ideologjik e moral si edhe mbiemra përçmues, detyrohen t'i ndërrojnë.

Neni 2. Kërkesa për ndërrimin e emrave të papërshtatshëm dhe të mbiemrave përçmues dhe zgjedhja e emrit dhe e mbiemrit të ri bëhet nga vetë i interesuari dhe, për fëmijët e mitur, nga prindërit, kujdestarët, adoptuesit ose nga institucioni shtetëror, brenda afatit që caktohet nga zyra e gjendjes civile. Kur kërkesa nuk paraqitet brenda afatit të caktuar, ndërrimi i emrit dhe i mbiemrit bëhet mbi propozimin e organizatave shoqërore. Vendimi për ndërrimin e emrave të papërshtatshëm dhe të mbiemrave përçmues merret nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit përkatës. Ndërrimi i emrave të papërshtatshëm dhe i mbiemrave përçmues duhet të përfundojë deri më 31 dhjetor 1976.

Neni 3. Nëpunësi i gjendjes civile nuk lejohet të regjistrojë lindjen e fëmijës, së cilës deklaruesi kërkon t'i verë emër të papërshtatshëm në vështrimin politik, ideologjik e moral. Me kalimin e afatit 30 ditor, regjistri i lindjeve bëhet, me vendim të këshillit popullor ose komitetit ekzekutiv të fshatit të bashkuar, të qytetit dhe për Tiranën me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të lagjes, ku kanë vendbanimin prindërit, duke i vënë fëmijës një emër të përshtatshëm.

Neni 4. Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në "Gazetën Zyrtare".

Për presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë

Haxhi Lleshi — Kryetari

Telo Mezini — Sekretari

BURIME ARKIVORE

-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 12, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 20, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 41, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 43, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 48, viti 1945.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 103, viti 1947.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 149, viti 1947.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 151, viti 1947.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1455, viti 1947.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 155, viti 1948.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 217, viti 1948.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 218, viti 1948.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 220, viti 1949.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 228, viti 1949.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 290, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 291, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 292, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 293, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 295, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 306, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 356, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 357, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 373, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1467, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1468, viti 1950.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 461, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 462, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 465, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1470, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1471, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 4633, viti 1951.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 594, viti 1953.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 66878, viti 1954.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 691, viti 1955.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 746, viti 1955.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 894, viti 1957.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 895, viti 1957.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 946, viti 1959.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 995, viti 1959.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1005, viti 1959.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1011, viti 1960.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1047, viti 1960.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1056, viti 1960.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1227, viti 1964.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja Nr. 1228, viti 1964.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1333, viti 1966.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1334, viti 1966.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1365, viti 1967.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1367, viti 1967.

-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1372, viti 1967.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 536, Dosja nr. 1382, viti 1967.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 647, Dosja nr. 206, fl. 1-2.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 32, viti 1958, fl.12.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 74, viti 1960.
-Arkivi Qendror i Shtetit, Kisha Ortodokse Autoqefale, Fondi 79, Dosja Nr. 275, viti 1967.
-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosja Nr. 4783-A, Theofan Popa.
-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328. Theofan Popa
-Këshilli i Ministrave, Dosja Nr. 1150, viti 1958.
-Ministria e Drejtësisë, regjistër i gjendjes gjyqësore, Nr. Prot. 2896, 2307, 3612.
-Ministria e Shtypit, Propagandës dhe kulturës Popullore, Dosja Nr. 128, viti 1945.
-Ministria e Financave, Dosja Nr. 457, viti 1946.

Dekret-ligje

-*Dekret-Ligjë mbi formimin e Komunitetet Fetare*, Korçë, 1929, në “Fletorja Zyrtare”, Nr. 38, 16 korrik 1929, faqe 1-3.
-Dekretligji Nr. 743, datë 26.11.1949 “Mbi komunitetet fetare”.
-Dekreti Nr. 1065, datë 4 maj 1950, i Presidiumit të Kuvendit Popullor për aprovimin e Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
-Dekreti Nr. 3030, datë 21 janar 1960, i Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi ndryshimin e paragrafit të dytë të Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, 1960.
-Dekret Nr. 3660, datë 10.04.1963 “Mbi disa ndryshime në dekretin Nr. 743, datë 26.11.1949 Mbi komunitetet fetare”
-Dekret Nr. 4337, datë 13.11.1967 “Mbi çfuqizimin e disa dekreteve”
-Dekret-ligjë nr. 253, datë 27 maj 1946, mbi disa ndryshime të Ligjës e Shtojcë-Ligjeve të Reformës Agrare, neni, 2, 3, botuar në Gazetën Zyrtare, nr. 50, Tiranë, 4 qershor 1946, faqe 5.
-Dekret Nr. 5339, datë 23.09.1975 "Mbi ndërrimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm".
-Fletorja Zyrtare, nr. 38, 16 korrik 1929.
-Fletorja Zyrtare, nr. 45, 14 gusht 1929.
-Gazeta Zyrtare, nr. 8, 23 shkurt 1950.
-Gazeta Zyrtare, nr. 38, 21 qershor 1950.
-Ligj Nr. 5506, datë 28.12.1976, Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, neni 37.
-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Korçë, 1929, në “Fletorja Zyrtare”, 14 gusht 1929.
-*Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë 1950, në “Gazeta Zyrtare”, Nr. 38, Tiranë, 21 qershor 1950.
-Rregullore mbi Administrimin e Përgjithshëm të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Mihal Duri, Tiranë, 1955.
-Rezolucioni i Kongresit III-të të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, mbajtur në Tiranë më 5-10 shkurt 1950, Tiranë 1950.

KOLEKSIONE

-Koleksioni i gazetave "Ngjallja", botim i K.O.A.Sh-it, (1992-2019)
-Koleksioni i revistave "Kisha Kombëtare", Shtypshkronja Dielli, Tiranë (1930)
-Koleksioni i revistave "Predikimi", Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë (1933-1940)
-Koleksioni i revistave "Jeta Kristiane", Shtypshkronja Gutenberg, Tiranë (1940-1944)
-Koleksioni i revistave "Tempulli", Shtypshkronja Kotti, Korçë (2000-2019)
-Koleksioni i revistave "Kërkim", Shtypshkronja Ngjallja, Tiranë (2009-2019)

BIBLIOGRAFI

-Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, (Monografi), Trifon Xhagjika, Tiranë 2019.
-Andrea Llukani, *Krishterimi në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2014.
-Andrea Llukani, *Një nga ata*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
-Andrea Llukani, *Onomastika e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2012.
-Andrea Llukani, *Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e kombit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
-Andrea Llukani, *Si duhet të jetë episkopi, (Komenti i Letrës së Parë të Timotheut)*, Trifon Xhagjika, Tiranë, 2010.
-Andrea Llukani, *Si kusari thërres, komenti i liturgjisë hyjnore të Joan Gojartit*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2010.
-Andrea Llukani, *Enciklopedia e krishterë*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
-Andrea Llukani, *Kanonet dhe statutet e Kishës Ortodokse*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2011.
-Andrea Llukani, *Toleranca ndërfetare në Shqipëri*, Trifon Xhagjika, Tiranë 2006.
-*70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993.
-*Arumunët e Shqipërisë, Histori dhe dokumente për figura të shquara historike*, botim i Shoqatës Arumunët e Shqipërisë.
-Apostolou Glavina, *H Orthodhoksi Aftoqefali Eklisia tis Alvanias*, Ipiresia Dhimosievmaton, Thesaloniki 1998.
-Ardit Bido, *Kisha Ortodokse Shqiptare*, UETPRESS, Tiranë, 2016.
-Artan R. Hoxha, *Kisha Ortodokse nën komunizëm*, UETPRESS, Tiranë, 2017.
-Atë Spiro Bulika, *Bariu i mirë (Episkop Kozmai)*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2005.
-Azem Qazimi, *Fjalor i Krishtërimit*, Plejad, Tiranë 2010.
-Azem Qazimi, *Procesi i asgjësimit të fesë në komunizëm*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2012.
-Azem Qazimi, *Komunitetet fetare në Shqipërinë Komuniste*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe pasojave të Komunizmit, Tiranë 2014.
-*Celebrating 100 years 1908-2008*, Albanian Orthodox Archdiocese in Amerika.
-Dionis Papa, *Berati dhe krishterimi*, Jonalda, Berat, 2001.
-Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë, 1992.
-Dhimitër Beduli, *Gjuha shqipe në kishë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.
-Dhimitër Beduli, Vlash Dhora, Kostandin Mara, *Shënime për bashkësinë ortodokse të Tiranës*, Nereida, Tiranë 2007.
-Dhimitër Beduli, *Kishë dhe kulturë*, Instituti i dialogut dhe komunikimit, Tiranë 2006.
-Dhori Qiriazi, *Krishterimi në Shqipëri*, Argeta LMG, Tiranë 2000.
-Efthim Dodona, *Noli i panjohur*, Shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë 1996.
-Edvin E. Jacques, *Shqiptarët*, Vëllimi parë, Katë e pendë, Stamboll 1995.
-Fan S. Noli, *Autobiografia*, Tiranë 1994.
-Fan S. Noli, *Vepra II*, Zgjedhur dhe përgatitur nga prof. Nasho Jorgaqi, Dudaj, Tiranë 2003.
-*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008.
-Foti Cici, *Midis shqiptarësisë dhe grekësisë*, Globus R, Tiranë 2006.
-Frederik Stamati, *Për flamujt e Muzeut Kombëtar*, Streha, Tiranë, 2019.
-Ilia Zaka, *Kisha e Shën Spiridhonit dhe veprimtaritë kishtare në Berat*, Berat 2009.
-Ilir Ikonomi, *Pavarësia. Udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, Tiranë, 2012.
-Ines Angeli Murzaku, *Returning Home to Rome, the basilian monks of Grottaferrata in Albania*, Grottaferrata, 2009.
-Jakov Moskonisiou, *Shërbesë e kënduar e shenjtit hieromartir të lavdëruar Astit, Episkopit të Durrësit*, Kostandinopojë 1918.
-*Mbrojtja e monumenteve*, "8 Nëntori", Tiranë 1974.
-Melsi Labi, *Gjon Vladimiri, princi që u bë shenjt*, MHK, Tiranë, 2015.

-Melsi Labi, *Joan Vladimir, the prince that became saint*, MHK, Tirana 2016.
-Mehmet Gëzhilli, *Fan S. Noli*, Argeta LMG, Tiranë 2003.
-Nasi Hobdari, Llazar Pjeshkazini, Lekë Tasi, *Ringjallja e kishës së Ungjillëzimit në Tiranë*, Maluka, Tiranë 2007.
-Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, Ombra GVG, Tiranë 2005.
-Naun Kule, *Rrëfimet e Ardenicës*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1999.
-Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë 2004.
-Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare*, Tiranë 2003.
-Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, *Na flet Visarion Xhuvani*, Tekno Paper, Tiranë 2008.
-Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, Kristalina-KH, Tiranë 2012.
-Kastriot Dervishi, *Burgjet dhe kampet e Shqipërisë komuniste*, Instituti i Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2015.
-Koço Tasi, *Shqiptarëvet të Krishten bashkëpunëtorë të Muhamendanëvet*, Athinë 1929.
-Kristofor Beduli, *Dhimitër Beduli bir i zgjedhur dhe i përkushtuar i kishës sonë*, Ngjallja, Tiranë 2015.
-Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000.
-Kristofor Beduli, *Shkollat Teologjike-Hieratike*, Neraida, Tiranë 2001.
-Kristofor Beduli, *At Marko Papajani dhe shënimet e tij*, Neraida, Tiranë 2004.
-Kristofor Beduli, *Saqellar atë Petro Doçi*, Neraida, Tiranë 2006.
-Ksenofin Ilia, *Kishat e Beratit*, Ombra GVG, Tiranë 2006.
-Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës*, Toena, Tiranë 2010.
-*Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Nëntor 1912-Janar 1914*, përpunuar e redaktuar nga Dhimitër Kotini, Xhavit Struga, Fane Veizi, Mediha Shuteriqi, Kleanthi Dedi, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore, Tiranë, 1963.
-Riçard Vurmbrand, *Përgjigje Biblës së Moskës*, Kreuzlingen 1993.
-Roberto Maroco dela Roca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri*, Elena Gjika, Tiranë 1994.
-Robert Agustin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, Tiranë 2000.
-Rune Ottosen, *Turist në utopi*, Skanderbeg Books, Tiranë 2018.
-Stavri Çipi, *Histori e gojëdhëna për Shën Joan Vladimirin*, Tiranë, 2016.
-Sotir Melka, *Dëmet e riteve dhe festave fetare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1967.
-Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Phoenix, Londër 1966.
-Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Maluka, Tiranë 2007.
-Tomor Aliko, *Genocide in the intellectual elite od the Albanian nation under the communist terror*, Maluka, Tirana 2007.
-*Trashëgimia kulturore, akte ligjore dhe nënligjore*, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Tiranë 2003.
-Valbona Karakaçi, *Himni kombëtar i shqiptarëve*, Naimi, Tiranë, 2009.
-Vasil Kaskadami, *Theofan Popa një misionar i kohës*, Apostoliqi Dhiakonia, Athinë 2000.
-Visarion Xhuvani, *Kujtim vepre dhe intrige*, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa I, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
-Visarion Xhuvani, *Çashtje politiko-religjoze Kostandinopoli-Tiranë*, Pjesa II, shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
-*Visarion Xhuvani, në kishë, në parlament dhe në burg*, Vepra, botimet 55, Tiranë 2007.
-Zoi Xoxa, *Kujtimet e një gazetari*, botimet 55, Tiranë 2007.
-Xhafer Sadiku, *Skenarë të përgjakur, (Përmeti 1943-1990)*, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë 2016.

ARTIKUJ
NË REVISTA SHKENCORE DHE GAZETA

-*Aktiviteti i shqiptarëvet në Rumani*, Dituria, Nr.3, 1 janar 1927, faqe 87-89.

-Alqi Jani, *Papapano Gjirokastra-figurë e shquar e kishës shqiptare*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë,* Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 88-92.

-Alqi Jani, *Të njohim dhe nderojmë klerikët e Kishës Ortodokse të Shqipërisë: Episkopi Eugjen Hoshteva*, Republika, 27 maj 2009, faqe 14-15.

-Andrea Llukani, *Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse*, 55, 21 maj 2004, faqe 18.

-Andrea Llukani, *Mesha e parë në gjuhën shqipe*, Le Radici, Anno 10, nr. 2, Aprile 2012, pagina 8, 16.

-Andrea Llukani, Hasan Aliaj, *Il movimento Unita in Albania*, Le Radici, Anno 5, nr. 4, Ottobre 2007, pagina 1, 3.

-Andrea Llukani, *Historiku i kishës së Shën Prokopit*, Le Radici, Anno 15, n.3, Giugno 2017, pagina 17.

-Andrea Llukani, *Kontributi i teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, Le Radici, Anno 15, n.5, Dicembre 2017, pagina 8.

-Andrea Llukani, *Dosja e teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 93.

-Andrea Llukani, *Ndihmesa e Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Dritëhije Nr. 1, Tiranë 2018, faqe 66-87.

-Andromaqi Gjergji, *Reflekse të krishterimit në kulturën popullore,* Tempulli, Nr. 4, Korçë 2001, faqe 10-12.

-Apostol Kotani, *Ndërtimi i Pallatit të Kulturës me miratimin e mitropolitit të qytetit dhe të këshillit kishtar,* Sot, 1 nëntor 2013, faqe 12.

-Arben Gjata, *Kisha e Fjetja e Hyjlindëses së Përmbishenjtë Mari*, Tempulli, Nr. 4, Korçë 2001, faqe 25.

-Arben Gjata, *Kisha e Shën Gjergjit*, Tempulli, Nr. 8, Korçë 2003, faqe 14-15.

-Arben Gjata, *Kisha e Profetit Ilia*, Tempulli, Nr. 10, Korçë 2005, faqe 16.

-*Ata që punuan për kishën tonë. Imzot Spiro Papa*, Ngjallja, korrik 2008, faqe 11.

-Atë Spiro Bulika, *Xha Petroja nga Qeparoi*, Ngjallja, korrik 2002, faqe 9-10.

-Atë Stavri Çipi, *At Spiro Veli, shembull i një kleriku të devotshëm*, Ngjallja, qershor 2005, faqe 9.

-*Atë Dhimitër Kokoneshi, figurë e shquar e fesë dhe kombit*, Mokra, fletëpalosje e botuar me sponsorizimin e Znj. Zografa Kokthit, mbesës së At Dhimitër Kokoneshit.

-Ben Andoni, *Pronat e klerit. Lista e pasurive të katër komuniteteve fetare*, Java, 7 shtator 2013, faqe 7-9.

-Ben Andoni, *Lista e pasurive të katër komuniteteve fetare*, Tema, 12 shtator 2013, faqe 10-11.

-Beqir Meta, *Peshkopi Marko Lipa hedh në gjyq Katedralen e Bostonit*, Metropol, 22 shkurt 2005, faqe 27.

-Beqir Meta, *Grekët, fushatë politike për kishën ortodokse shqiptare në Amerikë*, Metropol, 26 janar 2005, faqe 27.

-*Çaste nga persekutimi ateist*, Ngjallja, shkurt 2019, faqe 9.

-Danish Bebeziqi, *Si e njoha Peshkopin Irine*, Vegim Drite, Nr.4, Qershor 1997, faqe 25.

-Dashnor Kaloçi, *Si e manipuluan komunistët Kishën Ortodokse Shqiptare*, Gazeta Shqiptare, 1 maj 2002, faqe 12-13.

-Dashnor Kaloçi, Genta Popa, *Viti 1967, kur Tirana zyrtare i shpalli luftë Zotit*, Shqip, 9 dhjetor 2007, faqe 18-19.

-*Deklaratë e Kryepiskopit të gjithë Shqipërisë Paisi mbi vizitën në Bashkimin Sovjetik*, Bashkimi, 10 shtator 1949, faqe 3.

-Dion Tushi, *Joakim Martiniani*, Kërkim, Nr. 6, Tiranë 2010, faqe 59-62.

-Dion Tushi, *Pjesë monografie për Evllogjio Kurillën*, Tempulli, Nr. 14, Korçë 2009, faqe 70-75.

-*Disa klerikë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë që u ekzekutuan, u persekutuan dhe vuajtën në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së regjimit ateist komunist (1943-1990)*, Ngjallja, dhjetor 2014, faqe 3-4.
-Dorela Paci, *1967, si u zëvendësuan ritet fetare me festat socialiste*, Standard 3 dhjetor 2007, faqe 10.
-Dhimtër Beduli, *Theofan Popa - teolog dhe studiues i denjë i kishës dhe i kombit*, Ngjallja, janar 1995, faqe 6,8.
-Dhimitër Beduli, *Teologë me origjinë shqiptare që janë diplomuar në Institutin Teologjik të Halkit*, Ngjallja, tetor 1996, faqe 10.
-Dhimitër Qosja, *50 vjet nga stuhia ateiste që u përpoq të shkatërronte besimin*, Ngjallja, shkurt 2017, faqe 1, 3.
-*Enveri, vendimi që hoqi festën e Bajramit dhe Pashkët*, Metropol, 7 shkurt 2005, faqe 27.
-*Fjalimi që solli revolucionin kulturor kinez në Shqipëri*, 55, 5 shkurt 2007, faqe 16-17.
-Ilia Spiro Vasili, *Si e gjeta Episkopin Jerotheos*, Ngjallja, gusht 1996, faqe 9.
-Ilia Spiro Vasili, *Jeta dhe veprimtaria e dhespotit Jerotheos*, Ngjallja, maj 2003, faqe 9,10.
-*Irine Banushi-martir i Kishës sonë Orthodhokse*, Ngjallja, nëntor 2018, faqe 9.
-Fatmira Rama, *Sinodi i parë shqiptar dhe Kongresi i Dytë Paortodoks i Kishës Autoqefale Kombëtare*, në në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 60-68.
-Kaliopi Naska, *Kongresi themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 10-20.
-Kastriot Dervishi, *Visarion Xhuvani: Problemet e mëdha të Shqipërisë*, 55, 28 dhjetor 2005, faqe 12-13.
-Kastriot Dervishi, *Fjalimi që solli revolucionin kulturor kinez në Shqipëri*, 55, 5 shkurt 2007, faqe 16-17.
-Kastriot Dervishi, *Kur kërkohej krijimi i një feje komuniste*, 55, 25 tetor 2005, faqe 12-13.
-Kastriot Dervishi, *Fjalori i emrave të papërshtatshëm në Shqipëri*, 55, 9 shkurt 2012, faqe 16, 17.
-Kastriot Dervishi, *Kishat e shkatërruara orthodhokse në Mitropolinë e Beratit*, Kërkim, Nr. 15, Tiranë 2017, faqe 82-91.
-*Kisha e shkatërruar e Shën Gjergjit, Korçë*, Ngjallja, dhjetor 2016, faqe 10.
-Koço Bihiku, *Themelimi i Kishës Ortodokse Kombëtare dhe roli i Nolit*, *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 29-35.
-Kozma Sovjani, *Të thëna...të pathëna...të përsëritura. Konstatime, konkluzione*, Ngjallja, mars 2017, faqe 6-7.
-Kristaq Prifti, *The Albanian Autocephalous Orthodox Church. A Brief History (1922-1992)*, në *70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e shkencave, Tiranë 1993, faqe 93-103.
-Kristofor Beduli, *Psaltët Vlash Nushi e Vlash Semini*, Ngjallja, gusht 1997, faqe 8.
-Leonard Veizi, *Zbatimi i platformës marksiste mbi shkatërrimin e fesë*, Ballkan, 9 shtator 2005, faqe 14-15.
-Leonard Veizi, *Udhëzimet e Ramizit për festat e reja*, Dita, 9 mars 2005, faqe 14-15.
-Leonard Veizi, *Projektet "anti-Zot" të Ramiz Alisë*, Dita, 23 mars 2005, faqe 14-15.
-Leonard Veizi, *Si u ngrit propaganda komuniste në luftën e egër kundër besimeve fetare*, Metropol, 2 dhjetor 2007, faqe 16, 17.
-Leonard Veizi, *Udhëzimi i Ramizit: martesat e orientim*, Telegraf, 10 shtator 2008, faqe 10-11.
-*Letra e PPSH, synetllëku dhe pagëzimi hiqen me vendim*, Metropol, 8 shkurt 2005, faqe 27.
-*Letër e KQ dërguar rretheve, mbi zëvendësimin e praktikave fetare me festat socialiste*, Ballkan, 20 mars 2007, faqe 14-15.
-*Letër e Komitetit Qendror të PPSh drejtuar komiteteve të partisë në rrethe "Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare"*, në "Dokumente kryesore të PPSh", Vëllimi V, 1966-1970, Instituti i Studimeve marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSh, "8 Nëntori", Tiranë 1974.
-Llazi Tona, *Në labirintet e monumenteve kulturore historike të përbotshme*, Mokra, prill 2009, faqe 7.
-*Mbi marëdhëniet midis shtetit dhe kishës*, Bashkimi, 1 dhjetor 1949, faqe 1.
-Mihal Sonellari, *Përkujtimi i ringjalljes së Kishës në ditën e Ortodoksisë*, Ngjallja, mars 2006, faqe 2.

-Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 5 nëntor 2007, faqe 6.
-Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 6 nëntor 2007, faqe 15.
-Myzafer Berberi, *Visarion Xhuvani-teolog dhe patriot i shquar i ndërgjegjes kombëtare*, 55, 7 nëntor 2007, faqe 6.
-Nasi Hobdari, *Liturgjia e parë Hyjnore, në kishën e shndërruar në palestër*, Ngjallja, prill 2006, faqe 9.
-Nasi Hobdari, Lekë Tasi, *5-vjetori i Liturgjisë së parë*, Ngjallja, prill 2006, faqe 10.
-Nasi Hobdari, *Nderim për psaltin Petro Ketri*, Ngjallja, prill 2002, faqe 2.
-Nasho Jorgaqi, *Fan Noli në ditët e fundit*, Shekulli, 11 mars 2005, faqe 18-19.
-Nasho Jorgaqi, *Të vërtetat e mia për Fan Nolin*, Klan, 14 shkurt 1999, faqe 48-49.
-Nina Smirnova, *Noli refuzon kërkesën e Enverit për ndihmë politike*, Metropol, 11 mars 2005, faqe 27.
-*Në kathedralen orthodhokse të Kryeqytetit u zhvillua mesha kryepiskopale e kryesuar nga Krye-Hirësia e tij, Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë Pasisi Vodica*, Bashkimi, 30 gusht 1949, faqe 3, 4.
-*Në Tiranë u çel Kongresi i Kishës Orthodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1,2.
-Nasho Jorgaqi, *Fan Noli në ditët e fundit*, Shekulli, 11 mars 2005, faqe 18-19.
-*Ndërroi jetë kryetari i parë i këshillave kishtarë pas monizmit z. Sotir Bambuli*, Ngjallja, qershor 2019, faqe 11.
-Nos Xhuvani, *Visarion Xhuvani*, Ngjallja, prill 1998, faqe 10.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Imzot Visarion Xhuvani për Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, 55, 6 tetor 2004, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Imzot Visarion Xhuvani për Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, 55, 6 tetor 2004, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Imzot Visarion Xhuvani për Kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, 55, 7 tetor 2004, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si nisi lëvizja për shqiptarizimin e kishës ortodokse autoqefale*, Tema, 10 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si betoheshin episkopët e kishës ortodokse shqiptare*, Tema, 12 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Patriarkana e Stambollit bekon Kongresin e Beratit*, Tema, 13 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si erdhi fronëzimi i Fan Nolit si Peshkop i Durrësit*, Tema, 14 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Kisha Ortodokse Shqiptare dhe Patriarkana e Kostandinopojës*, Tema, 15 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *1929, si u krijua Sinodi i parë i KOASh-it*, Tema, 16 prill 2005, faqe 9.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Historia e fshehur e Kongresit të dytë të KOASh-it*, Tema, 5-6 qershor 2005, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si zgjidhej kryepeshkopi ortodoks në bazë të Statutit*, Tema, 7 qershor 2005, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Kryetari i KOASh Visarion Xhuvani shpjegon statutin*, Tema, 8 qershor 2005, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Çfarë parashikonte Rregullorja e KOASh-it*, Tema, 9 qershor 2005, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Roli i Mbretit Zog në krijimin e KOASh-it*, Tema, 10 qershor 2005, faqe 12-13.
-Nos Xhuvani & Pavli Haxhillazi, *Si reaguan grekët kundër autoqefalisë shqiptare*, Tema, 11 qershor 2005, faqe 12-13.

-Olimbi Velaj, *Shqipëria, më 44 me 300 priftërinj, më 92 vetëm 30*, Metropol, 2 nëntor 2006, faqe 8.
-Olimbi Velaj, *Klerikët një konferencë si vëllezërit moskovitë*, Metropol, 30 tetor 2006, faqe 18-19.
-Olimbi Velaj, *Klerikët një konferencë si vëllezërit moskovitë*, Metropol, 31 tetor 2006, faqe 22.
-Orfea Beci, *Orthodhoksi i çliruar, sepse u ngjall*, Kërkim, Nr.9, Tiranë, 2012, faqe 81-90.
-*Pas klerikëve, Enver Hoxha diskriminoi pakicat kombëtare*, Albania, 9 mars 2005, faqe 11.
-Pavli Haxhillazi, *Kontributi i harruar i Visarion Xhuvanit për gjuhën dhe kishën shqiptare*, tema, 16 qershor 2004, faqe 8-9.
-Peshkopi Nikon, *Zhurnal Moskovskoj Patriarhij*, Nr. 9, shtator 1951.
-Petrika Shalësi, *Dokumente që provojnë pronësi të Kishës*, Ngjallja, korrik 1996, faqe 12.
-*Përshëndetja e përfaqësonjësit të Qeverisë Shokut Adil Çarçani*, Bashkimi, 8 shkurt 1950, faqe 1.
-Pilo Peristeri, *Vdiq Dhimitër Kokoneshi*, Bashkimi, 19 tetor 1973, faqe 2.
-Pirro Thomo, *Konseguent deri në fund në bindjet e tij*, Ngjallja, prill 2002, faqe 3.
-Pirro Kondili, *Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste*, Ngjallja, gusht 2007, faqe 3-4.
-Pirro Kondili, *Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste*, Ngjallja, shtator 2007, faqe 3-4.
-Pirro Kondili, *Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste*, Ngjallja, tetor 2007, faqe 3-4.
-Pirro Kondili, *Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste*, Ngjallja, nwntor 2007, faqe 3-4.
-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Ngjallja, shtator 2019, faqe 9-10.
-Pirro Kondili, *Orthodhoksia: burim qëndrese dhe shprehje lirie në Shqipërinë komuniste*, Kërkim, nr.16, Tiranë, 2019, faqe 52-72.
-*Raport informativ për rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e saj të mëtejshëm*, Ngjallja, mars 2018, faqe 5.
-*Si i pushkatuan 250 klerikët Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu*, Albania, 9 mars 2005, faqe 10-11.
-*Si e liberalizoi Ramiz Alia të drejtën e besimit në vitin 1990*, Albania, 4 tetor 2007, faqe 19.
-Skifter Këlliçi, *Noli në kujtimet e Sejfulla Malëshovës dhe Reshat Këlliçit*, Koha Konë, 21 mars 2005, faqe 10-11.
-Sotir Bambuli, *Në vitin 1990 ra këmbana në Shën Marinë e Boboshticës*, Ngjallja, tetor 2000, faqe 2.
-Sotir Bambuli, *Lajmërim*, Koha, 31 maj 1991.
-Sotir Bambuli, *17 mars-Liturgjia e parë në Korçë*, Ngjallja, prill 1996, faqe 10.
-Spiro Mëhilli, *Ndalimi i fesë: Stalini rrafshoi katedralet, Enveri u vuri dinamitin*, Telegraf, 23 shkurt 2011, faqe 18.
-*Stalini-Enverit, Popullit shqiptar të mos i dhunohet feja*, Shekulli, 8 nëntor 2005, faqe 21.
-Stefanaq Pollo, *Problemi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare gjatë Rilindjes, 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 21-28.
-*Takimi i fundit i Fan Nolit me shqiptarët*, Sot, 6 dhjetor 2002, faqe 15.
-*Takimi i parë i këshillave kishtarë të vendit tonë pas fitimit të lirisë fetare*, Ngjallja, mars 2019, faqe 12.
-Thimi Lapi, *Një përvjetor domethënës i kishës së ringjallur*, Ngjallja, mars 2006, faqe 9-10.
-Vangjel Xoxe, Ilia Zaka, *Spiro Theodhor Papa*, Ngjallja, dhjetor 1999, fq. 9-10.
-*Veprimet e fundit Patriarkale dhe Sinodike të Kishës së Kostandinopojës*, Orthodhoksia, Kostandinopojë, viti XII, 1937.
-Viron Koka, *Përpjekjet për njohjen e Kishës Ortodokse Autoqefale nga Patriarkana (vitet 20-30), 70-vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë*, Akademia e Shkencave, Tiranë 1993, faqe 69-74.

TABELA E ILUSTRIMEVE

HYRJE

Fig.1. Imzot Theofan Noli
Fig.2. Imzot Visarion Xhuvani
Fig.3. Atë Vangjel Çamçe
Fig.4. Atë Vasil Marku
Fig.5. Delegatët e Kongresit të Beratit
Fig.6. Çertifikatë që u është dhënë delegatëve
Fig.7. Statuti i Kongresit të Beratit
Fig.8. Hirësia e Tij Jerotheu
Fig.9. Hirësia e Tij Kristofori
Fig.10. Dorëzimi Fan Nolit në gradën episkopale (Viti 1923)
Fig.11. Sinodi i Visarion Xhuvanit (Viti 1929)
Fig.12. Visarion Xhuvani
Fig.13. Agathangjel Çamçe
Fig.14. Thanas Ambrosi
Fig.15. Viktori i Cetinjës
Fig.16. Kongresi i Korçës (Viti 1929)
Fig.17. Kongresi i Korçës (Viti 1929)
Fig.18. Dekretligji për komunitetet fetare (1929)
Fig.19. Statuti i vitti 1929
Fig.20. Sinodi i vitit 1937
Fig.21. Evllogjio Kurilla
Fig.22. Pandelejmon Kotoko

KREU I PARË
KISHA NË DIKTATURË
(1945-1967)

Fig.1. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e Kotokos
Fig.2. Letra e Visarion Xhuvanit
Fig.3. Agathangjeli Zëvendëson Kotokon
Fig.4. Irine Banushi, Episkop i Strugës
Fig.5. Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve të K.O.A.Sh-it
Fig.6. Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarioni
Fig.7. Kujdestarët e kishave të Libofshës akuzojnë Visarionin
Fig.8. Kujdestarët e kishave të Libofshës akuzojnë Visarionin
Fig.9. Visarioni merr në dorëzim akuzat kundër tij
Fig.10. Sinodi i Shenjtë i komunikon akuzat Visarionit
Fig.11. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi
Fig.12. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi

Fig.13. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik
Fig.14. Ikonostasi i kishës kishën Uspjesku ku kurorëzoheshin carët e Rusisë
Fig.15. Intervista që dha Paskal Vodica në selinë e Patriarkanës së Rusisë
Fig.16. Delegatët e Kongresit III të vitit 1950
Fig.17. Delegatët e Kongresit III të vitit 1950
Fig.18. Rezolucioni i Kongresit III të vitit 1950
Fig.19. Dekretin Nr. 1065 datë 4 Maj 1950
Fig.20. Rregullorja e Administrimit të Përgjithshëm
Fig.21. Koka e shkresave zyrtare
Fig.22. Sinodi i Shenjtë i vitit 1952
Fig.23. Imzot Pasisi Vodica, Kryeepiskop
Fig.24. Imzot Damjani, Episkop i Gjirokastrës
Fig.25. Sofron Borova episkop ndihmës
Fig.26. Filothe Duni, episkop i Korçës
Fig.27. Qirill Naslazi, episkop i Beratit
Fig.28. Episkopi i Apolonisë Dhanil Çuli
Fig.29. Mitropoliti i Beratit Spiridhon Papa
Fig.30. Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryeepiskop
Fig.31. Kisha e Shën Gjergjit, Boston
Fig.32. Kisha e Joan Pagëzorit, Boston
Fig.33. Fan Noli me veshje episkopale
Fig.34. Dorëzimi i Stefan Laskos

KREU I DYTË
PERSEKUTIMI I KISHËS
(1967-1990)

Fig.1. Visarion Xhuvani në manastirin e Shijonit, Elbasan
Fig.2. Çështje politiko-religjoze
Fig.3. Shërbesa e Gjon Vladimirit
Fig.4. Irine Banushi në manastirin e Ardenicës
Fig.5. Atë Gjergj Suli
Fig.6. Theofan Popa
Fig.7. Leja për të mbledhur ikonat
Fig.8. Theofan Popa me familjen
Fig.9. Atë Kozma Qirjo
Fig.10. Imzot Joan Pelushi
Fig.11. Motrat Cico
Fig.12. Atë Marko Papajani
Fig.13. Dhimitër Beduli
Fig.14. Atë Petro Doçi, Spiro Findiku, Dhimitër Beduli, atë Marko, Theofan Popa

KREU I TRETË
RINGJALLJA E KISHËS
(1990-1991)

Fig.1. Nasi Hobdari
Fig.2. Llazar Pjeshkazini
Fig.3. Kisha e Ungjillëzimit, Tiranë (Viti 1991)
Fig.4. Kisha e Ungjillëzimit e kthyer në palestër
Fig.5. Kisha e Ungjillëzimit pas rikonstruksionit
Fig.6. Nismëtarët e rihapjes së kishës së Ungjillëzimit
Fig.7. Atë Artur Liolin në Shqipëri (Viti 1991)

Fig.1. Imzot Theofan Noli

Fig.2. Imzot Visarion Xhuvani

Fig.3. Atë Vangjel Çamçe

Fig.4. Atë Vasil Marku

Fig.5. Delegatët e Kongresit të Beratit

Fig.6. Çertifikatë që u është dhënë delegatëve

Statuti i Kishës Shqiptare

Neni 1.—Kisha Orthodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë pies e pandarë e të shenjtës Kishë të përgjithshme e Apostolike të gjith Orthodoksvet, përfaqësohet prej terë bancrve të shtetit Shqiptar që i besojnë Krishtit dhë pohojnë simbolin e shenjtë të fesë (Simvolon tis pisteos) dhe pranojmë gjithë sa pranon Kisha e shenjtë e Krishtit Orthodoksë Lindore themelonjësi e Kryet e së cillës asht Zoti e Perëndija jonë Jezu Krishti.

Kjo Kish sundohet prej Episkopësh Kanonik duke rujtë pa ndryshim, si dhe gjith kishat e tjera orthodokse të Krishtit Kanonet e shenjta apostolike e sinodhike si edhe goj-dhënat e shenjta (leras paradhosis).

Neni 2.—Në shtetin Shqiptar parija ma e lartë Kishtare do të jetë sinodhi i përbersëm, i perbërë prej Episkopësh Kanonik nënë Kryesin e nji Mitropoliti. Ky Sinodh do të ketë titullin: Sinodhi i shenjtë i Kishës Orthodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipnia dhe do qëndrojë në Kryeqytet.

Neni 3.—Mitropoliti do zgjidhet nër pes Episkopata tue kjesë të bashkuar me pes Llajkër. Këto Llajkër do zgjidhen në ç' do Episkopatë nga zgjedhësit e dytë të Episkopatavet, dhe zgjedhësit e dytë do të jënë të zgjedhur mbas popullsia në 2000 (dy mij) frymë nji.

Kisha Orthodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë deri sa të mbaroj gjith sa përmbledhë nyja e dytë do të sundohet përkohsisht prej nji Këshillë të përberë prej katër Klerikësh e katër Llaikësh nën kryesin e nji klerikú qi do të ketë titullin Kryetari i Këshillës se lartë Sundimtori të Kishës Orthodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipriës. Kjo Këshillë do të qendrojë në Korçë dhe do të ketë vulën e vet me Kryqin në mes: më dy dega dafin përanësh e rrotull shkronjat:

Këshillat e Lartë e Kishës orthodokse autoqefale Kombëtare 1922.

Neni 4.—Anëtarët klerik të Këshillës së përzier do të jenë ipsofakto zavendës të rregullueshëm të qendrave

Fig.7. Statuti i Kongresit të Beratit

Fig.8. Hirësia e Tij Jerotheu

Fig.9. Hirësia e Tij Kristofori

Fig.10. Dorëzimi Fan Nolit në gradën episkopale (Viti 1923)

Fig.11. Sinodi i Visarion Xhuvanit (Viti 1929)

Fig.12. Visarion Xhuvani

Fig.13. Agathangjel Çamçe

Fig.14. Thanas Ambrosi

Fig.15. Viktori i Cetinjës

Fig.16. Kongresi i Korçës (Viti 1929)

Fig.17. Kongresi i Korçës (Viti 1929)

Vjeti i VIII. Tiranë, e Marte 16 Korrik 1929 Nr. 38

MBRETNIJA SHQIPTARE

Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAJTIMË: për një mot fr.ar 12 në Shqipni ; fr. ar 20 Jashta | Drejtimi: Drejtoria Fletores Zyrtare TIRANË | Një copë e javës fr. ar 0.25: një copë e javës së kalueme fr. ar 1.00

PERMBAJTJA

Dekret-Ligjë mbi Formimin e Komuniteteve Fetare.

Dekret-Ligjë mbi përmirësimin e artikullit 3 të ligjës date 17. IV. 929 mbi monopolizimin e volguri, benzinës etj. Shullet e Gjyqevet.

Dekret-Ligjë
mbi Formimin e Komuniteteve Fetare

Art 1. Çdo njeri në Shqipnie gëzon lirinë e ndergiegjes dhe të fesë qi dishiron; Kjo lirië asht e garantueme me artikujt 5 e 203 të Statutit Themelor të Mbretniës.

Art. 2. Formimi i Komuniteteve bazu që kanë qellim thjeshtë ushtrimin e lirisë së ndergiegjes dhe të besimit, organizimin e ndihmësimin e këtij konvikcioni asht i lejuem si mbas dispozitave të kësaj Dekret-Ligjë.

Art. 3. Komunitetet fetare janë përsona morale, dhe gëzojnë të gjitha të drejtat relative me këtë përsonalitet në konformitet me këtë Dekret-Ligjë dhe me ligjet e tjera të Shtetit; por ato nuk mund të ndjekin qellime politike as drejtë për drejtë, as tërthorazi; gjith-ashtu nuk munden me ushtrue të drejtë gjykimi (juridikcion) për ndi çështje.

Art. 4. Komunitetet fetare quhen të formuema dhe gzojnë të drejtat e akorduema prej ligjes, vetëm kur Statuti i paraqitun prej tyne, aprovohet prej Këshillit Ministruer dhe dekretohet nga Mbreti. Deri në të kryemit e këtyne formaliteteve mbrenda afatit të caktuem prej kësaj Dekret-Ligjë, situata juridike e këtyne rregullohet me ligjet e ms-parshme.

Statuti i një Komuniteti mund t'i paraqitet Qeverin për aprovim mbassi të jetë votuem prej Asamblës ose prej autoritetit kompetent si mbas rregullave kanonike të Komunitetit respektiv.

Art. 5. Çdo Statut i Komunitetit fetare i dekretuem si mas Art. 4 të kësaj Dekret-Ligjë formon detyrim ligjuer dhe zbatimi i tyne sigurohet nga ana e Qeverisë për sa përmetojnë ligjet e Shtetit.

Art. 6. Krytarët e çdo Komuniteti, para se të dekretohen prej Mbretit gjithashtu edhe të gjithë funkcionarët e tjerë para se të legalizohen si mbas Statutit të Komunitetit në të cilin bajnë pjesë, nuk mund të fillojnë edhe t'ushtrojnë detyrat e tyne; për ndryshe si kta ashtu edhe ata që kan qenë të pushuem vazhdojnë t'ushtrim, ndeshkohen si mbas nenit 213 të Kod. Pen.

Art. 7 Krytarët e teve ashtu edhe subalternt imediat të tyre, dhe ndihmësit e zavendësit e kryne duhet të jenë shtetas Shqiptare dhe prej fisit e prej gjithes Shqiptare, të dijnë me shkrue e me këndue lirisht gjuhen zyrtare dhe të jenë në një moshë të paktën 25 vjetsh dhe të mos jenë të njoftum në Shqipnië për vepra antikombëtare.

Sa për Klerin çi pasojnë subalternet immediat, ndihmësit e zavendësit e tyne, duhet të jenë shtetas Shqiptare dhe të mos jenë të njoftum për vepra antikombëtare.

Art. 8 Krytarët e çdo Komuniteti gjithashtu edhe subalternet immediat të tyne, mbassi të zgjidhen në bazë të Statutit të tyne, emnohen me Dekret Mbretnuer.

Posë këtyne mund t'emnohen me Dekret-Mbretnuer edhe funksionarë të tjerë për të cilët Statuti lyp Dekret-Mbretnuer.

Art 9 Komunitetet Fetare janë të lidhuna në Ministrien e Drejtësies dhe të gjitha marrëdhanjet e tyne me Qeverin kryhen me anen e saj, e cilla ka edhe inspektimin e tyne.

Art. 10 Budgetet dhe rregulloret e Komuniteteve nuk mund të hyjnë në fuqië pa u aprovue nga Ministrija e Drejtësis, e cilla në çdo rast ka të drejt të kontrollojë gjendjen e t'ardhunave e të pasunive që zotnojnë këto komunitete, me anen e një Inspektori ose të një Prokurorit të Shtetit, dhe t'u kerkojnë llogarinë, të hetojë dhe menyren e shpenzimeve të bame dhe të vrejë në disponimet e kanuna të

Fig.18. Dekretligji për komunitetet fetare (1929)

Vjeti i VIII. Tiranë, e Merkure 14 Gusht 1929 Nr. 45

MBRETNIJA SHQIPTARE

Fletorja Zyrtare

Botohet prej Ministris së P. të Mbrendshme

PAGUHEM: për nji mot fr.ar 12 në Shqipni ; fr. ar 20 Jashta | Drejtimi: Drejtoria Fletores Zyrtare TIRANË | Nji copë e javës fr. ar 0.25: nji cop e javës së kalueme fr. ar 1.00

PERMBAJTJA

Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipris

STATUTI

i Kishës orthodhokse Autoqefale të Shqipris

Gjithë kleri dhe populli Orthodhoks i Mbretërisë Shqiptare, i përfaqësuar prej Delegatëve fuqiplotë të mbledhur në Kongresin e Dytë që u mbajtë në Korçë, voton me një za statutin definitiv të Kishës Orthodhokse Shqiptare të proklamuar Autoqefale në Kongresin e Beratit me datë 12 Shtator 1922.

Kaptina e I.

Kisha

Art. 1. Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, pjesë e pandarë e së Shenjtës Kishë të Përgjithëshme dhe Apostolike, përbahet prej tërë bashkësive të Mbretërisë Shqipëtare që i besojnë Krishtit dhe pohojnë Simbollin e Shenjtë të Fesë Orthodhodokse (to simvolon tis pisteos) dhe ruan të pandryshme gjith aa pranon Kisha e Shenjtë Lindore e Krishtit, Themelojës e Krye i së cilës është Zoti dhe Perëndia jonë Jisu Krishti.

Art. 2. Kisha Orthodhokse Autoqefale e shqipëris asht e bashkuar dogmatisht dhe shpirtërisht me të gjitha patriarhit e shejta, dhe me Kishat orthodokse autoqefale dhe ruan, pa nonjë ndryshim, si të gjitha Kishat e tjera Orthodokse të Krishtit, burimet e besimit, shkrimet e shënjta dhe gojëdhënat e Hirëshme (Agian Grafin qe Hieran Paradhosin) si dhe kanunet e Shenjta Apostolike dhe Sinodhike.

Art 3. Gjuha zyrtare e Kishës është Shqipja.

Art. 4. Autoriteti ma i naltë i Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqiptare asht Sinodhi i Shënjtë Peshkopal i përbërë prej Peshkopëve aktivë të çdo Dhioqeze, pr.j Ikonomit të Math Mitrofor dhe i krpesuar prej Mitropolitit të Qendrës, Kryepishko,it të gjithë Shqipërisë.

Titulli Zyrtarë i Sinodhit asht: Sinodhi i Shenjtë i kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Peshkopata e Qendrës merr titullin "Mitropoli" dhe titullari i saj quhet Mitropolit i asaj Dhioqeze dhe Kryepeshkop i gjith Shqipërisë, Peshkopët e tjerë mbajnë titullin Peshkop dhe Dhioqezat e tyre Peshkopata.

Art. 5. Kisha Orthodhokse Shiptare është person juridik dhe trashigon të gjith tiujt dhe të drejtat e komunitetevet Orthodhokse të gjer tanishëm.

Kaptina e II.

Sinodhi i Shenjtë dhe detyrat e tija

Art. 6. Sinodhi i Shenjtë: Regullon Kishën Autoqefale të Shqipërisë për sa i pëket besimit, adhurimit (Latria) disiplinës Kishëtare, organizimit dhe administrimit të brendëshëm të Kishës në bazë të dogmave dhe të kanuneve të Shenjta dhe në konformitet me Ligjët e Shtetit;

Ushtron kontrollimin mbi veprimet e Peshkopëve dhe të organeve të Kishës, si pas rregullave Kishëtare; themelon dhe mban Shkolla Fetare;

Harton programet e tyne dhe i mikqyr me anën e Peshkopëve;

Përkujdeset për edukatën fetaro-Kombëtare për kultatën dhe për të krpemit e detyrave të Klerikëve] e të Murgëve;

Kujdeset për edukatën fetare të popullit Orthodoks me anën e predikimeve Kishëtare, të mësimeve Fetare edhe të redaktimit e të botimit të librave dhe të revistave Fetare.

Art. 7. As një libër nuk mund të përdoret në Kishë pa pëlqimin zyrtarë të Sinodhit kështu dhe në shkollë për mësimet e Fesë Orthodhokse pa pëlqimin zyrtarë të Sinodhit dhe të Ministrisë s' Arësimit.

Art. 8. Librat e Kishës që janë përkthyer do të kqyren prej Sinodhit, i cili e ka për detyrë të kujdeset va më shpejt për përkthimin dhe botimin e botimin e atyne librave të Kishës që mungojnë.

Art. 9. Sinodhi i Shenjtë detyrohet

Fig.19. Statuti i vitti 1929

Fig.20. Sinodi i vitit 1937

Fig.21. Evllogjio Kurilla

Fig.22. Pandelejmon Kotoko



QEVERIJA DEMOKRATIKE E SHQIPNIS

MINISTRI E DREJTËSIS

Nr 794

Tiranë, më 19 VI 45 194

7

V.P.L.P.

Kryesis së Sinodhit të Shënjtë
të Kishës Orthodhokse Autoqefale.

T i r a n ë

Gjegje shkresës Nr.236 dt.13.VI.1945
Kjo Ministri mori dijeni mbi pushimin e peshkopit Pandeleimon Kotokos,me vendimin e marë më datë 16 Maj 1945 prej Sinodhit të Shënjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale.

Vendimi i Sinodhit të Shënjtë është me vend,pse i përgjigjet misionit të lartë fetar dhe patriotik t'instituteve t'ona fetare. Kisha Orthodhokse, me të drejtë,nuk mund të tolerontë një peshkop,që ka shvilluar dhe shvillon veprimtari antikombëtare të vazhdonte të mbante titullin e peshkopit të një dioqeze shqiptare.

Qëndrimi i Sinodhit pajtohet plotësisht me fryman dhe me urdhërimet e Statutit të Kishës Orthodhokse si dhe me misionin e shënjtë të Kishës.

M I N I S T R I

Fig.1. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e Kotokos



MITROPOLIA E HIRËSHME
E
BERATIT-VLONËS DHE MYZEQESË

Berat, më _____ 194

Nr. _____

— 3 —

shkuarnim sinodhikisht Qeverisë, në ilëndo re-
gjim që ka kaluar Shqipnija deri sot, tue i kujtuar
kësaj kompetencën e shkarkimit nga detyra Peshkopale
e Gjinokastrës të Peshkopit Pandeleimon, në bazë
të statutit në fuqi të Kishës s'onë. Mitropoliti
i Beratit, Vlonës dhe Myzeqesë, Visarion.»

Lutës ndaj Lotit
Mitropoliti

MITROPOLIA E SHËRITIT
FJER

Fig.2. Letra e Visarion Xhuvanit



6

Pes kopi i Korçës Imzot Agathangjel deri sa të gjendet një Titullar
i përshtatshëm për t'u emnuar n'atë.

Anëtarët.

Kryetar i Kishës Orth.Autoqefale
Kryepiskop'i gjithë Shqipërisë
Kristofor.

Episkopi i Korçës dhe Zëven.i Gjinokastrës
† Agathangjel

Fig.3. Agathangjeli Zëvendëson Kotokon



SINODHI I SHENJT I KISHES ORTH.AUTOQEFALE
TË SHQIPËRISË

Mbledhje e parë.-

V E N D I M

Sot,më 4 Korrik 1945 në Selin e Kryesis së Kishës Orth.Autoqefale u-mbloth Sinodhi i Shenjt i Kishës nëmë kryesin e Kr.H.Tij Kryepiskopit të Gjith Shqipnis Imzot Kristofor dhe me antarë H.H.T.T. Mitropolitin e Beratit-Vlorës Im.Vissarionin dhe Episkopin e Korçës dhe Zëvëndës i Përgjithëshëm i Gjirokastrës Im.Agathangjelit.

U-muar në bisedim çështja e H.Tij Im.Irineut,episkop i Strugës. Kryetari Kr.H;Tij Im.Kristofori deklaroi se H. e Tij Imzot Irineu ka qenë emëruar me vendim të Sinodhit episkop i Strugës,por gjer më sot dekreti qeveritar s'qe e mundur të dalë;me gjith këtë Sinodhi i Shenjt vendosi që H.e Tij të marë pjesë si antar i Sinodhit me cilësin si episkop i Strugës.

KRYETAR I SINODHIT TË SHENJT
KRYEPISKOPI KRISTOFOR

A N T A R Ë T:

Mitropolit i Beratit dhe i Vlorës
V i s s a r i o n .....

Episkop i Korçës dhe Zëv.i Për. i Gjirokastrës
A g a t h a n g j e l.....

Pas vendimit të mësipërmë u-thir për të marë pjesë si antar i i Sinodhit H. e Tij Episkop Irineu.

Kr. H. e Tij Kryepiskopi,si përshëndeti n'emër të Sinodhit të Shenjt H.e Tij Episkopin Irine duke theksuar se Shenjtëria e Tij ka për të dhënë,si antar i Sinodhit,gjith kontributin e tij,në zgjidhjen e problemeve q'i përkasin Kishës, i bëri një përshkrim të shkurtër Sinodhit të Shent rreth vdekjes dhe varrimit të të ndjerit Episkop të Prizrenit Serafim,mik i zinqert i Shqipërisë, dhe të kujdesjevet që Kryesia e Kishës ka treguar gjat kohës së qëndrimit të tij në Tiranë.

Përmendi pastaj ngjarjen gazmore të njohjes së Autoqefalësë së Kishës Orthodhokse të Bulgarisë nga ana e Patriarhisë Ekumenike, të çdukjes së konfliktit që ekzistonte qysh prej 75 vjetësh mërmjet të dy Kishavet si edhe të zgjedhjes së Mitropolitit të Sofjes Stefa

Fig.4. Irine Banushi, Episkop i Strugës



Fig.5. Lidhja e teologëve dhe e seminaristëve të K.O.A.Sh-it

Fig.6. Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Myzeqesë, Imzot Visarioni



Kopje

Deklaratë

Neve të nënëshkruarit kujdestarët dhe anëtarët të Kishës së Libof-
shës deklaroim se i kemi dhënë Mitropolitit të Beratit me iponim 1 një
teneqe djathë që kostoj fr.shq. 260.40 xdhe dy karoqe fasule për
nga 40 fraga..... " " 80.- tetdhjet fraga sh.
që bëjnë shumën.....340.40 treqint e dyzet e dyzet qin.
pra lëshojm këtë Deklaratë për ku t'i a lypë nevoja.

Libofshë 8/3/945

Antar Sekretar
At Josifi d.v.

Antar
Uan Como d.v.

Kujdestarët Kishavet të Li-
bofshës
Themi Gore d.v.
Gaq Prifti d.v.

Fig.7. Kujdestarët e kishave të Libofshës akuzojnë Visarionin



Kopje

Deklaratë

Neve të nënëshkruarit Kujdestar dhe arkëtar para efimerit
At Joan Kullës me foroë dhe me shtërgat të madhe,Mitropolit i Beratit
na ka marë fr.ar 300 treqint se për se nuku dim.
Vërtetojm dhe nënëshkruajm

Libofshë 8/3/945

Efimeri
At Joani d.v.

Arkëtari
Themi Prento d.v.

Kujdestar i Kishës Shgj.
Libofshës
Gaq Prifti d.v.

Fig.8. Kujdestarët e kishave të Libofshës akuzojnë Visarionin

SINODHI I SHENJT I KISHES ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
TE SHQIPERISË

Mbledhje e datës 11 Korrik 1945

Me datën e sipërme u-këndua përpara Sinodhit land
akuzimevet më datë 10.VII. 1945 dhe me Nr.Prot. 272, kundër Mitro
politit të Beratit Imzot Vissarion, u-aprovua dhe u-vendos që
t'i komunikohet të përmendurit. Këto akuzime janë po ato që u-bënë
kundra tij më 6 të këtij muaji në mbledhjen e Sinodhit të Shenjt
të Kishës Orthodhokse Autoqefale dhe në prezencën e të akuzuarit.

Kryetari i Sinodhit

A n t a r ë t:

Episkop i Korçës dhe Zëv.Përgj. i
Gjirokastrës Agathangjel.....

Episkop Irineu.....

Fig.9. Visarioni merr në dorëzim akuzat kundër tij

V ë r t e t i m

I nënëshkruari Mitropolit i Beratit Visarion vërtetoj se
morra në dorëzim prej Sekretarit të Kryesis së Kishës Dhimitër
Bedulit shkresën Nr 272/I, dt 10.VII.1945, prej 4 faqesh që për-
mban landën e akuzimevet kundër Personit t'im.

Mitropolit i Beratit

Tiranë më 11.VII.1945

Fig.10. Sinodi i Shenjtë i komunikon akuzat Visarionit

Fig.11. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi

Fig.12. Titullar i dioqezës së Gjirokastrës Irine Banushi

Fig.13. Delegacioni zyrtar në Bashkimin Sovjetik

Fig.14. Ikonostasi i kishës kishën Uspjesku ku kurorëzoheshin carët e Rusisë



V. P. L.P.

Korçë më 2o.II.1948

KRYESHIRËSISË TJI.

Kryepiskopit Kristofor

T I R A N Ë

Bashkëmbyllur kemi nderin tju dërgojmë kopjen e një interviste zyrtare që me datë 13.I.948.dhe ora 6.p.pas me 6 dite që është mbajtur në celinë të patriarhisë Moskës,midis fenkcionarëve te lartë të patriarhisë Ruse dhe delegacionit kishetar të Shqipërisë.

Me gjithë që neve nuku ishim pregatitur,edhe ndofta nuk i kemi bërë përgjigjet ekzakte.Po këtu nuku është faji tone,kur se neve nuk na u dha ne një udhëzim,ose stamistik kë.Si do qjofte unë pas mejtimit tem dhe të shkëvet këto përgjigje dhame.

Prandaj për dheni ju a dërgojme që ne çdo rast të je te në dieninë tuaj.

Mbetemi në bekimet TUAJA
Zëvend.i përgjithëshme i Episko
patës Korçës
(Arhim.Paskço Vodiva)

Fig.15. Intervista që dha Paskal Vodica në selinë e Patriarkanës së Rusisë

Fig.16. Delegatët e Kongresit III të vitit 1950

Fig.17. Delegatët e Kongresit III të vitit 1950



Fig.18. Rezolucioni i Kongresit III të vitit 1950



VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

21 QERSHOR Nr. 38 1950

PËRMBAJTJE

1. Dekret Nr. 1065 datë 4.5.950 mbi aprovimin e Statutit të Kishës orthodokse Autoqefale të Shqipërisë F. 2 —19

2. Shkurtim vendime e Fiesa F. 19—20

Fig.19. Dekretin Nr. 1065 datë 4 Maj 1950



Fig.20. Rregullorja e Administrimit të Përgjithshëm



Fig.21. Koka e shkresave zyrtare

Fig.22. Sinodi i Shenjtë i vitit 1952

Fig.23. Imzot Pasisi Vodica, Kryeepiskop

Fig.24. Imzot Damjani, Episkop i Gjirokastrës

Fig.25. Sofron Borova episkop ndihmës

Fig.26. Filothe Duni, episkop i Korçës

Fig.27. Qirill Naslazi, episkop i Beratit

Fig.28. Episkopi i Apolonisë Dhanil Çuli

Fig.29. Mitropoliti i Beratit Spiridhon Papa



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE
E SHQIPNIS
KKYESIA
E
SINODHIT TË SHENJTË

ADMINISTRATA

Nr. 24/11 Prot.

Tiranë, më 14/3/ 1966

EPISKOPATAVE TË HIRËSHME DHE
GJITHË ZËVËNDËSIVE MITROPOLITANE DHE
EPISKOPALE.-

QARKORE

Kemi nderin t'ju njoftojmë se Sinodhi i Shëntë i Kishës s'onë, në mbledhjen e tij të posaçme me datë 7 Mars 1966, vendosi unanimisht dhe zgjodhi për Kryetar të Kishës Orthodhokse Autoqefale dhe Kryepiskop të gjithë Shqipërisë, Hirësinë e tij Episkopin e Gjirokastrës Dhamiano, i cili, po në mbështetje të vendimit të lartpërmëndur të Sinodhit të Shënjtë, do të mbajë përkohësisht edhe drejtimin e Episkopatës së hirëshme të Gjirokastrës, si Ad Interim.

Duke u mbështetur në faktin e lartpërmëndur, porositen titullarët e episkopatave të hirëshme dhe titullarët e kleri mvartës i zëvëndësive

./.

Fig.30. Qarkore nr. 24/11, datë 14 mars 1966, Damjani Kryeepiskop



Fig.31. Kisha e Shën Gjergjit, Boston

Fig.32. Kisha e Joan Pagëzorit, Boston

Fig.33. Fan Noli me veshje episkopale

Fig.34. Dorëzimi i Stefan Laskos

Fig.1. Visarion Xhuvani në manastirin e Shijonit, Elbasan



15. MAJ 1920

Çashtie politiko-religjoze

KONSTANDINOPOLI-TIRANË

P R E J :

EPISKOPIT VISSARION XHUVANNIT.

Theolog me Diplomë i Universitetit t' Athinës

Ish Senator i Elbasanit dhe ish Deputet i Durrsit

Botohet me rastin e bisedimevet përkatse qi janë tyke u bamë kto ditt në Tiranë.

BOTOHET NË DY PJESË

Landa e Pjesës së I^rë:

1). Kisha Orthodh. Shqiptare dhe Patriarhia e Konstandinopojës
2). Nëritvrja e Patriarhis së Konstandinopojës
3). Episkopët e huajë në Shqipni
4). Gjuha e huajë në Kishë
5). Gjuha e huajë në Shkollat Shqiptare

KOSTON NJI (1) KORONË

TIRANE
Shtypshkronja "Tirana"
1926

Fig.2. Çështje politiko-religjoze

Sherbesa e Shejtë
E
SH' JON VLLADIMIRIT

Çudibarëzit Mbrotit të Ivdhesëhëm dhe dëshmorit të madh.

E perkthyerme dhe e botuerme
Me bekim të
Kryepiskopit të gjith Shqipnis
Krye-Hirsis Tij Emzot D^r VISSARION-it

PJESA E PARË

Sh' Jon Vlladimiri. — Elbasan 1934.

Fig.3. Shërbesa e Gjon Vladimirit



Fig.5. Irine Banushi në manastirin e Ardenicës

Fig.5. Atë Gjergj Suli

Fig.6. Theofan Popa

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS
Instituti i historisë e gjuhësisë
Nr. 65/1 Prot.

Tiranë, më 22/VII/1967

KOMITETET EKZEKUTIV TË RRETHIT
Durrës, Kavajë, Lushnjë, Fier,
Berat, Elbasan, Korçë, Pogradec, Ersekë

Sh. Theofan Popa, beshkëpuntor shkencor i këtij Instituti, po vjen në rrethin tuaj për të dhënë udhëzime në lidhje me grumbullimin e ikonave të kishave dhe të objekteve të tjera të kultit nga kishat që nuk janë shpallur monumente dhe edhe nga familjet.

Lutemi t'i jepen lehtësitë e nevojshme në kryerjen e kësaj detyre.

DREJTORI
(Androkli Kostallari)

Fig.7. Leja për të mbledhur ikonat



Fig.8. Theofan Popa me familjen

Fig.9. Atë Kozma Qirjo

Fig.10. Imzot Joan Pelushi

Fig.11. Motrat Cico

Fig.12. Atë Marko Papajani



Fig.13. Dhimitër Beduli

Fig.14. Atë Petro Doçi, Dhjak Spiro Findiku, Dhimitër Beduli, atë Marko Papajani, Theofan Popa

Fig.1. Nasi Hobdari

Fig.2. Llazar Pjeshkazini

Fig.3. Kisha e Ungjillëzimit, Tiranë (Viti 1991)



Fig.4. Kisha e Ungjillëzimit e kthyer në palestër

Fig.5. Kisha e Ungjillëzimit pas rikonstruksionit

Fig.6. Nismëtarët e rihapjes së kishës së Ungjillëzimit

Fig.7. Atë Artur Liolin në Shqipëri (Viti 1991)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Llukani, Andrea
Redaktor: Hajri Shehu, gjuhëtar.
Kisha në diktaturë (1945-1990)
Andrea Llukani, Tiranë: 2019
250 f, 29 cm.

ISBN